

Dibran Fylli

**HASAN PRISHTINA,
STËRNIP I ABDULLAH VELIQIT**

Ribotimi III

Botues
Shtëpia botuese “ProkultPress”

Redaktor
Prof. Sci. Fatmir Halimi

Lektor
Prof. Asllan Qyqalla

Korrektor
Prof. Abdullah Troshupa

Recensentë:
Akademik Hakif Bajrami
Akademik Flori Bruqi
Prof. Dr. Sulejman Abazi

Përkthyes i dokumenteve arkivore
Bensat PAJAZITI - UZM GmbH

Kopertina-dizajni
Durim Fylli

Radhitja kompjuterike dhe faqosja
uniART Creative
Prishtinë, 2020

© të gjitha të drejtat autori

Dibran Fylli

HASAN PRISHTINA
STËRNIP I ABDULLAH VELIQIT

Monografi

(Ribotimi III)

**PROKULT**
PRESS
Prishtinë, 2020

Na luftojmë, e ndoshta nuk e gëzojmë,
por ata që vinë mbas nesh, kanë me i gjet shejet tona.

Hasan Prishtina

THËNIE TË PAVDEKSHME

”Vetëm fatosat vdesin të pagjunjëzuar dhe pa hequr dorë nga e kaluara!”

Emil Zola

“Unë kam një rrugë të caktuar para mejet, atë kam shkelë dhe atë do të shkelë deri në vdekje, rrugën e independencës ma të plotë të tan Shqipnisë!”

Hasan Prishtina

”Ky trim, biri i Shqipnisë është shembull me veprat e tij i kaq shumë shqiptarëve.”

Josif Bageri

“Fjala e tij, penda e tij si dhe kuleta e tij janë në dispozicion të çështjes kombëtare. Në tribunën e parlamentit ai është Jupiteri që gjëmon dhe ua kthen të tjerëve vetëtimat nga qielli mbi kokën e armiqve të popullit shqiptar!”

Mustafa Asim Kruja

“Në jetë je i detyruar të shkelësh shumë rrugë, por nga njëra nuk guxon të largohesh, kurrë! Ajo është rruga e shqiptarisë që na vie nga Skënderbeu te Hasan Prishtina...!”

Stak Mark Mirdita

“Të njifen zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë; autoritetet civile e ushtarake të kenë kombësi shqiptare; ushtria shqiptare të shërbejë në Shqipëri e të jetë komanda prej oficerëve shqiptarë, veprimet zyrtare në Shqipëri të bëhen në gjuhën shqipe”.

Hasan Prishtina

(korrik - gusht 1912)

“Luftën dhe kundërshtimin ndaj copëtimit do ta ndaloj vetëm kur të çlirohet dhe të bashkohet kombi im. -Dhe, para së gjithash, ruhuni nga mallkimi i historisë dhe mos e harroni atë kur të jepni mendimin tuaj!”

Hasan Prishtina

(Dorë, më 28.11.1912)

“Rroftë atdhetari i shkëlqyer, ky engjëll i Shqipënisë së mjerë! Istoria e kombit tonë me shkronja t'arta, me shkronja të shkëlqyera do të shkruajë ndër faqet e saj shërbimet e mëdha, punët e shënuara, që qëndrojnë sipas çdo lavdimi, të cilat asht tue bâmun deputeti i adhurueshëm ndër deputetët tonë Hasan be Prishtina në fushë atdhësie... brez pas brezi, ati dhe bir pas biri zembrat e djegurata t'atdhetarëve emnin t'uaj kânë me bekuar, dhe një shtat i shkëlqyeshëm, një shtat i mermertë që do të ngrehet për ju, pasi motet të kalojnë, ka me leçitun për para botës së qytetënueme, që një komb i gjithë ju ka detyrë !”

Luigj Gurakuqi,

“Bashkimi i Kombit” (nr. 25-25.11.1910)

NË VEND TË PROLOGUT

MIRË MËNGJESI FLAMUR E SHQIPËRI

Dielli kurrë nuk ka qenë më i bukur mbi Kalanë e Gurit dhe shtëpinë e Hasanit. Thonë kur u lind Hasani edhe hëna bëri më shumë dritë, po edhe yjet shndrisnin më mirë qiellin, Hasani ivogël e kishte mbushur djepin plot me faqe si molla. Rrezet e puthën si një copë krenarie të atdheut. Edhe dritaret edhe oborri morën shumë bukuri, dhomat morën më shumë aromë. Nëna e Hasanit dukej krenare si nëna e Gjon Buzukut dhe Teuta ilire... e puthi djalin e zemrës tri herë në ballë dhe afër djepit ngjyrë gruri ja la një copë lapsi, ndërsa gjyshi që dukej si një vetull mali; Haxhi Ali Veliqi ja la pushkën e gjyshit të gjyshit nga Palaci i Drenicës kreshnike me shekuj dhe epoka.

Thonë në Palac të babës të Hasanit tri ditë e tri net nuk ndaluan këngët dhe krismat. Edhe në Vushtri kënga rriste këngën e Qyqavica përpinte krismat si malet, baladat dhe legjendat. Gjyshi i Hasanit, ende nuk dihet pse e gdhendi emrin Istref?! në kondak të pushkës.

DOKUMENTET TREGOJNË:

Hasan Prishtina-Veliqi ishte mik i luftës dhe i zemrës me trimat e Kurpalëve. Kulla e kurpalëve ishte një kështjellë e pamposhtur që ka hyrë dhe ka mbetur nëpër kujtime e balada.

HISTORIA TREGON:

Një Komandant i huaj hungarez, shumë i lodhur dhe pa gjumë, u kishte thënë banorëve: “Hiqni këtë Kullë të Kurpalëve e shtyjeni më tutje në thellësi, se këtu veç telashe do të keni. Ju djeg e ju përcëllon llava e luftës”. Dervish Kurpali, luftëtar gjithë jetën, iu kishte përgjigjur: “Ne kemi mbirë nga toka bash në këtë vend bashkë me gurë, për me e luajt shtëpinë duhet me luajt krejt toka...”.

Për Kurpalët jeta ishte luftë e përditshme. E Hasan Prishtina kurrë nuk u nda prej tyre nëpër zjarre e furtuna. Hasan Prishtina edhe rrugës edhe maleve u jipte dritë. Hasan një herë lind nana në një mijë vjet. Me Hasan Prishtinën nuk mund të krahasohet askush as si dije as si bimë e atdheut. Krejt jetën dhe pasurinë i shkriu për të gjitha trojet e Ilirisë. Ai shumë e donte lirinë. Gjysmën e zemrës e kishte Kosovë e gjysmën tjetër Shqipëri. Shumë i donte malet dhe fushat e atdheut, e donte Çamërinë dhe detin, e donte Kalanë e Ulqinit dhe Kështjellën e Shkodrës. Shumë i pëlqente uji i Shalës të Bajgorës dhe pemët e Boletinit.

Në Vushtri u rrit si pëllumb i Vlorës.

Shpeshherë u thonte lisave të maleve: JU DUA! I pëlqente shumë plisi i bardhë i Ukshin Kovaçicës së vjetër dhe fjala e drejtë e vizioni i qartë i Hoxhë Rezallës...

As lumi Ibër as lumi Llap as Drini e Luma kurrë nuk e harrojnë...

Një ditë të ftohët dimri, te Kulla e Haxhi Zekës, Azem Shkreli pati thënë:

Qaba sonte për Ty
Arbëri
Nuk më vjen turp
pse qaba
Më vjen turp
pse s'munda
të bëj tjetër
Nga turpi qaba...

As vargjet e Mitrush Kutelit nuk thahen dhe nuk harrohen kurrë:

Atdheu është Atdhe
Bile edhe atëherë kur të vret
Unë jam këtu e do të jem
Denbabaden
Sa mali të bëhet hi
E hiri mal përsëri...

THONË:

Dervish Kurpali tri herë ishte dënuar me vdekje nga Perandoria Osmane. Tri herë ju dogj shtëpia nga barbaria e egër armike. Tri vjet ishte në internim në Gjirokastrë, bashkë me Bajram Kurpalin ishin miqësuar me plumba. Edhe ëndrrat i kishin me krisma. Shpeshherë kishin pirë ujë të ftohtë si akull te Kroi i Veliqëve të Palacit dhe në Vushtrri e në Boletin të Isait.

Hasani shumë e donte vendlindjen e gjyshit dhe të babës. I pëlqente shumë buka e misrit, po edhe kumbullat e bardha. Një grua e moçme e Prekazit i kishte thënë: “I pari i Palacit, Pali, kishte qenë nga Laçi-Pali i Lacit, një kreshnik i madh si Pjetër Shini.

Hasan Prishtina i kishte thënë Sulltanit në Stamboll: “Nëse ende më shtypet populli im, unë me ushtrinë time do ta djeg Ballkanin... Nuk do të durojmë kurrë më të shkelet mbi kurrizin e nipave dhe stërnipave të Skënderbeut”, thonë Sulltanit i kishte ndryshuar gjeografia e fytyrës.

Dihet, Toplica dhe Molla e Kuqe e Hasan Prishtinës ende lotojnë matanë kufirit. Hasan Prishtina duhet të ringjallet dhe të bashkohen të gjitha Trojet shqiptare. Shumë jemi lodhur nga zjarret dhe krismat e gjata. Shumë herë u dogj Palaci i gjyshit të Hasanit, edhe Prekazi i Adem Jasharit e i Tahir Mehës.

Hasan Prishtina shumë herë u thoshte edhe maleve: “Asgjë nuk guxon të hiqet nga trungu i lashtë, ndarje nuk guxon të ketë Iliria sepse ekziston vetëm një flamur me një shqiponjë të cilën e puthi Gjergj Kastrioti në Krujë dhe shumë trima të lirisë nëpër malet shqiptare.

Hasan Prishtina-Veliqi është një copë e madhe e diellit që do të bëjë dritë me shekuj e shekuj, me epoka dhe epoka. Është një roman dhe vepër e madhe e krejt gjeografisë së Atdheut. Ditari i Hasanit është një pjesë Bible me shumë dritë dhe dritare.

-Le të hapet kjo Monografi e vogël për Hasanin e Madh që i gjallë hyri si Prometheus në Përmendore të të gjitha kohërave.

-Le të përsëritet: Hasani e shkriu krejt pasurinë që Kosova të vishet me Këmishë të Dritës.


-Le të shkrihet edhe një copë mali nga një shpirt i madh që ky libër për Hasan Prishtinën, Hasan Kosovën, Hasan Palacin, Hasan Shqipërinë të merrë udhën prej dore në dorë, prej zemre në zemër.

-Mirëmëngjesi Diell, Hasani po bëhet një pjesë e jote!

-Mirëmëngjesi Adem Jashari, edhe ti e kishe Hasan Prishtinën mësues të Artit e të Lirisë!

-Mirëmëngjesi Flamur me dy ngjyra dhe një Shqiponjë!

-Mirëmëngjesi Shqipëri Etnike!



TOKË E DARDANISË

Kjo tokë e ujitur me shira gjaku të trimave ka rritur shumë male dhe lisa gjatë shekujve... Nuk ka mal as fushë, nuk ka kodër as shkëmb, nuk ka lumë as gurinë, nuk ka arë as grykë që nuk është lagur nga gjaku për liri dhe bashkimin e Trojeve Ilire. Një i huaj pati thënë para kalasë të moçme në Vushtrri; Në këtë tokë Martire do të derdhet edhe shumë e shumë gjak...

Kjo tokë që i thonë Dardani, e herë-herë Shqipni, dhe herë-herë Kosovë, i ka të gjitha “fajet”...

E pse - e kishte pyetur një plak me plis të bardhë. Ai ishte përgjigjur dhimbshëm: Sepse korja e këtij dheu fle mbi Flori dhe Dukat...

Po edhe është e bukur. Çdo pëllëmbë fsheh shumëçka përbrenda. Edhe uji edhe dielli, edhe hëna kur bën dritë ka ngjyrë të artë. Lakmia është e madhe. Edhe shiu kur bie është dukat. Edhe këmba ime është e zezë... Sepse shkeli mbi një Tokë të shenjtë Ilire.

Për mua çdo lis është ushtar, çdo Mal dhe Grykë është kështjellë. Dihet, Trepçën, Dukagjinin dhe krejt Llapin dhe Drenicën ka dëshirë ta ketë të veten edhe Djalli i Zi e lëre më të huajt me gjak ujku.

Thuhet Plaku i Urtë atë ditë kishte trokitur në derën e Shtëpisë së Hasan Prishtinës, dhe ia kishte treguar kallëzimin e Shkelësit të huaj. Thonë, Hasani atë ditë kishte qenë duke lexuar “Shkronjëtoren e gjuhës shqipe” të Sami Frashërit, të botuar në vitin 1886 në Bukuresht.

Ende nuk dihet ku është e “fshehur” koj gramatikë që e kishte lexuar edhe rilexuar i ndrituri Hasan Prishtina.

Dihet pak i ka “fajet” Bazeni i qymyrit, pak Bukuria e Grykës së Rugovës, pak Malet e Sharrit, pak Lumi Ibard.^a Dhe shumë më shumë dukati i Trepçës. Por një ditë do të vjen, Kosova do të jetë ashtu siç ishte dikur Shqipëri. Duhet mos ta lëshojmë kurrë pushkën dhe librin prej dore derisa të çlirohet çdo pëllëmbë e të gjitha trojeve shqiptare. Do të derdhet e derdhet shumë gjak...

Por lulet e gjakut dhe të lirisë do të çelin e çelin me aromë dhe ngjyra shumë më të mira. Në fund plaku i tha: Jetofsh sa malet o, Hasan Prishtina!

Ndoshta në ditarin e Hasanit ruhen edhe këto fjalë. Thonë Plaku i Urtë u kishte treguar edhe lisave, çka i kishte thënë i huaji dhe Hasan Prishtina.

Në mbrëmje u kishte treguar edhe Yjeve edhe Hënës.

a) Lumi Ibër - i bardhë-bardhyl-i bardhë

TREGIMI QË PËRCILLET NDËR BREZNI

Plaku i Urtë kishte shkuar në Malet e Kovaçicës dhe të Kaçanollit të Shalës, dhe disa lisa i kishte emërtuar me emrat dhe mbiemrat e Trimave që nuk harrohen kurrë dhe i ruan kujtesa e gjatë e Kohës. Lisin e parë e kishte pagëzuar Azem Bejtë Galica, një lis të trashë me emrin Shotë, lisin e tretë Bajram Curri, lisin e katërt Bajram Sylë Kurpali, një lis tjetër Haxhi Zeka, dhe një tjetër Isa Boletini, dhe ishte ndalur pranë një kroi, Lisin dhe Kroin i kishte pagëzuar Hasan Prishtina.

Kurse një Gurë të zi në një përrua të keq, e kishte emërtuar me emrin dhe mbiemrin e Abdullah Sahit Sheremetit, një tradhtari me sy shkau që e kishte prerë në besë Zymer Faslinë, shokun më të ngushtë dhe më të mirë të fëmijërisë, me të cilin kishte pirë gjakun e njëri-tjetrit dhe ishin vëllazëruar për jetë, gjer në vdekje. Por floriri që iu premtua nga turqit, ia prishi gjakun, dhe në kullë të vet me sakicë të druve e preu copa-copa. Për Zymer Fasliun thonë: sa herë shkonte në luftë fluturonte si Azem Bejta. Këtë pabesi dhe tradhti të shëmtuar nuk do ta harrojë kurrë Toka as Dielli as Historia.

Dhe në fund Plaku i Urtë e pështyn Gurin e zi. Të nesërmen përsëri zuri t'i pagëzojë lisat me emrat dhe mbiemrat e Trimave; Sylejman Vokshi, dhe disa emra të trimave të Kurpalëve. Shumë e shumë lisa të maleve morën emrat e trimave. Në këtë mënyrë Plaku i Urtë vepronte çdo ditë... Fotografinë e Hasan Prishtinës e merrte çdo ditë me vete. Bisedonte me Hasanin si më vëllain e një nëne.

Nanat tona rritën shumë Yje drite që nuk shuhen kurrë, me të ndezur ngjyrë zjarri dhe flake, të cilën kishin faqe dhe gishta për pushkë, fishekët e zemrës i ndanë njëri me tjetrin edhe në luftë edhe në dasma.

Historia e re tash e ka Lapsin e dritës në dorë, as një pikë gjaku e derdhur nuk do të harrohet kurrë. Do të flasë çdo gur e çdo fibulë e lashtë, do të fletë edhe dheu edhe balta, do të rrëfejnë edhe kullat edhe kështjellat... do të ringjallen të zhdukurit, do të ringjallen të vrrarët dhe të pushkatuarit.

Amanet e kemi prej Hasan Prishtinës, mos të pushojmë kurrë në Udhën e Dritës dhe të Lirisë. Libri është dhuratë e Zotit... Shtëpia që nuk ka libra dihet është pa dritë dhe pa dritare.

Mirëmëngjesi përsëri Hasan Prishtina. Ëndrra jote dhe e të gjithë atyre që e deshën Lirinë dhe e duan po merr ngjyrën e Hartës Ilire.

Edhe Çamëria po i çelë lulet e syve të ndarë.

Një ditë do të mbjellim edhe pemë të reja në Toplicë.

Ende i ruajmë farat e Mollës së Kuqe.

**PALACI (PAL-LACI)
HISTORIK I SHKURTËR**



EMRI

Sipas studimeve të deritanishme, emri i fshatit Palac mund të jetë nga fjala latine Palaco-Palato por edhe Palacijum, ose Palata-Palatinus-Palatin, kurse banorët e këtushëm, gjatë proceseve historike kanë bërë që fshatin e tyre ta emërtojnë me emrin Palac. Derisa një e dhënë tjetër del se emri i fshatit Palac mund të jetë nga Pal-Laci (Pali i Laçit).

HISTORIKU

Palaci ka një hapësirë territoriale të gjerë. Kufizohet në perëndim me Skenderajn, në jugperëndim me Kryshefcin, për të vazhduar pastaj me Marinë, Palluzhë, Shtuticë, Dashefc, Baks, Prelofc, Mikushnicë, Prekaz i Epërm dhe Prekaz i Ulët. Në kohën e okupimit serb këtu qenë formuar dy fshatra me kolonistë, Palaci i Ri dhe Kralica, të gjitha këto në prona të shqiptarëve. Kolonët serbomalazias filluan të shpërngulen nga këto fshatra duke kërkuar jetë më të mirë, kurse hovi i madh i këtyre shpërnguljeve ndodhi pas rënies së Rankoviqit, prapë duke ua shitur, për të saten herë, pronat e veta shqiptarëve.

Në fshatin Palac jetojnë mbi 500 familje, duke mos i llogaritur shpërnguljet nëpër qytete të ndryshme të Kosovës dhe jashtë vendit. Palaci ka shtatë lagje: Veliqi, Xani, Koci, Gruda, Hoti, Kabashi dhe Kerolli. Tradicionalisht banorët e këtij fshati kanë kaluar mirë mes veti. Ky fshat njihet për shkollim të hershëm qysh nga viti 1909, mësuesi i parë i këtyre anëve ka qenë Sali Hoti, por njihet edhe për mejtepe e hoxhallarë në zë si: Mulla Ibrahim, Mulla Abdullahu, Mulla Rexhepi, Mulla Jashari etj. Fshati Palac ka dhënë figura të njohura atdhetare kombëtare e patriotike, që nga Hasan Prishtina e deri te shtresa intelektuale e kohës së sotme.

ARKEOLOGJI

Gërmime të mirëfillta arkeologjike nuk janë bërë në Palac dhe nuk mund të thuhet e as të konstatohet saktësisht se kur ka filluar jeta e njerëzve këtu. Nga banorët vendës janë bërë zbulime të rastit (gjatë punimeve të tokës) dhe ato pak gjetje dëshmojnë se jeta ka filluar që në kohën ilire. Në arën e Isuf Xanit (te Kroni i Madh) janë zbuluar themelet e jashtme të kështjellës së Palacit me një madhësi prej 50 X 40 metra. Themelet janë të punuara prej guri me mure të trasha rreth 2 metra. Vetëm 300 metra më larg, në arën e Vehbi Kocit janë gjetur dy amfora, njëra e dëmtuar (e mbushur me dhe) kurse tjetra e ruajtur mirë, kjo e fundit u gjet e zbrazët nën një rrasë guri. Këto amfora janë ruajtur në shtëpinë e Brahim Kocit, por me djegien e shtëpisë nga serbët në luftën e fundit, edhe ato u zhdukën pa gjurmë.

ANTIKË

Kroi që ndodhet ne lagjen Veliqi-Veliu, nuk dihet saktësisht se në cilin vit është ndërtuar, por ajo që dihet është se me dekada të tëra banorët e kësaj lagjeje, barinjtë dhe bagëtia e tyre, kalimtarët e viseve të ndryshme që kanë udhëtuar këtë rrugë kanë shuar etjen në këtë krua, ajo që botërisht dihet është se ky krua ka bërë të pashtershëm uji, si dhe uji i këtij kroi shquhet për cilësi të lartë.¹



Kroi i Lagjes Veliqi në Palac

MONUMENTE KULTURORE-FETARE

Monumentet e para fetare - xhamitë në Drenicë janë ngritur në Krajkovë, Plluzhinë dhe në Palac. Pas pranimit të besimit islam, banorët e Palacit qysh në vitin 1662, ndërtuan xhaminë e parë në këtë fshat. E njëjta është meremetuar në vitin 1799. Gjatë luftës së fundit, kjo xhami, monument i vjetër kulturor e fetar, u granatua dhe u dëmtua në masë të madhe nga forcat serbe, por sërish është rindërtuar. Afër xhamisë ka qenë ndërtuar edhe mejtep, ku kanë vijuar mësimet shumë breza, jo vetëm nga Palaci por edhe nga fshatrat përreth.²

¹ Halil Xani, "Palaci dje, sot, nesër..."; të dhëna për autorin.

² Vehbi Koci; të dhëna për autorin.

TROJET E LASHTA

Duke u bazuar në rrëfimet e Rexhep Veliqit, i cili së bashku me Habib Kukiqin kishin shërbyer për 14 vite rojë e afërt dhe ndër më të besuarit e Hasan Prishtinës, po paraqesim një argument plus për vendin se ku ka qenë trualli i Haxhi Ali Veliqit, gjyshit të Hasan Prishtinës-Veliqit. Vendi dhe kujtesa e shumë qytetarëve të Lagjes Veliqi edhe sot e asaj dite janë të ditura botërisht, të vërtetuara saktësisht dhe të njohura historikisht për të parët dhe trungun familjar të Hasan Prishtinës.

“Ne na kanë treguar të parët tanë dhe këtë se luan as topi, sado që mundohen ta shtrembërojnë këtë fakt e kanë të kotë, se trualli i të parëve të Hasan Begut ka qenë këtu ku po e shohim, bile në mes truallit ndodhet edhe një pus (bunar). Këtë ma ka thënë me qindra herë babai im Rexhepi, ai kur fliste për Hasan Beun, edhe qante nga mallëngjimi. Babai e kishte pas dashur vërtet Hasanin, këtë më së miri e tregon fakti se ai i kishte qëndruar besnik Hasan Prishtinës për 14 vite bashkë me Habib Kukiqin e Tërstenikut, bile Habibin shokët e kishin pas quajtur “Dragoi i Hasan Begut”.


Më kujtohet njëherë i pata treguar babait se një shok nga Mikushnica e kishte një këngë të mirë për Hasan Prishtinën, ai më tha: “Çou bre bir e shkojmë ta dëgjoj...” Shkuam me qerre të kuajve në Mikushnicë dhe pasi e dëgjoj këngën, edhe pse ishte natë, prapë u kthyem në Palac.³




Palac - Lagja Veliqi. Vendi ku ka ekzistuar trualli i Avdullah Veliqit

³) Zeqir Rexhep Veliqi, Palac, shënime familjare, janar 2013; të dhëna për autorin

Unë e mbaj mend lagjen e Veliqve kur i ka pasur vetëm 14 shtëpi (diku në vitin 1943/'44), kurse nëna e Plakut tim, gjithja ime, kur ka ardhur nuse këtu, kjo lagje ka qenë me vetëm 4 shtëpi (diku viti 1923/'24), thotë Zeqiri.



Rexhep Veliqi



Zeqir Rexhep Veliqi



Në odën e Zeqir Rexhep Veliqit në Palac, 2013

LEGJENDË

Legjenda thotë se dikur moti nga ky liqe dilte një vashë si zanë mali. Ajo kishte një ka (dem) të pashëm, të fuqishëm dhe në dyluftim me ata të fshatit gjithmonë dilte fitimtare. Një bari i vë kaut të tij gjilpëra në brirë dhe në një dyluftim me kaun e vashës-zanë mali, kau i bariut del fitimtar. Ajo, nga inati zhytet në liqe me vaj e gjëmë dhe më nuk duket në sipërfaqe. Legjenda më tej thotë se banorët e afërt, marrin aksion dhe e mbyllin burimin e liqenit me lloj-lloj materialesh, sepse u bënte dëm fushave me të mbjella. Pas asaj mbylljeje të liqenit, shpërthejnë tri kroje në tri fshatrat e afërta. Viteve të fundit ky liqe pati shteruar fare, këtij dimri prapë është akumuluar ujë, por për fat të keq peshq nuk ka.⁴



L'keni i Palacit



Palaci sot

⁴Halil Xani, "Polaci dje, sot, nesër..."; të dhëna për autorin

ARSIMI DHE SHKOLLA

Shkolla e parë shqipe në fshatin Palac është hapur më 5 maj 1909. Shkolla ka nisur punën në plemen e Dan Kerollit, kurse dimrit edhe në odën e tij (oda e Danit). Shkolla është hapur me kërkesën e patriotit Hasan Prishtina, i cili ishte me origjinë nga ky fshat dhe familja e tij ishte këtu deri më 1771, kur u shpërngul në Vushtri. Pas ripushtimit nga Mbretëria SKS shkolla shqipe këtu u mbyll dhe u hap shkolla në gjuhën serbe, më 1927, ku mësonin serbët dhe malazezt kolonistë dhe formuan dy fshatra të reja në pronat e shqiptarëve të Palacit. Mësimet në këtë shkollë i ndoqën edhe disa nxënës shqiptarë, si: Sheremet Koca, Mursel Koca, Hetem Xani, Vehbi Veliqi, Dan Xani, Istref Koca, Fazli Koca, Kadri Koca e të tjerë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore prapë filloi mësimi në gjuhën shqipe. Mësues ishte Sylejman Strazha nga Shijaku i Shqipërisë. Në vitin 1946, mësues i parë ishte Sali Rexhep Hoti nga Palaci, kurse pastaj erdhën edhe Halil Krasniqi, Rrahim Gashi, Bajram Gashi, Zeqir Zena, Zenel Sheqirolli nga Peja, Shaqir Uka, Engjëll Berisha nga Peja, Kajtaz Rreci, Lah Azemi e tjerë.

Deri në vitin 1964 shkolla ka punuar në Polac të Ri, ku vijonin mësimet edhe nxënës nga Shtutica, Dashefci, Kryshefci, Marina e Polaci. Nga viti 1964 mësimi vazhdoi në shkollën e re në Polac.

Më 1970, bëhet shkollë e plotë fillore. Kjo shkollë përherë është dalluar për suksese të larta në mësim dhe aktivitete të tjera.⁵



Nxënësit e shkollës së Palacit me arsimtarët, viti shkollor 1961/'62

⁵Avdullah Memish Koci, veteran i arsimit; shënime historike.; të dhëna për autorin

HISTORIA E DREJTË NGA SHPIRTI I POPULLIT

Bilall Koci, arsimtar, aktor i teatrit dhe filmit, nga Palaci, është një aktivist i çështjes kombëtare, shënues i mirë i kujtesës historike të popullit, i cili shpeshherë e thotë se; “Historia më e drejtë është ajo që del nga shpirti i popullit”. Ai ka të evidentuara në fletoret e tij shumë ngjarje historike e sidomos për arsimin shqip. Sipas shënimeve të tij, shkolla e parë shqipe në Palac është hapur në vitin 1909, bile në përrurimin e kësaj shkolle, i madhi Hasan Prishtina kishte sjellur bendin muzikor nga Vushtrria.

Fshati Palac mund të merret si fshat përparimtar në Komunën e Skënderajt, kurse shkolla e Palacit ka një traditë të lashtë si në cilësinë e mësimdhënies ashtu edhe në cilësinë e mësimnxënies. Palaci tani është i stolitur me plot intelektualë të sferave të ndryshme, si nga mjekësia, inxhinierë të profileve të ndryshme, specialistë të mjekësisë, anesteziologë, poetë, gazetarë, juristë të shkallës së lartë etj.

Palaci, në krahasim me kohën e pas Luftës së Dytë Botërore, ka bërë hapa të suksesshëm në arsimimin e gjeneratave të shumta. Të rinjtë e fshatit Palac për shkollim kanë qenë të motivuar nga ideologu i shkollave shqipe, i madhi Hasan Prishtina, i cili sipas shënimeve të Bilall Kocit, të parët e Hasanit trungun familjar e kishin nga Lagjja Veliqi dhe pikërisht kjo ishte një shtytje më shumë që të shkollohen të rinjtë e këtij fshati. Hasan Prishtina ishte simbol i arsimit shqip jo vetëm i Palacit por i të gjithë Kosovës dhe gjithë trojeve shqiptare.⁶



Shkolla e fshatit Palac (2013)

⁶Shënime nga kujtesa e popullit, Bilall Koci, arsimtar; të dhëna për autorin

PËR HASAN PRISHTINËN

Për prejardhjen dhe për gjenealogjinë e Hasan Prishtinës kam filluar të interesohej nga fundi i viteve të 60-ta të shekullit të 20-të, në të gjitha arkivat shtetërore të Jugosllavisë, të Vjenës, të Tiranës e të Shkodrës. E kam shënuar Kujtesën historike në Drenicë e në të gjitha viset e Kosovës, në Shkup, Tiranë e në Shkodër. Dhe si në burime, ashtu edhe në Kujtesën historike Hasan Prishtina, thuhet se rrjedh nga Vëllazëria stërgjyshore VELIQI të Palacit të Drenicës. Gjyshi i Hasan Prishtinës, Haxhi Ali Berisha del se e trashëgoi emrin e gjyshit të vet Ali Veliqit. Sipas kujtesës historike, të ndjekur me kujdes, një familje nga Vëllazëria e Veliqëve shkoi në Mikushnicë (fshat i afërm), e cila me kohë do të quhet Manxholl (nga turqishtja bijtë e MAN-it-ardhacak)

Prof. Dr. Muhamet Pirraku

Për një kohë, emri dhe vepra e të madhit Hasan Prishtina, qenë mbuluar me pluhurin e harresës. Madje, deri në vitin 1962, nga organet zyrtare shqiptare ai cilësohej si “tradhtar” i kombit. Në vitin 1977, eshtrat e tij u sollën nga Selaniku në Shqipëri. Ata u varrosën në Varrezat e Dëshmorëve, në Kukës. Me dekret presidencial nr. 435, datë 26.01.1993, atdhetari dhe luftëtari Hasan Prishtina është dekoruar me Urdhrin e Lirisë të Klasit të Parë, me këtë motivacion:

“Udhëheqës dhe organizator i shquar i kryengritjeve gjithëkombëtare për pavarësinë që sollën krijimin e shtetit shqiptar në vitin 1912”.

Në Kosovë puna qëndroi më ndryshe. Patriotin demokrat, Hasan Prishtina, populli e mbajti në mendje e në zemër. Mirëpo, pushteti antipopullor sllavo-komunist e anatemoi dhe e ndaloi dhunshëm emrin dhe bustet e tij nëpër shkolla e institucione të tjera.


Dibran Fylli, regjisor

-“Jam shumë i sigurt se po të kishte qenë gruaja e Hasanit, Igballja me të, në asnjë mënyrë nuk do të ishte vrarë Hasani, sepse ajo ka qenë shumë vigjilente dhe asnjëherë nuk ka shkuar pa revole. Ajo, atij tradhtarit të Zogut, kishte me ja shkrep para se ai t’ia shkrepnte Hasanit!”

-“Unë nuk kam asgjë kundër askujt që kontribuon për shtatoret dhe veprën e Hasan Prishtinës, por mos të ëndërojnë kush që do të mund ta blejë Hakanin me pare e ta shtrembërojë historinë e një njeriu aq të madh siç ishte Hasan Prishtina...Na nuk mund të durojmë më, jemi shumë të zhgënjyer me këto veprime që ndodhin sot...”

Hakan Berisha

HASAN PRISHTINA
STËRNIP I ABDULLAH VELIQIT



Mua në idenë teme patriotike nuk ka must as nuk do të mund me më
shtrve ari i të tanë botës, por as mënia e të tanë anmiqvet.



Ka me më shtrve vetëm vdekja!

Hasan Prishtina


SIPAS KUJTESËS HISTORIKE

Për prejardhjen dhe për gjenealogjinë e Hasan Prishtinës, historiani Prof. Dr. Muhamet Pirraku ka filluar të interesohet nga fundi i viteve të 60- ta të shekullit të 20-të, në të gjitha arkivat shtetërore të Jugosllavisë, të Vjenës, të Tiranës e të Shkodrës. Ai ka shënuar Kujtesën historike në Drenicë e në të gjitha viset e Kosovës, në Shkup, Tiranë e në Shkodër. Dhe, si në burime, ashtu edhe në kujtesën historike Hasan Prishtina, thuhet se rrjedh nga Vëllazëria stërgjyshore VELIQI të Palacit të Drenicës.

Gjurmëve të këtyre burimeve, më 24 prill 1977, duke i pasur me vete pleqtë më në zë të Palacit ka shkuar në “Varret e Katunit” te “L’keni”, ku janë të varrosur barqet e fisit Berishë nga “Paganizmi”, të varrosur në drejtimin jug-lindje. Aty i ka hyrë leximit të “Nishaneve”, dhe në vendin “Krye vorreve” afër një lisi shekullor e ka gjetur të vdekurin që i diktonte Kujtesën historike, Katragjyshin dhe Pestagjyshin e Hasan Prishtinës. Për fat u ruajt Blloku nr. 5 i shënimeve të 24 prillit 1977. Në Gurin e Varrit shkruan: **“El-mehrum vel-magfur Abdull-llah bin Ali, ruhiçyn elfatiha, sene 1213”**, shkrim ky që i përgjigjet vitit 1798.⁷




Dshifrimi i shkrimit-epitafit në gurin e varrit të Abdullah Berishës - Veliqit



Prof. Dr. Muhamet Pirraku gjatë deshifrit të shkrimit në gurin e varrit të Abdullah Veliqit, katragjyshit të Hasan Prishtinës

⁷ Prof. Dr. Muhamet Pirraku, Shënime nga blloku nr.5, burim i cituar.

Gjyshi i Hasan Prishtinës, Haxhi Ali Berisha del se e trashëgoi emrin e gjyshit të vet Ali Veliqit. Sipas kujtesës historike të ndjekur me kujdes një familje nga Vëllazëria e Veliqëve shkoi në Mikushnicë (fshat i afërm), e cila me kohë do të quhet Manxholl (nga turqishtja bijtë e MAN-it- ardhacak). Gjyshi i Hasan Prishtinës, Haxhi Ali Berisha u shkëput nga Manxhollët e shkoi në qendrën e “Nahisë” në Vushtrri. Kujtesa historike në Palac, e shënuar më 28 e më 29 qershor 1977, e saktëson pa asnjë dilemë se Rizah Manxholli i Mikushnicës Hasan Prishtinën, e ka një shokë (brez), më afër sesa Veliqët e Palacit. Sipas shumë gjasave, Ali Veliqi, gjyshi i Hasan Prishtinës shkoi në Vushtrri i pamartuar, pak vite pasi i kishte vdekur i ati Abdullahu (1798).



Shaban Manxholli



Hasan Prishtina

Shikimi i fakteve me analizë shkencore tregon se sikur Aliu të kishte qenë i martuar do të ishte ruajtur kujtesa për të bijtë e Haxhi Aliut, si nipa të dikujt në Drenicë. Edhe për faktin se ata u bënë alamet burra të rëndësishë pushtetore e kombëtare, e veçantë tre nipat e Haxhi Ali Berishës: Syleman Aga (*pashë më 1898*), Zejnullah Begu, Vuçiterni e Hasan beg Prishtina, të cilët famën e arritën me mbështetje në lidhje gjaku me Drenicën e jo në lidhje krushqie. Këtu duhet të konstatojmë edhe faktin se së paku nga vitet e 90-ta të shekullit të 19-të pasardhësit e Haxhi Ali Veliqit në burimet konsullore serbe janë quajtur “Shishkoviç”, nga turqishtja “Shishko” që do të thotë (i trashë).


Nëna e Hasan Prishtinës, gruaja e Ahmet Haxhi Ali Veliqit-Berishës ishte Vushtrriase, Nexhibe Haxhi Sallahu (*sipas Fahri Buçinces është quajtur edhe Nexhibe Haxhi Salihu*).

Realisht, Haxhi Ali Veliqi, e dimë nga burimet arkivale se i ka pasur tre djem që kanë pasur trashëgimtarë. Të bijtë e Haxhi Ali Veliqit, kishin miqësi e krushqi me: Mulla Haxhi Zekën (Pejë), me Ali pashë Dragën (Mitrovicë) me Zija pashë Gjinollin (Prishtinë) me Sylejman pashë Berishën-Prishtinën, me të bijtë e Emin Agës (Sllatinë e Moravës së Epërme), me Begollët e Pejës, me Shaban Pashën e Shkupit.

Djali i madh i Haxhi Ali Veliqit, Mehmeti (nuk ishte i martuar me drenicase), ishte haxhi me autoritet, në vitet e 70-ta të shekullit të 19-të, pati pushtet në Rrethin e Vushtrrisë ishte kryetar i Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Vushtri dhe përfaqësues i kësaj dege në Komitetin Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i nënshkruar herë “Haxhiu” e herë Haxhi Mehmet. Sipas kujtesës së zyrtë, të ruajtur në Vushtri, i la djemtë: Sylejman Agën (i cili më 1898 mori gradën “pashë”, vdiq në Vushtri më 1918), Abdurramanin dhe Jusufin (*ishte pashë proturk jetoi e vdiq në Stamboll*) dhe Nefisën e martuar në Vushtri për Haxhi Hysen Aliun).

As djali i dytë i Haxhi Ali Veliqit, Mahmuti (*nuk ishte i martuar me drenicase*), ishte kontraktor në projektin e hekurudhës Mitrovicë-Shkup-Selanik, e përfunduar më 1873. Mahmuti e la Zejnullah beg Vuçiternën, (*ishte rreth shtatë vjet para Hasan Prishtinës*), e mbështetja kryesore e Hasanit, lidhja e parë e tij me vendlindjen stërgjiyshore, Drenicën.

Djali i tretë i Haxhi Ali Veliqit, Ahmeti (1848 - 1919), ishte intelektual, ekonomist. Nga vitet e '60-ta të shekullit XIX e gjejmë furnizues të garnizonit të Selanikut. Ahmet Haxhi Ali Veliqi, i pati tre djem: Hasanin, Ymerin dhe Jakupin (e evidentuar për të parën herë)...⁸



Shënimet nga blloku nr.5

⁸Prof. Dr. Muhamet Piraku; “Gjenealogjia e Hasan Prishtinës”, burim i cituar.

HASAN PRISHTINA TRURI I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Figura më e ndritur e kombit, Hasan Prishtina, dha e shkriu nga vetja, madje edhe jetën, për Shqipërinë e plotë, me Preshevë e Çamëri, me Tivar e Prevezë e deri te Molla e Kuqe. Pra, për një Shqipëri siç e kishte krijuar Zoti.

Më 1771, një plak me emrin Ali, së bashku me familjen e tij, kapërceu kodrat e Galicës dhe zbriti në Vushtrri, atëherë askujt nuk i shkonte ndërmend se nipi i tij do të bëhej aq i madh, sa do ta shkundte Perandorinë Turke në themel dhe do t'u prijë shqiptarëve në luftëra e beteja për çlirim e bashkim kombëtar. Ishte ky Ali Berisha i Palacit të Drenicës, i biri i Abdullah Ali Berishës.

Avdullahu vdiq dhe u varros në Palac, ku edhe sot, në varrezat e Palacit gjendet varri i tij, kurse në hyrje të Lagjes Veliqi ekziston trualli i Avdullah Berishës.

Hasan Prishtina u lind në Vushtrri, në vitin 1873. Deri në vitin 1908 është quajtur Hasan Berisha-Palaci, gjegjësisht Hasan Vuçitërn, kurse prej kur zgjidhet deputet i Prishtinës, nënshkruhet Hasan Prishtina. Hasani qysh në rininë e hershme dukej se ishte kureshtar dhe inteligjent. Mësimet e para i kreu në vendlindje, të mesmet në Selanik dhe Fakultetin e Drejtësisë në Stamboll. Gjatë shkollimit fitoi kulturë të gjerë dhe u brumos me ide revolucionare e përparimtare evropiane. Ai shumë shpejt u bë një erudit i madh, dhe pos shqipes njihje mirë: anglishten, arabishten, frëngjishten, çerkezishten, greqishten, gjermanishten, italishten, serbishten dhe turqishten.

Në kryeqytetin otoman krijoi lidhje të ngushta me bashkatdhetarë të dalluar dhe do të lexojë shpirtërisht veprat e vëllezërve Frashëri, Pashko Vasës, Hoxhë Tahsinit, etj, si dhe do të njihet me veprat e iluministëve francez: Voleterit, Monteskie, Zhan Zhak Rusos, etj.

Ishte inteligjent, i matur, trim e vigjilent me trup mesatar, qëndrim të drejtë e sy fascinues, me shikim dhe zë bindës, me shije për veshmbathje. Fillimisht punoi në administratën perandorake në Stamboll, ku arriti postin e kryekonsullit të shtetit, ku u njoh me mekanizmin dhe nevojat e shtetit si organizëm kombëtar si dhe me kërkesat liridashëse e çlirimtare të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. U vu në shërbim të kombit dhe atdheut të shumëvuajtur. Si i tillë u zgjodh deputet i shqiptarëve nga Prishtina (1908) në parlamentin osman nga ku edhe e mori mbiemrin Prishtina. Deri në vitin 1912 ishte deputeti shqiptar më i zëshmi në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe jo vetëm të këtyre, por edhe të popujve të tjerë pa të drejta. Qe kundërshtari më i rreptë i politikës antishqiptare të xhonturqve. U bë ideologu, udhëheqësi e shpresa e fitoreve të shqipes mbi armiqtë e gjithfarshëm. Ishte bamirës kombëtar, apostull i shkollës shqipe, mendjendritur, shpirtdëlirë, njeri i besës, i fjalës dhe i aksionit revolucionar. Në mbledhjen e "Taksimit" në Stamboll, mori detyrën e organizatorit dhe udhëheqësit të kryengritjes së vitit 1912 në


Kosovë. Me sukses e udhëhoqi atë, duke çliruar Kosovën dhe Shkupin e duke i hapur rrugën Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, që ndodhi në Vlorë më 28 nëntor 1912 nga bashkëmendimtari e bashkëpunëtori i tij, Ismail Qemali. Në Qeverinë e Ismail Qemalit, në mes të mandatit ishte ministër i Bujqësisë dhe Punëve të Brendshme...

VIGAN I PAPËRKULUR


Hasan Prishtina si deputet shqiptar në Parlamentin turk ngriti zërin kundër padrejtësive turke mbi shqiptarët dhe me diskutimet e tij të zjarrta trazuan gjithë Perandorinë. Largpamësinë e tij, për rrezikun që vinte nga Aleanca Ballkanike, turqit nuk donin ta dëgjonin e as ta kuptonin.

Hasan Prishtina është unikat edhe në fushën e arsimit kombëtar. Me nismën e tij u organizua Kongresi i Alfabetit në Manastir (14 - 22 nëntor 1908). Atë vit do të nisë punën edhe Shkolla Normale e Elbasanit, ku do të mësojnë edhe shumë nxënës nga Kosova e nga Dibra, shumica me harxhimet e tij. Kryengritja e Madhe në Kosovë, e vitit 1910, u shua me gjak nga Hilmi Pasha. Kjo e tmerroi Hasan Prishtinën, i cili u ngrit në Parlamentin turk, kërkoi që të shpërndahej menjëherë kabineti i Haki Pashës dhe i bëri me dije për shpërthimin e kryengritjeve shqiptare, në ballë të të cilëve do të printe edhe vetë ai.

Më 5 maj 1912, Hasani, ashtu siç kishte paralajmëruar, doli në Drenicë dhe krerëve të tubuar në Kullë të Ahmet Delisë së Prekazit iu drejtua me një fjalim të zjarrtë, duke i shpallur luftë Turqisë, sepse: " *Më mirë një pushkë në male se një thes fjalë në Parlament*". Besëlidhje dhe tubime të tilla u mbajtën kudo, por Kuvendi i Junikut (21-25 maj 1912), mori vendime për një kryengritje të përgjithshme, duke u dërguar Fuqive të Mëdha Memorandum prej 14 kërkesash, që më vonë do të njihen si; *14 pikat e Hasan Prishtinës*.



Kongresi i Alfabetit, (1908)



Deklarata e Pavarësisë, 1912

AS TOSKË, AS GEGË, POR SHQIPTAR

Hasan Prishtina, i cili ishte Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke parë se 14 kërkesat e tij, të aprovuara në Kuvendin e Junikut, nuk po jetësoheshin nga xhonturqit, ai u vu në ballë të krerëve kryengritës, të cilët pas vetes kishin 30.000 luftëtarë sypatrembur dhe, vendosmërisht, ia mësynë Shkupit. Pasi e çliruan edhe kryeqendrën e Vilajetit, bënë përgatitjet për ta shpallur Pavarësinë e të gjitha Trojeve Etnike Shqiptare, por ngjarjet e kohës morën rrjedhë tjetër.

Nëse luftërat ballkanike për disa popuj ishin fatlume, sepse ua sollën lirinë, për shqiptarët e Kosovës ishin të kobshme, sepse u sollën robëri të re.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Kosova u pushtua nga Serbia dhe Mali i Zi. Shumica e udhëheqësve dhe krerëve të Lëvizjes, në mesin e tyre edhe truri i saj, Hasan Prishtina, ishin burgosur dhe mbajtur për një kohë në burgun e Kalemegdanit në Beograd.

Përkundër masave represive, dhunës e terrorit të mbretërisë SKS, çetat e lirisë, të udhëhequra nga Azem Galica, po vepronin kudo. Ai, bashkë me Hasan Prishtinën, me Hoxhë Kadriun, me Bajram Currin, me Sadik Ramën e me trima të tjerë përgatiteshin për një kryengritje të përgjithshme në Kosovë.

Hasan Prishtina ishte i vendosur në rrugën e tij atdhetare e revolucionare. Ai nuk i trembej vdekjes dhe në letrën që vinte nga Vjena e përfundonte kështu: *“Mua në idenë teme patriotike nuk ka mujt as nuk do të mund me më shtrve ari i të tanë botës, por as mënia e të tanë anmiqvet. Ka me më shtrve vetëm vdekja!”*

Që nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, Hasan Prishtina ishte i brengosur për copëtimin e Trojeve Etnike Shqiptare dhe nuk pushonte së vepruari në rrugën e nderit kombëtar. Ai mori pjesë edhe në përgatitjen e Kongresit të Lushnjës (1920) dhe, që nga prilli i vitit 1921, ishte zgjedhur deputet i Dibrës në Parlamentin Shqiptar.

Më 8 dhjetor 1921, Këshilli i Lartë ia besoi formimin e Qeverisë. Kryeministri i ri, me vizion të qarta të bashkimit kombëtar ai formoi kabinetin gjithëpërfshirës, por, papritur u gjend përpara një situatë të rëndë politike. Kabineti i tij nuk u pëlqye nga opozitarët, zogistët dhe esadistët, andaj që të mos vinte deri te gjakderdhja vëllazë-rore, ai tërhoqet, duke dhënë dorëheqje pas katër ditësh. Ideali i Hasan Prishtinës ishte çlirimi i Kosovës dhe bashkimi i kombit shqiptar. Ai ishte i papajtuëshëmme çdo përpjekje e insinuatë përçarëse, veri-jug, toskë e gegë. Në një fjalim në Parlamentin shqiptar, më 1921, ai deklaroi: *“Unë nuk jam as toskë, as gegë, por jam shqiptar”...*

PSE HASAN PRISHTINA MË 28 NËNTOR 1912
NUK ISHTE NË KUVENDIN E VLORËS?⁹

Çka thonë të dhënat e botuara dhe çka vërtetojnë dokumentet e panjohura deri me tashti lidhur me veprën madhore të Hasan Prishtinës, sidomos në momentin e shpalljes së pavarësisë, tani dihet çdo gjë. Por, pse në të gjitha librat deri në vitin 1962 Hasan Prishtina konsiderohej për “tradhti”, këtë e dinin vetëm miqtë e pushtetit.

Për Hasan Prishtinën edhe para vitit 1981 ishin botuar monografi dhe artikuj nëpër revista dhe gazeta e që kishin një vlerë modeste shkencore. Por më 1983 u mendua se u shënua një kualitet i ri në njohjen e veprës së Hasan Prishtinës, sepse nga Drejtoria e përgjithshme e arkivave të shtetit shqiptar u botua në Tiranë, “Hasan Prishtina, përmbledhje dokumentesh 1908-1934”, përgatitur nga studiuesit: Kujtim Nuro dhe Nezir Bato. Në përmbledhje janë prezantuar 158 dokumente që reflektojnë personazhin eminent patriotik e politik të Hasan Prishtinës. Lidhur me këtë, sipas të dhënave, për Hasan Prishtinën mund të përgatitën edhe katër vëllime dokumentesh të tjera për botim. Dokumentet janë të provinijencave të ndryshme.

Në publikimin e dokumenteve të botuara në Tiranë, më 1983, hulumtuesit i lind një dilemë fundamentale. Si ka mundur Hasan Prishtina të “qëndroj” në Parlamentin e Turqisë në Atamboll më 28 nëntor 1912, kur Ai e dinte fare mirë se do të shpallej Pavarësia e Shqipërisë, i cili për atë ditë kishte jetuar, luftuar dhe ishte shkrirë deri në vdekje. Së këndejmi, duke e njohur karakterin, moralin, veprimin racional të Hasan Prishtinës, duke e njohur sensin politik dhe përkushtimin kombëtar të tij, hulumtuesi e studiuesi Prof. Dr. Hakif Bajrami i hynë një hulumtimi më të thellë, për të vërtetuar se ku ishte me të vërtetë Hasan Prishtina ditën e shpalljes së pavarësisë më 28.XI.1912, përkatësisht prej 2 nëntorit të vitit 1912 e deri më 1 prill 1913.

Për t'u përgjegjur në pyetjen e parashtruar, patjetër duhet të ndalemi të dokumenti nr.42, i botuar në përmbledhjen e sipërshënuar në Tiranë (1983, f.70), “Diskutimi i Hasan Prishtinës në parlamentin turk ku kërkoi shpjegim mbi politikën e brendshme dhe te jashtme nga kryeministri xhonturk-Stamboll 15 nëntor (1328)-28 nëntor 1912”. Sipas këtij dokumenti Hasan Prishtina më 15.XII.1328 (1910) e jo 1912, kishte thënë: “Para se të fillohet me rendin e ditës dëshiroj t'i heq vëmendjen në një pikë mbledhjes së nderuar. Shkëlqesia e tij kryeministri ende nuk ka ardhur që të na japë shpjegime rreth politikës së jashtme dhe të brendshme. Nëse do të vazhdojë kjo gjendje kemi për të kërkuar shumë shpjegime. Kështu që ta dimë, edhe ne e t'i përvishemi kërkimit të shpjegimeve, sepse nga vendi, çdo ditë po marrim telegrame tepër të prekshme dhe tepër pezmatuese. Ato vende që po mbesin, me të vërtetë në zjarrin e

zullumit dhe të despotizmit, po zhduken. Nëse nuk do t'i lexoni deklaratat e tyre të kërkojmë shpjegime”. Në fund të dokumentit shënon se ky shënim është nxjerrë nga procesverbalet e mbledhjes së parlamentit turk më 15 nëntor 1328-28 nëntor 1012, Vëllimi I. f 131 (osmanisht). Për brendinë heuristike dhe hermeneutike të këtij dokumenti kaq delikat dhe kaq kompromitues për patriotin Hasan Prishtina më 1983 në Tiranë nuk jepen kurrfarë shpjegimesh. Autorët e përmbledhjes Kujtim Nuro dhe Nezir Bato për të mos lënë dilema, kanë mundur për t'i prezantuar edhe disa telegrame që shkonin prej viseve shqiptare në Stamboll, gjithnjë duke u përpjekur pse një pjesë e prijësve kosovarë nuk ishte në Vlorë më 28.XI.1912, kur për atë ditë kishin jetuar tërë jetën! Tani lind pyetja pse u bë viti 1328 (sipas hixhrit) pikërisht 28.XI.1912. Kjo datë u përpilua më 1962 nga redaksia Dhimitri Kotini, Xhavit Struga, Fane Veizi, Mediha Shuteriqi, Kleavidhi Dedi. Kjo redaksi nuk e llogariti me saktësi shkencore se viti 1328 (Hixhri) do të thotë viti 1910. Me këtë gabim u përgatit publikimi "Qeveria e Përkohshme e Vlorës...", Tiranë 1963.

Në librin e Dr. Tahir Abdylit, “Hasan Prishtina në lëvizjen demokratike shqiptare 1908-1933”, Prishtinë 1990 f. 172 thuhet: "Seanca e fundit parlamentare, në të cilën Hasan Prishtina mori pjesë dhe diskutoi për fatin e vendit të tij, ishte ajo e datës 28 nëntor 1912, pra e mbajtur atë ditë kur u shpall akti i Pavarësisë së Shqipërisë në Vlore Auloni këtë konstatim e citon prej dokumentit të botuar në Tiranë, më 1081, e ku autorët Kutim Nuro dhe Nezir Bato e vëjnë datë 15 nëntor 1328 (28 XI. 1912) jo datën me të cilën janë bërë diskutimet më 1S.XL1328 (1910) në Parlamentin osman. Nga kjo datë pastaj është “nxjerrë” në Prishtinë më 1990 pa qëllim duke i besuar botimit të Tiranës konkludimi se Hasan Prishtina paska qenë më 28. XI 1912 në Parlamentin turk!!! e nuk përkon me të vërtetën, sepse 15.X. 1328 (sipas hixhrit do thotë 2 XL. 1910. jo 28. XI.1912.

Në studimin monografik të De Liman Rushitit, “Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912 1918”, Prishtinë 1986, f. 132 tekstualisht thuhet: “Kështu në Shkup i zunë (ushtria serbe -H.B.) shumicën e parisë”. Se në ç'mënyrë dhe si ndodhi kjo gjer me tani kemi të dhëna. Paria (ku ishte edhe Hasan Prishtina-HB.) prej Shkupit dërgohet në internim në Kështjellën e Beogradit... (DASIP B.MPB SERBISE, F. XTR/12-1912. Komanda e Kështjellës së Beogradit Nr. 4578. 24 XI 1912. Me shënimin e kësaj date nga Dr. Liman Rushiti, lëkundet me argumente pohimi i publikuar në Tiranë më 1983 se "Hasan Prishtina do të këtë qenë më 28 nëntor 1912 në parlamentin osama?").

Ne studimin monografik të Dr. Xheladin Shalës, “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918”, Prishtinë 1990 1.93 thuhet: "Në vigjilje (pra

edhe këtu nuk jepet data e saktë kur u burgos Hasan Prishtina...por përjashtohet sikurse të Liman Rushiti mundësia që Hasan Prishtina do të këtë qenë më 28. XI. 1912 në Stamboll - H.B.) të vendosjes për shpalljen e pavarësisë ia arritën qëllimit që ta zënë IDEOLOGUN dhe organizatorin kryesor të Kryengritjes se përgjithshme shqiptare, Hasan Prishtinën. Atë e zunë në nëntor të vitit 1912 në rrethinën e Shkupit, kur ai përpiqej ta pengonte tërheqjen dhe shpërnguljen e popullsisë shqiptare. Së bashku me Hasan Prishtinën u zunë edhe 13 patriotë të tjerë, në mesin e të cilëve ishin edhe Idriz Seferi, Nexhip Draga, Said Hoxha e të tjerë që u internuan në burgun e kalasë së Beogradit (AS.MID-PO (Politicko odelenje) 1913, fas. XVI dos I-nr.3456). Edhe në këtë publikim jepën të dhëna se Hasan Prishtina më 28.XI.1912 nuk ishte në Stamboll.

Autorët e tjerë që merren me periudhën në fjalë, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri dhe në diasporë, fatin e një pjese të udhëheqësisë shqiptare në krye me Hasan Prishtinën në çastin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë e injorojnë fare.

Hasan Prishtina ishte internuar me shokë në Kështjellën e Beogradit prej serbëve, pa u caktuar vendi dhe data, se kur ishin arrestuar, jipet në botimin e Tiranës më 1963, në faqen 87. Aty thuhet se: "sipas një lajmi të sigurt që më ka ardhur (25 janar 1913) nga burimet shqiptare (bënte presion Qeveria e Vlorës në krye me Ismail Qemajlin - tel. sekret 5 janar 1913 Vjenës) se ish-deputeti shqiptar Hasan bej Prishtina, që mbahet i arrestuar prej Serbisë së bashku me persona të tjerë nga parësia e shquar para pak kohe ka bërë një tentativë për t'u arratisur, e që kishte dështuar vetëm prej rrethinës së policia në Zimeni (Zemun) i kishte kthyer përsëri për mungesë pasaporta. Edhe në këtë burim vërtetohet se Hasan Prishtina gjendej i burgosur në Kështjellën e Beogradit më 25 janar 1913, por nuk jipet data e saktë se prej kur gjendej aty i burgosuri (izoluar deri sa të mbarojë Konferenca e Londrës). Kështu "fakti" se Hasan Prishtina, më 28.X.1912 "paska qenë në Parlamentin Osman" mistifikohet. Mistifikimi u vyente atyre që e kishin shpallur patriotin "tradhtar" më 1953 në Tiranë. Pse e bëri këtë A. Buda dhe S. Polli, u mësua më 1973.


Kur jemi te ky problem, sërish duhet të kthehemi në monografinë e Dr. Liman Rushitit, "Rrethanat politiko-shoqërore 1912-1918", Prishtinë 1986, f. 133 ku jepet një detal që nuk është në monografitë e tjera. Aty prezantohet kërkesa e të izoluarve shqiptarë drejtuar Nikolla Pashiçit për t'i liruar. Në atë lutje thuhet: "...zotëri Pashiçit, Kryetar i Këshillit të Ministrave, lartmadhëria e juaj. Ne, poshtë të nënshkruarit, tregtarë jemi dhe posedues në Vilajetin e Kosovës dhe kurrfarë lidhjesh nuk kemi me ushtri, e as që jemi ushtarë, e as

eprorë ushtarakë. Pra pasi që është kështu, ditën e 6-të (gjashtë) me të okupuar të Shkupit nga ana e ushtrisë serbe, neve pa kurrfarë arsyeje, na dërguan këtu në Kështjellën e Beogradit, duke na i lënë fëmijët dhe pasuritë tona të tretën e të shkatërrohen. Këtu na e kanë ndaluar edhe leximin e gazetave. Kuptohet kjo është në kundërshtim me drejtësinë. Me rastin e deportimit tonë këtu, disave prej nesh u është thënë që si të kaloni kufirin do të jeni të lirë, e disa të tjerëve prapë u është thënë që vetëm një muej do të jeni të internuar (kur përmendet kufiri është fjala për kalimin prej Kosovës në territorin e Serbisë). Qe u bë një muej që gjendemi këtu. Që të mos shkatërrohen fëmijët tanë dhe pasuria jonë, që kjo të pengohet si dhe që të pengohet shkatërrimi i shëndetit tonë ju lutemi, në emër të drejtësisë dhe të njerëzisë, të na lironi." Letrën në gjuhën turke e kanë nënshkruar: 1. Seit Hoxha nga Shkupi, 2. Nexhip Draga nga Mitrovica, 3. Hasan Bej nga Vuçiterni, 4. Jashar Pasha nga Peja, 5. Xhemajl Begu nga Prishtina, 6. Mehmet Kemail nga Shkupi, 7. Ibrahim Efendiu (Temo) nga Podujeva, 8. Hurshid bej Omeri nga Prishtina, 9. Jurshid bej nga Prishtina, 10. Muharrem Efendiu nga Prishtina, 11. Mustafa Muhsin nga Stambolli (profesor gjimnazi nga Shkupi), 12. Muharrem Efendiu nga Prishtina. Siç shihet, mungojnë emrat e Idriz dhe Qazim Seferit të cilët u sollën në Kështjellë më vonë. Në lidhje me këtë letër, duhet vërtetuar se cila është dita e gjashtë (6) pas okupimit të Shkupit për të orientuar gjetjen e burgimit të parisë shqiptare.


Më 23 nëntor 1912 nga Ministria e Ushtrisë, Sekretari i gjeneralshtabit i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme shkresë nr. 833 me të cilën Milan Paunoviq kolonel gjeneralshtabi do të sjellë vendim që Marko Cemoviq-vicekonzul mund të bisedojë me parinë shqiptare në Kështjellën e Beogradit. Me parinë shqiptare kishte fituar të drejtë për të biseduar edhe Orllo Kalliqi. Që të dy kishin biseduar me parinë shqiptare për garancinë që ata duhet t'i jepnin që nuk do të merren me politikë. (DASIP B.MPB. Serbisë F. XII, R-13/12 d. 4578 - dokument që vërteton se paria shqiptare më 24.XI.1912 gjendej në Kështjellën e Beogradit).

Gjatë muajit shkurt 1913 kudo në Vilajetin e Kosovës agjentët serbë po nxitonin në anën tjetër për t'i detyruar shqiptarët që t'i drejtojnë Konferencës së Londrës "kërkesa" se "duan të jetojnë nën Serbinë dhe jo nën Shqipërinë". Kjo propagandë ishte iniciuar me shkresën nr. 2448 sekret dhe sekret nr. 168, të 22.XII.1912. Cirkularët urdhërues ishin nënshkruar nga Nikollë Pashiqi. Kërcënimet e tilla përhapeshin përmes njëfarë Mehmet Shani Beut i lindur në Prizren dhe Fehmi Zavalanit. Këta tradhtarë do të shkojnë edhe në Beograd për të kërcënuar Hasan Prishtinën me shokë, që me çdo kusht ta lidhin politikën e tyre me Serbinë. Duke e njoftuar Hasan Prishtinën me "porosinë e Ismail Qemalit, që kosovarët duhet të bëhen të kujdesshëm", Fehim Zavalani do të

mundohet për të luajtur në letrën e tradhtisë. Por do të përbuzet dhe diskreditohet keq gjatë bisedimeve prej Hasan Prishtinës duke i thënë: "Sa të kanë paguar zotëri" (AS MID-po-1913, F. XV/a-sekret, 26-27.11.1973).



Dokumenti f.18



Dokumenti f.19

Kur u burgos Hasan Prishtina me shokë në Shkup

Në një letër që e prezantuar më parë u tha decidivisht kërkesa drejtuar Nikolla Pashiqit nga Kështjella) se: "jemi burgosur gjashtë ditë pasi që ushtria serbe ka hyrë në Shkup". Kjo do të thotë se një pjesë e parisë shqiptare është burgosur në Shkup, më 3 nëntor (kalendari i vjetër) 1912.

Në raportin e Komandës supreme të 14 nëntori 1912 nga Shkupi që bashkëngjitet këtu, thuhet më sa vijon: "Me parinë tjetër shqiptare u dërguan për Beograd, Hasan bej prej Vuçiterni dhe Said Hoxha prej Shkupit. Që të dy janë ish-deputetë në Parlamentin e Stambollit si dhe nacionalistë shqiptarë.

Hasan bej është i telegjent, fanatik dhe flet mirë frëngjisht. Ky dhe Ismail Qemali kanë shërbyer si përfaqësues kryesorë të çështjes shqiptare te të huajt dhe kanë mbajtur lidhje me Ambasadat e interesuara në Stamboll si dhe jashtë Turqisë, por lidhje kanë mbajtur në Austri dhe në Itali, posaçërisht. Hasan bej ka qenë i njohur si njeri i cili në çështjen shqiptare është mbështetur në Austrinë ku ka mjaft lidhje.

Sipas të dhënave, të dy të përmendurit (H. Prishtina dhe Said Hoxha - H.B.) gjenden së bashku me parinë tjetër shqiptare në Beograd, prandaj do të ishte e dobishme për t'i ndarë, është vështirë për të konstatuar se ata ndonjëherë do të tërhiqen nga lufta për nacionalizmin shqiptar dhe autonominë e Shqipërisë, për çka Hasan Beu është shumë i rrezikshëm për shkak të lidhjeve që i ka jashtë Turqisë, prandaj ndaj tij duhet vë vëmendje të posaçme.

Me të dy të përmendurit gjendet në Beograd edhe Nexhip Draga nga Mitrovica, gjithashtu ish-anëtar i parlamentit të Stambollit. Ky në çështjen shqiptare ka luajtur një rol, ishte i renditur në radhët e parisë shqiptare. Por, derisa Hasan bej nuk ka pothuaj kurrfarë pasurie që do ta lidhte me atë territor, Nexhip Draga është posedues i pronës së madhe të patundshme, e cila e vë në pozitë të varur prej saj. Ky si njeri është shumë i kthjelltë, nuk është me karakter të fortë, nuk është fanatik dhe do të mundej nga ana e pushtetit për ta bërë të përdorshëm dhe të dobishëm, për çka kam nderin ta informojë Komandën Supreme."

Me 14 nëntor 1912 Shkup

*Nënshkrimi Nëntogeri rezervë i këmbësorisë
i Shërbimit të Komandës Supreme*

Çka u tha për Hasan Prishtinën më 1964

Në librin e Ajet Haxhiut, "Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës", Tiranë 1964 f.62 thuhet: "Megjithëse populli e zgjodhi përsëri deputet të vet, Hasan Prishtina nuk shkoi fare në parlamentin e ri (18 prill 1912), pasi po merrej me përgatitjen e organizimin e kryengritjes shqiptare të vitit 1912". Në librin e Ajet Haxhiut, pra më 1964 u tha e vërteta edhe në faqen 99: "Ditët e fundit të vitit 1912, kur po përpiqej të pengonte tërheqjen dhe shpërnguljen e popullsisë shqiptare, Hasan Prishtina, së bashku me Nexhip Dragën dhe një grup patriotësh u zu rob pabesisht nga serbët në rrethet e Shkupit. Qeveria serbe i dënoi ata me burgim, duke i mbyllur në Kështjellën e Beogradit. Në këto rrethana Hasan Prishtina dhe patriotë të tjerë nuk patën mundësi të marrin pjesë në çastin solemn dhe historik të ngritjes së flamurit dhe të shpalljes së pavarësisë kombëtare në qytetin hero të Vlorës." Lidhur me këtë konstatim të drejtë më 1964 pse në Tiranë më 1983 u bë diversion ndaj personalitetit Hasan Prishtinës nuk është vështirë për t'u zbuluar. Ajet Haxhiu atëbotë kishte rënë në listat e "banditëve". Dhe kur njeriu "rëzohej", në ato lista, ishte fare lehtë që të gjendet një "beseler" për ta "kompromituar" jo vetëm atë në listë, por edhe tërë atë punë që kishte bërë akcil shkrimtari.

Kujt iu nevojit në Tiranë ai falsifikim me saktësi dihet.

Nga cilido dokument ta marrim, del qartë se Hasan Prishtina më 3 nëntor 1912, u privua nga liria në Shkup, me pjesën dërmuese të parisë shqiptare. Ndërsa më 14 nëntor 1912 u dërgua në Beograd në burgun e Kështjellës famëkeqe. Për këtë ai dhe shumë burra të tjerë shqiptarë nuk mundën të marrin pjesë në Vlorë, e jo pra se "ishte (ishin në Stamboll në parlamentin e Osmanlisë), si u tentua të paraqitet me tendencë përmes një dokumenti të pa verifikuar mirë më 1983" që u botua në Tiranë me prapavijë të caktuar.

Si u lirua paria shqiptare nga Kështjella e Beogradit


Me shkuarjen e Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe Isa Boletinit në Itali, Austri dhe Angli gjatë prillit 1913, çështja e lirimit të parisë shqiptare nga burgu i Beogradit ishte aktualizuar në nivelet më të larta diplomatike evropiane.

Për shkak të presionit që bënte mbi Beogradin diplomacia Austro-Hungareze, Nikolla Pashiqi më 29.III.1913, do t'i drejtohej vojvodës përgjegjës të Ushtrisë me shifër sekrete nr. 1399 se "ka nderin për t'u lajmëruar Juve, se zoti ministri i luftës në saje të propozimit tim i ka lëshuar në liri poshtë të emëruarit pari të cilët kanë qenë të internuar në Kështjellën e Beogradit, pasi që kam fituar bindjen se do të mbesin qytetarë lojalë.

Duke ua komunikuar juve këtë, kam nderin për t'iu lutur që të urdhëroni për t'i njohur udhëheqësit përkatës dhe të rekomandoni që ndaj tyre (parisë) të sillen me kujdes, por në të njëjtën kohë të vështrohet mbi sjelljet e tyre", (pasojnë emrat e atyre shqiptarëve që duhej të liroheshin. Në fund figuron nënshkrimi i Nikolla Pashiqit): Dokumenti i bashkangjitur me këtë shkrim.

Më 1 prill 1913 Seksioni politik i Ministrisë punëve të jashtme me shifër sekret nr. 4852 i drejtohet Komandantit Armatës II-të zoti Ministrit të Ushtrisë me poroz imin e Kryetarit të Këshillit të ministrave i kishte lëshuar në liri poshtë të përmendurit pari, të cilët kishin qenë të internuar në Beograd, pasi që ishte arritur besimi se të njëjtit do të mbesin qytetarë lojalë:

Nexhip Draga prej Mitrovice, Hasan Bej prej Prishtine, Hoxha Said prej Shkupit, Shaban Pasha prej Prishtine, Çemal Bej prej Shkupit, Hurshid Bej prej Prishtine, Rushid Bej prej Dobratini, Muarrem Efendia prej Prishtine, Xhemajl Bej prej Prishtine, Jashar Pasha prej Peje, Ibrahim bej Kokola prej Prishtine, Idriz Seferi prej Gjilani, Qazim Seferi prej Gjilanit. Për lirimimin e tyre dhe kujdesin që duhej pasur ndaj sjelljeve të tyre u ishte dhënë urdhër çarqeve policore të Kosovës. Detyrë striktive për t'i përcjellur kishte marrë edhe seksioni politik operativ i Ushtrisë dhe xhandarmërisë.



Dokumenti f.22

Të përfundojmë, me izolimin dhe burgimin e udhëheqësisë shqiptare të Vilajetit të Kosovës, strategjia serbe synonte realizimin e plotë të okupimit të viseve shqiptare. Për realizimin e asaj strategjie Ushtria serbe kishte startuar prej dy pikave që e kishin komandën në Nish: 1. Prej Kraleve forcat serbe duhej të depërtonin Luginës së Ibrit - Rashkës, për të ndaluar në Dukagjin. Prej

andej Luginës së Drinit nëpër Shqipërinë veriore synohej për të dalur në Lezhë drejtë Detit dhe 2. Luginës së Moravës dhe Vardarit (Nish-Shkup) nëpër Gjevgjeli në Selanik, në nëndrejtimin Tetovë - Gostivar - Kërçovë - Manastir - Ohër - Strugë - drejtë Shqipërisë qendrore - Luginës së Shkumbinit nëpër Elbasan synohej për të dalë në Detin Adriatik në Durrës. Së këndejmi, izolimi dhe burgimi (eventualisht likuidim) i parisë shqiptare siç u veprua në rastin konkret, ia mundësoi Serbisë për ta okupuar pjesën dërmuese të Kosovës. Ky izolim (burgim) ia mundësoi Serbisë përmes Kampanjës (Luftës) ballkanike të zgjerohet në viset shqiptare edhe për 39,000 km² dhe për 1.290.000 banorë. Mali i Zi, në anën tjetër, do të zgjerohet për 7000 km² dhe për 260.000 banorë.

Serbia i frikohej Hasan Prishtinës. Hasan Prishtinën me shokë shteti serb e izoloj sepse nuk guxoi ta likuidonte publikisht, ngase kishte dro nga opinioni evropian. Prandaj Serbia, derisa Hasan Prishtina me shokë ishte burgosur në Shkup dhe në Kështjellën e Beogradit (4 nëntor 1912 - 1 prill 1913), në Kosovë ishte vendosur pushtet okupues i huntës ushtarake me dirigjime të rusëve, ndër më despotët në botë. Ndërsa, në Londër ku po mbahej Konferenca për fatin e viseve që kishin dalë nga zgjedha osmane, përmes politikës imperialiste ruse në Ballkan, në vend të një Shqipërie në të 90100 km (Vilajeti i Kosovës 32900 km vilajeti i Shkodrës me 10 800 km² Vilajeti i Janinës me 17 900 km) u pranua një Shqipëri me 28000 km². Dhe vetëm kur Serbia dhe Rusia u bindën se kishte kaluar rreziku (më 1.IV.1913) prej Hasan Prishtinës, N. Pashiqi e kishte liruar luftëtarin e pamposhtur të Kosovës. Me të dalë nga burgu, Hasan Prishtina menjëherë do të vihet si blea në organizimin e luftës kundër okupatorëve të ri. Dhe nuk do të vonojë shumë, kështu që në shtator të vitit 1913 e tërë Shqipëria e paqliruar prej Mitrovice e deri te Struga sërish do të ngritet në luftë për liri. Parimit të luftës për liri Hasan Prishtina do t'i qëndrojë deri në vdekje. Por edhe pastaj armiqtë e popullit të Hasan Prishtinës do të frikësohen prej tij, sepse ka mbetur vepra e tij që nxitë, mendon dhe vepron për ardhmërinë e të gjitha gjeneratave që vijnë pas tij.

Me dëshmi autentike që i sjellim këtu u vërtetua se Hasan Prishtina më 28 nëntor 1912 ishte burgosur në Kështjellën e Beogradit. Hasan Prishtina pra, nuk ka mundur e as që do të qëndronte në Stamboll siç thuhet në "dokumentin" e botuar në Tiranë më 1983. Vetëm me argumente pra, duhet të thuhet e vërteta. Në të kundërtën, Hasan Prishtina më 28.XI.1912 do të ishte pranë e Ismail Qemalit dhe Flamurit Kombëtar.

⁹⁾Prof. Dr. Hakif Bajrami, "Pse Hasan Prishtina më 28 nëntor 1912 nuk ishte në Kuvendin e Vlorës", "Dëshmi dhe Artikuj", dokumentet duhet studiuar me kritikë objektive, Me rastin e 90 - vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, burim i cituar.

VEPRAT E TIJ E BËN ATË TË PËRJETSHËM

Hasan Prishtina me fatin e luftës për çlirimin e kombit u lidh nga fillimi i shekullit XX, por në dritën e historisë politike doli pas fitores së Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, i cili për fortesë i pati viset shqiptare.

Rilindësi ynë, Sami Frashëri, shkroi: “*Njeriun e bëjnë të përjetshëm veprat e tij!*”, ndaj të ecim nëpër veprën e Hasanit, por vetëm sikur të kalonim mbi gurët e një vau të rrëmbyeshëm, nisur nga zgjedhja e tij deputet i Parlamentin Osman për Prefekturën e Prishtinës, në nëntor të vitit 1908.

Meqë xhonturqit e etnisë turke abuzuan me fitoren e revolucionit demo-kratik, deputetët shqiptarë dhe intelektuesit rilindës preferuan kryengritjen e armatosur për të fituar autonominë e Shqipërisë, e cila do të përfshinte katër vilajetet me shumicë shqiptare: të Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Janinës, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 90.100 km². Këto kërkesa ishin palca e programit politik të Kryengritjeve të vitit 1909/1910/1911 dhe 1912, të cilat përkrah i patën viset shqiptare që edhe sot janë jashtë Shqipërisë Londineze.

Realisht, Hasan Prishtina shenjat e para të mospajtimit me xhonturqit i shfaqti pas Kongresit të Alfabetit të Shqipes në Manastir, i cili mori një vendim soloman, të dëmshëm për të ardhmen e kombit shqiptar, ndaj sapo filloi Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, Hasani e inicioi thirrjen e *Kongresit të Dytë të Manastirit*, i cili, realisht, u drejtua nga personalitetet ndjekës besnikë të Hasan Prishtinës. Ky kongres e vendosi fatin e alfabetit të kombit tonë.

Në vijim, Hasan Prishtina, i përkrahur nga udhëheqësia e Klubit arsimor “*Bashkimi*” të Shkupit i dërgoi në Normalen e Elabasanit 38 nxënës nga Kosova, shumicën me financim të vetin.

Rilindësi Josif Bageri, duke shkruar për kontributin e Hasan Prishtinës për shkollën shqipe dhe lirinë e Shqipërisë, do të konstatojë: “*Ky trim, biri i Shqipnis është shembull me veprat e tij, në ndihmë kaq shumë shqiptarëve*”, kurse Mustafa Asim Kruja, bashkëveprimtar e biografi i parë i Hasanit, do të saktësojë: “*Fjala e tij, penda e tij si dhe kuleta e tij janë në dispozicion të çështjes kombëtare. Në tribunën e parlamentit ai është Jupiteri që gjëmon dhe ua kthen të tjerëve vetimat nga qielli mbi kokën e armiqve të popullit shqiptar!*”

Dija dhe guximi i Hasan Prishtinës është në Themelet e “Shqypnis” së Hafëz Ymerit “*sa ni Hanë...!*”. Hasani për mëvetësinë e Shqipërisë Etnike ishte i lidhur me qarqet ushtarake vjeneze që nga viti 1904, dhe një javë para se ta shpallte kushtrimin për Revolucionin Shqiptar Çlirimtar në Parlamentin Turk, kërkoi përkrahjen diplomatike të Vjenës e më vonë edhe të Anglisë e të fuqive të tjera evropiane për shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.

Një ditë pas fjalimit historik të Hasan Prishtinës në Parlamentin Turk më 11 janar 1912, me iniciativën e Ismail Qemalit u thirr “*Kuvendi i Taksimit*”, ku u dha betimi për organizimin e Kryengritjes gjithëshqiptare për autonominë e gjithë Shqipërisë.

Hasan Prishtina pa vonuar do të kthehet në Kryeselinë historike të Kosovës, në Shkup, ku vuri kontakte me përfaqësuesit e VMRO-së bullgare për luftën çlirimtare të përbashkët, kurse nga Anglia kërkoi ta përkrahte kauzën kombëtare shqiptare të lirisë. Më 5 maj 1912 Hasan Prishtina doli në kështjellën e Shqipërisë, në Drenicë dhe e lëshoi kushtrimin e Kryengritjes.

Kushtrimi bëri jehonë në mbarë vilajetin e Kosovës, kurse sukseset në front Hasanit ia hapën portat e Prishtinës. Më 24 korrik 1912 Këshilli i ministrave i Turqisë e formoi komisionin për të biseduar për të ardhmen e Shqipërisë në kornizat perand-orake osmane. Bisedimet vazhduan deri më 9 gusht 1912. Kërkesat kryesore që i mbrojti Hasan Prishtina mund të sublimohen në këto pika: “*Të njifen zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë; autoritetet civile e ushtarake të kenë kombësi shqiptare; ushtria shqiptare të shërbejë në Shqipëri e të jetë komanda prej oficerëve shqiptarë; veprimet zyrtare në Shqipëri të bëhen në gjuhën shqipe*”. Këto kërkesa do të detajizohen në “*14 pikat historike të Hasan Prishtinës*”, me të cilat sigurohej *Autonomia e Shqipërisë*. Fatkeqësisht viset e tjera të Shqipërisë nuk u ngritën në përmasat që kërkonte momenti historik, e në anën tjetër qeveria serbe ndërhyri me para ndër personalitetet që komandonin pjesën më të madhe të forcave kryengritëse, që bëri të mos vendosej fati i Shqipërisë sipas “*Betimit të Taksimit*”.

Kjo “punë shqiptarçe” e tregtare për vlerën e kombit, Hasanin, e shtyri të bënte të pamundurën që të shpëtonte diçka nga fitorja me pushkë, ndaj më 17 gusht 1912, e informoi “*Shtabin Kryesor të Kryengritjes*” dhe opinionin botëror se: “*kërkesat e pranuar nga qeveria janë ato të propozuara nga e gjithë Shqipëria*”, e më 18 gusht urdhëroi të shpërndaheshin kryengritësit! Për krajetat dhe fatin e kryengritjes së Kosovës, të 5 majit - 18 gushtit 1912, Hasan Prishtina shkroi në broshurën “*Nji shkurtim kujtimesh për Kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*”.

Burri i madh, Hasan Prishtina, përmes bashkëpunëtorëve më besnikë: Bedri bej Pejanit, Salih Gjukë Dukagjinit e Rexhep Mitrovicës kontribuoi edhe për organizimin e Kuvendit Gjithëshqiptar të Vlorës. Për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor, Hasan Prishtina foli në seancën e Parlamentit Osman në Stamboll dhe kërkoi nga kabineti qeveritar veprime ushtarake të shpejta për ta shpëtuar Shqipërinë nga okupimi dhe masakrat gjenocidiale të ushtrive të “*Aleancës Ballkanike*”, të përkrahura nga pesë fuqitë e mëdha: Rusia, Anglia, Franca, Italia dhe Austro-Hungaria.

Gjatë rrugës së kthimit nga Stambolli në atdhe, Hasan Prishtina do të kapet nga ushtria serbe dhe do të dërgohet në burgun e “Kalemegdanit”, ku ishin sjellë edhe disa krerë të kapur në Shkup e gjetkë në Kosovë, midis të cilëve edhe shërbëtorë besnikë të Serbisë, të cilët më vonë do të shpërblehen me pensione të përjetshme.

Filozofi i shquar, Emerson, shkroi se: *“Njerëzit me karakter janë ndërgjegje e popullit të cilit i përkasin”*. Kësaj lagjeje i përkiste edhe Fatosi i kombit tonë-Hasan Prishtina, i cili pas lirimit nga internimi në pranverë të vitit 1913, përmes Vjenës e Trieshtës arriti në Vlorë për të dhënë kontributin e nevojshëm në ngritjen e shtetit Shqipëri.

Këtë rrugë e ndoqi besnikërisht edhe gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë, si edhe në Shqipërinë Londineze nga fillimvitet e '20-ta. Nevoja e jetës së kombit Hasan Prishtinën e solli në postin e Kryeministrit të Shqipërisë, më 8 dhjetor 1921, por për ta evituar luftën civile, dha dorëheqje më 11 dhjetor. Për shumicën e personaliteteve të veshur me pushtete krahinore Shqipëria Londineze ishte e mjaftueshme!?

Hasan Prishtina punoi i pagjunjësuar për ta ngritur shtetin shqiptar në piemont të kombit e të copëtur mizorisht, por hasi në pengesa të pakapërcyshme të një pjese të personaliteteve të veshur me pushtet, sa që u detyrua të kalonte “kaçak” dhe në emigrim të përjetshëm së bashku me gruan e vet fisnike, Igballen.

Hasan Prishtina kurrë nuk pushoi së vepruari për ribashkimin e kombit të copëtuar, deri në minutat kur e përjetoi martirizimin (më 14 gusht 1933), nga dora e zgjatur trathtarë e Ahmet Zogut, edhe për interesa të albano-fobisë serbe shekullore.

Rëndësinë e veprës patriotike shembullore të Hasan Prishtinës për kombin shqiptar e ka përmbledhur në një sentencë dëshmori i Shqipërisë Etnike nga Nëntori i Përgjakur 1944, Stak Mark Mirdita: *“Në jetëje i detyruar të shkelësh shumë rrugë, por nga njëra nuk guxon të largohesh, kurrë! Ajo është rruga e shqiptarisë që na vie nga Skënderbeu te Hasan Prishtina...!”*




HASAN PRISHTINA NË FAQET E HISTORISË

Hasan bej Prishtina ka qenë njëri nga personalitetet dhe figurat më të shquara të Lëvizjes sonë Kombëtare. Ky ideolog i shquar, dhe udhëheqës i palodhur i kryengritjes së përgjithshme për pavarësinë e tokave shqiptare, tërë pasurinë e dha për çështjen kombëtare shqiptare. Lirisht mund të thuhet se veprimtaria e tij luftarake gjatë muajve maj-gusht 1912 e përgatitën ngritjen e Flamurit në Vlorë. Hasan Prishtina lindi në vitin 1873 në Vushtrri, por familja e tij, ishte nga treva e Drenicës, nga fshati Palac. Mbiemri i vërtetë i Hasan Prishtinës ka qenë Berisha, por me largimin e gjyshit të tij Haxhi Ali Berisha nga Palaci në Vushtri, mbiemrin e ndryshoi nga Berisha në Palaci.

Mbas zgjedhjes së tij deputet në Kuvendin Popullor Turk (1908-1912), ai e ndryshoi mbiemrin përsëri, por kësaj here nga Palaci në Prishtina, pra edhe u njoh si Hasan bej Prishtina. Studimet politiko-juridike i kreu në Stamboll. Shovinizmi i xhonturqve kundër shqiptarëve dhe Shqipërisë, nxiti një urrejtje të deputetëve shqiptarë, anëtarë të Kuvendit Popullor turk, të cilët ndërmorën një takim të fshehtë për fillimin e Kryengritjes (1909-1912) në Shqipëri. Esat Pashë Toptani mori përsipër krahinën e Shqipërisë së Mesme dhe krahinën e Mirditës, Myfti Beu, Azis Pasha dhe Syrja Beu, morën përsipër krahinën e Toskërisë. Ismail bej Qemali u nis për në Evropë, për të mbledhur të holla dhe armë për kryengritjen. Hasan bej Prishtina mori përsipër organizimin e kryengritjes në Kosovë, bashkë me Bajram Currin dhe Isa Boletinin.



Hasan Prishtina



Bajram Curri

HASAN PRISHTINA MIK ME TRIMAT E ZAJAZIT

Kalosh e Lazam Dan Zajazi ishin prijës të çetës së Zajazit në të gjitha kryengritjet që nga viti 1903 deri më 1927. Babai i tyre Dan Çeliku u vra në Betejën e Karbunicës bashkë me komandantin e çetës së Zajazit, Sefer Zajazi dhe pas kësaj komandimin e çetës së Zajazit e mori djali i Dan Çelikut, Kalosh Dan Zajazi.

Tre djemtë e Dan Çelikut: Kaloshi, Lazami dhe Rasimi, patën kaluar nga Zajazi dhe ishin vendosur në Kurdari të Matit, Komuna e Burrelit. Mik shtëpie i këtyre trimave ishin Bajram Curri e Hasan Prishtina. Të gjithë ishin përkrahës të Qeverisë së Nolit.

Nipi i Kalosh Dan Zajazit, Luftim Rasim Çeliku, i ka prezantuar të dhënat me shkrim që i ka lënë babai i tij Rasim Dan Çeliku, se Hasan Prishtina për një kohë të gjatë kishte qëndruar i fshehur në shtëpinë e tyre në Kurdari, dhe kur i lajmëruan se Zogu ishte informuar për vendndodhjen e tyre, Hasan Prishtina bashkë me Kalosh e Lazam Zajazin, natën kalojnë në Gjakovë dhe prej atje Hasan Prishtina shkon drejt Selanikut, kurse Kaloshi e Lazami strehohen në një shpellë afër Brodit në Maqedoni. Me urdhër të Zogut dhe me ndihmën e Serbisë, Kaloshi e Lazami, në vitin 1927 vriten në tradhti, kurse Hasan Prishtina në vitin 1933.

Nipi i Kalosh Dan Zajazit, Luftim Rasim Çeliku është i gatshëm që të takohet me të afërmit e Hasan Prishtinës, sepse Hasan Prishtina bashkë me gruan e tij, gjashtë muaj kanë qëndruar në shtëpinë e tyre në Kurdari të Burrelit. Nga këto të dhëna kuptojmë se Hasan Prishtina ka qenë mik shtëpie i luftëtarit të Zajazit, Kalosh Dan Çeliku.¹⁰



Luftëtarët Kalosh dhe Lazam Dan Zajazi nga Kurdari dhe Hasan Prishtina

¹⁰⁾ Dr.sc. Ilmi Veliu, "Kujtesa historike e Rasim Dan Çelikut"

SHTYPI KROAT PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE DHE IDEOLOGUN E SHKOLLËS SHQIPE

Shqiptarët të parët panë se nga xhonturqit nuk kanë çka të presin, dhe filluan luftën për të drejtat e veta, dhe të parët u ndanë nga ata. Prandaj me këtë shqiptarët i treguan botës se Ballkanit i nevojitet intervenimi nga fuqitë e jashtme. Çështjen e Turqisë më së miri do ta rregullojnë popujt në territorin e Ballkanit.¹¹

Gjatë kësaj kohe të gjithë ishin të bindur se ky popull i robëruar shekuj me radhë, do ta fitojë lirinë e vet. Sipas “Hrvatsko”, para se të arrijë komisioni shqiptarët e Prishtinës i dërguan qeverisë turke një ultimatum në të cilin kërkuan që brenda dyzet e tetë orëve të shpërndahet parlamenti dhe në qoftë se qeveria nuk e bën këtë, shqiptarët do të nisen për në Shkup. Kurse një numër i madh i kryengritësve ishin vendosur në rrugën e vet prej Shkodre për në Tiranë dhe pritnin përgjigjen e qeverisë turke.¹²

Komisioni qeveritar, sipas “Novost”, arriti në Prishtinë më 27 korrik, dhe u prit me gëzim të madh nga popullsia e cila mendonte se do të lejohet autonomia. 214 krerët shqiptarë në Prishtinë ishin të ndarë në dy grupe me konceptione të ndryshme. Grupin e parë e përbënin përfaqësuesit e Prishtinës, Gjilanit, Preshevës, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Novi Pazarit, Mitrovicës, Vuçiternës, Ferizajt dhe të Kaçanikut të cilët arrinin afro 100 delegatë, në mesin e tyre ishin edhe 4 serbë. Grupin e dytë e përbënin Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Riza Beu, Jahja Efendi dhe Musa Efendi nga Prizreni. Para komisionit qeveritar turk doli me kërkesa grupi i parë i cili shtroi këto kërkesa:

- Brenda dyzet e tetë orëve të shpërndahet parlamenti, për ndryshe do të sulmohet Shkupi,
- Liri për mbajtjen e armëve,
- Shqiptarët ta kryejnë shërbimin ushtarak në pjesën evropiane të Turqisë,
- Të hapen shkolla në marrëveshje me pushtetin,
- Me rastin e emërimit të nëpunësve për këto vise, të emërohen brenda mundësive, nëpunës shqiptarë,
- Ministrat xhonturq të nxirren para gjyqit,
- Amnestimi i të dënuarve politikë,
- T'i kushtohet kujdes i madh bujqësisë dhe komunikacionit
- Të hudhet poshtë ideja për ndarjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.¹³

11) “Slobodna riječ”, Veliki događaji na Balkanu, br. 170 (29.07.1912, f.5).

12) “Hrvatska” Događaji u Turskoj, br. 223, (1.8.1912, f.1).

13) Shukri Rahimi, “Kryengritjet shqiptare në Kosovë 1909/1912”, Prishtinë 1972, f.1).

Megjithëse këto kërkesa, siç po shihen, nuk ishin me karakter autonom, komisioni nuk i pranoi, ndërsa kryengritësit në shenjë mospajtimi e lëshuan Prishtinën dhe u tërhoqën në Ferizaj. Mirëpo nga frika se kryengritësit do të marshojnë në Shkup, Veziri i Madh telegrafoi që te presin për arsye se së shpejti do të arrijë një komision tjetër i kryesuar nga mareshali Ibrahim Pasha.¹⁴

Ky komision më 1 gusht arriti në Prishtinë dhe menjëherë hyri në bisedime. Para komisionit foli Hasan Prishtina, dhe ai e sulmoi ashpër barbarizmin e xhonturqve, mandej kërkoi që zyrtarisht të njihen kufijtë e Shqipërisë, që autoritetet civile dhe ushtarake të jenë të kombësisë shqiptare, shërbimi ushtarak i shqiptarëve të kryhet në Shqipëri duke qenë të komanduar nga oficerët shqiptarë, dhe gjuha shqipe të njihet si gjuhë zyrtare. Sipas “Obzor” shqiptarët e Kosovës ishin këmbëngulës në kërkesat e tyre, kurse ata të Shqipërisë Jugore kërkonin që të shpërndahej Parlamenti.¹⁵

Kërkesat e Bajram Currit, Ibrahim Pasha i konsideroi si përpjekje për shkëputje nga Perandoria, dhe nuk i pranoi. Ai filloi t'i përçajë kryengritësit duke nxitur parime turkomane dhe kërkesa italfiste për shpërndarjen e parlamentit. Gjatëbisedimeve, sipas “Obzor” shqiptarët kërkonin:

- Shërbimi ushtarak të kryhet në pjesën e Turqisë evropiane,
- Mësimi në shkolla të mbahet në gjuhën shqipe,
- Nëpunësit ta dinë gjuhën shqipe,
- Të jepen urdhra të posaçëm për ata njerëz që jetojnë në viset kodrinore,
- Kabineti i Sait Pashës, i cili nuk qe në gjendje ta mbarojë Tripolin nga invazioni italian, duhet të akuzohet,
- Armët e dorëzuara duhet përsëri t'u kthehen shqiptarëve,
- Masat për pronarët e tokave,
- Vendimet e Këshillit të Vilajeteve të plotësohen,
- Formimi i besimit i cili do të ketë kujdes për zbatimin e këtyre kërkesave.¹⁶

Për t' i plotësuar kërkesat italfiste të elementit turkoman sipas “Hrvatskës” qeveria turke më 5 gusht u detyrua nga presioni shqiptar ta shpërndajë Parlamentin dhe të japë dorëheqjen duke ia lënë vendin një qeverie të re të kryesuar nga Qamil Pasha.¹⁷

Ndërsa me rastin kur ushtria turke filloi ndjekjen e kryengritësve shqiptarë shumë ushtarë turq kaluan kufirin nëpër Zetë dhe duke i ndjekur kryengritësit vranë disa malazet për të cilët qeveria turke nuk dëgjoi fare. Kështu pas kësaj përgjigje konsulli turk u largua nga Cetinja.¹⁸

14) Ajet Haxhiu, Hasan Prishtina, Tiranë, 1960, f.23.

15) “Obzor” Dogagjaji u Albaniji, nr. 214, (6.8.1912, f.3).

16) “Obzor” Arnautska buna pri kraju, nr. 221, (13.8.1912, f.1).

17) “Hrvarska” Raspust turske komore, nr. 222, (6.8.1912, f.1).

18) “Obzor” Jedan turskih ultimatum, nr. 216, (8.8.1912, f.1).

Këto ngjarje i shfrytëzoi me mjeshtëri komisioni turk duke i nxitur turkomanët kundër shteteve fqinjë si dhe kundër autonomisë. Nga kjo Hasan Prishtina u detyrua të bëjë kompensime me grupin turkoman dhe së bashku formuluan 14 kërkesa të cilat ia dorëzuan komisionit qeveritar në Prishtinë më 9 gusht dhe duke i deklaruar se në qoftë se kërkesat nuk pranohen brenda dy ditëve kryengritësit do ta marrin Shkupin. Qeveria turke e vonoi përgjigjen për kërkesat e paraqitura dhe për këtë, sipas “Obzorit” afro 30.000 kryengritës të armatosur, por të uritur hyjnë në Shkup, duke kryer vendimin që e vendosën në Prishtinë edhe përkundër përpjekjeve të mëdha nga ana e organeve për t'i ndërprerë. Me këtë kryengritësit treguan fuqinë e vet të madhe.

Pas kësaj Hasan Prishtina ia dërgoi një depesh gazetës “Sabah”, në të cilën i demantoi të gjitha lajmet lidhur me kundërthëniet në mes kryengritësve dhe duke treguar se çdo tentim i xhonturqve për përçarjen e tyre do të gjejë vdekje.¹⁹

Për këtë “Slobodna Rjeç” shkruante: “Afro 12.000 kryengritës të armatosur të hipur në 28 trena duke kënduar hyjnë në Shkup pa u ndeshur në ndonjë rezistencë”²⁰

Kështu në Shkup u grumbullua një numër i madh i kryengritësve, dhe sipas kësaj gazete, edhe pse Sulltani kishte nënshkruar “Iradën” në të cilën pranoheshin kërkesat shqiptare gjendja në Arnautlluk ishte jo e qetë, për arsye se 30.000 kryengritës të armatosur prisnin zgjerimin e ngjarjeve për luftë për autonominë e Shqipërisë, e cila lëvizje kishte edhe Mirditën e Malësorët. Në Ferizaj kishin arritur udhëheqësit e Shqipërisë Jugore që t' u bashkëngjiten kryengritësve.²¹

Edhe pse te kryengritësit ndihej mungesë e madhe armësh dhe ushqimi, sipas gazetës në fjalë, këta vendosën qetësinë dhe rendin, ndërsa udhëheqësit deklaruan se secili prej atyre që prish qetësinë dhe u merr qytetarëve ndonjë gjë pa pagesë do të dënohet rreptësisht. Në anën tjetër, në Kumanovë e Lezhë hynë kryengritësit dhe vendosën rendin dhe qetësinë.²²

Sipas “Obzorit” Hasan Prishtina pas pranimit të kërkesave nga ana e qeverisë turke u bëri thirrje shqiptarëve që ta lëshojnë Shkupin, por kësaj thirrjeje iu përmbajt vetëm një pjesë e tyre, kurse Isa Boletini, Riza Beu dhe Bajram Curri rreth të cilëve ishin mbledhur 15.000 kryengritës në duar të të cilëve qëndronte tërë qyteti, nuk iu përmbajtën kësaj thirrjeje. Te këta, meqenëse ndihej mungesë e madhe ushqimit për ushtrinë, situata u keqësua shumë shpejt.

19) “Obzor” Ustanak arnauta, nr.225, (17.8.1912, f.3).

20) “Slobodna rjeç” U turskoj, nr.184, (14.8.1912, f.2).

21) “Slobodna rjeç” Polozhaj u Turskoj, nr.186, (16.8.1912, f.1).

22) “Slobodna rjeç”, nr.188, (19.8.1912, f.1).

Derisa në viset e ndryshme të shqiptarëve zhvilloheshin luftime të përgjakshme, me iniciativën e Hasan Prishtinës, Nexhip Dragës dhe të tjerëve, u mbledh një kuvend në fshatin Junik (*në veriperëndim të Gjakovës*) në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e shqiptarëve nga të gjitha viset e Kosovës. Në kuvend merrnin pjesë rreth 250 njerëz të dalluar nga ky Vilajet atdhetarë, politikanë dhe luftëtarë siç ishin: Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi, Mahmut Zajmi, Zefi i Vogël e shumë të tjerë.

Në këtë kuvend turqit arritën që t' i fusin njerëzit e vet me qëllim që ta dezorganizojnë punën e këtij kuvendi, por nuk iu shkoi për dore, për arsye se në saje të punës së madhe të Hasan Prishtinës dhe shokëve të tij arriti që si më parë edhe kësaj radhe u bashkuan të cilët duke i parë rrethanat shoqërore e politike formuan kërkesat e përbashkëta, të cilat në formë të memorandumit ia paraqitën Fuqive të Mëdha dhe Portës këto kërkesa:

- Të përcaktohen kufinj të Shqipërisë,
- Në Shqipëri të ngrihet flamuri shqiptar,
- Të emërohet një guvernator në Shqipëri i zgjedhur nga shtëpitë e vjetra të vendit,
- Nëpunësit e huaj të hiqen dhe të zëvendësohen me nëpunës shqiptarë,
- Gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare ,
- Zbatimi i këtyre kërkesave të sigurohet nga Fuqitë e Mëdha.²³

Për këtë ngjarje "Slobodna Rječ" shkruante: "Gjatë kohës kur në ushtrinë turke bëheshin dezertime nga radha e ushtarëve në vendin Junik, që gjendej në mes të Pejës e Gjakovës shqiptarët mbajtën një kuvend popullor në të cilin deklaruan se nuk bisedojnë në emër të malësorëve, por të të gjithë shqiptarëve dhe formuan kërkesat të cilat ia dërguan qeverisë turke. Në këtë kuvend morën pjesë 86 udhëheqës të krishterë e myslimanë dhe paraqitën këto kërkesa”:

- Liria e plotë e shqiptarëve dhe njohja e popullit shqiptar,
- Me ligj të njihet ekzistimi i karakterit nacional pa kurrfarë kufizimi,
- Me ligj të rregullohen të drejtat,
- Pastërtia absolute e shqiptarëve,
- Organizimi i administratës, dhe decentralizimi i saj deri në themel,
- Të gjithë përfaqësuesit e ushtrisë, administratës, civilëve të cilët dinë shqip kanë përparësi,
- Emërimi i një guvernatori të përgjithshëm dhe që në Shqipëri si gjuhë shtetërore të futet gjuha shqipe,
- Rekrutët nuk guxojnë të dallohen nga detyra,
- Një pjesë e të ardhurave shtetërore të lejohet për ndërtimin e urave, rrugëve dhe shkollave,


²³) Shukri Rahimi, "Vilajeti i Kosovës", (f.174).
"Slobodna rječ", nr.189,

- Zgjedhja e një kontrolli të aparatit shtetëror,
- Themelimi i një fondi për ndërtimin e shtëpive të djegur nga artileria turke.²⁴



Për vazhdimin e kryengritjes së popullit shqiptar për autonomi, dhe në vazhdim të dezertimit të ushtarëve turq "Novosti" shkruante: " *Tash po shihet qartë se kryengritësit shqiptarë po luftojnë së bashku me ushtarët e dezertuar kundër qeverisë turke. Kjo vërehet nga dezertimi i ushtarëve të cilët kërkojnë që shqiptarëve t'u jepet autonomia që u është premtuar vitin e kaluar. Populli shqiptar dëshiron të ketë të njëjtat të drejta të cilat i kanë edhe popujt tjerë.*"²⁵

Të gjitha ngjarjet e zhvilluara në "arnautllëk" del se e kishin sjell në pozitë të palak-mueshme qeverinë turke. Hyrja triumfale e forcave në Shkup, përsëritja e kërkesave kombëtare të formuluar në memorandumimin e Hasan Prishtinës, propozimi i Bertoltit për një hap kolektiv të Fuqive të Mëdha pranë qeverisë turke për t'i kërkuar zbatimin e decentralizimit, presioni i Vjenës dhe i Berlinit mbi qeverinë në Stamboll që t'u njihet shqiptarëve autonomia territoriale, sipas këtij shtypi vuri vendet ballkanike në lëvizje dhe drejt intensifikimit të përga-titjeve për luftë kundër Turqisë. Sa i përket qëndrimit të shtypit kroat të kohës, u pa se pjesa më e madhe e këtij shtypi mbante një qëndrim të mirë dhe të drejtë duke përkrahur të drejtat e shqiptarëve.



Faksimile e gazetës "Slobodna riječ", Zagreb, 1912

²⁴ "Slobodna riječ", Turska pred raspadom, nr.145, (28.6.1912, f.1).

²⁵ "Novosti", Arbanaški ustanak, nr.174, (19.7.1912, f.1).

Sipas këtyre gazetave të gjitha dyqanet ishin të mbyllura si dhe bankat për arsye se të gjitha të hollat e gjërat e vlershme ishin dërguar në Selanik. Pushteti turk kishte rrethuar krejt qytetin dhe pritej të zhvillohen konflikte të mëdha, por kjo nuk ndodhi për arsye se më 21 gusht u nënshkrua marrëveshja në mes të udhëheqësve shqiptarë dhe Ibrahim Pashës, sipas se cilës shqiptarëve do t'u jepen 35.000 pushkë, kurse 60.000 pushkë do të vendosen nëpër garnizonet ushtarake. Mirëpo gjatë bisedimeve shqiptarët me këmbëngulje kërkonin autonominë.²⁶

Nga frika sipas “Novostit”, qeveria turke u detyrua t' i pranojë këto kërkesa:

- Dhëna e ligjeve të posaçme për një pjesë të Shqipërisë veçanërisht atyre viseve malore,
- E drejta për shërbimin ushtarak i cili do të kryhej në Rumeli, por në rast lufte edhe jashtë saj,
- Shpërndarja e armëve do të bëhej pas zgjedhjes së qeverisë,
- Vendosja e nëpunësve e atyre që dinë gjuhën dhe traditat e popullit,
- Ndërtimi i gjimnazeve në ato vise të cilat kanë 300.000 banorë në të cilat mësimi do të zhvillohet në gjuhën amtare,
- Lejimi i ndërtimit të shkollave private shqipe,
- Ushtrimet ushtarake të bëhen në gjuhën shqipe në shkollat fillore dhe të mesme,
- Zhvillimi i vijave hekurudhore,
- Formimi i të drejtës komunale,
- Ruajtja e traditave sipas ligjeve fetare,
- Kabineti i Haki Pashës dhe i Sait Pashës do të gjykohej,
- Amnistia e përgjithshme e kryengritësve dhe atyre oficerëve dhe ushtarëve të cilët iu kanë bashkangjitur shqiptarëve,
- Dëmtshpërblimi për shqiptarët të cilëve iu kanë shkatërruar shtëpitë.²⁷

Karakteristikë e këtyre kërkesave të pranuar nga qeveria turke, është se në to nuk zihet askund emri Shqipëri dhe shqiptarë. Mospërfillja e kësaj kërkesë do të thotë mosnjohja e kombësisë shqiptare. Pas kësaj turqit mendonin se kryengritja pushoi. Por sipas “Slobodna Rjec”, në këto bisedime turqit nuk patën sukses edhe përkundër këtyre lëshimeve, sepse shqiptarët kërkonin autonominë kundër të cilës ishin Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, të cilave, siç deklarorin ato, me autonominë shqiptare rrezikoheshin interesat e tyre në këto vise të Ballkanit.²⁸

²⁶) “Obzor”, Arnautski ustanak, nr.230, (23.8.1912, f.3).

²⁷) “Novosti”, Arbanski popustishe, nr.230, (22.8.1912, f.1).


²⁸) “Slobodna riječ”, Rat i Balkan, nr.192, (26.8.1912, f.1).

Ky qëndrim i shteteve ballkanike na jep të kuptojmë se aleanca nuk ka pasur për qëllim të thjeshtë luftën kundër Turqisë, por luftën për copëtimin e viseveqë i mbante ajo gjer më tani nën sundimin e saj. Edhe shtetet e mëdha u përpoqën të ndikonin në këto ngjarje. Sipas “Hrvatska” pasi kryengritësit shqiptarë hynë në Shkup, ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë konti Bertholt u orvat ta siguronte përkrahjen e kërkesave shqiptare nga ana e Fuqive të Mëdha. Ai më 13 gusht u propozoi Fuqive të Mëdha që të bënin një hap kolektiv pranë qeverisë turke, dhe për të kërkuar zbatimin e politikës së decentralizimit.

Deklarata e tij nuk hasi në përkrahje nga ato, por i shqetësoi më së shumti shtetet ballkanike, të cilat e konsideronin atë si një hap të ri të Vjenës për të siguruar daljen në Selanik.²⁹

Udhëheqësit e kryengritësve shqiptarë, pas përfundimit të kryengritjes, filluan për-pjekjet për realizimin e vetëqeverisjes dhe formuan organet e para. Duke i zbatuar kërkesat e vendosjes së administratës shqiptare, popullsia i dëbonte nëpunësit turq, dhe në vend të tyre emëroheshin shqiptarët. Sipas “Slobodna Rjeç”, popullsia në Ferizaj vrau kajmekamin i cili nuk dëshironte të largohej, kurse në Vlorë shqiptarët çarmatosen të gjithë ushtarët turq. Në Pejë shqiptarët sulmuan një garnizon ushtarak dhe i morën të gjitha armët dhe katër topa.³⁰

Kurse sipas “Jutarni list” shqiptarët përveç dëbimit të organeve shtetërore turke, sulmonin edhe popullsinë krishtere si për shembull në rrethin e Beranës, me ç'rast popullsia e krishterë e këtij vendi u ngrit në kryengritje kundër të cilëve u dërgua Xhavit Pasha, i cili katër ditë rresht zhvilloi bisedime me ta. Gjatë bisedimeve, kryengritësit kërkonin mbrojtjen e fshatrave nga zullumet turke dhe një pjesë të shqiptarëve myslimanë, të drejtat e barabarta me myslimanët dhe lejimin për bartjen e armëve, kurse dorëzimi i armëve të bëhet vetëm në rast çarmatimi të përgjithshëm.³¹



¹⁹ “Hrvatska”, Nova vremenja o predlogu gr. Berçefollid, nr.239, (22.8.1912, f.1).

³⁰ “Slobodna rijeç”, Kritičan položaj na Balkanu, nr.195, (29.8.1912, f.1).

³¹ “Jutarni list”, Vrijenje na Balkanu, nr.153, (1.9.1912, f.1).

Në rrethinën e Mitrovicës organet e pushtetit turk, sipas kësaj gazete, nuk kishin kurrfarë pushteti, për arsye se Isa Boletini kishte formuar këshillin popullor për mbajtjen e qetësisë, i cili punonte pa kurrfarë detyre ndaj qeverisë në Stamboll. Kështu shqiptarët jo vetëm që kërkonin autonominë e Shqipërisë, por deklarorin në mënyrë energjike që edhe Maqedonia të fitojë autonominë.³² Por fillimi i luftës Ballkanike, më 9 tetor, dhe depërtimi i ushtrive të vendeve ballkanike në viset e banuara me shqiptarë, u dhanë fund këtyre përpjekjeve.

Depërtimi i ushtrive ballkanike ndikoi në ndryshimin e situatës. Përpara qarqeve patriotike shqiptare u shtrua çështja e fatit të shqiptarëve, prandaj shqiptarët të mashtruar gjithmonë nga premtimet e qeverisë turke, i rrokën armët jo për ta mbrojtur ekzistencën e Perandorisë Osmane në Ballkan, por për t' i dalë zot territoreve të veta. Kryengritësit myslimanë e katolikë të udhëhequr nga Isa Boletini, iu bashkëngjitën ushtrive ballkanike për shkatërrimin e Perandorisë Osmane me qëllim që edhe shqiptarët të fitojnë të drejtat e tyre. Kur qeveria turke u informua për këtë, vendosi që në çdo mënyrë të bëjë vrasjen e Isa Boletinit. Kështu valiu i Kosovës këtë detyrë e mori përsipër. Ai së bashku me Esat Pashën e thirri Isën në oborrin e tij për bisedime, duke i premtuar se nuk do t' i ndodhë asgjë. Por Isa që i kujdesshëm duke ditur që po i përgatitet kurthi, dërgoi një njeri nga njerëzit e vet të cilin kur shkoi te valiu menjëherë e vranë.³³

Disa shqiptarë myslimanë luftonin së bashku me ushtrinë turke kundër ushtrive fqinje. Idriz Seferi me 6.000 njerëz u nis në drejtim të kufirit serb, kurse në disa vise të Shqipërisë shqiptarët kërkonin armë nga pushteti turk për të shkuar në kufi, por nga frika organet nuk i armatosen.³⁴

Ushtritë e aleatëve ballkanikë brenda një kohe të shkurtër shpartalluan ushtrinë turke në të gjitha frontet. Trupat bullgare pasi thyen qëndresën e ushtrisë turke në Thrrakinë lindore, ia mësyn Adrianopojës, kurse ushtria malazeze, e ndarë në tri kolona, sulmoi në dy drejtime të Shkodrës, dhe njëra në drejtim të Pejës, dhe brenda tri javësh pushtuan Pejën dhe iu afruan Shkodrës. Armata serbe pushtoi Prishtinën, Prizrenin, dhe së bashku me malazez pushtuan Gjakovën, pastaj nëpër luginën e Drinit iu drejtuan Shkodrës, Lumës, Mitrovicës dhe Matit. Trupa të tjera të ushtrisë serbe, pas fitores që arritën në betejën e Kumanovës, më 26 tetor, pushtuan Shkupin dhe ia mësyn Manastirit. Ushtria greke pasi theu forcat turke në Thesali dhe në Epir, çliroi Selanikun dhe e rrethoi Janinën.

³² "Hrvatska", Albanija i Makedonija, nr.250, (4.9.1912, f.1).

³³ "Novosti", Protiv Ise Boletinac, nr.277, (13.10.1912, f.2).

³⁴ "Hrvatski pokret", Albance trazhe od Turske oruzhje, nr.235, (14.10.1912, f.2).

Duke parë rrezikun nga ky copëtim i vendit, patriotët shqiptarë filluan të punojnë me të madhe për ruajtjen e tërësisë së territoreve. Ata filluan përgatitjet për mbajtjen e një kuvendi kombëtar dhe shpalljen e pavarësisë së vendit të tyre. Iniciativën për këtë e morën Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi, të cilët mendonin se do të kishin përkrahje nga fuqitë e mëdha. Ata u nisën nga Stambolli në Bukuresht, dhe pas bisedimeve që patën aty arritën në Vjenë, dhe nga Vjena në Itali. Për këtë gazeta kroate shkruante: *“Ismail Qemali më 20 nëntor i përcjellur nga 14 shokë në Trieste, do të udhëtojë për në Shqipëri me anijen “Brun”. Ai gjatë bisedës me gazetarët shprehu dëshirën që të arrijë në Durrës para ushtrisë serbe. Terreni në Durrës është përgatitur dhe do të shpallim pavarësinë e vendit tonë për të cilën i gjithë populli shqiptar është duke bërë luftë të kahershme për arritjen e këtij qëllimi”*- tha ai.³⁵

Nga Trieshta, komisionit që ishte formuar në Vlorë për përgatitjen e mbledhjes së kuvendit kombëtar, iu dërgua një telegram me anën e të cilit duhej të merreshin masa për thirrjen e delegatëve. Grupi i kryesuar nga Ismail Qemali arriti në Durrës më 21 nëntor i përcjellur nga shumë patriotë shqiptarë, dhe më 25 nëntor nga Durrësi arriti në Vlorë. Ndërkohë ushtria serbe po përparonte me shpejtësi në tokat shqiptare dhe po i afrohej Durrësit, Tiranës, Krujës dhe Elbasanit. Rrethet patriotike shqiptare vendosën ta shpallin sa më shpejtë pavarësinë, dhe kështu më 25 nëntor Elbasani shpalli i pari pavarësinë, kurse të nesërmen e shpallën edhe Durrësi e Tirana, dhe më 27 nëntor Kavaja, Peqini dhe Lushnja.³⁶ Për shkak të përparimit të ushtrisë serbe, gjendja në Shqipëri bëhej gjithnjë më kritike, prandaj kjo ishte arsyeja që në mbrëmjen e 27 nëntorit delegatët që ndodheshin në Vlorë, ndonëse nuk kishin arritur ende përfaqësuesit e disa krahinave, vendosën të mbanin të nesërmen kuvendin kombëtar. Më 28 nëntor të vitit 1912, në orën 14, Kuvendi u hap në Vlorë dhe në të merrnin pjesë 35 delegatë. Kuvendi zgjodhi kryetar Ismail Qemalin, i cili foli mbi të kaluarën e Shqipërisë, dhe luftërat e shqiptarëve për të fituar të drejtën e tyre. Kuvendi shpalli pavarësinë e Shqipërisë me një porosi të përkohshme, dhe zgjodhi një pleqësi për të ndihmuar e kontrolluar qeverinë dhe për të dërguar një komision për çështjen shqiptare përpara fuqive të mëdha. Shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar, shtypi kroat i dha publicitet të madh.³⁷ Shqiptarët arritën ta përmbysin Turqinë, e cila mbajti Shqipërinë afro pesë shekuj. Kjo kthesë, në historinë e popullit shqiptar, është premisa politike themelore për organizimin mbi baza më të përparuar të jetës së brendshme të vendit, dhe për zhvillimin më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor të tij...


³⁵ “Obzor”, U oçi proglašenje albanske nezavisnosti, nr.332, (22.11.1912, f.1).

³⁶ “Historia e popullit shqiptar” -I-, (f.351).

³⁷ “Historia e popullit shqiptar” -I-, (f.352).

HASAN PRISHTINA IDEOLOG I ÇLIRIMIT DHE I BASHKIMIT KOMBËTAR

Hasan Prishtina, ishte njëri ndër ideologët kryesorë të çlirimit dhe bashkimi kombëtar të shqiptarëve. Vepra dhe tërë jeta e tij kanë qenë të lidhura me fatin e kombit e Atdheut. Me një natyrë të çiltër, tejet komunikues, i dashur dhe i përkushtuar për bashkatdhetarët e vërtetë e të devotshëm, në anën tjetër të karakterit të tij ai ishte kundërshtar i pa kompromis kundër kolaboracionistëve dhe politikanëve që bënë pazare mbi kurriz të popullit. Në luftë për të realizuar aspiratat kombëtare, ishte i vetëdijshëm se duheshin bërë sa e sa sakrifica. Ishte në shënjestër të forcave reaksionare të Perandorisë turke por edhe të shteteve grabitçare të Ballkanit. Në rrugën e tij jetësore iu kishte përmbajtur motos: “Ka me m' shtruve vetëm vdekja”.



Kredoja e tij jetësore, trimëria dhe temperamentit tipik i shqiptarit me prejardhje nga Drenica, (zona spartane të Shqipërisë ndër shekuj), bënë që në qenien e tij të manifestoheshin vetitë më karakteristike të shqiptarit intelektual dhe luftëtar në të njëjtën kohë, demokrat dhe atdhetar ndër më të dalluarit e kohës. Qëndrimi i tij i palëkundur në zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare, bëri që jeta dhe vepra e Hasan Prishtinës të mbetet burim frymëzimi për të gjithë idealistët e kombit deri te Adem Demaçi, Adem Jashari dhe të gjithë trimat e trimëreshat e tri ushtrive tona çlirimtare. Emri i Hasan Prishtinës është emër nderi e respekti për brezat liridashës të shqiptarëve. Jeta dhe vepra e tij i përkasin Atdheut, gjithandej ku bukës i thuhet bukë, ujit ujë dhe kripës, kripë...

E VËRTETA HISTORIKE



“...nuk është dashur dhe nuk guxon që të ndryshohet
realiteti historik për Hasanin e madh”

Hakan Berisha

HISTORIA NUK NDRYSHOHET

Për vitin e lindjes së Hasan Prishtinës ka ndryshime në shkrime të autorëve të ndryshëm, por, unë do mbështetem në faktin historik-epitafin në pllakën e mermerit, e cila madhërisht qëndron mbi vendin ku pushojnë eshtrat e tij, në varrezat e Dëshmorëve në Kukës e që vërtetojnë se Hasan Prishtina është lindur në vitin 1873. Këtë konstatim, se Hasan Prishtina është lindur më 1873, e mbështesim edhe në rrëfimet e pasardhësve të shumë figurave atdhetare e kombëtare të miqve e luftë-tarëve të Hasan Prishtinës, por edhe duke u bazuar në shumë shkrime të deritanishmehistorike, ndër më të besueshmet e historianëve shqiptarë dhe të huaj.



Varri i Hasan Prishtinës në Kukës

Derisa për trungun familjar të Hasan Prishtinës, për paraardhësit dhe pasardhësit e tij, jemi mbështetur në shënimet familjare, fotografitë, faktet, dekoratat me vlera historike e shumë argumente të tjera të Hakan Berishës, nipit të Zejnullah begut, të cilat fakte ruhen në arkivin familjar të njeriut më të afërt të Hasan Prishtinës, në Mitrovicë.

Hakan Berisha përveç fakteve që posedon, ai me fanatizëm ruan fotografi dhe dokumente të kohës, të cilat argumentojnë së Hasan Prishtina ishte stërnip i Abdullah Veliqit nga fisi Berishë. Se Hasan Prishtina ishte i afërm i Zejnullah Begun e argumenton fakti i një sheme të trungut familjar të Familjes Berisha, të cilën e gjejmë në arkivin familjar të Hakan Berishës.

TRUNGU FAMILJAR

Hakan Ismet Berisha, nga Mitrovica, i cili është familjari më i afërt i Hasan Prishtinës, publikon realitetin e trungut familjar të Hasan Prishtinës. Ai, pas gjithë këtyre viteve, ishte konsideruar e respektuar nga të gjithë si më i afërmi i Hasanit, me një dozë nervozizmi shprehet: *“...nuk është dashur dhe nuk guxon që të ndryshohet realiteti historik për Hasanin e madh. Këtë e bëjnë vetëm ata që nuk mendojnë shqiptarisht, sepse, më shumë se 100 vjet të gjitha faktet historike, doktor shkencash, historianë e studiues të fushave të ndryshme kanë treguar se kush ishte dhe nga ishte Hasan Prishtina...”*

Me fillimin e shkollës shqipe në Mitrovicë, të themeluar nga Bedri Gjina, Hakani nis dhe e përfundon shkollimin fillor 5 vjeçar, pastaj në vitin 1943 ka vazhduar Shkollën Normale në Prishtinë me financimin-ndihmën e shtetit shqiptar. Pas përfundimit të Normales ka vazhduar studimet në fakultetin e Nishit, duke u kualifikuar si inxhinier i makinerisë. Hakan Berisha dhe familja e tij, si pasardhës të Hasan Prishtinës, gjithmonë kanë qenë nën përcjellje të regjimit serb.


Hakani shpjegon për familjen e tij e cila kishte jetuar në Vushtrri dhe prej kohësh ishte shpërngulur në Mitrovicë. Në Vushtrri kjo familje jetoi deri në vitin 1933/34, deri atëherë kur shtëpinë e tyre, e cila ka qenë shtëpi e ndërtuar mirë, me më shumë se 30 ari truall, e kishin marrë serbët dhe e kishin shfrytë-zuar si gjyq komunal.

Zejnullah begu dhe Hasan bej Prishtina kanë qenë djemtë e dy vëllezërve. Zejnullahu ka qenë i Abdullahut e Hasani i Ahmetit, kurse Abdullahu dhe Ahmeti kanë qenë te Aliut. Zejnullah begu kishte vetëm një motër e cila ishte e martuar në Turqi, kurse Hasani e kishte vetëm një vëlla Ymerin. Zejnullah begu, gjyshi i Hakanit, kishte katër djem; Qemajlin, Ismetin, Abdullahun dhe Besimin, si dhe dy vajza; Shukrijen dhe Naziren, kurse Hasan Prishtina nuk kishte fëmijë, ndër më të afërmit e tij ka qenë Elma, vajza e të vëllait, Ymerit.

Hakani i ka dy djem, Afrimin dhe Agronin dhe një motër e cila jeton në Prishtinë, e cila ka një djalë dhe një vajzë, që të gjithë me pasardhës.

Për Zejnullah begun deri më tash është shkruar shumë pak. Ai ka qenë njeri i madh, trim, i pasur dhe i shoqëruar me shumë atdhetarë të kohës. Hakani flet sipas kujtesës historike të lënë në shënim familjar nga gjyshja e tij, e cila ka jetuar 101 vjet; për takimin e shumë atdhetarëve, të tubuar në Kullën e tyre në Balincë. Në një rast i kishin bërë planet për organizimin e hyrjes së tyre në Sanxhak me qëllim të largimit të forcave çetnike nga ajo pjesë shqiptare. Për shkak të zbulimit të këtij plani ilegal, ky planifikim i tyre kishte mbetur i perealizuar.

Hakani mban mend qyshkur kishte qenë fëmijë se Veliqët e Palacit janë më të afërmit e tyre. Ai thotë se në një rast kur kishte ardhur Rexhep Veliqi dhe mixha Murat e kishin marrë babain e tij Ismetin dhe kishin shkuar në Balincë për të qëndruar katër vite aty. Gjatë asaj kohe Rexhep Veliqi e kishte ushtruar Hakanin (*Hakani atë kohë ikishte vetëm 14 vjet*) se si kalërohet, si duhet përdorur pushkën dhe si duhet shkrepur me revole dhe pas kapitullimit të Gjermanisë, krejt pasurinë e tyre në Balincë e kishin konfiskuar serbet.



Shema e paraardhësve dhe pasardhësve të Hasan Prishtinës

VIZITA NË TRUALLIN E TË PARËVE

Hakani shpjegon se si para disa muajsh kishte qenë i ftuar në Lagjen Veliqi në Palac dhe kur kishte shkuar aty, kishte përjetuar emocione të papërshkruara, sepse kishte qëndruar në truallin e të parëve të tij, aty ku i pari i tyre Abdullah Veliqi e ka varrin. Hakani aty pas kaq viteve ishte njohur me djalin e Rexhep Veliqit, me Zeqirin, babain e të cilit gjithmonë e kishte respektuar për kushëri të vetin, si dhe ishte takuar e çmallur edhe me shumë të afërm e kushërinj, që konsiderohen dhe në realitet janë të afërm të Hasan Prishtinës. Hakani kishte poseduar një fotografi ku ishin Zejnullah begu dhe Rexhep Veliqi, por edhe posedon shumë fotografi familjare e dokumente arkivore që vërtetojnë se Hasan Prishtina dhe Zejnullah begu trungun familjar e kanë nga Lagjia Veliqi të Palacit.



Faksimile e pasaportës së Zejnullah begu, lëshuar në vitin 1914

Kur ka dëgjuar Hakani se një person me mbiemrin Prishtina pretendon së është stërnip i Hasan Prishtinës, i kishte telefonuar Gazmend Boletinit, i cili e kishte takuar atë person dhe kishin shkuar së bashku në Shkup, ai i kishte shpjeguar se të gjithë e dinim se vetëm Hakani është më i afërmi i Hasan Prishtinës dhe është shok me babain tim. Pas një kohë edhe vetë Hakani e kishte ftuar në një takim, ai pas një kohe kishte ardhur në Mitrovicë dhe ishin takuar. Hakani i kishte thënë atëherë dhe vazhdon të qëndrojë pas asaj se Mehmeti mund t'i ndërrojë një mijë mbiemra por një gjë duhet ta ketë të qartë se ky njeri nuk ka lidhje as me trungun e as me gjakun e Hasan Prishtinës.

Ai nuk është dhe nuk mund të jetë pasardhës i Hasan Prishtinës, sepse Hasani nuk ka pasur as ka lënë pasardhës të vetin. Ky person dhe secili që pretendon ta shtrembërojë historinë e ndritur të Hasan Prishtinës, mund të jetë më së paku shqiptar, sepse jam i sigurt se këtë e bëjnë për ndonjë qëllim jo të mirë. Hakani shprehet kështu: *“Turp është për institucionet shqiptare në Tiranë, në Prishtinë dhe në Shkup që të nënshtrohen para një individi për shkak të investimit të tij në shtatore te Hasan Prishtinës. Atë është dashtur ta bëjë shteti, sepse Hasan Prishtina ka dhënë më shumë se çdokush për shqiptari, prandaj shteti është dashtë të përkujdesej edhe për këtë e jo të përqafohen me njeriun e ta falënderojnë atë që nuk e ka as fis as farë Hasan Prishtinën. Unë nuk kam asgjë kundër Mehmetit, as kundër askujt që kontribuon për shtatoret dhe veprën e Hasan Prishtinës, por mos të ëndërrojë kush që do të mund ta blejë Hakanin me pare e ta shtrembërojë historinë e një njeriu aq të madh, siç ishte Hasan Prishtina...Na nuk mund të durojmë më, jemi shumë të zhgënjyer me këto veprime skandaloze...”*⁴¹

Hakani i ka dërguar letër edhe Kryeministrit të Shqipërisë duke kërkuar një takim urgjent për t'ia sqaruar edhe atij se kjo që po ndodh nuk është e vërtetë. Letrën ia ka dërguar para 28 nëntorit dhe i ka shpjeguar se kush është pasardhësi i Hasan Prishtinës. Hakani, sot, në emër të familjes demantonë atë që flitet e thuhet se pasardhësi i Hasan Prishtinës është Mehmeti. *“Dihet botërisht se Mehmeti është nga Samadrexha e jo nga Palaci i Drenicës, këtë e di unë dhe e dinë të gjithë ata që duhet ta dinë!”*



Zejnullah begu dhe Hasan Prishtina

Hakani nuk e fsheh mllefin duke potencuar se i ka ngelur hatri kur kishte dëgjuar për pajtimin e Mehmetit me familjen mbretërore të Zogut, edhe atë në prezencën e burrave të shtetit shqiptar, ai për këtë na rrëfen dhimbshëm duke thënë; *“...unë jam ndier shumë keq, motra më thirri në telefon, më qortoi mua duke më thënë mevaj në buzë: “Qysh po lejon bre vëlla?!” , unë nuk dija si t'i përgjigjem, i thashë se nuk mundem për të bërë asgjë, me pare bën njeriu gjithçka, t'ia shtrijë dorën armikut të familjes sonë, ai nuk mund të jetë anëtar i kësaj familje e aq më pak gjak shqiptari...”*. Pastaj vazhdoi me nervozizëm duke shprehur pakënaqësinë e tij dhe të familjes duke thënë se askush nuk e ka autorizuar asnjë njeri që ta shtrijë dorën e pajtimit me armikun tonë. Ai e ka bërë këtë, por Hakani nuk ka ndërmend ta bëjë këtë kurrë për jetë duke thënë se unë kam fytyrë, jam shqiptar, jam drenicas dhe mburret me atë që të parët e tij kanë qenë Veliqët e Palacit të Drenicës.

Hakani përmend edhe pasurinë e tyre që ekziston në Balincë, atje janë mbi 197 hektarë të shënuar në tapitë e tyre që i kanë të ruajtura edhe sot, por pasi që kanë hyrë partizanët në këto anë, në kullën e tyre është vendosur, si uzurpator, një njeri i cili ka qenë në shërbim të UDB-së. Kulla edhe tash ekziston në të njëjtin vend. Gjatë luftës së fundit ka qenë e granatuar por jo edhe aq shumë sa është shkatërruar nga keqbërësit e kësaj kohe!? Sot kjo kullë është e regjistruar si pronë shoqërore, por ka pretendime që kjo kullë të shpallet “Kompleks Memorial”, për të cilin propozim edhe familja edhe vetë Hakani janë të pëlqimit. Kjo familje asnjëherë nuk pushon së kërkuari që edhe eshtrat e të madhit Hasan Prishtina të sjellën në Kosovë.


Kur përmendet vrasja e Hasan Prishtinës, Hakani i shpjegon dy gjëra shumë interesante, të mbajtur në kujtesën e gjyshes së vet e që për herë të parë shkruhet në këtë libër:

1. *“Jam shumë i sigurt se po të kishte qenë gruaja e Hasanit, Igballja me të, në asnjë mënyrë nuk do të ishte vrarë Hasani, sepse ajo ka qenë shumë vigjilente dhe asnjëherë nuk ka shkuar pa revole. Ajo, atij tradhtarit të Zogut kishte me ja shkrep para se ai t'ia shkrephte Hasanit!”*

2. *“Në një rast tregonte gjyshja, kur ishte Hasani në Stamboll, Zogu i kishte telegrafuar Ataturkut të ruhej se Hasan Prishtina ka ardhur që të vrasë, por pasi që Hasani e merr vesh këtë punë, largohet nga Turqia dhe vendoset në Vjenë. Edhe atje Zogu e paguan një njeri që ta përcjellë Hasanin dhe ta vras. Atentatori i paguar nga Zogu, i del Hasanit para, por nuk mund t'i ngrehë gishtin armës, i thotë: nuk munda të të vras, o Hasan pasi edhe unë jam shqiptar”*.

Këto fakte historike që ruhen në kujtesën e Hakan Berishës, janë të vërteta dhe të mbështetura në shumë fakte dhe të ruajtura në shënime familjare

për paraardhësit e tyre. Janë fakte të pakontestueshme dhe thuajse të njëjta me shumë shkrime të historianëve, të autorëve të ndryshëm që janë marrë me studime historike për figurën e atdhetarit Hasan Prishtina. Këto fakte të shkruara në këtë libër, më së miri mund të vërtetohen, ose të krahasohen me argumentet e shënuara në librin e Prof. Dr. Muhamet Pirrakut “Gjenealogjia e Hasan Prishtinës”, në të cilën ai zbërthen, deshifron e argumenton për trugun familjar të ideologut e patriotit Hasan Prishtina, duke përkujtuar historinë, jetën dhe veprën e tij dhe të paraardhësve e pasardhësve të tij.



Kjo listë e tapisë është e përpiluar nga vetë dora e Hasan Prishtinës dhe për çudi është e përpiluar aq mirë sa që e gjithë pasuria e tyre është e llogaritur dhe e ndarë deri me një gosh, secilit çka i ka takuar, prej të parit e deri tek i fundit, përveç Hamamit në Mitrovicë që i kishte mbetur Zejnullah Begut dhe Izet Badivukut.

Kurse për Hasan Prishtinën, Hakani ka shumëçka të thotë, por ai, në shenjë respekti për figurën e Hasan Prishtinës, nxjerr nga sirtari dokumente arkivale, tapi të pasurive, fotografi, dekorata e argumente të tjera *(të gjitha të shënuara për vitin dhe vendin e fotografive)* që mund të thuhet se heq të gjitha dilemat për trungun familjar të Zejnullah begut dhe Hasan Prishtinës.



Medalje me vlerë historike


FUNDI I RRËFIMIT I HAKAN BERISHËS

Duke e përmbyllur këtë shkrim të regjistruar edhe në shirit filmik, nga Hakan Berisha, nip i Zejnullah begut, i cili është më i afërmi i Hasan Prishtinës, jam i befasuar me faktin se si ka mundur të ndodhë që për 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, në Kosovë të dekorohet me dekorata e mirënjohje si më i afërmi i Hasan Prishtinës, kurse në Shqipëri e në Maqedoni të dekorohet njeriu tjetër, që sipas Hakan Berishës nuk ka lidhje farefisnore me familjen e Hasan Prishtinës. Hakani në fund na i tregoi të gjitha dekoratat dhe mirënjohjet që ndër vite i ka ruajtur si trofe të vlefshme në shenjë nderi e respekti për Hasan Prishtinën. Prandaj duhet të shkruhet e të thuhet, të reagohet e të punohet drejt e mirë, t'u thuhet ndal punëve jo të mira, sidomos keqinterpretimit të fakteve historike për njerëzit e mëdhenj.



Hakan Berisha, Mirënjohjen që e ka pranuar në emër të familjes së Hasan Prishtinës





Hakan Berisha me autorin




Hasan Prishtina



Zejnullah Begu me bashkëveprimtarë

**HASAN PRISHTINA
I MUNGON SHQIPTARISË**



“Vetëm me dije, me shkollim këto troje do të mbesin e do të
quhen troje shqiptare...”

Hasan Prishtina

KUJTIMET E PLAKUT PËR HASAN PRISHTINËN ³⁸

Palac 2013

Të flasim e të shkruajmë për figurën e Hasan Prishtinës duhet shumë kohë e duhet të mbushen edhe shumë e shumë faqe të historisë, dhe kurrë nuk është mjaftueshëm. Hasan Prishtina është fakt se prejardhjen e ka nga Palaci, por ai ka qenë i krejt popullit shqiptar, i krejt Kosovës dhe i gjithë shqiptarisë.

I

Tash dua t'ua tregoj disa raste, ashtu siç më ka treguar plaku im-baba Rexhep, i cili ka qenë për 14 vite ushtar i tij, kur e përmendte emrin e tij ju mbushnin sytë me lot, kurse për Habib Kukiqin, më ka treguar baba Rexhep se ka qenë shumë i aftë, edhe si luftëtar, edhe si njeri i shpejtë në përdorimin e armëve, por edhe i hollë nga mendja, çdo shtet që ka ardhur këtu, ai për tre muaj e ka mësuar gjuhën dhe ka qenë i aftë të bëhet përkthyes (*thuhet se Habibi i ka njohur gjashtë gjuhë të huaja*), pastaj në një rast kur kanë qenë duke shkuar për Mitrovicë, kanë kaluar nëpër Vushtrri, në pajton ish-in Plaku, Hasan Begu, Habibi dhe pajtonxhiu, kur kalojnë nëpër Urë të Gurit në Vushtrri, Habibi kërcen nga pajtoni dhe fillon të ecë nëpër mbajtësen e urës, kurse Hasani i kishte thënë pajtonxhiut që ta ndalë pajtonin e të ka kujdes, nga frika se mos po rrëzohet Habibi e po dëmtohet, sepse aq e kishte dashur Habibin sa nuk mund të përshkruhet.

II

Rasti tjetër interesant ka qenë kur kanë tentuar të bëjnë atentat mbi Hasan Begun, Hasani kishte qenë duke shkruar në tavolinën e vet, Plaku - Rexhep Veliqi, ka qenë afërderës kurse Habibi në një qoshe të dhomës duke shikuar në një pasqyrë që dukej Begu dhe dera e dhomës, kur në derë kishte hyrë atentatori, e sheh Habibi që po tenton ta nxjerr revolen për t'ia drejtuar Hasanit, ky kërcen nga aty, mbi tavolinë e ia nxjerr revolen prej dore dhe e vret me revole të vetën. Disa ditë kishte mbetur kufoma e atentatorit aty, nuk e kanë larguar me qëllim, sepse atë kohë ishte përhapur fjala se Hasan Prishtina po i vret njerëzit e vet, këtë propagandë e kishin përhapur zyrtarët “hyqymeti” i shtetit okupues, prandaj kur kanë ardhur ekspertët ndërkom-bëtarë e kanë bërë ekspertizën dhe e kanë vërtetuar se ishte tentim vrasje e atentatorit ndaj Hasan Begut, kurse vrasja është kryer nga Habib Kukiqi, në përpjekje për ta shpëtuar Hasanin.

III

Një rast tjetër është dhe ia vlen të përmendet, kur Hasan begu së bashku me Habib Kukiqin e me disa të tjerë kanë ardhur nga Vushtrria në Kullën e Ahmet Delisë për t'i sjellë disa mjete për në tubimin e Marinës, me qëllim të organizimit të një kryengritjeje, ata para se me arritur në Prekaz, kishin ndaluar

IV

në Kodrën e Galicës dhe Hasani u thotë: *“A po e shihni atë mjegull mbi L'kenin tonë, aty e kam të varrosur stërgjyshin tim, aty e kam trungun familjar...”*

Të flitet për Hasan begun, të mundohet pët ta shtrembëruar historinë e atij njeriu aq të madh, është mëkat, sepse Ai ka qenë i krejt shqiptarisë. Atëherë kur e kanë ndarë tokën me Prekaz, na Veliqët jena në kufi “mexhë” me Prekaz, kanë qenë Zenel Musliu i Prekazit, Hajrullah Kotorri i Kotorrit, Hasan begu dhe mixha im Avdyli, mixhën e kanë marrë për t'i hapur vendet e gurëve-mexhave, ja kanë nis të L'keni, e kanë ndarë përgjysmë, kanë shkuar kah çeshmja, nëpër Malin e Stafës e kanë dalë te Kodra e Dëshmorëve (*ish Kralica*), sot është guri aty, atij guri i kanë thënë Guri i Dashefcit, pasi e vendosin gurin aty, Hasani ia jep një shuplakë mixhës, kurse Hajrullahu e pyet Hasanin, i thotë: *“-...pse Beg po i bjen Avdylit?”* Hasani qeshet dhe i thotë Hajrullahut: *“...nuk është se po dua me bërë për asgjë, por ky djalosh nuk ka për ta harruar kurrë këtë vend të mexhës...”* Pastaj vazhdojnë për Mikushnicë, kalojnë kah Kika dhe ndalojnë për një pushim, Hajrullahu i drejtohet Hasanit: *“..Beg, po më duket se po ua mban krahun tuajve”* Hasani ia merr fjalën nga goja dhe i drejtohet Hajrullah Kotorrit: *“E more Hajrullah, ty të paça, po mos me më ardh marre prej popullit tash ishim prish unë e ti. Unë jam Veliq, po një mbaje mend; Veliq e Prekaz e kah ka shqiptar unë i kam vëllezër, unë nuk dalloj as Prekazin as Palacin e aq më pak Veliqët e lagjet tjera, sepse unë jam i të gjithëve ashtu siç të gjithë janë të mijtë...”*

V

Dua të tregoj edhe një ngjarje mjaft interesante që mua më ka treguar disa herë Plaku im. Në një rast kur Hasan Prishtina kishte shkuar te Haxhi Zeka, kurse Plaku im dhe Habib Kukiqi kanë qenë përcjellës të tij dhe Haxhi Zeka asnjëherë nuk ishte ngritur në këmbë për t'i pritur ose përcjell ata që kanë shkuar në kullën e tij, por kur kishte shkuar Hasani, Haxhi Zeka ishte ngritur në këmbë dhe e kishte përshëndetur atë. Bejlerët e Pejës e kishin pyetur Haxhi Zekën se si është e mundur që u çove për këtë djalë të ri e i bërë kaq nder, kurse Haxhi Zeka u përgjigjet krerëve të bejlerëve: *“...o burra, po t'i bashkojmë edhe shumë koka nuk do të mund të bënin sa një kokë të këtij djaloshi që quhet Hasan Prishtina, prandaj e ka e do ta ketë nderin tim sa të jam gjallë.”*

VI

Dihet saktësisht se edhe turqit kanë qenë kundër Hasanit, sepse Hasani ka qenë në anën e popullit të vet e sidomos për shkollimin e popullit në gjuhën shqipe dhe në një rast kanë pyetur se a ka Hasan begu ushtarë që e mbrojnë atë sepse kanë menduar për Hasan begun se din për të luftuar vetëm me penë “kalem”, e për ta zënë ngushtë Hasanin nuk besoj se ka mundur kush mbi këtë faqe të dheut, dhe kur dëgjon Hasani vjen në Drenicë-Palac, bashkë me Rexhep Veliqin e me Habib Kukiqin, ndalon në lagjen tonë dhe e mobilizon

Muharrem Veliqin, Nuredin Hasanin-Veliqin, Shaban Memishin-Kocin, Besim Kabashin, Bislim Grudën e disa të tjerë dhe i bën 25 ushtarë të armatosur dhe shkojnë te Ura e Gurit, ku takohen me një ekip ndërkombëtarësh për ta vërtetuar se Hasan Prishtina ka ushtrinë e vet. Kështu më ka treguar Plaku im, bile ai e thoshte shpeshherë se Hasan beg Prishtina i ka pasur depot “magazet” e veta prej Shkupi e deri në Zubin Potok dhe të gjithë mallin e vet e ka shkrirë për çështjen kombëtare dhe për shkollat shqipe, sepse pasuria më e madhe dhe më me vlerë e tij ka qenë shkollimi i të rinjve shqiptarë në gjuhën amtare dhe ribashkimi i trojeve etnike shqiptare.

VII

Edhe sot, edhe nesër, edhe pas mija viteve kur të përmendet emri i Hasan beg Prishtinës, duhet me qenë i përmbajtur, i sigurt dhe i vendosur se çka të flitet e çka të thuhet për të, e jo të shtrembërohet historia e tij, sepse Ai ka qenë i madh. Unë besoj dhe jam i sigurt se edhe sot shqiptarisë po i mungon koka e Hasan Prishtinës. S'ka ma Hasan! Ka me kaluar kohë e kohë derisa të lind një Hasan Prishtinë në shqiptari.

Të gjithë ata që po mundohen me thënë diçka të re për figurën e Hasan Prishtinës duke u munduar që ta shtrembërojnë historinë e drejtë qindra vjeçare, ndoshta kanë qëllime të këqija, por e kanë të kotë sepse historia e Hasan Prishtinës nuk ndryshohet!



Gjatë grumbullimit të shënimeve në odën e Zeqir Rexhep Veliqit, Palac, 2013

³⁸⁾ Zeqir Rexhep Veliqi; “Kujtimet e Plakut për Hasan beg Prishtinën”, shënime për autorin

LËVIZJET E PATRIOTËVE TË KOHËS

Plakut Behram Feka, 95 vjeçar nga Koshtova e Bobit, kujton lëvizjet e patriotëve të kohës në Koshtovë siç ishin: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Ferat Draga e shumë atdhetarë të tjerë. Plaku mban në kujtesë rrëfimet e babait të vet edhe për hapjen e shkollës së parë shqipe në këtë fshat, e cila ishte bërë me iniciativën e Hasan begut e të patriotëve të tjerë. Për ndërtesën e shkollës së parë shqipe në Koshtovë, plaku kthen kujtesën të vitet e hershme të asaj kohe, duke kujtuar oborrin e saj plot me nxënës të moshave të ndryshme, por edhe shndërrimin e saj në mejtep e pastaj edhe në xhami *“Koha e bën të vetën!?”*, thotë Behram Feka. Për Hasan Prishtinën thuhet se gjithmonë ka punuar për komb e për atdhe, kurse plaku Behram e ka dëgjuar me mijëra herë së është folur, qysh në atë kohë, se Hasani trungun familjar e ka nga Veliqët e Palacit të Drenicës. Ai ka pasur autoritet të madh në popull, jo vetëm në Koshtovë po në të gjithë shqiptarinë, sepse ishte njeri i madh, vizionar e i shquar sa që edhe sot e shumë shekuj është zor të lindet soji i tij. Behrami citon fjalët e pleqve të kësaj ane kur ishte dhënë lajmi për vrasjen e Hasan Prishtinës; *“...ai, bre, a keni ni çka ish ba? Ish vra Hasani...na ka thy krahun, bre!...”*

Behram Feka mban mend edhe shumë luftëra që janë zhvilluar në këto anë, në mes të shqiptarëve dhe çetnikëve, bile në disa beteja, si i ri kishte qenë pjesëmarrës i tyre, p.sh. atë që ishte zhvilluar te *“Çuku i marikut”* në Koshtovë, betejë të cilën e kishte udhëhequr Jusuf Hasani me bashkëluftëtarë, si Nebih Ibrahim, Halimi i Smajlit, Abazi i Ferizit, Rama i Osmanit, Haradini e disa të tjerë. Derisa për fund plaku koshtovas, 95 vjeçari Behram Feka, duke folur e kujtuar për Hasan Prishtinën, gati me sy të përplotur na thotë: *“Gjithmonë është folur mirë e do të flitet për Hasanin, derisa t'i bie rrezja e diellit kësaj toke. Ai ka qenë njeri i madh”*.³⁹



Me Behram Feken (95 vjeçar)



Hasan Prishtina

³⁹) Behram Feka, 95 vjeçari nga Koshtova e Bobit; “Kujtime për Hasan begun”, rrëfime për autorin.

HASAN PRISHTINA ISHTE DHE ËSHTE I TË GJITHËVE

Samedin Kukiqi, nip i Habib Kukiqit nga Tërsteniku i Drenicës, rrëfen për gjyshin e tij i cili kishte qenë trupprojë e Hasan Prishtinës, plot 14 vite. Për ato kohë të vështira, Samedini kthen kujtesën dhe kujton fjalët e gjyshit të vet që asnjëherë nuk i ka harruar. Në një rast kur kishte pasur një sulm me revole mbi Hasan Prishtinën, babagjyshi i tij e kishte shpëtuar duke ia nxjerr revolen nga dora atentatorit, kështu që Habibi e kishte marrë një plagë në dorë, por falë shkathësisë së tij Hasani kishte shpëtuar nga vdekja.

Sipas kujtesës dhe shënimeve familjare, Habib Kukiqi bashkë me Hasan Prishtinën e me shumë luftëtarë të tjerë kanë marrë pjesë në shumë beteja. Në një betejë të ashpër me forcat serbo-çetnike, në afërsi të Merdarit, Habibi plagoset në gjoks, por për fat të mirë i shpëton vdekjes dhe shërimi i tij zgjat shumë edhe pse në mungesë të mjekëve por shërimi del i suksesshëm dhe Habib Kukiqi shpëton nga ajo plagë e rëndë.

Për Hasan Prishtinën po flitet e po shkruhet gjithçka, kur dikush thotë se është Aliuk, tjerët thonë ndryshe por një e vërtetë është që s'mund ta ndryshojë askush, Hasan Prishtina rrjedh nga Vëllazëria Veliqi, këtë e vërteton edhe Samedin Kukiqi, gjithmonë sipas rrëfimeve të gjyshit, por ai e thotë edhe një thënie mjaft interesante: *“Dikush thotë është i imi, tjetri i imi e unë dua të them se Hasan Prishtina ka qenë i krejt shqiptarisë”* dhe këtë thënie nuk mund ta mohojë askush, sepse është shumë e vërtetë se Hasani ka qenë, është dhe do të mbetet i të gjithëve.⁴⁰

Hasan Prishtina dhe Habib Kukiqi, pas shumë përpjekjeve për ta bërë Shqipërinë Shqipëri, vjen koha dhe i ndajnë rrugët, Hasani shkon në Selanik, kurse Habibi ndalon diku në afërsi të Kukësit. Atje Habibi shoqërohet me Dastan Sylë Elezin, një luftëtar e patriot i devotshëm i çështjes kombëtare, i cili ishte nga një familje me tradita atdhetare. Gjithashtu Habibi, mbante lidhje të mira me Bajram Currin, Luigj Gurakuqin e Tahir Berishën, *(me këtë të fundit ishin vëllazëruar)* si dhe me shumë patriotë të tjerë të kohës.

Samedini, në moshën 17 vjeçare, iu kishte bashkëngjitur Shaban Palluzhës e Mehmet Gradicës për të vazhduar rrugën e gjyshit të vet për lirinë e atdheut.

Familja e Habib Kukiqit e din se ai ka vdekur dhe është i varrosur diku në Kukës, ata edhe sot kërkojnë që të gjendet varri i tij dhe eshtrat e Habibit të sillen në Kosovë, për lirinë e së cilës nuk pushoi së luftuari deri në vdekje.

40) Samedin Kukiqi, nga Tërsteniku, “Kujtime për Hasan Prishtinën e Habib Kukiqin”, rrëfime për autorin.

SHABAN MEMISH KOCI, USHTAR I HASANIT

Avdullahu shfleton shënimet familjare sipas rrëfimit të xhaxhait të tij, Rexhë Kocit, i cili thotë se shkollën e parë shqipe në Palac, në vitin 1909 e kishte hapur Hasan Prishtina dhe ditën kur është përruruar shkolla e kishte sjell bandin muzikor nga Vushtrria. Shkolla fillimisht ishte vendosur në Plemen e Ramadan Kerollit, por aty mësimi ishte mbajtur gjatë kohës së verës, kurse gjatë vjeshtës dhe dimrit ishin zhvendosur në një odë të fshatit.

Babai i Avdullahut, Shaban Memish Koci, ishte ushtar i Hasanit për më shumë se gjashtë muaj. Ata fillimisht në mënyrë të organizuar kishin marshuar nga Kosova, më saktësisht nga Vushtrria për në Shqipëri. Nga këtu ishin nisur 800 veta, të gjithë të organizuar dhe të armatosur mirë, kurse kur kishin mbërritur në Prizren kishin mbetur 400 veta për të vazhduar rrugën drejt Kukësit derisa të vendoseshin në Lumë. Pas qëndrimit të tyre gjashtëmuajor në Shqipëri, kishte ardhur një urdhëresë me të cilën kanë pasur mundësi të vazhdojnë qëndrimin e tyre në radhët e ushtrisë së Hasan Prishtinës, me pagesë mujore, por ndërprerja e shërbimit dhe kthimi i Shabanit në shtëpi ka qenë shkaku i shëndetit të keqësuar të tij.

Sipas kujtesës historike dhe shënimeve familjare në familjen e Shaban Memish Kocit të gjitha shënimet e vërtetojnë se trangu familjar i Hasan Prishtinës është nga vëllazëria Veliqi të po kësaj lagjeje të Palacit, bile Shabani, siç e thotë biri i tij Avdullahu, asnjëherë nuk ka thënë se është nga ajo apo kjo lagje, por i Veliqëve, kurse për Aliukët thoshte se kanë qenë nga Samadrexha të ardhur këtu e të vendosur në tokat tona.⁴¹

VEPRA E TIJ PËRPUTHET ME JETËN E TIJ

Sipas imagjinatës sime, unë Hasan Prishtinën e shoh si një qiri që edhe sot shndrit në trojet shqiptare, i cili dha çdo gjë nga vetja e tij, disa herë e rrezikoi edhe veten, pra ishte një prijatar, ishte një fanar që shndriti, por mund të them se ishte edhe një udhë-rrëfyes për popullin shqiptar, se si duhet një shqiptar, një intelektual të gjendet në aso situata aq të mjegulluara, në aso situata aq delikate të rrugës së popullit shqiptar për liri e për bashkim kombëtar. Pra e shoh si një intelektual të kompletuar që vepra e tij përputhet me jetën e tij, sepse ne kemi nganjëherë intelektualë e atdhetarë të mirë, por sikur ta shikojmë jetën e tij, ajo nuk përputhet me veprën e tij, kurse Hasan Prishtina ka qenë edhe njeri i punës, edhe i fjalës, edhe i dijes por edhe i pathyeshëm në rrugën e synimeve të veta. Ai ka dhënë çdo gjë prej vetvetes vetëm e vetëm që populli shqiptar të dalë nga errësira. Ai e dha edhe unazën-myhyrin e fundit për çështjen e arsimit shqip.⁴²

41) Kujtesa historike për familje dhe shkollën, Abdullah Shaban Koci, veteran i arsimit.

42) Shënime historike për Hasan Prishtinën, Bilall Bajram Koci, arsimtar. aktor.

ABETAREN E PARË E SOLLI HASAN PRISHTINA

Hasan Prishtina një pjesë të jetës së tij e ka kaluar në Koshtovë, sepse ai e kishte një pjesë të pasurisë - tokës që shtrihej prej Koshtove në Zubç e deri në Zubin Potok (*sot të pushtuara nga serbët*). Në atë kohë njerëzit tuboheshin shpesh dhe bisedonin për raste të ndryshme, ku më së shpeshti vinin Hasan Prishtina, Isa Boletini e Ferat Draga. Në një rast, sipas kujtesës historike, në vitin 1903 në Kokol, një vend në kodrën e Koshtovës, pikërisht në odën e Miran Alisë takohen këta tre burra, sipas traditës aty tubohen edhe shumë njerëz të fshatit Koshtovë dhe në bisedë e sipër Hasani hap bisedën dhe shtron pyetjen për hapjen e shkollave shqipe, duke thënë se pa dituri nuk ka ardhmëri. Të gjithë fshatarët fillojnë të ankohen për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, por falë zemërgjerësisë së këtyre tre burrave, të cilët i afrojnë ndihmë fshatit për shpenzimet e ndërtimit të shkollës, ajo u ndërtua dhe filloi punën, derisa vendin për shkollë e dhuroi i zoti i konakut, Miran Alia.

Kështu në Koshtovë kishin filluar negociatat për ndërtimin e shkollës së parë shqipe. Në vitin 1905 në Koshtovë fillon mësimi fetar në shkollën e re, por gjithsesi me inici-ativën dhe kontributin e të madhit Hasan Prishtina. Ngjarjet zhvilloheshin sipas rrjedhave historike, të njohura botërisht dhe kjo shkollë punon për 7 vite ku përveç lëndëve fetare ligjërohej edhe në disa lëndë shkencore si gjeografi, histori e disa lëndë të tjera me rëndësi kombëtare. Kjo shkollë për ta arritur madhësinë e saj, në vitin 1915 fillon ligjërimin kryekëput në gjuhën amtare, ku mësues i parë emërohet Jusuf Rexha, i cili e kishte përfunduar kursin pedagogjik dhe kështu për herë të parë shpaloset Abetarja në gjuhën shqipe, para afro 25-26 nxënësve të kësaj shkolle. Këtë Abetare e kishte sjellë i madhi Hasan Prishtina, të cilën ia kishte dhënë mësuesit Jusuf Rexha duke e udhëzuar atë se si të punohej me nxënës.

Mësuesi qysh në ditën e parë nxënësve iu kishte shpjeguar për shkronjën *A-atdheu* dhe u flet për atdheun, më pas për shkronjën *Gj-gjuha* dhe shkronjën *F-flamuri*, duke ua treguar nxënësve se si këto tri gjëra duhet ruajtur si sytë e ballit. Kështu filluan hapat e parë në shkollën e parë shqipe në Koshtovë të Bobit.

Shkolla punon për tri vite, pa pasur asnjë pengesë nga regjimi austro-hungarez, kështu që më 1918, kjo pjesë e Kosovës prapë pushtohet nga Serbia dhe shkolla do të mbyllet nga pushtuesit serbë për t'u rihapur prapë në vitin 1943. Shkolla thuhet se është hapur në Zhabar, në gjuhën serbe, por nuk mbahen shënime e as nuk flitet në popull se ndokush ka vijuar apo përfunduar atë shkollë në gjuhën serbe.

Hasan Prishtina shkriu gjithë pasurinë e vet për arsimin shqip. Ishte dashamir i shkollës shqipe, i ditorisë, i arsimit, ai gjithmonë thoshte: "*Vetëm*

“Vetëm me dije, me shkollim këto troje do të mbesin e do të quhen troje shqiptare...”

Hasan Prishtina nuk ka luftuar vetëm për veten e tij, vetëm për vendin e tij apo për lagjen e tij, por lufta e tij gjithnjë ka qenë për Kosovë, për shqiptari, për bashkim të trojeve shqiptare. Hasan Prishtina ishte njeri i madh, ishte shpirti i kombit, e donte kombin e vet, e donte arsimin, e donte vetveten. Sikur ta kishte sot Kosova një mendje, një kokë, një personalitet si Hasan Prishtinën shumë më mirë do t'i kishte punët.

Po i citoj disa fjali të Mustafa Asim Krujës, i cili jo rralë i kishte përsëritur në shumë vende, duke e ngritur figuren e Hasan Prishtinës:

“Fjala e tij, penda e tij si dhe kuleta e tij janë në dispozicion të çështjes kombëtare. Në tribunën e parlamentit ai është Jupiteri që gjëmon dhe ua kthen të tjerëve vetimat nga qielli mbi kokën e armiqve të popullit shqiptar!”



Shkolla e parë shqipe në Koshtovë të Bobit

ATA JETOJNË NË KUJTESËN E POPULLIT

Për Jusuf Rexhën më së miri flet populli dhe historia e popullit. Veprimtaria e Jusuf Rexhës tash ka filluar të shkruhet dhe emri i tij po shënohet në historinë e shkollës shqipe krahas emrit të të madhit Hasan Prishtina, dhe falë këtyre shkrimeve e fakteve historike po tregohet se fshati Koshtovë, qysh në vitin 1915 ka qenë celula e parë e arsimit shqip në rrethin e Mitrovicës. Nexhi duke rrëfyer për shkollën shqipe, për Abetaren që e sollti Hasan Prishtina për herë të parë në dorën e gjyshit të tij Jusufit e për shumë gjëra të tjera të pashkruara e të pathëna deri më tash shprehet: *“Unë të flas për Hasan Prishtinën jam i ri, por atë që e kam dëgjuar nga gjyshi e nga babai mund të them se ai ka qenë njeri shumë i madh, ideolog i çështjes kombëtare, kurse për gjyshin tim le të fletë historia. Unë jam krenar që e pata gjysh Jusuf Rexhën e gjyshi im ka qenë i afërt me Hasan Prishtinën...”*. Historia e drejtë e këtyre figurave eminente të kombit shqiptar, ndër vite është mohuar nga sistemi monist dhe ka bërë që të mos përkujtohen deri vonë, por sot falë atyre që asnjëherë nuk ndaluan rrugën e Hasan Prishtinës e sollën lirinë e Kosovës e bashkë me të edhe faqet e ndritura të historisë sonë kombëtare, ringjalljen e shumë figurave të shquara kombëtare. Kjo më së miri tregon se shkolla në fshatin Koshtovë, sot mban emrin e mësuesit të parë të shkollës shqipe në këtë fshat. Vepra dhe emri i njerëzve të mëdhenj si Hasan Prishtina e shumë të tjerë nuk humbin kurrë. Ata jetojnë në kujtesën e popullit. Ata janë e do të mbetën në shpirtin e popullit e në faqet e para të historisë sonë më të re.⁴³

VARRI I PARAARDHËSIT TË HASANIT

Duke mos dashur t’iu hyjë në hak atyre që bënë histori, Xhafer Koci, i cili e kishte njohur personalisht Rexhep Veliqin, tregon për burrin që i kishte shërbyer si truprojë e Hasan Prishtinës për 14 vite, kurse Hasani në shenjë respekti e besnikërie për Rexhepin, ia kishte dhuruar 14 hektarë tokë. Për rrethanat e krijuara në familje Rexhepi heq dorë nga ajo pasuri, por gjithsesi ai sa ka shërbyer truprojë e Hasanit ka jetuar atje.

Kurse për truallin e të parëve të Hasan Prishtinës Xhaferi me vendosshmëri thotë: *“...edhe sot ekziston shenja e truallit të të parëve të Hasanit, është në hyrje të lagjes, afër trafos që sot aty është i vendosur Tahir Veliqi...bile thuhet se të parët e Hasanit më të afërt janë me Manxhollët e Mikushnicës se me këta Veliqët këtu”*. Argument më i fuqishëm, për të parët e Hasan Prishtinës se janë Veliq, sipas Xhaferit është edhe sot varri i Avdullah Veliqit, te L'keni, këtë nuk mund ta mohojë askush.⁴⁴


43) Nexhuk Rexha, nip i Jusuf Rexhës, “Shënime për Hasan Prishtinën e Jusuf Rexhën”

44) Xhafer Mehmet Koci, “Kujtesë historike për Hasan Prishtinën”, shënime për autorin


HASANIN E KA NJOHUR HISTORIA

Sipas të gjitha shënimeve që posedon Haxhi Salihu si dhe arkivi i Shkollës fillore “Jusuf Rexha” në Koshtovë, shkolla e parë shqipe në këtë fshat ka filluar punën që nga viti 1915 dhe kjo me iniciativën e pinjollit të çështjes kombëtare Hasan Prishtina. Edhe pse ky fshat ishte malor-kodrinor, pa rrugë, pa ura, vend mjaft i thyer, Hasan Prishtina një kohë të gjatë e kishte kaluar pikërisht në fshatin Koshtovë. Sipas shënimeve, bisedimet për hapjen e shkollës shqipe kishin filluar në konakun e Shaban Rexhës, gjë që e vërtetojnë të gjitha faktet e deritanishme, të papublikuara deri më tash, por gjithsesi të ruajtura në kujtesa historike e në mendje të popullit, duke fituar bindje se historia më e drejtë është ajo që del nga shpirti i popullit.

Shaban Rexha i kishte pesë djem, njëri prej tyre ishte Jusufi, i cili e kishte Medresenë e përfunduar. Jusufi, me ndihmën e Hasan Prishtinës, kryen edhe kursin pedagogjik dhe aftësohet për mësimdhënës, kështu që me fillimin e shkollës në Koshtovë, me propozimin e Hasanit emërohet mësues.



Shaban Rexha



Jusuf Rexha

Me ardhjen e Austro-Hungarisë shumë gjëra befasuese ndodhën për popullin e kësaj ane. Përpos sjelljes së Abetares nga Hasan Prishtina, edhe flamuri kombëtar ishte i lejuar që të përdorej, kështu që populli shqiptar, sado që i okupuar nga austro-hungarezët, filloi të merrte frymë më lirshëm sesa nën sundimin serbosllav. Hapja e kësaj shkolle shqipe pati jehonë të madhe në gjithë vendin. Kjo shkollë punoi deri në vitin 1918, atëherë prapë u bë

Ideologët e çështjes kombëtare si: Hasan Prishtina, Isë Boletini, Ferat Draga e shumë të tjerë, përpos që hapnin shkolla shqipe, ata donin që të fitonin edhe aleatë për luftë, sepse asaj kohe situata ishte tejet e komplikuar në Kosovë. Në fshatin Koshtovë takoheshin ideologët e çështjes kombëtare sepse këtu vetë konfiguracioni i këtij terreni ishte ndihmë dhe aleat i tyre, pastaj edhe lumi Ibard (*Ibër*) ishte mjaft mbrojtës për Koshtovë.

Hasan Prishtina kishte pasuri të madhe, edhe sot ekziston vendi i mullirit të tij në mes Koshtovës dhe Zubçit, por tash ai vend i takon Zubçit, bile serbët vendorë edhe sot e asaj dite këtë vend e quajnë "*Hasanbegov mlin*", kështu që pasuria e Hasan Prishtinës është shtrirë prej Koshtove e deri te Zubin Potoku. Disa njerëz nga Koshtova si Shaban Rexha, Behram Salihu, Fejzë Hajdini, kanë qenë kujdestarë të Hasan Prishtinës (*në gjuhën turke Qehaj*), të cilët kanë qenë të obliguar për të tubuar qiranë (*t'dhetat*) e pasurisë së Hasan begut si në Zubç, si në Uglar e deri në Zubin Potok, që sot serbët thonë se janë toka të tyre.

Një tregim mjaft domethënës e shpjegon Haxhiu duke na argumentuar për fshatin Çabër, fshat ky në komunën artificiale serbe që është i banuar etnikisht me shqiptarë. Atje të gjithë mbajnë në kujtesë emrin dhe veprën e Hasan Prishtinës si njeri i cili kishte vizion të qartë për mbrojtjen e tokave shqiptare, çlirimin e tyre dhe bashkimin me shtetin amë.

Vizioni i Hasan Prishtinës për hapjen e shkollave shqipe dhe përqendrimi i forcave aleate të brendshme ishte që ato të forcoheshin afër kufirit. Ky ishte qëllimi kryesor i Hasan Prishtinës, që ta forcojë kufirin në të gjitha format e mundshme, sepse rrezikun gjithmonë e priste nga Serbia, prandaj edhe veprimet e tij ishin më aktive këtu afër kufirit serb.⁴⁵

Haxhiu qysh në moshën rinore e kishte idol Hasan Prishtinën, pastaj ka të lexuar shumë literaturë për ideologun e çështjes kombëtare dhe sot mund të thuhet se është njohës i mirë i jetës dhe veprimtarisë së Hasan Prishtinës, derisa është i sigurt në atë që thuhet se trangu familjar i Hasanit është nga Lagjja Veliqi te Palacit të Drenicës, ky vetë disa herë e ka vizituar varrin e Avdullah Veliqit, e ka të shënuar në fletoren e vet mbishkrimin apo epitafin e gurit të varrit ku në gjuhën turke, me shkronja arabe shkruan; "*Abdullah Berisha-Veliqi*" si dhe është interesuar dhe ka grumbulluar shumë shënime ku thuhet se paraardhësi i Hasan Prishtinës është Avdullah Berisha nga Palaci. Hasani fatmjerisht nuk ka lënë pasardhës, por ai ka lënë popullin të cilin e ka dashur aq shumë, ka lënë shumë djem e vasha që sot ecin rrugës së tij. Hasani ka qenë është dhe do të mbetet shpirti i kombit. Njeriun që e ka njohur historia është shumë lehtë të flitet për të sepse ke çka të lexosh e të mësosh prej tij.

45) Haxhi Salihu, mësimdhënës në Shkollën fillore "Jusuf Rexha" në Koshtovë të Bobit.

DISA FAKTE

Dihet, Hasan Prishtina nuk i kishte raportet e mira me Zogun. Bashkë me Bajram Currin migroi në Vjenë dhe më vonë në Romë. Më 1919 u kthye në Shqipëri, u bë deputet në parlament më 1921, madje ishte edhe kryeministër.

8 Janar 1920

Kongresi i Lushnjës, zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetash, i cili do të kryente funksionet e Kryetarit të Shtetit, si dhe Këshillin Kombëtar prej 37 vetash, që do të kryente funksionet e Parlamentit.

21 Prill 1921

Në Tiranë u mbledh Parlamenti i Parë Shqiptar i dalë nga zgjedhjet e para parlamentare të zhvilluara gjatë muajve Shkurt-Mars 1921.


Parlamenti përbëhej nga 78 deputetë të dy grupeve kryesore politike, Partisë Popullore dhe Partisë Përparimtare.

1 Qershor 1925

U mbledh Parlamenti i dalë nga zgjedhjet parlamentare të zhvilluara gjatë muajve Prill-Maj. Në vitet 1925-1928 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë përbëhej nga dy dhoma, Dhoma e Deputetëve me 57 vetë dhe Senati me 18 vetë.

Shtator 1928

Në Shtator 1928 Shqipëria u shpall monarki. Gjatë periudhës 1928-1939 Parlamenti përbëhej nga një dhomë e vetme me 57 deputetë...



Delagatët e Kongresit të Lushnjës

**EDHE ËNDRRAT LIDHESHIN
ME HASAN PRISHTINËN**



“Fjala e tij, penda e tij si dhe kuleta e tij janë në dispozicion të çështjes kombëtare. Në tribunën e parlamentit ai është Jupiteri që gjëmon dhe ua kthen të tjerëve vetimat nga qielli mbi kokën e armiqve të popullit

Mustafa Asim Kruja

PAK MË NDRYSHE PËR HASAN PRISHTINËN

Kujtimet u përcollën dhe ende ruhen prej kujtimeve në kujtime. Hasani shpeshherë u thoshte trimave të luftës: *“Jeta përbëhet nga puna dhe fjala, kush i ka në rregull këto dy të mira të jetës, mund të thotë se jeton. Si dhe dhurata më e mirë që e kanë krijuar popujt është miqësia e madhe. Kurrë nuk është vonë nëse dikush don të bëhet i mirë dhe trim...”*

Hasan Prishtina shpeshherë e vizitonte Ulpianën e lashtë, në periferi të qytetit. U merrte aromë edhe gurëve të rrënojave ilire. Nganjëherë shkante edhe në Argentinën e Re të Marecit, e këqyrte Kështjellën sikur ta kishte motër të zemrës. Thonë shpeshherë ka pirë ujë kroi te Kulina dhe lumi Llap.

Hasan Prishtina shpesh i numëronte një për një fshatrat shqiptare në rrethin e Prokuples: ...Albana, Dragusha e Epërme, Dragusha e Poshtme, Kutllovci i Madh, Kutllovci i Vogël, Drevina, Baca, Qungullbi, Tmava, Simnica, Qyqalla, Pllana e Madhe, Gojnovci, Gërguri i Poshtëm, Konjusha, Magjera, Spanca, Stublla, Mërsheli, Vërbovci, Bresi, Arbanashka, Popova, Bllaca, Bogujevci, Prekashtica, Tullari, Gjermnica, Drenovci të cilat i ruan koha dhe historia, i ruajnë hartat e moçme dhe fibulat që nuk thahen kurrë, i ruan toka nën lëkurën e trashë të dheut. Shpeshherë Hasan Prishtina e ndiente si në ëndërr të gjatë zërin e një gjysheje shumë të lashtë:

“E more bir, e morën Toplicën, e morën edhe Mollën e Kuqe”.

Ai i shqetësuar merrte frymë, nganjëherë i dridhej edhe trupi dhe vazhdonte:

☪ kanë marrë edhe Trojën

☪ kanë marrë edhe Çamërinë

☪ kanë marrë edhe Sanxhakun

☪ kanë marrë edhe Ulqinin

☪ kanë marrë edhe Tetovën

☪ Nanën Shqypni e kemi me shumë plagë...

Edhe atëherë kur vetmia i sillej rreth dhimbjes thoshte: *“Atdheut i duhen shumë Gjergja e shumë Teuta”* dhe po të ishte gjallë do të thoshte përsëri: *“I duhen shumë Adema dhe shumë Xheva e Tringa e Nora e...”*

Një mbrëmje me të reshura, një vajzë nga Boletini tha para Urës së Ibrit të ndarë me tela gjemborë: Mitrovica sot po kërkon Hasan Prishtina dhe Mic Sokola. Dhe loti i rrodhi mbi një copë të gurit, ajo më gjysmë zëri vazhdoi: *“Varri i Latif Berishës kërkon që mbi Mitrovicë të fluturojnë pëllumbat e jo sorrat e huaja dhe korbat e zi...”*

KËSHITU NDODHI

Një javë pasi u hodhë në letër një prolog për librin monografik me fakte e kujtesë historike për Hasan Prishtinën, dhe pak më shumë se dhjetë ditë nga vizita në Lagjen Veliqi të Palacit në Drenicë, u takuam me Istrefin në një lokal pa zhurmë. Me të ishte edhe një mik i tij nga Zabeli i Drenicës, ai quhej Kastriot. Thanë se jemi shokë të pandarë. Jashtë binte një shi i butë dhe i hollë, herë-herë edhe fluskat e borës rrëshqisnin mbi dritaren pranë tavolinës. E rastësishme që edhe biseda që filluam atë ditë. Ajo mbrëmje mori ngjyrë të mirë dhe bukuri ndër më të bukurat. Në fytyrën e mikut çelën do buzëqeshje të reja. Edhe gotat u përqaftuan me gota. Ishte ajo mbrëmje që nuk do të harrohet.

E PSE? - TREGIM ARTISTIK

Sepse Istrefi ishte i Palacit, bile edhe mbiemrin e mbante Veliqi, ishte i oxhakut dhe i trungut të Hasan Prishtinës. Atë ditë shkurti një pjesë e dimrit u kthye në pranverë. Bisedat vazhduan ndersa ai vazhdimisht ndiqte i thelluar bisedën e ëmbël me kujtime.

Autori i këtij libri tha: Thonë Hasan Prishtina përveç që ishte një dinamo dhe motor i Lëvizjes për Çlirim, kishte edhe bukuri të paparë, thonë edhe zanat e malit janë mahnitur me bukurinë e tij. Krenarinë dhe pamjen e tij e ruajnë edhe kujtimet po edhe fotografitë që i ruajti koha një kohë të gjatë me të reshura dhe pa të reshura. Autori vazhdoi: Nganjëherë njerëzit e mendjes së shëndoshë i dërgon Zoti në vendin e duhur. Po bëhet një kohë e gjatë që bëjë hulumtime për Figurën dhe Piramidën e rrallë-Hasan Prishtinën, i cili herët u nis në rrugën e Dritës. Më pas autori nga çanta e vet, me të cilën kishte qenë edhe në Male të Çlirimit, e nxori projektin për një libër artistik - Monografi të panjohur për Hasan Prishtinën, dhe pas pak edhe Prologun e nisur për atë monografi. Interessant e lexoi në mënyrë shumë artistike. Në fund të prologut lotët na rrodhën mbi librin e Agim Spahiut për Kurpalët. Loti lagu lotin.

Veliqët, i madh e i vogël thonë: Po na duket edhe dielli i zgjati duart bashkë me rreze. Ata të thelluar në lashtësi flasin. Na duket se po e shohim shpirtin e Hasanit tonë sipër kokave tona, po na sheh e po na bën dritë. Me kënaqësi i përqaftuam gotat edhe një herë.

Të gjithë Veliqët, por edhe Istrefi si një lis i maleve, duke u ngritur në këmbë tha: Monografisë që do të shkruhet ne do t'ia dhurojmë duart dhe këmbët le ta shehë dritën. Për Hasan Prishtinën jemi të gatshëm të bëjmë atë që ai e bëri dikur për shqiptari. Na rrodhi loti të gjithëve. Ishte kjo hera e dytë që Ganiut i rrodhën lotët. Ishin këto lotët e gëzimit që Hasan Palaci i trungut të Veliqëve, po ringjallej për të satën herë pas një kohe të egër me borë e pa borë. Atë mbrëmje u hapën të gjitha dritaret. Edhe lisat e maleve do të flasin, edhe Arkivi i Parisit, i Vjenës e i Gjenevës do të flasë...

EDHE ËNDRRAT LIDHESHIN ME HASANIN

Prej asaj mbrëmjeje kishim më pak gjumë... Nganjëherë edhe ëndrrat ishin të lidhura me Hasan Prishtinën, me Shotë e Azem Galicën, Xhemë Gostivarin dhe Sulltane Qafën... bile një natë autori kishte parë ëndërr që nga Gryka e Kaçanikut dhe nga Malet e Berishës ndihej zëri i Hasanit: *“Do të shohin dritën edhe Trojet e Toplicës, edhe Pazari i Ri, edhe Plava edhe Gucia...edhe të gjitha Trojet ilire, edhe vetë Troja”*.

*Kur Hasan Prishtina i këqyrte malet,
Atdheu kishte shumë plagë në trup
Ymer Prizreni dhe Sylejman Vokshi ishin pa gjumë
Në Bujanoc dhe Preshevë flitej tinëz shqip
Në Shkup dhe Ulqin nuk kishte asnjë abetare
Edhe Çamëria kërkonte dorën e nënës
Liqeni i Ohrit ishte i ndarë me gjarpër
Edhe Liqeni i Shkodrës
Në ëndrrat e tyre mungonte edhe dielli...*


Hasan Prishtina kur ishte në moshën e re, shpesh shkonte tek Lumi Sitnikë dhe të Ura e Gurit. I donte shumë edhe pëllumbat kur fluturonin mbi Kalanë e bukur të Vushtrrisë, kishte thënë se: *“Edhe më bukur fluturojnë mbi Kukës e mbi Tropojë”*. Për madhështinë e Hasanit një pjesë e plotësojnë kujtimet e moçme dhe kujtesa historike që nuk i ka mbuluar krejtësisht pluhuri i harresës as historia jonë.



Hasan Prishtina dhe Igballe Prishtina me një shoqe, Vjenë, 1929

FAKTE HISTORIKE

Kur u plagos Hasan Prishtina, Bajram Sylja ia shëroi plagët me veglat e veta të mjekimit që i mbante në qesen e meshintë të varur në rripin e brezit. Pas shërimit të plagëve, Hasani ia dhuroi një pushkë të rrallë në shenjë kujtimi të përjetshëm. Bajram Sylja-Kurpali, tri herë ia puthi grykën pushkës me kundak prej drurit të arrës. Disa ditë pas mjekimit të Hasan Prishtinës, shkruan Agim Spahiu në monografinë e tij plot dritë historike: Në fund të Qershorit të vitit 1915, Bajrami i Kurpalëve shkon në Drenicë, aty bëhet një luftë me gjakderdhje të madhe nga të dyja palët...serbët pësuan humbje të madhe. Në këtë luftë të madhe, në Fushën e nderit bien edhe dy vëllezërit e Azem Galicës, aty plagoset edhe Bajram Sylja i Kurpalëve.⁴⁶



a) *Veglat e mjekimit dhe qesja e meshintë, me të cilat mjete Bajrami ka mjekuar dhe shpëtuar jetët e shumë luftëtarëve të lirisë, në mesin e tyre edhe Hasan Prishtinën.*

b) *Armë e rrallë-pushkë çifte e Bajram Sylë Kurpalit, të cilën pas shërimit të plagëve Hasan Prishtina ia dhuroi Bajram Sylës.*

⁴⁶) Agim Spahiu, "Kurpalët"; monografi, Tiranë, 2000.

KUJTESË HISTORIKE

Trimi i Kurpalit në fillim të pranverës të vitit 1917 ndeshet me forcat bullgare në periferi të Kumanovës. Aty luftoi së bashku me luftëtarët e lirisë, si: Ramë Binaku i Dashinocit e Sadik Rama i Gjurgjevikut, i cili dy vite më vonë udhëheq Kryengritjen në Rrafshin e Dukagjinit. Edhe në këtë betejë të madhe prapë plagoset Bajram Syla. Zakoni për të luftuar pip në këmbë, Bajramit i dha shumë plagë, i dha plagë, por i dha edhe fitore. Kujtimet e shkruara dhe të pashkruara thonë: Kur bënte thirrje Bajrami, gjaku i tij i ndezur zgjonte edhe malet. Dihet, ende pa u mbyllur mirë plagët e Kumanovës, ai plagoset duke luftuar kundër forcave austro-hungareze në Gjakovë.



Bajram Sylë Kurpali dhe Hazir Sylë Kurpali, patriotë dhe luftëtarë të shquar

Sipas udhëzimeve të Hasan Prishtinës, në verë të vitit 1919, çetat kryengritëse u bashkuan dhe filluan kryengritjen e përbashkët si gishtat e një dore dhe si degët e lisat e një mali në Krahinën e Rahovecit. Kryengritja filloi në Gjurgjevik... Masa e kryengritësve arriti deri në 10.000 veta. Dhe në verën e përgjakur të vitit 1920 Bajram Kurpali i shumë plagëve, i shumë betejave dhe i shumë fitoreve merr edhe dy plagë të reja, trupin e tij me plumba plot Atdhe nga Fushë-beteja e marrin Ramë Binaku, Ramadan Shabani e Mon Avdia dhe e çojnë në Kullën Legjendare të Kurpalëve në Letaj.

Hasan Prishtina u mërzit shumë. I avullonte balli me rrudha si lugjet e maleve. Mbi trojet shqiptare edhe retë ishin të zymta dhe të trazuara. Edhe dielli dukej më i lodhur dhe me rreze të mërzitura. Hasan Prishtina u mërzit shumë. I avullonte balli me rrudha si lugjet e maleve. Mbi trojet shqiptare edhe retë ishin të zymta dhe të trazuara. Edhe dielli dukej më i lodhur dhe me rreze të mërzitura.

Hasan Prishtina u lidh me Trima si mali me male, si bjeshka me bjeshkë dhe mori lartësinë e yjeve dhe të Diellit. I dha frymëmarrje lirisë një kohë të gjatë me krisma dhe furtunë. Kurpalët dhe Azem Galicën i kishte rriska dhe ndriçim të zemrës.

Shpeshherë u thoshte shokëve të pushkës dhe të udhës së dritës: *“Çlirimi i atdheut është si një “ëndërr guri”. Kur të bashkohen të gjitha trojet edhe zemrat rrahin më ndryshe, edhe ajri është më i mirë”*.

Kur vritet Bejtë Galica, Bajram Kurpali betohet: *“Kurrë në jetë nuk do të luftoj i shtrirë po veç n'këmbë”*.

FLITET E THUHET PRILLI I KAÇANIKUT

Krisma të llahtarshme topash, mizeri ushtrie osmane, tym, flakë, klimtha, britma, digjet qielli e toka qëndresë e pashoq burrash që s'dinë ç'është tuta, një prill i përgjakur i gjithi thërret në Gurin e shpuar... E ku tjetër më mirë se në atë Kala të pamposhtur prej guri, me rrënjë gjer në zemër të tokës, populli do të vinte ofshamën e vet prej dhimbjeje, qëndresën e vet prej gjaku:

*Kaçanikut i raftë pika
Hiç s'po di se shka asht frika
Nant sahat tuj therrë me thika
Therrë me thika nant sahat
Po shkon kali not në gjak...*

Gryka e Kikut ka qenë më e përgjakshmja dhe më e tmerrshmja. Ka hyrë në Legjendë dhe është bërë akt historie. Hasan Prishtina kur kalonte nëpër Grykë të Kaçanikut, gjithmonë ndalonte aty, pinte ujë të ftohtë dhe sikur u thoshte maleve: Të gjitha trojet duhet të bashkohen.

*Po pëvet Hasan Prishtina
Po ku gjendet Bajram Syla
Bajram Syla ma njoftue
Sa fort randë un'jam plague...*

HASAN PRISHTINA
JETON BASHKË ME HISTORINË



“... a po e shihni atë mjegull mbi U'kenin tonë ?, aty e kam të
varrosur stërgjyshin tim, aty e kam trugun familjar...”

Hasan Prishtina

SI U VRA HASAN PRISHTINA NË SELANIK

Vrasja mizore e atdhetarit të kombit shqiptar dhe ish-kryeministrit të Shqipërisë, Hasan Prishtina

Më 13 gusht të vitit 1933, në qytetin e Selanikut, u vra në pabesi dhe mizori ish-Kryeministri i Shqipërisë Hasan Prishtina. Gjatë viteve të qëndrimit të autorit të shkrimit në Selanik, në arkivat e këtij qyteti ka zbuluar një gazetë të vjetër që përshkruante ngjarjen e vrasjes së atdhetarit të shquar.

Atë kphë në gazetën “Maqedonia e Re” e datës 14.8.1933, ishte botuar fotografia e Hasan Prishtinës i vdekur dhe fotografia e vrasësit Ibrahim Çelo.

Gazeta e asaj kohe shkruante për jetën, veprimtarinë dhe pasurinë në Selanik të Hasan Prishtinës dhe na sjell një fakt të vërtetë për datën e vrasjes së tij që deri më sot shumë historianë shqiptarë që janë marrë me figurën e tij e kanë gabuar duke shkruar si datë të vrasjes 14 gushtin e 1933, por sipas gazetës së kohës është data 13 gushti i vitit 1933.

Gazeta greke e kohës “Maqedonia e Re” (Μακεδονικα Νεα)

“Maqedonia e Re”, e datës 14 gusht 1933, një ditë mbas vrasjes së Hasan Prishtinës, shkruante për ngjarjen që tronditi Selanikun më 13 gusht të vitit 1933. Gazeta e asaj kohe shënonte se Hasan Prishtina është pronar i ndërtesës së sotme “Shkolla e të Verbërve”. Gazeta e kohës përshkruan vdekjen tragjike të atdhetarit, politikanit të madh Hasan Prishtina. Në faqet e gazetës shkruhej: “Një tjetër vrasje që u bë në rrugën Çimisqi, tronditi Selanikun”.

Politikani shqiptar Hasan Prishtina u vra në qoshen Çimisqi në Vogaxhiku, përpara bakallhanes “IVI”. Shqiptari Ibrahim Çelo, 38 vjeçar, i papunë, qëlloi pesë herë ish-kryeministrin shqiptar Hasan bej Prishtinën. Vrasja u krye në orën 2 mbasdite më datë 13 gusht 1933. Në rrugën Çimisqi u pa një zotëri i moshuar, i mbajtur mirë dhe me tipare simpatike, të ecte përkrah e që fjaloste me një person të veshur mirë, i gjallë, sa e tradhtonte dhe toni i zërit. Arritën në kryqëzimin e rrugës Çimisqi-Vogaxhiku dhe po drejtoheshin për tek bakallhane “IVI” dhe në largësi dy hapa nga kinkaleria e invalidit J. Janopullo. Njeriu me pamje të zymtë nxori rufeshëm revolverin e markës “SMITH” dhe shtiu kundrejt bashkëbiseduesit, i cili ishte Hasan bej Prishtina, që ra në trotuar. Kalimtarët e mbledhur nga të dy të shtënat, panë vrasësin të turrej me mizori mbi viktimën dhe t’i zbrazë edhe tre plumba të tjerë, dy në kraharor dhe të tretin në kokë, si e shtënë vdekjeprurëse, për të qenë i siguritë për përfundimin e aktit të vrasjes.

Fill pas krimit të tij, vrasësi që t'i ikte rrezikut prej turmës së mbledhur që u vu për ta kapur, ia dha vrapit nga rruga Vogaxhiku. Nga tronditja ai ra në vitrinën e tregtores “Beharnaë” të cilës ia dëmtoi tendën, por rimori veten, për t'u turrur drejt rrugës “Paleon Patron”, ku u rrethua nga turma, që e ndiqte me synime të errëta. Vrasësi hyri në banesën e mjekut z. Dukidhis, ku dhe iu dorëzua rojës së policisë. Por nuk mundi t'i shpëtojë egërsimit të turmës. Kalimtarët që e ndoqën dhe banuesit fqinjë të çdo moshe, shtrese, pa ditur identitetin e tij dhe as motivet e vrasjes, të indinjuar ndaj egërsisë që tregoi vrasësi ndaj viktimës, sa panë të vijë skuadra e policisë, u turrën dhe ata duke thirrur: “Shqyjeni, shqyjeni, vrasësin!” Ndërsa polici më kot përpiqej të shpëtonte atentatorin, turmat u turrën ndaj tij dhe nisën ta grushtojnë, duke i shkaktuar mavijosje në pjesë të ndryshme të trupit. Do ta kishin çarë përgjysmë vërtet, nëse nuk do t'ia mbërrinte të hynte në një tjetër shtëpi, në rrugën “Paleon Patron”, ku u strehua nga i zoti i shtëpisë, i cili nxitoi ta mbyllte derën e jashtme turmave të zemëruara.



Faksimile e gazetës greke Μακεδονικά Νέα (dt.14 gusht 1933)

Pas pak mbërriti sekretari i policisë, nëntogeri z. Zografo, dhe vrasësin e transferuan me motoçikletë në Seksionin e tretë të policisë. Hasan Prishtina, i mposhtur nga plagët, u dërgua ndërkohë në Spitalin Popullor, ku trupit të tij iu bë autopsya. Në orën 2:50 minuta mbasdite oficeri Sotiriu nisi hetimet me përkthyes, pyeti vrasësin nëse e njeh gjuhën greke, ai u përgjigj se njeh gjuhën shqipe, frënge dhe gjuhën turke. Vrasësi nënvizoi se akti i tij u dedikohet motiveve politike. Ndërkaq pretendoi se ish-kryeministri i atdheut të tij ishte komit dhe bashkëpunonte me komitetin bullgaromaqedonas me qëllim që të vrisnin mbretin e Shqipërisë, Ahmet Zogun. Planet, thotë atentatori, m'i tregoi Hasan Prishtina përpara pesëmbëdhjetë ditëve, kur po vinim prej Vjene dhe më bënte presion që të bëhesha unë kryetar i bandës komite dhe të shkoja në Tiranë, ku të vrisja mbretin Ahmet Zogu. Prishtina, vijon vrasësi, më premtoi shpërblim mujor dhe një shpërblim dhuratë mbas aktit të vrasjes, por unë i kundërshtova këto propozime të tij, sepse jam proregjimit të mbretit Ahmet Zogu dhe nuk dëshiroja të bëhem vegël e Hasan Prishtinës...

GAZETAT E KOHËS PËR VRASJEN E HASAN PRISHTINËS

Vrasje mizore

-Vrasja mizore e në mënyrë tradhtare u krye në orën 2 pasdite, më datë 13 gusht 1933 në Selanik nga agjenti i Zogut, Ibrahim Çelo.⁴⁷

(Lajmi i gazetës « Spiros » mbi vrasjen e Hasan Prishtinës në Selanik prej agjentit të Zogut, Ibrahim Çelo).

Janinë, më 15 gusht 1933

U vra ish-kryeministri i Shqipërisë

-Athinë-Telegrafojnë nga Selaniku se dje mbas mesdite u vra në mes tregut ish-kryeministri i Shqipërisë Hasan Beu, prej... Ibrahim Husen Çelos, arritur për këtë gjë nga Manastiri. Vrasësi shtiu kundër viktimës shtatë herë prej të cilave katër plumba e goditën këtë figurë dhe e lanë në vend të vdekur. Vrasësi u zu dhe u dërgua në polici.⁴⁸

(Pjesë nga artikulli i gazetës greke « To Fos » mbi shkaqet e vrasjes së Hasan Prishtinës).

Athinë, 18 gusht 1933

Si e shohin serbët vrasjen e Hasan Prishtinës

-Vrasja e Hasan bej Prishtinës, është karakteristike se në Beograd asnjë gazetë dhe asnjë parti nuk mungoi të theksojë se në personin e të vramit u zhduk njëri prej armiqve më me rëndësi të politikës serbe në Shqipëri, bile edhe një prijës i rrezikshëm i minoriteteve shqiptare në Serbinë e Jugut...⁴⁹



Atdhetari Hasan Prishtina



Agjenti i Zogut Ibrahim Çelo

47) Gazeta "Spiros" - Janinë, 15 gusht 1933.

48) Gazeta "To Fos" - Athinë, 18 gusht 1933.

49) Gazetat serbe - Beograd, gusht 1933.

PASURIA E HASAN PRISHTINËS NË SELANIK

Shkrimi i mëposhtëm është marrë nga gazeta greke “Maqedonia e Re” e datës 14 gusht 1933, një ditë mbas vrasjes së Hasan Prishtinës, në Selanik, ku është shënuar se ai është pronar i ndërtesës së sotme “Shkolla e të Verbërve”.

Hasan Prishtina ka qenë shumë i pasur, por pasurinë ai e shkriu për çështjen kombëtare shqiptare. Ai pati mbledhur të holla për të çuar në Shkollën Normale të Elbasanit djemtë shqiptarë nga Kosova. Pasuri e patundshme që i ka ngelur ende dhe që njihet botërisht është një ndërtesë shumë e madhe që ndodhet në qendër të Selanikut, anës detit në rrugën Vasilis Ollga (dikur zonë e privilegjuar). Ndërtesa është trekatëshe dhe rrethohet prej një oborri gjigant me sipërfaqe rreth 1500 m katrorë, vlera e saj në tregun e shitjeve të banesave me truall arrin në shumë milionë dollarë amerikanë. Sot shtëpia është pronë shtetërore dhe funksionon si shkollë dhe Institucion bamirës për personat shurdhmemecë dhe të verbër.⁵⁰

Kjo ndërtesë për shqiptarët ka një vlerë të madhe historike. Vendosja në murin e saj të jashtëm e një pllake memoriale është gjëja më elementare për identitetin e ndërtesës dhe kujtimin e këtij personaliteti. Hasan Prishtina pranoi më mirë të vdesë nëpër malet e Kosovës, se sa kolltukun e turpit në një ministri në Stamboll.



Shtëpia e Hasan Prishtinës në Selanik

⁵⁰) Artikull i përkthyer nga gazeta greke “Maqedonia e Re” (Македоника Реа).

PËRSE U VRA HASAN PRISHTINA ⁵¹

Nga Memorandumet që dalin nga penda e Hasan Prishtinës, si dhe nga ato të konceptuara dhe të redaktuara prej tij, të dërguara Lidhjes së Kombeve, asociacioneve të saj dhe opinionit demokratik evropian e botëror, prej dokumenteve arkivore, publicistike e letrare shihet qartë se në periudhën e formimit dhe forcimit të pavarësisë së Shqipërisë së paku deri në vitet e 30-ta, Hasan Prishtina ishte më i përshtatshmi, më i afti, më diplomati, më i respektuari dhe më i njohuri në rrafshin kombëtar e ndërkombëtar për ta udhëhequr shtetin shqiptar. Aftësia, vigjilenca politike, gjykimi diplomatik, argumentimi historik, vendosshmëria, trimëria, gatishmëria për sakrificë, besnikëria ndaj atdheut, matura e zotësia për punë e penë, sidomos në gjuhën frënge e turke, njohja teorike e revolucionit kombëtar borgjez demokratik, i regjur në diplomaci, asnjëherë i shitur, kurrë i tradhtuar e shumë veti të tjera e bënë të dashur e të shenjtë për popullin e tij, shqiptar.

Hasan Prishtina pothuaj tërë jetën, sidomos atë midis viteve 1912-1933 e kaloi në migrim e në ilegalitet me pushkë e me penë në dorë për bashkimin dhe çlirimin e popullit shqiptar nga robëria shekullore osmane (turke), robëria austro-hungareze, serbe e bullgare dhe nga shtypja kombëtare e klasore e borgjezo-feudale jugosllave e shqiptare të regjimeve antipopullore të Jugosllavisë dhe të Ahmet Zogut, për Shqipëri etnike, unike e demokratike me marrëdhënie të mira fqinjësore e të njohur ndërkombëtarisht.

Ai për popullin e vet nuk kërkonte asgjë më shumë se kishin popujt fqinjë, lirinë dhe ekzistencën kombëtare të njëjtë. Po të realizoheshin këto të drejta për bashkatdhetarët e tij, do ta kishte për vete e pranë vetes secila qeveri ballkanike e evropiane, por meqë asnjëra prej tyre nuk pranonte t'i barazonte shqiptarët me popujt e tjerë, kjo diktonte ngutjen e qarqeve politike, sidomos të atyre shqiptare e jugosllave për vrasjen e Hasan Prishtinës.

Hasani duhej të vritej, sepse duhej të vritej lëvizja revolucionare demokratike në Ballkan dhe Evropë. Ishte luftëtar i madh kundër imperializmit ballkanik e evropian. Shpirti atdhetar e revolucionar e kishte bërë Hasan Prishtinën të padashur për armiqtë e shqiptarëve e të dashur për popullin e tij, madje jo vetëm në Kosovë e Maqedoni, por në diasporë e në Shqipëri. Hasani deri në këtë kohë ishte dhe mbeti lider i shqiptarëve jashtë Shqipërisë, ndërsa aktuale çështja e bashkimit të Kosovës, me Shqipërinë. Plani i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë nën ombrellën e Italisë si duket qe shkaku kryesor i vrasjes së Hasan Prishtinës.

Me këtë plan nuk pajtohej Jugosllavia, e cila kishte punuar shumë që ta gllabërojë Shqipërinë. Ahmet Zogu që kishte marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, e cila e sjelli në pushtet, por edhe me Italinë, e cila e njohu mbret,

e eliminoi kundërshtarin e vet Hasan Prishtinën, të cilin më parë e kishte akuzuar "tradhtar" dhe e kishte dënuar me vdekje. Vrasjen e Hasan Prishtinës e përgatiti Ahmet Zogu me Beogradin.


I pari e siguroi vrasësin e i dyti mjetet, paratë të cilat i kishte me bollëk kur ishte në pyetje vrasja e shqiptarëve. Vrasës caktohet Ibrahim Çelo nga Manastiri, 37- vjeçar i aftë për këso punë, i martuar me spanjolle, kishte një fëmijë, emigrant shqiptar në Francë, tregtar frutash-pijesh në Nicë, i cili njihte mirë Hasan Prishtinën.

Pas një veprimtarie të dënuar patriotike, në disa vende të Evropës e Ballkanit, Hasani tani diku me moshë 60-vjeçar, në gusht të vitit 1933 u gjet në Greqi, në Selanik pranë familjes së tij, te e ëma dhe vëllai Ymeri, pa Igballen - gruan dhe bashkëpunëtoren e tij, e cila kishte ndërruar jetë dy vite më parë në Paris. Pas disa ditëve u vendos në hotelin "Astoria" sigurisht me rekomandim të autoriteteve greke që kishin gisht në vrasjen e Hasanit, sepse ai qe kundërshtar i rreptë i qarqeve sunduese greke, të cilët shqiptarët ortodoksë i asimilonin e ata myslimanë i largonin, me siguri për t'ia bërë më lehtë vrasjen e Hasanit vrasësit. Pas një veprimtarie të dënuar patriotike, në disa vende të Evropës e Ballkanit, Hasani tani diku me moshë 60-vjeçar, në gusht të vitit 1933 u gjet në Greqi, në Selanik pranë familjes së tij, te e ëma dhe vëllai Ymeri, pa Igballen - gruan dhe bashkëpunëtoren e tij, e cila kishte ndërruar jetë dy vite më parë në Paris. Pas disa ditëve u vendos në hotelin "Astoria" sigurisht me rekomandim të autoriteteve greke që kishin gisht në vrasjen e Hasanit, sepse ai qe kundërshtar i rreptë i qarqeve sunduese greke, të cilët shqiptarët ortodoksë i asimilonin e ata myslimanë i largonin, me siguri për t'ia bërë më lehtë vrasjen e Hasanit vrasësit.

Hasan Prishtina vdiq për dashurinë e atdheut. U varros në Selanik e u rivarros në Kukës. U ngrit në përmendore Hero i Kombit për të mos vdekur kurrë. Përmendore në shenjë nderimi e përkujtimi të Hasan Prishtinës - Hero i Kombit, iu ngrit edhe në Tiranë, Prishtinë e Shkup në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë për të cilën punoi, vdiq dhe e shkriu tërë pasurinë.

51) Drejtoria e Përgjithshme e arkivave të shtetit: Hasan Prishtina; Përmbledhje dokumentesh 1908-1934), Tiranë, 1983. Naim Halimi, "Koha" Përse u vra Hasan Prishtina (!?)

**HASAN PRISHTINA -
IDEOLOGU I KOHËS**



Hasan Prishtina në gazetën austriake Das interessante Blatt
Vijenë, 1931

KËMBËNGULJA PËR ALFABETIN LATIN ⁵²

Në rrugën e përpjekjeve të tij për arsimin kombëtar, Hasan Prishtina këmbë-ngulte për vendosjen e alfabetit latin, si më të përshtatshëm dhe praktik për shkrimin e gjuhës shqipe.

Ja se çka shkruante gazeta “Dielli” e Bostonit më 26 nëntor 1909: *“...lëvizja kombëtare ka nisë m`u ngjallë shumë në Kosovë... ndër këto ditë, me të përpjekurat e Hasan Beut, deputetit të Prishtinës, u hap një mësonjë-tore shqipe në një fshat afër Vuçiternës... pritet për së shpejti qi Hasan Beu të çelin edhe një mësonjë-tore tjetër (shqipe) brenda në Vuçitërnë, ku ka shpin`e vet. Prej këti atdhetari të nderçëm priten shumë punë të dobishme për kombin, se asht tuj na dhanë provë për dit e ma tepër qi asht një atdhetar i flaktë e i vërtetë, e qi përpiket me mish e me shpirt për shndritjen e kombit të vet”*.

Nga kjo informatë mësojmë se shkollat shqipe kishin filluar të hapeshin në vise shqiptare edhe para çeljes së Shkollës Normale të Elbasanit. Shkolla e parë shqipe në rrethin e Vushtrrisë, për të cilën shkruan gazeta “Dielli”, është hapur në fshatin Pantinë të Vushtrrisë.

Qysh nga janari i vitit 1912 ai do të mbajë mbledhje të fshehta së bashku me Ismail Qemalin, në lagjen “Taksim” të Stambollit dhe do të vendosin për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të Armatosur në Shqipëri. Për këtë vendosmëri e kishte paralajmëruar edhe Parlamentin otoman, kur ky Parlament nuk merrte parasysh kërkesat e deputetëve shqiptarë, kërkesat e drejta të tyre për një autonomi të Shqipërisë, ku ndër të tjera deklaroi: *“...një ndër të parët që do e marrë në dorë flamurin e revolucionit, ndofta i pari ndër të parët do të jem unë”*. Kështu gjatë pranverës së atij viti fillon përgatitjet e një kryengritjeje me karakter të përgjithshëm kombëtar duke u lidhur me besa-besë me tribunët popullorë: Isa Boletinin, Bajram Currin, Idriz Seferin, Ahmet Delinë, Mehmet pashë Derallën, kushëririn e vet Zejnullah Begu, etj.

Pas një lufte, me betejat triumfale midis 5 majit -18 gushtit 1912, kryengritësit shqiptarë në krye me Hasan Prishtinën e çliruan Vilajetin e Kosovës. Toskë e Gegë ia besuan ngritjen e flamurit kombëtar në Shkup, më 12 gusht 1912. Me marrjen e Shkupit, kryengritësit shqiptarë i çliruan të burgosurit që ishin mbi 1000 veta, e shtinë në dorë postëtelegrafin dhe suspenduan shumë qeveritarë dhe administratorë turq dhe përkrahës të tyre edhe nëpër shumë qytete të tjera të Vilajetit të Kosovës.

Më 18 gusht pas një zhagitjeje të gjatë të përgjigjes qeveria turke doli zyrtarisht se i pranon 12 pika nga 14 kërkesat e njohura me emrin “14 pikat e Hasan Prishtinës”, sa kërkonin kryengritësit shqiptarë.

⁵²) Ramadan Pllana, “Hasan Prishtina, ideologu kryesor i Shqipërisë etnike”.

KOMBI SHQIPTAR DHE ARMIQTË E TIJ

Shqiptarët janë një popull shumë i vjetër dhe i veçantë në Evropë dhe në Ballkan, me një autoktoni të përhershme në këto troje të ngushtuara shumë kundër tyre nga luftërat mijëvjeçare për ta shpopulluar, për ta shkatërruar, për ta zhdukur nga faqja e dheut, sikur të mos kishte ekzistuar më parë. Falsifikimet e shumta janë shpërndarë kudo që ishte e mundur. Me gënjeshtat e armiqve është mbushur kjo botë. Të gjithë shkencëtarët që ndërlihen në shkenca nga bota e qytetëruar janë ngritur përmes kësaj pseudoshkence. Sepse, të ndërlihdesh në shkencë nga gjenealogjia, gjeografia, atlasit, arkeologjia, historia dhe shkencat e tjera që sot quhen "shkencë" është pothuajse e pamundur të ngrihesh dhe të jesh një shkencëtar i mirëfilltë. Mijëra libra anekënd botës janë të mbushura me të pavërtetat e tyre.

Në studimin e bërë nga Universiteti i Kalifornisë lidhur me prejardhjen gjenetike të popujve, është konstatuar se shqiptarët janë populli më autokton në Ballkan, që nuk kanë asnjë lidhje me sllavët, por që kanë disa ngjashmëri me helenët-grekët e vjetër. Sipas këtij studimi-hulumtimi të bërë, shqiptarët janë popull shumë i vjetër dhe kanë një gjuhë të veçantë. Sipas këtij studimi, shqiptarët, përgjatë shekujve kanë ruajtur homogjenitetin, ndërsa për shkak të zhvendosjeve, migrimëve e martesave, të dhënat gjenetike tregojnë se popujt e Evropës, kush më shumë e kush më pak, të gjithë janë kushërinj të tyre. Shumica e popujve në kontinentin e vjetër janë paraardhës të njëjtë apo të ngjashëm. Në këtë grup bëjnë pjesë shqiptarët. Prejardhja e tyre ilire dhe gjuha tërësisht e veçantë, i bën relativisht edhe më të veçantë. Peter Ralph dhe Graham Coop janë dy studiues nga Departamenti për Evolucion, Ekologji dhe Biologji të Popullsisë në Universitetin e Kalifornisë në SHBA, që kanë publikuar studimin e tyre të quajtur "Gjeografia e fundit e prejardhjes gjenetike nëpër Evropë".⁵³

Popullsia parahelene, autoktone e Greqisë, ishin pellazgët. Shqiptari ka plotësisht të drejtë të ndihet kryelart që është trashëgimtar i denjë i gjuhës së pellazgëve pjellëbardhë, i stërgjyshërve të tij më të lashtë.⁵⁴

Ata janë stërnipërit më autentikë të pellazgëve, të dardanëve dhe ilirëve të vjetër. Pellazgo-iliro-shqiptarët e ruajtën me mijëra vjet të papërlyer gjenin e vet me bukuri të virtytshme. Kombi shqiptar e ka prejardhjen e lashtë prej pellazgëve hyjnorë, që nga gjenealogjia e botës. Pellazgët antikë nga epoka klasike e deri në epokën helene i përfshin në katër degët e tyre: ilirët (duke i përfshirë aty edhe dardanët), thrakët, epirotët dhe maqedonët.⁵⁵

53) Brahim Avdyli, Artikuj shkencor 1 (Qëndresa).

54) Sotir Lashova, "Pellazgët / Stërgjyshërit e Kombit Shqiptar", Tiranë 2007, faqe 29.

55) Aref Mathieu, "Mikenët-Pellazgët, Greqia e vjetër-zgjidhja e një enigme" ;Plejada, Tiranë 2008, faqe 203.

Kombin tonë e njohim nga shkrimet e para dhe të vjetra të Homerit të verbër, që ishte pellazg nga Smirna e Azisë së Vogël. Shkencëtarët e mëdhenj e mësojnë si i pari shkrimtar grek, dhe jo shqiptar. Në atë kohë, nuk janë quajtur kështu shqiptarët. Nuk e dinë shkencëtarët e botës se prej kujt dhe në cilën periudhë të historisë jemi quajtur shqiptarë. Verbësia tek të lashtë lidhej me largpamësinë shpirtërore. Homeri ishte i verbër dhe nuk mund t'i shkruante poemat e tij.⁵⁶ Prandaj, ato u ndryshuan nga të tjerët, nga ata që shkruanin dhe botonin në Greqinë e vjetër.

Sami Frashëri thoshte se shkronjat e para u sollën nga Kadmi, që ishte alfabeti i tij, alfabeti fenikas,⁵⁷ të cilit më vonë, sikurse flasin mjaft shkencëtarë grekë dhe të botës, të vjetërit grekë ia shtuan zanoret. Gjuha nuk mund të shkruhej pa zanore. Dhe, askush nuk ia vënë gishtin kokës për ta gjetur të vërtetën. Me bashkëtingëllore, pa zanore, nuk funksionon asnjë gjuhë. Alfabeti pellazg i kishte të dyja, zanoret dhe bashkëtingëlloret.⁵⁸

Mbishkrimet e lashta pellazge dhe etruske kanë ndër të tjera shumë ngjashmëri të madhe me gjuhën e sotme shqipe, e jo greke, siç thuhet sot, sepse ajo nuk mund t'i deshifronte këto shkrime, p.sh. Stelën e Lemnosit, në Kretë.⁵⁹

Pellazgët e vjetër dhe etruskët kishin ngjashmëri në të gjitha aspektet, pra në gjuhë: të dy palët (*pellazgët dhe etruskët*) kanë përdorur formën bustrofedike të shkrimit, nga e djathta në të majtë.

Gjuha e sotme që e flasim ne, gjuha shqipe, është gjuha e vjetër pellazge, është gjuha e parë në botë, më e vjetër se "greqët" dhe "greqishtja", të ardhur këtu për ta zhdukur kombin e vjetër, që diti ta ruajë të folurën e pellazgëve deri në ditët tona, dhe është e përbërë nga toskët (*etruskët*) dhe gegët (*malësorët*). Të gjitha mbishkrimet e Vinçës, Tartarias (*Rumani*), Dispilos (*Greqi*) tregojnë se shkrimi me gërmat e alfabetit pellazgoetrusk është përdorur në mijëvjeçarin e 6 p.e.s. në tërë rajonin e Ballkanit.

Ky shkrim është më i vjetër se shkrimi piktografik shumer, i thënë në anglishte "*Protosumerian pictographic script*" nga Uruku i Bagdatit (*Siri*), që është konsideruar se është shkrimi më i vjetër në botë, që daton rreth viteve 3300 p.e.s. dhe alfabetit egjiptian, që datohet rreth vitit 2000 p.e.s. Shkrimi, alfabeti dhe kultura pellazge përbëjnë qytetërimet më të vjetra të botës. Gjuha pellazge, shkrimi dhe alfabeti i saj, të gjetura kohët e fundit, përbëjnë thelbin kulturor të qytetërimit të lashtë pellazgjik. Ai shfaqet e dokumentohet rreth 12.000 vjet p.e.s.

⁵⁶ Aref Mathieu, "Mikenët-Pellazgët, Greqia e Vjetër-zgjidhja e një enigme", Plejada, Tiranë, 2008, f.498.

⁵⁷ Aref Mathieu, "Mikenët-Pellazgët...", f.419-426, prej Sami Frashërit, "Grekëria ishte vendi i stërgjyshërve tanë ilirëve"

⁵⁸ Dr. Luftulla Peza dhe M. Liljana Peza, "Pellazgët e shpikën shkrimin dhe alfabetin e parë në botë".

⁵⁹ Nermin Vlora Falaskit, "Pellazgët, ilirët, etruskët dhe shqiptarë,-Qytetërimet e lashta mesdhetare", Prishtinë, 2004.

Me këtë rast, do të përmendim edhe një faktografi, sa i përket formimit të gjuhëve indoevropiane. Edhe pse këtë familje të gjuhëve indo-gjermane ose evropiane e quajmë diskutabile dhe nuk ka gjuhë përpos pellazgjishtes së vjetër që do të mbushte mbi 50% të gjuhës nënë në vendet e mbledhura nga Evropa deri në Indi, një vështirësi të madhe paraqitet identifikimi i vazhdimësisë historike të gjuhës shqipe. Njëherë për njëherë na paraqet vështirësinë e parë dokumentimi i shkrimit të kësaj gjuhë para shekullit XV⁶⁰ apo mundësia për ta dokumentuar këtë, pasi kemi kaluar errësirën shekullore të Perandorisë Osmane; dhe vështirësia e dytë, mund të jetë fakti se metoda e shkrimit të pellazgjishtes së vjetër ka qenë forma bustrofedike, nga e djathta në të majtë, gjë që është "*gjë e panjohur*" për studiuesit e gjuhës së vjetër pellazge. Prandaj, fatkeqësia qëndron se shkencëtarët nuk e njohin sa duhet këtë gjuhë, as historinë e pellazgëve të vjetër dhe kanë pak mjete për ta dëshmuar këtë.

Dijetari francez, Robert d'Angely, në veprën e tij „*Enigma*“ shpjegon se "*territoret që përbëjnë Jugosllavinë e sotme... banoreshin qysh prej kohëve që nuk mbahen në mend nga pellazgët, ... të cilëve autoktonët u dhanë emrin ilirë... Me këtë emër ata zinin gjysmën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, që nga bregu i djathtë i Danubit në veri, deri në Epir në jug... Ishin breukët... që zinin brigjet jugore të Savës; në verilindje të Bosnjës ishin japodët; liburnët banonin në brigjet e Dalmacisë dhe ishujt; ardienjtë ose vardenjtë, që jetonin në të dy anët e malit Makarska; daversët afër Nerentës (Neretvës) përdornin monedha bakri, që kishin si emblemë një anije; në trevat e Malit të Zi banonin diokletiatët; fqinjët e tyre, labeatët, jetonin afër brigjeve të liqenit të Shkodrës dhe nga ana e vet kishin si fqinjë pirustët, të cilët ushtronin mjeshtrinë e metalurgëve. Më në brendësi ishin vendosur aktariatët, armiq të ardiejve, dhe parthinët, që grupoheshin rreth Uzhiçës dhe adhuronin Zeusin Parthen si mbrojtës të tyre. Në luginën e epërme të Vardarit dhe Drinit të Bardhë, në fushën e Kosifopejdonit ose të Shkupit dhe në rajonin e Nishit shtriheshin të famshmit dardanë..., si popullsi tjetër qenë delmetët ose dalmatët, të cilët kishin kryeqytet Delmeniumin... dhe si port qytetin Salon (Spliti i sotëm). Po në atë epokë romake kishte gjithashtu popujt e tjerë të fortë: dasaretët, ditionët, taulantët, sardeatët, e të tjerë... “⁶¹ Në brendi të Shqipërisë jetonin disa fise të vogla, por mjafton të përmendim atë që është bërë më i njohur, albanët, dhe në Maqedoninë e vjetër, enkelejtë dhe paeonët...*

Një metodë që ka hedhur "*në pah fakte origjinale*" na paraqet pema e diferencimit të gjuhëve indo-evropiane. Fjala është për sistemin e gjeneve, HLA-në, që ka pasur të evidentojë trungjet e përbashkëta dhe degëzimet e

⁶⁰)Robert Elsie, "Historia e letërsisë shqiptare", Dukagjini, Pejë 2001.

⁶¹)Robert D'Angely, "Enigma/Nga pellazgët te shqiptarët", Toena, Tiranë 1998, faqe 241, 242, 243.

veçanta të gjuhëve indo-evropiane dhe ka vërtetuar që gjuha shqipe është një degë e veçantë në trungun e gjuhëve indo-evropiane, e cila është e ndarë nga gjuhët e tjera, të paktën 4000 vjet që përpara dhe dokumentohet uniteti gjenetik i kombit shqiptar kudo që jeton, midis gegëve dhe toskëve. Përkundër sistemit të gjeneve, HLA-në, një metodë tjetër e kanë përdorur shkencëtarët amerikanë nga Universiteti i Kalifornisë, Ralph dhe Coop, në korrik të këtij viti. Kjo është metoda e biologjisë molekulare, që na dërgon në shqyrtimin e historisë së vërtetë të pellazgëve të lashtë parahistorikë dhe lidhjen e tyre direkt me shqiptarët e sotëm.⁶²

Të shohim si është themeluar kombi shqiptar:

-Pas antikitetit të hershëm u krijuan shumë popuj apo kombe nga populli apo fisi më i madh i pellazgëve: *ilirë, epirotë, helenë, maqedonë, thrakasë, hititë*, etj. Në Mesjetë, pas antikitetit të vonshëm, nga gjiri i fiseve të kombit të madh pellazgë-ilir u krijuan shtete kombëtare, të cilat gradualisht e morën emrin më të njohur të fiseve prej nga rrjedhin apo të rajoneve natyrore ku jetonin. Pra, janë pellazg-ilirët prej nga rrjedhin shqiptarët e sotëm që na interesojnë më tepër se çdo gjë tjetër, dhe sidomos pranë nesh armiqtë fqinjë. Ajo që më së shumti na preokupon, është emri shqiptar se prej kujt dhe kur e kemi marrë.

-Për herë të parë na ka quajtur kështu Pirro Ajakidi (Pirhos-II), nga Epiri, mbreti molos i Epirit,⁶³ që ka jetuar në vitet 319-272 para Krishtit,⁶⁴ fëmijët e shqiponjës, pra bijtë e shqiponjës, që veten e quanim *jemi bijtë e shqipes*. Emri SHQIPTAR, sipas disa dijetarëve rrjedh nga emri SHQIPONJË. Shqiponja në sistemin e hieroglifëve të alfabetit fonetik egjiptian, të shkrimeve të para të njerëzimit, të krijuara nga kumtari i zotave; nga themeluesi i shkencës së lashtë fetare dhe laike; THOTIT, që njerëzit e quanim TATIT (*t Atit, ati i ynë*), paraqet hieroglifin e parë, Ain-shqiponjë.⁶⁵ Shqiponja simbolizonte krijuesin e të gjitha krijesave, simbolizonte ZOTIN, dhe ka edhe sisteme të tjera të alfabeveve nëpër botë.⁶⁶ Ne ishim dhe mbetëm shqiptarë, nga shqiponja, jo sepse e flitshim gjuhën shqipe, por sepse qemë në kualitetet e genies së Zotit në tokë. Kjo gjë është kryesorja, që na kishte lënë të quhemi: SHQIPTARË. Serbët avatarë (*avarë*) dhe sllavë, u vendosën në shekullin VI në jug të Danubit, në rrethinën e Smederevës së sotme. Atëherë, nuk përmendeshin serbët. Nuk ekzistonin serbët. Historiografia "*serbe*" e mbolli kështu emrin e tyre. Serbët "*lindën*" më vonë me kishat bizantine dhe *gjuhën ilire* të shpikur prej Cirilit dhe Metodit, që kanë qenë evrej të Greqisë dhe të shkolluar në Bizant.

⁶²) Prof. Genc Sulçebes, "Fakte gjenetike mbi lashtësinë autoktone të popullit shqiptar".

⁶³) Aref Mathieu, "Mikenët-Pellazgët...", faqe 216.

⁶⁴) Elena Kocaqi, "Albanët-Pellazgo-iliro-shqiptarët me famë botërore", Tiranë 2008, faqe 116-125.

⁶⁵) Xhyzepe Katapano, Thot-i fliste shqip, Botimet Enciklopedike, Tiranë 2007, faqe 83.

⁶⁶) Prof. Dr. Skender Rizaj, "Shqiptarët dhe serbët në Kosovë", Zëri, Prishtinë, 1991, faqe 9.

Ndër fiset më të mëdha kanë qenë dardanët që shtriheshin në perëndim të Moravës deri te rrjedha e sipërme e lumenjve Pek dhe Timok, dhe në viset lindore deri përtej Nishit. Dardanët shtriheshin në tërë Kosovën e sotme dhe një pjesë të madhe të Maqedonisë, në veri dhe në perëndim. Kjo trevë quhej Dardania. Vllehtë, që banonin aty, kanë qenë konglomeratë i dardanëve, ilirëve, shqiptarëve dhe të turqve të romanizuar në pikëpamje gjuhësore.

Avarët (avatarët) dhe peçenegët kanë qenë si kalorës mercenarë që t'i shërbenin administratës bizantine, për të penguar dyndjen e barbarëve të tjerë në brendësi të Gadishullit Ballkanik. Numri i tyre i vogël u shkri me popullatën vendëse, me fiset ilire: mezët, tribalët, dardanët, etj. Avarët/avatarët, që më vonë e morën emrin serbë, e kanë prejardhjen nga Himalajet dhe i përkisnin fisit turk-avar. Ndonjëri flet për zhdukjen e avarëve, si p.sh. historiani amerikan mbi Ballkanin, Ferdinand Schewill, në veprën e tij "Ballkani-historia dhe qytetërimi", në të cilën, për kundërshtim të Prof. Dr. Skender Rizajt, në fund të shekullit të shtatë dhe të tetë, këtë gadishull ua lë në duar sllavëve, të ardhur nga territori mëmë i sllavëve në Ballkan, djerrina e lumit Pipet, në veri të qytetit ukrainas të Kievit, pa e llogaritur se sllavët erdhën dhe u përzier me avarët, duke u kthyer nga grabitës në banorë që ngulën rrënjë nëpër territoret e pushtuara.⁶⁷

Peçenegët vinin nga rrethinat e maleve Karpate. Ai nuk i zë fare në gojë. Fiset e dyndura nga Azia Qendrore në Gadishullin Ballkanik nga shekulli VI e deri në shekullin XIII, u takonin fiseve turke, si p.sh: avarët, peçenekët, oguzët, magjarët, gaguzët, etj. Nga oguzët i kemi turqit gaguzë të Rumanisë dhe të Bullgarisë, që janë ortodoks dhe flasin turqisht; nga magjarët i kemi hungarezët e sotëm dhe shtetin e tyre Hungaria (Magjaria); emri bullgar ka dalur nga fjala turke: të përzier; ndërsa emri vllah ka dalë nga fjala turke: kalorës nomad. Për këtë arsye pra serbët kanë qenë pjesërisht kalorës mercenarë të avarit, që Perandoria Bizantine i ka pranuar si nomadë për të mbrojtur kufirin e epërm nga dyndjet e mëvonshme, dhe pjesërisht nga pakicat e tjera, peçenegët, sllavët, jevgjitët, evrejët, etj. që u asimiluan me avarët (avatarët) për t' u kthyer në luftë kundër ilirëve, si kategori sociale e popullsisë ilire, dhe mezi e prisnin rastin të "çliroheshin" njëherë e përgjithmonë. Edhe kroatët e shekullit VI-VII, qenë vendosur si kalorës mercenarë të Perandorisë Bizantine në kohën e Justinianit I, me qëllim që të mbronin kufirin nga dyndjet e Gadishullit Apenin. Ata u shkrinë shpejt me dalmatët, istrianët, etj, dhe kanë rrënjën ilire, gëzojnë trashëgiminë e tyre, veçanërisht të Dalmacisë, por emri i tyre ka rrjedhje prej hervati (kalorës nga Hervi), që është një qytet në Afganistan.⁶⁸

⁶⁷ Ferdinand Schewill, "Ballkani-historia dhe qytetërimi", Eugen, Tiranë 2002, faqe 73.

⁶⁸ Prof. Skender Rizaj, "E drejta historike...", në fusnotë, në faqet 25 e 26.

HASAN PRISHTINA - DIPLOMAT MENDJENDRITUR

Kujtime të Hasan Prishtinës

Kryengritja e përgjithshme antiosmane e vitit 1912

Ismail Kemal begu, sikur m'a pat dhanë fjalën, u gjet në shpi t'eme për darkë dhe e kaluem natën së bashku. Gjanë e gjatë biseduam mbi fatin e Shqipnis e ma në fund venduem me i dhanë mbarim mizorivet tyrke me një kryengritje.⁶⁹

Ismail Kemal begu:

“Hasan beg, i besoj fetarisht karakterit të zotnis s'ate. Ky besim më ka shty me i shkruë në zemër t'eme ato fjalë qi i përdorove sot në Parlament tue thanë: kam me kenë njeni e ndoshta i pari i atyne qi kam për t'a ngrehë flamurin e kryengritjes”!...

Hasan Prishtina:

“Ismail beg, para se me folë një fjalë mbatem shumë e mbasandej flas; por, mundem me Ju sigurue qi zakoni i em asht me mbajtë një fjalë qi del nga goja. Pra mbasi edhe zotnija e juaj po e ndien nevojën e një kryengritje, ndoshta vetëm vendimi i ynë nuk mund të mjaftojë për me qitë në krye këtë qëllim, po më duket qi do të na duhet me u bashkue edhe katër, pesë veta rreth këtij vendimi”.

Ismail Kemal begu:

“Po, edhe unë jam në mendim të zotnis sate”.

Një zë i Shqipërisë - Une voix d'Albanie

Sotir Kolea, në gazetën dyjavore “L'ALBANIE”, që dilte në Losanë të Zvicrës në gjuhën frënge, do të shkruan:

“...Në apelin aq fisnikërisht e me aq burrëri atdhetare që do ta lexojmë, është zëri i gjithë popullit shqiptar, i etur qysh me shekuj, për liri dhe pavarësi, zë që jehon. Në rrethanat aktuale, populli ynë nuk do të gjente përfaqësues më besnikë dhe më me ndikim se grupi i atdhetarëve që janë rreth Z. Hasan Bej Prishtina, në kërkesën që i bëjnë Z. Wilson, në emër të tyre”

“...Dans l'appel si noblement et si virilement patriote qu'on va lire, c'est la voix de tout le peuple albanais, depuis des siècles assoiffé de liberté et d'indépendance, qui retentit. Dans les circonstances actuelles, notre peuple ne pouvait trouver d'interprète plus fidèle et plus autorisé que le groupe de patriotes qui se pressent autour de M. Hassan Béy Prishtina, signataire, en leur nom, de la supplique à M. Wilson”⁷⁰

⁶⁹) Kujtim Nuro dhe Nezir Bato“Hasan Prishtina-Përmbledhje dokumentesh 1908-1933, Tiranë, 1982.

⁷⁰) Gazeta dyjavore “L'Albanie”, Losanë-Zvicër, 19 janar 1919.

PJESË NGA LETRA E HASAN PRISHTINËS, DREJTUAR:
PRESIDENTIT Z. WILSON NË PARIS GJATË KONFERENCËS SË PAQES

18 dhjetor 1918

Në këtë çast solemn, ne, përfaqësues të dy milionë e gjysmë shqiptarëve, të popullit më të vjetër të gadishullit të Ballkanit...ju lutemi të shqyrtoni aspiratat e kombit tonë...dhe të na jepni mundësinë t'ia paraqesim këto aspirata Konferencës së Paqes. Për shekuj të tërë, me gjithë fatkeqësitë e panumërta kundër të cilave i është dashur të luftojë, kombi ynë ka ruajtur gjuhën, origjinalitetin, zakonet, doket dhe traditat e veta. Për pesëqind vjet populli ynë ka kundërshtuar në mënyrë më të vendosur shtypjen otomane dhe më në fund e detyroi qeverinë turke të bënte lëshime të konsiderueshme nëpërmjet Kryengritjes së 1912-ës. Është e vërtetë se Konferenca e Ambasadorëve, që u mbajt më 1913 në Londër, njohu një Shqipëri të pavarur, por shumica e shqiptarëve kanë mbetur jashtë kufijve të këtij shteti...Kombi shqiptar, ka bërë aq sakrificat për realizimin e idealit të vet kombëtar dhe ka derdhur aq gjak për këtë qëllim...Ju lutem, zoti president, të ushtroni ndikimin tuaj me qëllim që gjatë negociatave, që do të zhvillohen lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e Shqipërisë, të thirret për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes një delegacion i popullit shqiptar për të parashtruar e për të argumentuar aspiratat dhe kërkesat e Kombit shqiptar.

Pranoni, zoti president, sigurimet e respektit tonë të thellë.



Thomas Woodrow Wilson



Hasan bej Prishtina

⁷¹)Dokumenti arkivor -AQSH i RPSH, F.251,D.9f. 122. (Originali frëngjisht).

ÇËSHTJA E KOSOVËS NË VITIN 1931 PAJTOI AHMET ZOGUN DHE HASAN PRISHTINËN

Një dokument i datës 23 shkurt 1931 dhe dokumente të tjera të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë tregojnë se atdhetari Hasan Prishtina për hir të çështjes kombëtare është pajtuar me Mbretin Zog dhe e ka përruar atë për shkëputjen nga Jugosllavia dhe aleancën me Italinë. Ky dokument tregon se Mbreti Zog dhe atdhetari Hasan Prishtina janë pajtuar për hir të çështjes shqiptare në përgjithësi dhe çështjes së Kosovës në veçanti. Dokumenti i datës 23 shkurt 1931 është marrë nga Arkivi i Maqedonisë.

Historiani Skëndër Hasani i cili e ka gjetur këtë dokument gjatë hulumtimeve për veprimtarinë atdhetare të Hasan Prishtinës, duke iu referuar dokumentit ai sqaron se në fillim të viteve '30-të u paraqit nevoja që të mobilizohej i gjithë potenciali në çlirim të Kosovës, ndërsa ky unifikim u forcua pasi mbreti Zog u shkëput nga politika e Beogradit, i cili ishte kushti i vetëm i atdhetarëve të asaj kohe që ishin në konflikt me mbretin Zog.



Atdhetari Hasan Prishtina dhe Ahmet Zogu (1914)

Dokumenti paraqet dy telegrame të diplomatit italian Macoti, i cili ka qenë ndërmjetësues mes Mbretit Zog dhe atdhetarit Hasan Prishtina, kryetar i komitetit revolucionar të Kosovës. “*Hasan bej Prishtina më foli për argumentet që do të bisedojë me Ministrin e Oborrit Mbretëror të Shqipërisë. Se ka qenë kundër Zogut kur ky dukej një instrument i politikës jugosllave,*

mirëpo ai e përruron Zogun prej ditës kur ai e drejtoi ndryshe politikën e Shqipërisë, duke arritur një aleancë ushtarake me Italinë dhe duke përjashtuar çdo lloj përzjerje me Jugosllavinë....”⁷²

Ndërkaq, në telegramin e parë flitet për ofertën e bashkëpunimit që i bën Mbreti Zog, kryetarit të Komitetit Nacional të Kosovës, Hasan Prishtinës, ku mbreti e ka pranuar prezencën e komitetit dhe ka treguar gatishmëri për të bërë diçka për kauzën e Kosovës.



Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Isë Boletini



Faksimile e të gjitha gazetave ku shkruante Hasan Prishtina për çështjen kombëtare

⁷²) Dokumenti i Arkivit të Maqedonisë; datë 23 shkurt 1931.

HASAN PRISHTINA DHE LIDHJA E KOMBEVE

Është e domosdoshme t'i jepet nderimi i duhur njerëzve që kanë bërë të mundur futjen e Shqipërisë në vitin 1920 në "Lidhjen e Kombeve", njëri ndër më meritoret e këtij akti madhor, padyshim është Kreu i Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve Hasan bej Prishtina.

Një pranim i tillë, një veprim kaq i domosdoshëm i dha fund edhe shumë tentativa të reja për aneksime dhe sajim terrioresh në dëm të shqiptarëve, dhe pikërisht territorit tashmë të njohur si i tillë. Ishte një moment i jashtëzakonshëm, por në fakt përveç presidentit Wilson i cili në fakt denoncoi interesa aneksimi tresh dhe veprimi në hije dhe të njëanshëm, ishin britanikët si gjithmonë që lobonin fort tashmë përpikërisht atë gjë që i duhej Shqipërisë mbas Kongresit të Lushnjës dhe formimit të qeverisë së parë normale. Kishin kaluar tetë vite lufte dhe pushtimesh, por dhe mosqeverisjeje, që nga 28 Nëntori i vitit 1912 dhe ku ishte shpallur zyrtarisht Pavarësia e Shqipërisë.

Nuk ka dyshim se momentet e tilla të mëdha i qartëson z. Herbert, dhe padyshim në paraqitjen e tij edhe Robert Elsie, por edhe Herman Bernstein, ambasadori amerikan në Shqipëri 1930/1933.

Italianët kishin pushtuar Vlorën dhe Shkodra rrezikonte serish në veri, por në përgjithësi vendi ishte në rrezik dhe vetëm diplomacia e madhe dhe e fortë e njerëzve me kompetencë të jashtëzakonshme, me kredenciale të larta në kancelaritë e botës mund të luanin në favor të vendit dhe patjetër janë individë si Ismail Qemali, Hasan Prishtina e shumë të tjerë, që e kanë bërë këtë me forcë, me penë dhe me dinjitet për atë pjesë që kanë mundur të arrijnë...



Faksimile e shkrimit të Herbert Urban dhe gazetës "Bashkimi i Kombit"


KOMITETI MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS

Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” u themelua në ilegalitet të plotë më 1 maj 1918 dhe më 7 nëntor 1918 u vendos përfundimisht në Shkodër nga figurat të shquara atdhetare si: Bajram Curri, Hoxha Kadri Prishtina, Sali Nivica, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Qamil Bala, Sali Rama, Hafiz Ismet Dibra etj.

Qëllimi parësor i kësaj organizate politike kombëtare ishte mbrotjtja e shtetit të pavarur shqiptar, demokratizimin e tij, çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të Jugosllavisë, që ishin të shkëputura padrejtësisht më 1913 dhe për bashkimin e tyre me Shqipërinë.



Figura të shquara atdhetare, themelues të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”



USHTAR NË MES TË USHTARËVE⁷⁷

“Në vend të një kulltuku me turp në Stamboll, preferova kryengritjen me nder në malet e Kosovës”⁷³

Atdhetari Hasan Prishtina zë vendin qendror si ideolog, politikan, udhëheqës dhe si ushtar në mes të ushtarëve mu në momentet më të thirrura të kohës dhe në çastet më dramatike të Atdheut, kur popujt e Ballkanit dhe sidomos populli shqiptar po bënin përpjekjet e fundit për t'i përzënë forcat e Perandorisë Osmane nga kjo pjesë e Evropës.

Qysh si fëmijë, Hasan Prishtina ishte edukuar dhe e kishte ushqyer shpirtin fëmijëror me këngët e trimërisë dhe me bisedat burrërore në shkollën e madhe shqiptare-odë, ku më së shumti bëhej fjalë për punët dhe hallet e popullit dhe të atdheut. Nga kjo kohë e më vonë, Hasan Prishtina, me mish e me shpirt, me mend e me grosh dhe me përpjekje mbinjerëzore deri në flijim do t'i kushtohet çështjes së lirisë, të pavarësisë dhe të demokratizimit të Atdheut si dhe të mbrojtjes së të drejtave kombëtare të popullit shqiptar në arenën ndërkom-bëtare. Mbi bazën e gjithë kësaj, Hasan Prishtina qe edhe dashamir i flaktë i arsimit dhe i shkollave në gjuhën shqipe.

I vetëdijshëm se pa arsimin e përgjithshëm të popullit nuk do të realizohen as synimet e emancipimit kombëtar, ai shprehej me bindje të plotë se *“arsimi është shpirti i një kombi”*. Nisur nga kjo bindje ai iu përvesh punës duke bërë agjitacion në tërë popullin e Kosovës dhe më në fund ia doli t'i tubonte më se 50 të rinj, të cilët i regjistroi në Shkollën Normale të Elbasanit, të hapur në vitin 1909. Për emrin dhe veprimtarinë e Hasan Prishtinës zu të dëgjohej çdokund. Gazeta *“Shqypeja e Shqypënis”*, që asokohe botohej në Sofje, ndër të tjera, shkruante: *“Shumë i vlefshmi atdhetar i flaktë, deputet i Prishtinës, zotni Hasan Prishtina po përpiqet për mbrojtjen e për të mirën e kombit shqiptar... Ky dashamir i bën një nder shumë të madh amës Shqipëri, për të cilën është gati të bëhet theror. Ky trim, bir i Shqipënis u është shembull me veprat e tia kaq shumë shqiptarëve...”*



Faksimile e gazetës *“Shqypeja e Shqypënis”* dhe *“Bashkimi i kombit”*

Duke e parë në personalitetin e Hasan Prishtinës një njeri të rrezikshëm për Perandorinë Osmane, Porta e Lartë u mundua ta bëjë atë për vete duke i premtuar edhe postin e ministrit. Këtë propozim Hasan Prishtina jo vetëm që nuk e pranoi, por edhe e përbuzi. Për këtë ofertë karrem, më vonë, në kujtimet e tij, Hasan Prishtina do të shkruajë: *“Në vend të një kulltuku me turp në Stamboll, preferova kryengritjen me nder në malet e Kosovës”*.


Pasi do të shkojnë kot të gjitha përpjekjet për ta përvetësuar dhe nënshtruar Hasan Prishtinën, qeveria turke fillon sulmet kundër personalitetit të tij duke e quajtur e akuzuar si kryengritës dhe kërcënues ndaj sulltanit... Por, në vend që këto fjalë t'ia ulin autoritetin, ato atij ia rritën namin edhe më tepër. Në këtë mënyrë, Hasan Prishtina, i cili për idealin atdhetar kishte bërë këtë betim: *“Mue n'idenë teme patriotike nuk ka mujtë as nuk do të muj me më shtrive ari i të tanë botës, por as mënia e të tanë armiqtvet. Ka me më shtrive vetëm vdekja.”* dhe që qeverinë turke e kishte kërcënuar me një kryengritje të re duke u zotuar se: *“...kam me kenë njeni, e ndoshta i pari i atyne, qi kam për ta ngrehë flamurin e kryengritjes...”* nuk i la fjalët peng, por rroku pushkën dhe u bë ideologu dhe udhëheqësi kryesor i Kryengritjes së përgjithshme të armatosur në Shqipëri gjatë vitit 1912.

Hasan Prishtina me të drejtë konsiderohet si njëri ndër veprimtarët më të dalluar dhe më të palodhshëm me nismën e të cilit u mbledh Kuvendi i Junikut (maj 1912), ku morën pjesë luftëtarë dhe njerëz të dalluar nga mbarë Kosova dhe ku u arrit që të bashkohen të gjitha forcat dhe të pranohen kërkesat e përbashkëta, të cilat iu paraqitën Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha. Frytet e kësaj lufte të përgjithshme u kurorëzuan në nëntor të vitit 1912 me pavarësinë e Shqipërisë, ndonëse të përgjysmuar dhe të cunguar barbarisht nga vendimi i Fuqive të Mëdha në vitin 1913.

Shpallja e Pavarësisë në Vlorë dhe ngritja e Flamurit kuq e zi, pas pesëqind vjet robërie, Hasan Prishtinën e gjejnë në burgun e Beogradit, të arrestuar nga pushtuesi serb. As vitet që pasuan pas kësaj date të rëndësishme, Hasan Prishtinën nuk do ta lënë të qetë. Përkundrazi, ai për herë e më tepër do të gjendet në ballë të detyrave të rëndësishme në të mirë të Atdheut. Përpjekjet e tij do të shtohen sidomos gjatë Luftës së Parë Botërore dhe pas saj. Në vitin 1913 emërohet ministër në qeverinë kombëtare të Vlorës. Bashkë me Hoxhë Kadriun, Bajram Currin, Sali Nivicën etj. Në vitin 1918 Hasan Prishtina themelon Komitetin “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, roli i të cilit qe shumë i rëndësishëm në organizimin dhe drejtimin e rezistencës dhe të luftës së popullit shqiptar të Kosovës e të viseve të tjera kundër pushtuesit serb, në demaskimin e terrorit, gjenocidit dhe përpjekjes për shfarosjen e shqiptarëve nga shteti serb.

Në dhjetor të vitit 1919, Hasan Prishtina, si kryetar i delegacionit të emëruar nga Komiteti, në Konferencën e Paqes në Paris, do të kërkojë bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Po në këtë rol, në shtator të vitit 1924, Hasan Prishtina do të shkojë edhe në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ku do të protestojë kundër gjenocidit dhe barbarizmave serbe mbi popullin shqiptar të Kosovës. Hasan Prishtina merr pjesë në organizimin e Kongresit Kombëtar të Lushnjës, (*janar 1920*), dhe pas më shumë se një viti, si përfaqësues i Dibrës, zgjidhet deputet në parlamentin shqiptar, ku me krejt qenien do të mbrojë fshatarësinë dhe do të demaskojë për vdekje çifligarët feudalë dhe tregtarët e pasur për rolin e tyre të dëmshëm ndaj atdheut.

Me rënien e qeverisë së Pandeli Evangjelit (dhjetor 1921), formohet qeveria e re, kryeministër dhe ministër i jashtëm i së cilës emërohet Hasan Prishtina. Në këtë qeveri, e cila nuk zgjati më shumë se katër ditë, zunë poste me rëndësi figurat më progresive të asaj kohe, si Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Fan Noli, etj. Në një situatë konfuze të krijuar asokohe, në një anë, dhe për të mos shkaktuar turbullira të brendshme dhe gjakderdhje vëllazërore, në anën tjetër, kjo qeveri u detyrua të japë dorëheqje. Në këtë kohë Hasan Prishtina braktis Tiranën dhe bashkë me Bajram Currin dhe patriotët të tjerë vazhdon rezistencën nëpër Malësinë e Veriut, prej nga udhëheq Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe çetat kryengritëse në Kosovë kundër pushtuesit serb. Gjithashtu Hasan Prishtina njihet edhe si luftëtar i vendosur për mbrojtjen e “Zonës neutrale” të Junikut.



Fan Noli



Pandeli Evangjeli

⁷³⁾Mr. Kadri Rexha, Motoja jetësore e atdhetarit, Hasan Prishtina ishte lufta për liri dhe bashkim kombëtar

ORGANIZATORI DHE UDHËHEQËSI I KRYENGRITJEVE
TË ARMATOSURA

“Na luftojmë e ndoshta nuk e gëzojmë, por ata që vinë mbas nesh, kanë me i gjet shejat tona...”

Si shumë atdhetarë të tjerë edhe Hasan Prishtina u detyrua ta braktisë atdheun. Edhe jashtë atdheut, si në Itali, Francë, Austri, Greqi e kudo që të gjendet Hasan Prishtina nuk e ndal veprimtarinë atdhetare. *“Luftën dhe kundërshtimin ndaj copëtimit, do ta ndaloj vetëm kur të çlirohet dhe të bashkohet Kombi im”* ishte shprehur Hasani. Gjatë tërë kësaj kohe ai do të gjendet në krahun e forcave më përparimtare shqiptare.

Ndonëse Shqipëria, në periudhën 7 mars 1914 - 3 shtator 1914, ishte nën administrimin e princit gjerman Vilhelm Vid, gjatë kësaj kohe Kosova dhe viset tjera etnike shqiptare me vendim të Konferencës së Londrës (1913), u lanë nën pushtimin serb, përjetonin çastet më të vështira në historinë e saj. Udhëheqësit e kryengritjes: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini dhe qindra të tjerë nga Kosova, që ishin larguar pas kryengritjes së vjeshtës 1913, u strehuan në Durrës dhe në Shkodër. Princi Vid dhe qeveria e tij, ndonëse nuk arritën të krijonin një stabilitet të qëndrueshëm politik brenda kufijve të Shqipërisë londineze, atëherë kishte pak mundësi të bëheshin hapa konkretë, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, ashtu siç kishin menduar disa krerë të kryengritjes nga Kosova, në fillim të ardhjes së Vidit në Shqipëri. Në këto rrethana u shtrua si detyrë imperative nga vetë shqiptarët që të përgatiten për një kryengritje çlirimtare, kundër pushtuesve serbë. Dhe këtë barrë të rëndë do ta marrë përsipër Hasan Prishtina.

Në gjysmën e dytë të vitit 1914, Hasan Prishtina pasi ka braktisur postin e ministrit të postë-telegrafëve që mbante në qeverinë e Durrësit, kaloi në Shqipërinë Veriore me qëllim të organizimit të një kryengritjeje antiserbe.

Ishte koha kur Serbia ishte e zënë në luftë me Austro-Hungarinë, për shkak të vrasjes së princit Franc Ferdinand (*më 28.VII.1914*) në Sarajevë, të cilën situatë Hasan Prishtina e vlerësoi si të favorshme për përgatitjen e një kryengritjeje për çlirimin e trojeve të pushtuara shqiptare.

Më 6 gusht 1914 konsulli austriak Karl, nga Durrësi njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë për fillimin e aksioneve kundër pushtuesve serbë nga Hasan Prishtina, Selim Batusha, Bajram Daklani, Qazim Begolli e Halim Deralla (*djali i Mehmet Derallës*), të cilët kishin me vete lëndë plasëse dhe municion për mauzerët.⁷⁴

Dy ditë më vonë (*më 8 gusht*) konsulli Karl përsëri njoftonte Vjenën për një protestë të konsullit serb Gavrilloviq, drejtuar qeverisë shqiptare të Durrësit

⁷⁴⁾ Shefqet Hoxha “Luma në luftrat për liri”, Tiranë 2002, fq.265. cit. Hasan Prishtina;dokumente, Tiranë 1983/dok.50,fq.927).

për fillimin e përgatitjeve të shqiptarëve për kryengritje kundër Serbisë, të udhëhequr nga Hasan Prishtina. Se kjo çështje në aspektin diplomatik, ishte bërë tepër shqetësuese për Serbinë, kuptohet edhe nga njoftimi i Ministrisë së Jashtme të Serbisë dërguar legatës mbretërore serbe në Romë, më 12 gusht 1914. Aty vihet në dukje veprimtaria e Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit etj, kundër politikës shoviniste serbe. Këto zhvillime gjithashtu konfirmohen edhe nga shtypi i asaj kohe.⁷⁵

Luftën antizogiste në Shqipëri si dhe luftën kundër robërisë serbe nuk do ta ndalë deri në frymën e fundit. Për këtë qëllim e themeloi edhe “Komitetin për Çlirimin e Kosovës”. Në mënyrë të veçantë janë të njohura përpjekjet dhe ankesat e tij në drejtim të Turqisë për mospranimin dhe ndalimin e shpërnguljes nga dhuna serbe të popullit shqiptar të Kosovës në krahinat e Anadollit.

Pushka e Zogut, që nuk u ndal dhe nuk u ngop me vrasjen e një vargu atdhetarësh shqiptarë, bij më të mirë të popullit, nuk përjashtoi as Hasan Prishtinën. Ai me dorën e Ibrahim Çelos dhe me të hollat e Karagjorgjeviqëve, e shtriu për tokë atdhetarin demokrat, figurën më të ndritshme të kombit shqiptar.

-Kështu, i dha fund jetës Hasan Prishtina, i cili gjatë tërë jetës së tij të vrullshme politike dhe atdhetare u kishte shpëtuar katër atentateve të organizuara nga armiqtë e popullit.

- Kështu i dha fund jetës Prometheu shqiptar që me stoicizëm u kishte bërë ballë dy burgosjeve nga pushtuesit serbë dhe bullgarë.

-Kështu i dha fund jetës i Pavdekshmi i Kombit, gjashtë herë i dënuar me vdekje nga xhonturqit, nga tradhtari i shitur tek serbët Esat Pasha, nga Serbia dhe tri herë nga qeveria e Ahmet Zogut.

-Kështu i dha fund jetës Tribuni i Kombit i paluhatshëm asnjëherë në betimin e vet: *“Mue n'idenë teme patriotike nuk ka muejtë as nuk do të muj me më shtrua ari i të tanë botës, por as mënia e tanë armiqëvet. Ka me më shtrua vetëm vdekja”*.

Në vitin 1977 eshtrat e Hasan Prishtinës nga Selaniku u sollën në Shqipëri. Dita e kthimit të eshrave të Hasan Prishtinës në Shqipëri do të mbetet e paharruar në zemrën e Kombit shqiptar. Atë ditë, që nga kufiri me Greqinë, arkivoli i Hasan Prishtinës do të kalojë nga dora në dorë dhe, në pamundësi që të udhëtojë për në Kosovë, do të ndalet përjetshëm në Kukës, buzë kufirit që e ndan përgjysmë kombin shqiptar.

-Atë ditë, me krenari dhe dhimbje të madhe, Shqipëria e qau Heroin e vet dhe Burrin e madh të Kosovës...

⁷⁵⁾ Po aty; Hasan Prishtina, dokumente, Tiranë 1983/dok. 51, fq. 93; dok. 53, fq. 94 / 96.

LARGIMI NGA DURRËSI

Sipas kujtimeve të I. Strazimirit, nga mbarimi i korrikut të vitit 1914, Hasan Prishtina me 150 dibranë e luftëtarë tjerë nga Kosova, ishte nisur nga Durrësi dhe fillimisht kishte ndaluar në Peshkopi. Ai e kishte tubuar parinë e Dibrës dhe u kishte treguar se Austrohungaria ka sjellë në Shëngjin armë e municion, dhe kishte kërkuar që të përgatitet një kryengritje kundër pushtuesve serbë. Kjo kryengritje, sipas Hasan Prishtinës, duhej bërë sa më parë dhe pa ndihmën e një shteti të huaj. Në tubimin me dibranët Hasan Prishtina kërkonte të miratohej edhe kjo deklaratë:

1. *T'i kërkohej Serbisë lirimi i tokave shqiptare, sepse nuk janë të saj dhe ajo nuk ka të drejtë dhe as është e aftë t'i qeverisë,*
2. *Në rast se Serbia nuk pranon t'i lirojë me hir, ndaj saj do të përdorim forcën...*⁷⁶

Prej Dibrës, Hasan Prishtina me bashkëluftëtarët e tij, kalon në krahinë e Lumës. Ato ditë para se të arrinte Hasan Prishtina në Lumë, krerët e kësaj krahine në një kuvend të mbajtur në Bicaj, kishin vendosur (*lidhur besën*) që të mos përzihen në zhvillimet politike dhe ushtarake të kohës. Në marrjen e këtij vendimi kishin ndikuar edhe ngjarjet dramatike të tetorit - nëntorit 1913, kur 27 fshatra të Lumës qenë djegur e shkrumbuar, ndërsa u vranë e u masakruan edhe qindra lumjanë nga ushtria barbare serbe. Përkundër këtij vendimi, Hasan Prishtina gjeti përkrahjen të një pjesë e krerëve lumjanë si te: Hoxhë Mehmeti, Qazim Lika, Sali Spahija, Sulë Elezi, Xhafer Bislimi, Xhafer Shema, Laçët e Bardhocit..., por edhe të vetë nënprefekti i Lumës me seli në Bicaj, Sadik Gostivari. Në fshatrat e Lumës ndodheshin edhe dhjetra atdhetarë që kishin ikur nga Kosova dhe pritnin momentin për t'u kthyer.

Gjatë kësaj kohe Hasan Prishtina u strehua në shumë familje atdhetare të Lumës si: në Kolesjan, në Kukës, në Shtiqën, në Bicaj, në Gjinaj, në Kalimash, në Surroj, në Bardhoc, në Has etj.⁷⁷

Hasan Prishtina pati lëvizur edhe në Has e në Malësi për t'i bashkuar malë-sorët e kësaj zone në luftë kundër pushtuesve serbë. Një gjë të tillë do ta bënte edhe Bajram Curri në Malësi të Gjakovës. Lëvizje për ta ndihmuar kryengri-tjen ka pasur edhe në krahinë e Dibrës.

Në shkurt 1915 me nismën e Hasan Prishtinës, i ndihmuar edhe nga krerët lumjanë dhe nënprefekti Sadik Gostivari, në Lumë u organizuan dy kuvende në: Bicaj e në Kullë të Lumës. Në Kuvendin e parë, që u mbajt në xhaminë e Halil Agës, në Bicaj morën pjesë shumë krerë lumjanë dhe krerë të tjerë nga viset e Kosovës, të strehuar në Shqipëri, si: Hasan beg Gizolli, Sheh

⁷⁶) Sh. Hoxha "Luma në luftërat për liri", Tiranë 2002, f.266-267.

I.Strazimiri (Kujtime 1910-1924) AIH Dosja A-VII-94.

⁷⁷) Sh.Hoxha "Portrete e syzime atdhetarësh", Tiranë 2002, fq.168.

Sheh Hasani i sektit rrufai (Prizren), Ajet e Selim Dervina, Mehmet Konjuhi (Llap), Keri i Sadik Bardhit, Sadik Gostivari, Mehmet Delia, Isuf Mehaniqi, Rexhep Delia i Pozheranit etj.⁷⁸

Nga krerët e Lumës qenë Sulë Elezi dhe nipi i tij Xhaferi, Isuf Dina (Bicaj), Mustafë Zyberi (Surroj), Hoxhë Mehmeti e Xhafer Shema (Shtiqën) etj, por nuk erdhën aty Islam Spahija, Cen Daci e ndonjë tjetër, sepse i qëndruan besnikë besës së lidhur (*në mbledhjen e Dheut*) për të mos u përfshirë në zhvillimet politike të kohës.⁷⁹

Në kuvend u bisedua për përgatitjet që duhet bërë për të sulmuar forcat serbe në kufi dhe për të çliruar më pas Prizrenin e vendet tjera nën pushtim.

Pas këtij kuvendi, Hasan Prishtina për të hulumtuar situatën politike dhe ushtarake në Prizren e rrethinë, atje i dërgoi tre lumjanë: Xhafer Shemën (Shtiqën), Sinan Hysenin (Shahe) dhe Rasim Istrefin (Ramhas).⁸⁰

Këta burra të kombit gjatë tërë kohës propaganduan kundër regjimit pushtues serb si dhe rekrutuan njerëz në shërbim të çështjes kombëtare. Në Prizren dhe në fshatrat përreth u shpërndanë trakte e thirrje për kryengritje, ndërsa për të penguar agjenturat serbe u shtua vigjilenca në krahinën e Lumës e të Hasit.

Pasi u bënë përgatitjet e duhura dhe u sigurua një forcë goditëse prej më shumë se 300 vetësh (*disa burime flasin për 600 vetë*) në kuvendin e dytë të mbajtur në Kullë Lumë, u përgatit plani për të sulmuar fillimisht garnizonin serb, të dislokuar në fshatin Zhur. Kryengritësit shqiptarë të prirë nga Hasan Prishtina dhe krerët tjerë: Hasan beg Gizolli, Ajet e Selim Dervina, Mehmet Konjuhi, Keri i Sadik Bardhit, Mehmet Delia, Isuf Mehaniqi, Sulë Elezi, Xhafer Bislim Elezi, Mustafë Zyberi, Isuf Dina, Cen Seda, Januz Kurti, Xhafer Shema etj, nga Kullë Luma u përqëndruan në fshatrat Bardhoc e Morinë dhe pastaj në orët e hershme të mëngjesit të datës 13 shkurt 1915, nëpër bjeshkët e këtij fshati, vazhduan rrugën për në Zhur. Meqë luftëtarët i kishin zënë të gjitha shtigjet dhe rrugët që të shpienin në drejtim të grykës së Zhurit, fillimisht grupi i drejtuar nga Hasan Prishtina i këputën telat (*lidhjet telegrafike e telefonike*) në malet e Koretnikut.⁸¹

Gjatë kësaj kohe në krahun e djathtë të shpatit të malit Koretnik do të arrijnë edhe malësorët nga fshatrat: Zapod, Belja, Lojme, Nimc të udhëhequr nga Rasim Selmani, për të mbështetur sulmet që do të kryhen kundër përqendrimit të forcave kufitare serbe.⁸²

78) Mustafë Mamusha 78 vjeç, /Kujtime-Kujtesë e popullit/, Kukës, 18.12.1968.

79) Sh. Hoxha - Vepra e cituar, fq.46./Sh.Hoxha "Luma në luftat për liri", fq. 270.

80) Xhafer Shema nga Shtiqëni, 86 vjeç, /Kujtime/, Shtiqën, 04.02.1972.

81) Xh. Shala - "Marrëdhëniet Shqiptaro-serbe 1912-1918", Prishtinë 1990, fq. 240/241.

82) Q. Mataj - "Hoxhë Mehmeti 1867-1927", Kukës 2002, fq.132.

Kryengritësit shqiptarë në agun e mëngjesit, të ndihmuar nga mulla Nasuf Hoxha i Zhurit, u futën në fshat dhe pasi e rrethuan garnizonin serb, u vendosën nëpër llogore -istikame që i kishin hapur vetë forcat serbe. Shenja e fillimit të sulmit që shpërthimi i një bombe nga luftëtari Xhemë Voka prej Shtiqënit. Komanda serbe e alarmuar nga shpërthimi, dha urdhër për të dalë në pozicione, mirëpo forcat shqiptare sulmuan furishëm repartet serbe.

Luftimet qenë të përgjakshme dhe pati përleshje trup më trup. Me kryengritësit, u bashkuan edhe shumë burra të Zhurit, Dobrushtit, Shkozës e të Vërmicës, të cilët me pushkë e sëpata, kosa e thika, sulmuan ushtarët serbë. Kushtrimin për t'u bashkuar radhëve të Hasan Prishtinës e dha atdhetari zhurjan Asllan Rexhë Ademaj, i cili në ato çaste bëri thirrje: "*Bini burra, bini trima, ja sot ja kurrë, ka ardhur koha me e largue shkaun nga vatani!*". Në këtë betejë, që zgjati disa orë rresht, u vranë rreth 100 ushtarë serbë, (*përfshirë këtu edhe disa oficerë*) dhe repartet e armikut u shpartalluan plotësisht.⁸³

Kryengritësit shqiptarë pasi morën nën kontroll Qafën e Zhurit marshuan në drejtim të Prizrenit. Ndonëse krismat e bombave dhe të pushkëve kishin alarmuar edhe komandën qendrore serbe në Prizren, ajo në drejtim të Zhurit kishte nisur disa reparte ushtarake. Ndërkohë që forcat kryengritëse shqiptare kishin arritur tek Ura e Vlashnjës, ata do të përballen me repartet serbe. Kryengritësit shqiptarë duke u përqendruar në zonën; Bregu i Drinit-Vlashnje-Poslisht-Billushë, zhvilluan një përleshje të përgjakshme me repartet serbe, të cilat me këtë rast përdorën edhe artilerinë e rëndë.

Në këto përleshje nga predhat e topit u vranë: Nebi Latifi e Brahim Jashari nga Bruti dhe dy burra trima nga fshati Kabash i Prizrenit. Pas një qëndrese heroike, forcat shqiptare (*në mungesë të municionit*) dhe të ndodhur përballë një armiku shumëfish më të madh në numër e të armatosur me topa e mitralozë, u detyruan të tërhiqen në drejtim të Zhurit, për të kaluar pastaj nëpër malet e Koretnikut dhe të Gjalllicës në thellësi të krahinës së Lumës.⁸⁴

Hasan Prishtina, pas largimit nga zona e luftimeve, duke e përjetuar rëndë këtë disfatë do të deklaronte: "*Na luftojmë e ndoshta gja nuk gëzojmë (lirinë), por ata që vinë mbas nesh kanë me i gjetë shejat tona...*"

Pas kësaj kryengritjeje të përgjakshme, banorët e fshatrave Zhur, Shkozë, Dobrusht e Vërmicë, për t'i shpëtuar masakrave serbe, u detyruan të shpër-ngulen dhe u strehuan në fshatrat e Lumës: Shtiqën, Nangë, Bicaj, Gabrricë, Kolesjan etj. Ata qëndruan rreth tre muaj larg shtëpive të tyre dhe pikërisht u kthyen ditën e Shëngjergjit, më 6 maj 1915.⁸⁵

⁸³) Ibish Avdi Rizanaj, Kujtime në dorëshkrim, Zhur, gusht 1992.

⁸⁴) Kujtime nga Mustafë Mamusha, 78 vjeç, Kukës 18.12.1968./ Sh. Hoxha "Luma në luftra...", fq.275).


⁸⁵) Sipas dëshmive të plakut Ibish Avdia nga fshati Zhur, për kthimin e banorëve të Zhurit.

**FAKTE HISTORIKE NGA ARKIVAT:
GJENEVË-VJENË**



*“Dy duar për kokën, koka për atdheun”
Hasan Prishtina*

Genève, le 26 Septembre 1924.



Monsieur le Président,

Dès les premiers jours de la restauration du régime serbe en Cossovo, Macédoine et Monténégro (15-30 Octobre 1918) nos Comités se sont adressés à la Conférence de la Paix, à celle des Ambassadeurs, à la Société des Nations et à l'opinion publique du monde civilisé pour protester contre ce régime et contre le fait que l'Etat serbe-croate-slovène non seulement n'a pas voulu respecter les droits des minorités, mais il est allé jusqu'à nier aux Albanais leurs droits à la vie.

En effet, d'après ce que ressort des documentations ci-incluses, voici un résumé de la conduite des serbes vis-à-vis des Albanais dans les régions précitées :

1. Organisation des bandes armées :

sous le nom d'organisations nationales, l'Etat serbe-croate-slovène a organisé des bandes armées qui terrorisent les régions albanaises, massacrent les paysans après leur avoir pillé et incendié les habitations (voir annexe N° 1)

2. Organisation des massacres périodiques :

sous prétexte de réprimer les catchak (dé-

Son Excellence Monsieur Paul HYMANS
Président du Conseil de la
Société des Nations GENEVE

- 2 -

(déserteurs) les forces armées régulières serbes ont détruit de nombreux villages des districts de Prichtina Vultchitrin, Mitrovitza et Tpek en y massacrant des milliers de paysans sans épargner les femmes, les enfants et les vieillards (voir annexe N° 2)

3. Colonisation des villages détruits et des foyers désertés :

Chaque coup de destruction des Albanais est suivi par une opération d'installation des colons russes, monténégrins et serbes. Ces colons, à leur tour, terrorisent systématiquement les villages avoisinants en obligeant les habitants de déserrer leurs foyers et leurs champs qui sont immédiatement confisqués et colonisés. Ce sont les victimes de cette manoeuvre tragique qui, en partie, rôdent autour de leurs foyers et qui s'appellent "catchak".

4. Pillages légalisés :

Gosovo, pays purement agricole et assez florissant sous le régime turc souffre actuellement d'une misère épouvantable : les paysans et les habitants des villes de nationalité albanaise, cultivateurs en général, ont été dépouillés de leurs champs sous prétexte de l'application de la loi agraire (voir annexe N° 3)

5. Emigration en masse des Albanais de Cossovo :
ce régime de fer, de feu et de pillages

- 3 -

constitue le principal mobile d'une émigration en masse des populations albanaises vers la Turquie qui s'effectue dans des conditions effroyables en coûtant la vie à des centaines de familles et en condamnant le reste à une misère sans remède. (voir annexe N° 4)

6. Libertés constitutionnelles :

la constitution Serbe en ce qui regarde les Albanais de Cossovo, de Macédoine et de Monténégro, n'a que la valeur des lettres dorées pour mieux méduser l'opinion publique du monde civilisé : elle est pour les Albanais ce qu'était la Constitution des Jeunes Turcs de 1908/1918 pour les Arméniens. (voir annexe N° 5)

7. Justice serbe :

pour se faire une idée nette de la justice serbe, il suffit de savoir que personne n'a été poursuivi par les tribunaux pour des milliers de crimes commis en plein jour : c'est l'unique pays du monde où l'on tue en présence des juges qui se taisent. (voir annexe N° 5)

Tout ce que nous venons de déclarer ci-dessus se trouve en évidente contradiction avec les stipulations contenues dans les articles 1 à 8 du Ter chapitre du traité relatif aux droits des minorités ethniques et signé à Saint-Germain-en-Laye, le 10 Septembre 1919 entre les principales Puissances Alliées et Associées et

- 4 -


serbe-croate-slovène.

Espérant que la Société des Nations voudra bien intervenir auprès du Gouvernement de Belgrade pour assurer l'application du traité précité, nous vous prions de vouloir bien agréer les sentiments de notre haute considération.

Bajram Curri *Hasan Prishtina* *B. Pejani*
Représentants des Comités Unis des Albanais irrédimés.



Bajram Curri



Hasan Prishtina



Bedri Pejani

DOKUMENTI Nr. 39302

Gjenevë, më 26 shtator 1924

(Vula dhe nënshkrimi të pallexueshëm)

Shumë i nderuari zotëri President

Që nga ditët e para të rivendosjes së regjimit serb në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi (15-30 tetor 1918) Komitetet tona u janë drejtuar Konferencës së Paqes, Konferencës së Ambasadorëve, asaj të Lidhjes së Kombeve si dhe opinionit publik në mbarë botën e civilizuar me qëllim që të protestojnë kundër këtij regjimi dhe kundër faktit që shteti i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve jo vetëm që nuk është duke i respektuar të drejtat e pakicave, por, për më tepër ka shkuar aq larg, sa që shqiptarëve ua mohon madje të drejtën për të jetuar.

Në bazë të fakteve që reflektojnë nga dokumentacioni i bashkëngjitur, përmes kësaj rruge jua dërgojmë një përmbledhje të atyre fakteve që rrëfejnë se si veprojnë serbët kundrejt shqiptarëve në rajonet e sipërpërmendura;

1. Organizimi i bandave të armatosura:

Duke i emërtuar si organizata kombëtare, shteti i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve ka organizuar banda të armatosura, të cilat ushtrojnë terror në rajonet e banuara me shqiptarë dhe të cilat i masakrojnë fshatarët, dhe të cilat, pasi t'i kenë plaçkitur këta, ua djegin madje edhe shtëpitë.

2. Organizimi periodik i masakrave:

Nën pretekstin e shtypjes së lëvizjes së kaçakëve, (dezertorëve) forcat e rregullta ushtarake serbe kanë shkatërruar fshatra të shumtë në rrethet e Prishtinës, Vuçitërnës, Mitrovicës dhe të Pejës dhe kanë vrarë atje me mijëra fshatarë, duke mos kursyer me këtë rast as gratë, fëmijët dhe pleqtë (*shih shtojcën nr. 2*).

5 Shtojca

*Shkëlqesisë së Tij zotit Paul Humans
President i Këshillit të Lidhjes së Kombeve
GJENEVË*

3. Kolonizimi i fshatrave të shkatërruara dhe i shtëpive të braktisura:

Pas secilit sulm kundër shqiptarëve dhe shkatërrimit, me të cilin shoqërohen gjithnjë sulmet e tilla, pason një operacion i kolonizimit të këtyre trevave me kolonë: rusë, malazez dhe serbë. Këta kolonë pastaj i terrorizojnë në mënyrë sistematike fshatrat fqinjë, duke i detyruar edhe banorët e atjeshëm t'i braktisin shtëpitë dhe tokat e tyre, të cilat pastaj menjëherë konfiskohen dhe kolonizo-hen. Dhe viktimat e këtyre manovrimeve tragjike, të cilat pastaj mbeten të sillen vërdallë rreth shtëpive të tyre, i quajnë “kaçakë”.

4. Plaçkitjet e legalizuara:

Kosova, një vend plotësisht agrar, i cili në kohën e regjimit turk faktikisht lulëzonte, është duke vuajtur aktualisht nga një mjerim i tmerrshëm; fshatarët e kombësisë shqiptare dhe banorët shqiptarë të qyteteve janë dëbuar nga fushat dhe arat e tyre me pretekstin e zbatimit të Ligjit për reformën agrare (*Shih shtojcën nr. 3*).

5. Shpërngulja masive e shqiptarëve nga Kosova:

Ky regjim i hekurt, zjarrvënës dhe plaçkitës është bërë zaten shkak kryesor për një shpërngulje masive të popullatës shqiptare për në Turqi, shpërngulje kjo që ndodh nën kushte të tmerrshme, gjë që qindra familjeve u ka kushtuar me jetë, ndërsa të mbijetuarit i ka mallkuar të jetojnë në një mjerim të paimagjinueshëm (*Shih shtojcën nr. 4*).



Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi

6. Liritë e garantuara me kushtetutë:

Për shqiptarët në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, kushtetuta serbe e ka vetëm vlerën e shkronjave të arta, të shkruara në letër, me qëllim të mashtrimit të opinionit publik në botën e civilizuar. Për shqiptarët kjo kushtetutë është njësoj siç ishte Kushtetuta e xhonturqve 1908-1918 për armenët (*Shih shtojcën nr. 5*).

7. Gjyqësia serbe:

Për ta pasur një ide të qartë lidhur me gjyqësinë serbe, mjafton që të dihet fakti se për mijëra krime, të cilat kanë ndodhur mu në mes të ditës, para gjykatave serbe nuk ka dhënë llogari asnjë person; ky është vendi i vetëm në botë ku njerëzit vriten mu para syve të gjykatësve, dhe këta s'ndërmarrin gjë, por vetëm heshtin (*Shih shtojcën nr. 5*).


Të gjitha këto, që i përmendëm më lart, qëndrojnë në kontradiktë të dukshme me dispozitat e neneve 1 deri 8 të kreut -I- të Kontratës mbi të drejtat e pakicave etnike, e cila është nënshkruar më 10 shtator 1919 në *Saint-Germain-en-Laye* ndërmjet fuqive kryesore fituese dhe aleatëve të tyre, në një rën anë, dhe shtetit të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve në anën tjetër.

Duke pasur shpresë që Lidhja e Kombeve do të intervenojë tek Qeveria e Beogradit me qëllim të garantimit të zbatimit të kontratës së sipërpërmendur, e nënshkruajmë këtë shkresë, duke ua shfaqur respektin e lartë.

(Tri nënshkrime, shih tekstin origjinal në gjuhën frënge)

*Përfaqësues të Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve
irredentistë*

Përkthimi i verifikuar nga gjuha frënge



Im Namen unseres Volkes, im Interesse des Friedens auf der Balkanhalbinsel, richten wir daher an den Völkerbund die Bitte, energische Massnahmen zu ergreifen, um den unter jugoslawischer Herrschaft lebenden Albanern ihre Menschenrechte zu sichern.

Wenn der Völkerbund auf seine Fahne die Gerechtigkeit und die Humanität geschrieben hat, wenn er den Frieden auf dem Balkan zu sichern wünscht, wenn der Völkerbund nach dem Ruhm strebt, in der Geschichte als der Retter der kleinen Völker verzeichnet zu werde, dann ist es hoch an der Zeit, bei der jugoslawischen Regierung Schritte zu unternehmen, um den im jugoslawischen Staate lebenden Albanern die Gewährung von Minoritätsrechten zu sichern.

Auf Wunsch bin ich und meine Volksgenossen bereit, unsere zahlreichen Beschwerden noch einmal zu formulieren. Eine vom Völkerbund veranstaltete Untersuchung würde ihre Richtigkeit in allen Teilen bestätigen.

Indem wir Eure Exzellenz bitten, unsere Wünsche dem Völkerbund gütigst zu unterbreiten, benütze ich diese Gelegenheit, um Eure Exzellenz der grossen Verehrung zu versichern, die unsere Nation für Sie empfindet und mit der ich zeichne als

Eurer Exzellenz sehr ergebener

Langegasse 26

Hasan Bey Prishtina

gewesener albanischer Minister.

Wien, 15. März 1927.

An Seine Exzellenz, den Hochwohlgeborenen
Herrn Dr. Stresemann,
Kanzler des Deutschen Reichs, Präsidenten des
Völkerbunds, etc. etc. Genf.

DOKUMENTI Nr. 58664

Vulat dhe datat e pranimit të shkresës dhe nënshkrimi, shih originalin në gjuhën gjermane (faqe 126)

Shkëlqesisë Suaj!

Në emër të 1.200.000 bashkëpatriotëve të mi shqiptarë, të cilët u dënuan me fatin që të jetojnë jashtë atdheut të tyre shqiptar, nën thundrën e pushtuesit serb në Fushën e Mëllenjave /Kosovë/ dhe në Maqedoni, unë - edhe vetë një shqiptar nga Kosova - i drejtohem Shkëlqesisë Suaj, në cilësinë Tuaj të Presidentit të Lidhjes së Kombeve me lutjen e përzemërt që kësaj pjese të shkëputur të kombit tonë t'i ofroni ndihmë.

Disa herë kemi tentuar tashmë që vëmendjen e Lidhjes së Kombeve ta kthejmë nga fati i dhimbshëm i kësaj pjese të popullit tonë. Mirëpo, për fat të keq, deri më tash nuk ja kemi dalë që ta sigurojmë garantimin e të drejtave të njeriut për ta.

Prej të gjitha padrejtësive, që janë pjesë e martirizimit të vëllezërve tanë, me këtë rast do të doja t'i përmendja vetëm disa fakte. Shqiptarët nga këto treva sistematikisht po detyrohen ta lëshojnë tokën e etërve të tyre, të cilën këta e kanë ushqyer me djersën dhe gjakun e tyre, dhe të shpërngulen në drejtim të Shqipërisë dhe të Turqisë. Të gjitha të drejtat, të cilat me marrëveshje ndërkombëtare u garantohen pakicave kombëtare, janë duke iu mohuar bashkëpatriotëve tanë.

Në emër të popullit tonë dhe në interes të paqes në Gadishullin Ballkanik, i drejtohem Lidhjes së Kombeve me lutjen që të ndërmerren masa energjike nga ana e saj, me qëllim që t'u sigurohen të drejtat njerëzore shqiptarëve që jetojnë nën sundimin jugosllav.



Nëse Lidhja e Kombeve në flamurin e saj e ka të shënuar drejtësinë dhe humanitetin, nëse kjo Lidhje dëshiron që në Ballkan ta sigurojë paqen, nëse Lidhja e Kombeve e synon lavdinë dhe nëse dëshiron që për të të flitet si shpëtimtare e popujve të vegjël, atëherë ka ardhur koha e fundit për të ndërmarrë hapa ndaj Qeverisë Jugosllave me qëllim që shqiptarëve, që jetojnë në shtetin jugosllav, t'u sigurohet garantimi i të drejtave të pakicave.

Nëse shprehet dëshira nga ana Juaj, unë dhe bashkëpatriotët e mi jemi të gatshëm që edhe një herë t'jua formulojmë ankesat e shumta në numër. Një investigim i organizuar nga ana e Lidhjes së Kombeve do ta dëshmonte vërtetësinë e këtyre ankesave në të gjitha pjesët e tyre.

Duke e lutur Shkëlqesinë Tuaj, që dëshirat tona t'ia përcillni Lidhjes së Kombeve, e shfrytëzoj rastin që Shkëlqesisë Suaj t'ia shprehi admirimin e madh, të cilin kombi ynë e ndjen për Ju, si dhe ta nënshkruaj këtë shkresë si:

VIII Langegasse 26


Besnik i madh i Shkëlqesisë Suaj
Hassan Bey Prishtina
Ish-ministër shqiptar

Vjenë, më 15 mars 1927

Shkëlqesisë së Tij, fisnikut

Zotëri Dr. Stresemann

Kancelar i Perandorisë Gjermane, Kryetarit të Lidhjes së Kombeve etj. etj.



Përkthimi i verifikuar nga gjermanishtja në gjuhën shqipe

Annexe N° 1

DOCUMENTATIONS DE SOURCE JOUGOSLAVE

I. Un aveu serbe

Préambule d'un ordre-circulaire du ministre de l'intérieur
du Gouvernement de Pasitch

"Nous sommes informé que quelques membres des organi-"
"sations nationales ont attaqué à plusieurs reprises et "
"ouvertement (!) nos sujets appartenant aux nationalités "
"en minorités",

B. Une déclaration au Parlement de Belgrade.

"Dans les régions d'Ipek ~~se~~ sont surgi dernièrement "
"deux individus qui prétendent appartenir aux organisations"
"nationales : l'un s'appelle Militch et l'autre Kerstitch."

"Ces deux messieurs, dépourvus de toute qualité offi-"
"cielle, ont sous leur commandement des bandes armées qui "
"égorgent les paysans en plein jour après leur avoir pillé"
"et détruit les foyers. Après avoir commis d'affreux crimes"
"dans les alentours d'Ipek, elles viennent d'entrer dans le "
"district de Novi-Bazar où elles continuent à terroriser les "
"habitants. Ce qui est très étonnant c'est que tout cela"
"se déroule sous les yeux des autorités de l'Etat (!!!...)"

"(Discours de Ferhad bey à la Chambre des Yougoslaves)."

DOKUMENTACION NGA BURIMET JUGOSLLAVE

Shtojca numër 1

1. Një pranim nga ana serbe

Parathënia e një qarkoreje të ministrit të brendshëm të Qeverisë së Pashiçit “Jemi të informuar lidhur me faktin që disa anëtarë të organizatës kombëtare i kanë sulmuar disa herë dhe haptazi (!) bashkështetasit tanë, të cilët u përkasin “pakicave”-kombëtare.

2. Një deklaram para parlamentit në Beograd

Në rajonin e Rrethit të Pejës janë paraqitur para pak kohësh dy individë, të cilët pohojnë se i përkasin organizatave nacionale; njëri prej tyre quhet Miliç, ndërsa tjetri Kërstiç. Këta dy zotërinj të cilët nuk janë të angazhuar me asnjë detyrë zyrtare, komandojnë në ato zona me banda të armatosura, të cilat mu në mes të ditës mbysin fshatarë, pasi që më parë ua kanë plaçkitur dhe shkatërruar shtëpitë e tyre. Dhe pasi që i kanë kryer këto krime të tmerrshme në rrethinën e Pejës, ata vazhdojnë të depërtojnë në qarkun e Pazarit të Ri, ku po ashtu i terrorizojnë banorët. Ajo që duket më e çuditshmja me këtë rast është fakti që të gjitha këto ngjarje ndodhin para syve të autoriteteve shtetërore (!!..)”.

(Fjalimi i Ferhad Begut para Kuvendit të deputetëve të Jugosllavisë)



N° 2

DOCUMENTATION DE SOURCE YOUGOSLAVE

1. Un aveu officiel du gouvernement de Davidovitch

Au mois d'Août 1924 le ministre de l'intérieur du Gouvernement de Davidovitch venait de faire la déclaration suivante à la Chambre de Belgrade :

"Dès notre arrivée au pouvoir nous nous sommes aperçu
"que la sécurité publique en Serbie Méridionale laisse à
"désirer. Nous sommes décidé de poursuivre les catchaks;
"mais sans massacrer les populations et sans détruire les
"villages".

2. Une liste de massacrés

Extrait du journal "Hak" N° 730 du 20.2.24 qui paraît à Uskib

Liste des victimes de Vultchitrin

<u>N° d'ordre</u>	<u>Nom et prénom des victimes</u>	<u>Agé de</u>	<u>Nom des villages</u>
1	Mousli Haïdar	62	Domenitza Zogar
2	Hasiné (sa femme)	52	"
3	Rasim (son fils)	15	"
4	Hachim (son fils)	8	"
5	Hamidé (sa fille)	12	"
6	Malik Aïdin	55	"
7	Ali (son fils)	15	"
8	Sehar (sa femme)	35	"
9	Halid (son fils)	2	"

Annexe N° 2 (suite)

10	Larif (son fils)	8	Domenitza Zagor
11	Zehra (sa fille)	4	"
12	Saliha (femme)	40	"
13	Husein (son fils)	4	"
14	Umehan (sa fille)	6	"
15	Redjeb Arif	50	"
16	Alet Zeka	53	Tohitchelia
17	Rabia (sa femme)	51	"
18	Zarife (femme)	48	"
19	Azemine (femme)	25	"
20	Saliha (femme)	33	"
21	Ahmed	1	"
22	Nie (femme)	30	"
23	Zeko (son fils)	5	"

DOKUMENTACION NGA BURIMET JUGOSLLAVE

*Shtojca numër 2***1. Një pranim zyrtar nga ana e Qeverisë së Davidoviçit**

Në muajin gusht të vitit 1924, ministri i brendshëm i Qeverisë Davidoviç e ka bërë këtë deklaratë para Kuvendit të deputetëve në Beograd:

“Që me rastin e marrjes së pushtetit nga ana jonë, kemi konstatuar se siguria publike në Serbinë Jugore le mjaft për të dëshiruar. Ne jemi të vendosur që t'i përndjekim kaçakët, por pa e masakruar me këtë rast popullatën dhe pa ua shkatërruar fshatrat”.

2. Lista e të masakruarve

Ekstrakt nga gazeta “Hak” numër 730 e datës 20.02.1924, e cila botohet në Shkup

Lista e viktimave në Vuçitërnë (Vushtrri)



Nr. rendor	Emri dhe mbiemri i viktimës	Mosha	Emri i fshatrave
1	Mousli Haidar	62	Domenitza Zogar
2	Hasime (bashkëshortja e tij)	52	-//-
3	Rasim (i biri i tij)	15	-//-
4	Hashim (i biri i tij)	8	-//-
5	Hamide (e bija e tij)	12	-//-
6	Malik Aidin	55	-//-
7	Ali (i biri i tij)	15	-//-
8	Sehar (bashkëshortja e tij)	35	-//-
9	Halid (i biri i tij)	2	-//-



Faksimile e gazetës “Hak”, Shkup (1924)

Lista e viktimave në Vuçitërnë (Vushtrri)

Nr. rendor	Emri dhe mbiemri i viktimës	Mosha	Emri i fshatrave
10	Latif (i biri i tij)	8	
11	Zehra (e bija e tij)	4	-/-
12	Saliha (grua)	40	-/-
13	Husein (i biri i tij)	4	-/-
14	Umehan (i biri i tij)	6	-/-
15	Rexhep Arif	50	-/-
16	Ajet Zeka	53	Tohitchelia
17	Rabia (bashkëshortja e tij)	51	-/-
18	Zarife (grua)	43	-/-
19	Azemine (grua)	25	-/-
20	Saliha (grua)	33	-/-
21	Ahmed	1	-/-
22	Nie (grua)	30	-/-
23	Zeka (i biri i tij)	3	-/-



Serbët në këtë mënyrë i shërbenin Qeverisë së Beogradit

Përkthimi i verifikuar nga gjuha frënge

N° 3

DOCUMENTATION DE SOURCE YOUGOSLAVE

Pillages légalisés

Fragments extraits du discours prononcé par Mr Akif
député de Novi-Bazar à la Chambre de Belgrade en date du
23.12.1923

"Il est étonnant qu'aucun des députés, soit des radicaux,
"soit des partis de l'opposition ne m'avait fait nulle objection
"et tous s'étaient vu obligés d'approuver la véracité de mes
"déclarations lorsque j'avais critiqué, à la 1ère section de la
"commission des Finances, l'application illégale de la loi
"agraire en Serbie méridionale et au Sandjakat, en décrivant
"les misères des Albanais provoquées par cette application et
"toutes les injustices commises sous ce prétexte."

"En une séance plénière de la susdite commission, mes
"déclarations venaient de provoquer en notre faveur les protes-
"tations des députés de l'opposition aussi bien que leurs at-
"taques furieuses contre le gouvernement lorsque, en parlant de
"la sécurité publique en Serbie Méridionale, j'avais prouvé que
"la justice n'y existe pas, que les criminels n'y sont pas même
"arrêtés et que les Albanais n'y jouissent pas du droit de vivre."

"Depuis qu'on a introduit au budget une somme de trente
"millions de dinars à titre de compensation nous sommes témoins
"des attaques injustes de l'opposition au Parlement et des calom-
"nies de toutes sortes de la presse de Belgrade qui s'efforce à
"diriger l'opinion publique contre nous. Mais Messieurs, il

Annexe N° 3 suite

"honteux de vous ruer si violemment contre un peuple innocent
"qui meure de faim."

"Chez nous il n'y a pas de terres qui, conformément à la
"loi agraire, puissent être enlevées à leurs propriétaires.
"Messieurs, en Serbie Méridionale l'application de la loi a-
"graire a voué à la faim exclusivement les Albanais. A aucun
"Serbe on n'a pris un pouce de terre. Aux Albanais on n'a laissé
"même pas un hectare de terre. Ces derniers constituent actuelle-
"ment la masse la plus en misère du peuple et la plupart des
"propriétaires se nourrissent avec des secours."

"Vous n'avez qu'à jeter un coup d'oeil aux rues de la Serbie
"Méridionale (Cossovo et Macédoine) pour y voir les enfants
"albanais des propriétaires qui poussent des cris de détresse
"pour un morceau de pain et qui se nourrissent de leurs propres
"larmes. Ceux qui vécurent jadis au milieu de grandes richesses
"sont devenus des ouvriers et des mendiants."

"Il n'est pas vrai qu'on a pris seulement les terres des
"beys et des notables : on enlève les champs des cultivateurs
"qui habitent les villes, les fourrages, les champs cultivés et
"et les prairies non fauchées des paysans albanais et on les
"donne aux riches, aux fonctionnaires et aux avocats serbes."

"Pour prouver ce que je viens de déclarer je ne veux pas
"vous retenir par de longues explications : qu'on constitue une
"commission de nos adversaires, chargés de se livrer à une en-
"quête sur place. Nous acceptons d'avance ses sentences."

DOKUMENTACION NGA BURIMET JUGOSLLAVE

Shtojca numër 3

Plaçkitjet e legalizuara

Ekstrakte nga fjalimi i zotëriut Akif, deputet për Pazarin e Ri, mbajtur para Kuvendit të deputetëve në Beograd më datën 23. 12. 1923

“Është vërtet për t'u habitur se si asnjë nga deputetët, as prej radikalëve dhe as nga partitë opozitare, nuk kishte asnjë kundërshtim ta shprehte ndaj meje, dhe është për t'u çuditur si të gjithë ata e panë veten të detyruar ta konfirmojnë vërtetësinë e deklaratave të mia, të cilat i kam bërë para Seksionit të parë të Komisionit të Financave përkritazi me zbatimin e padrejtë dhe të paligjshëm të Ligjit të Reformës Agrare në Serbinë e Jugut dhe në Sanxhak, të cilin edhe e kam kritikuar, dhe ku e kam përshkruar mjerimin e shqiptarëve, të cilin e ka shkaktuar zbatimi i kësaj reforme, si dhe të gjitha padrejtësitë, të cilat janë duke ndodhur nën pretekstin e zbatimit të kësaj reforme”.

“Në një seancë plenare të këtij komisioni, deklaramet e mia në favor tonin kanë shkaktuar madje protesta të deputetëve të opozitës, si dhe sulme plot zemërim të këtyre deputetëve kundër qeverisë, sidomos kur kam folur lidhur me sigurinë publike në Serbinë e Jugut dhe kur kam sjell dëshmi për faktet që atje nuk ka drejtësi, që kriminelët atje madje as që arrestohen dhe se shqiptarët atje nuk kanë të drejtë as të jetojnë”.

“Prej se nga buxheti është ndarë një shumë prej tridhjetë milionë dinarësh për kompensime, jemi bërë dëshmitarë të sulmeve të padrejta të opozitës në parlament, si dhe dëshmitarë të shpifjeve të llojllojshme të shtypit beogradas, e cila përpiket që ta kthejë opinionin publik kundër nesh”. Por zotërinj të nderuar, më duhet të them se është e turpshme që me kaq vrull të vërsulesh kundër një populli të pafajshëm, i cili është duke vuajtur urie”.

“Tek ne nuk ka toka të tilla, të cilat do të mund t'u merreshin pronarëve të tyre në emër të zbatimit të Ligjit mbi Reformën Agrare. Zotërinj të nderuar, e vetmja gjë që ka arritur ta bëjë zbatimi i Ligjit mbi reformën agrare në Serbinë Jugore, ka qenë që t'i bëjë shqiptarët të vuajnë nga uria. Asnjë serbi nuk iu është marrë as edhe një pëllëmbë tokë. Shqiptarëve ndërkaq nuk iu kanë lënë madje as nga një hektar tokë. Andaj, ata e përbëjnë sot atje masën dërrmuese të popullatës, e cila jeton në mjerimin më të madh, dhe ku shumica e pronarëve të mëparshëm, mezi arrijnë të ushqehen sot për nesër”.

Shtojca numër 3 (vazhdimi)

“Do t’ju mjaftonte ta hidhnit vetëm një vështrim nëpër rrugët e Serbisë Jugore (Kosovë dhe Maqedoni) që atje të shihni fëmijë shqiptarë të pronarëve të tokave, të cilët të dëshpëruar këlthasin për ta gjetur një copë bukë dhe të cilët ushqehen nga lotët e tyre. Ata, të cilët deri dje jetonin në bollëk dhe mirëqenie, sot janë shndërruar në argatë e lypsarë”.

“Nuk qëndron e dhëna, se tokat u janë marrë vetëm bejlerëve dhe fisnikëve; tokat po u merren edhe punuesve të tokës, të cilët jetojnë në qytet, ndërkaq fshatarëve shqiptarë po u plaçkitet ushqimi i bagëtisë, po u plaçkiten arat e mbjella, si dhe livadhet e pakositura, dhe këto të mira pastaj po u shpërndahen pasanikëve serbë, nëpunësve dhe avokatëve”.

“Për t’i dëshmuar të gjitha këto që po i cek sot para jush, nuk është e nevojshme të bëhen deklarata të gjata: le ta formojmë një komision, qoftë edhe prej kundërshtarëve tanë dhe le ta ngarkojmë që ta zhvillojë një hulumtim në terren. Dhe ne shfaqin që tani gatishmërinë tonë që ta pranojmë gjykimin e këtij komisioni”.



Jeta e shqiptarëve gjatë zbatimit të Reformës Agrare

Përkthimi i verifikuar nga gjuha frënge

Annexe N° 4

DOCUMENTATION DE SOURCE ALBANAISE

Un épisode tragique de l'émigration.

L'année passée plusieurs centaines de familles albanaises des environs de Prichtina et de Guilan partirent pour la Turquie, restèrent plus de trois mois dans les rues de Sofia et plusieurs semaines sur les bateaux à cause de ce que la Turquie ne voulait pas les recevoir, la Yougoslavie ne leur permettait pas de regagner leurs anciens foyers et l'Albanie n'était pas en état d'assurer leurs installations. La Société des Nations a été régulièrement informée des souffrances de ces malheureux. Une quarantaine de ces familles installées dernièrement à Kavaia (Albanie) racontent des scènes affreuses lorsqu'on veut savoir les raisons qui les avaient forcées d'abandonner leurs foyers séculaires.

DOKUMENTACION NGA BURIMET SHQIPTARE

Shtojca numër 4

Një episod tragjik i emigrimit

Vitin e kaluar janë nisur disa qindra familje nga rrethinat e Prishtinës dhe Gjilanit për në Turqi. Këto familje kanë mbetur fillimisht tre muaj nëpër rrugët e Sofjes dhe pastaj edhe disa muaj të tjerë nëpër anije, meqë Turqia atyre nuk u lejonte të hynin në këtë shtet, ndërsa Jugosllavia në anën tjetër ua ndalonte që të ktheheshin në shtëpitë e tyre të përparshme. Shqipëria ndërkaq nuk kishte mundësi që t'i vendoste këta njerëz.

Lidhja e Kombeve është informuar rregullisht për vuajtjet e këtyre njerëzve të pafat.

Rreth dyzet prej këtyre familjeve, të cilat më në fund ia kishin dalë të vendosen në Kavajë (Shqipëri) raportojnë për skena nga më mizoret, duke u përgjigjur në pyetje se për ç'arsye i kanë braktisur shtëpitë e tyre, të cilat shekuj me radhë kanë qenë në pronësi të tyre.



Ikja e shqiptarëve nga dhuna serbe

Përkthimi i verifikuar nga gjuha frënge

Annexe N° 5

DOCUMENTATIONS DE SOURCE YOUGOSLAVE

Constitution serbe

Fragments extraits du discours prononcé à la Chambre de
Belgrade par Mr Ferhad Draga, député de Mitrovitza.

A propos des élections municipales de Mitrovitza :

"Le lendemain, lorsque je suis retourné à Mitrovitza
"j'ai trouvé une lettre dans mon bureau dont le contenu
"était : "Si tu te mêles des élections municipales, tu
"payeras de ta tête!..." Je me suis informé et 8 autres
"notables de la ville, y compris le mufti, venaient de
"recevoir de ces mêmes lettres. Le mufti remit la sienne
"au sous-préfet et moi j'en ai transmis le contenu télé-
"graphiquement à Mr le Ministre de l'Intérieur en y ajou-
"tant tout ce qui s'était passé à Prichtina. Dans cette
"dépêche je lui disais aussi qu'on allait faire des atten-
"tats contre nous. Qu'arriva-t-il ? Le jour de samedi nous
"avons vu arriver une vingtaine d'Orianoches (fachistes
"serbes) dans le but de prendre part à l'attaque qui s'était
"perpétrée pour le jour des élections. Immédiatement je me
"suis adressé au sous-préfet de la ville, attirant son
"attention sur l'arrivée des Orianoches et lui demandant
"s'il était en état de nous défendre ou non. J'ajoutais
"que dans le cas contraire nous serions obligés, comme à
"Prichtina, de ne pas prendre part aux élections. Ver

5
uite

- 2 -

"minuit le sous-préfet m'avisait par téléphone qu'il venait
"de recevoir du Ministère de l'Intérieur des instructions
"pour empêcher toute sorte d'attaque, que les troupes se trou-
"vaient prêtes contre toute éventualité et que le susdit
"ministère le tiendrait responsable de tout ce qui pouvait
"advenir.

"En nous fiant aux assurances données nous nous
rendîmes le lendemain matin aux lieux des élections pour
nous servir du droit assuré par la Constitution. Jusqu'aux dix
heures du matin tout marcha bien. A dix heures les Orianoches,
ceux de Prishtina en tête, manifestèrent dans les rues en
blasphémant contre les Albanais. A une heure de l'après-midi
nos électeurs furent attaqués à coup de fusils. Dès le premier
coup j'étais au balcon de ma maison; car l'attaque se dérou-
lait justement devant le bureau des élections qui se trouvait
en face de ma maison.

Lorsque le deuxième coup fut tiré, ceux qui m'accompa-
gnaient et moi nous vîmes que c'était Mr Protitch, référant
des affaires agraires qui venait de tirer ce coup. Juste à ce
moment une patrouille de gendarmes arriva sur le lieu des
élections et tira quelques coups en l'air... Après cinq
minutes une seconde patrouille de trois gendarmes arriva et
rencontra un jeune barbier qui n'avait aucune sorte d'arme,
même une simple canne et qui fut pourtant tué par les gendarmes
en tombant sur le seuil de ma porte; après quoi j'ai enten-

- 5 -

un commandement donné aux gendarmes : "En avant, tuez les Albanais où vous les rencontrerez!..."

Dans la cour du troisième bureau des élections avait été tué un vieillard de 70 ans et à 60 mètres au nord de ma maison un autre de 60 ans. Un licencié en droit.-J'ai honte de citer son nom - accompagné d'une foule fanatisée venait d'enfoncer la porte d'un moulin et y tuait un vieillard âgé de 70 ans et un âgé de 80 ans!... Un gendarme s'était rendu à un quartier d'une vingtaine de minutes loin du lieu des élections, était entré dans la maison d'une veuve où il assassinait un vieux commerçant âgé de 70 ans.

Maintenant Messieurs, voici la phrase la plus noire et la plus tragique du drame : les morts dorment, les blessés gémissent; mais les élections continuent!...

Pendant quatre heures, Messieurs, nous n'avons pas été en position de recueillir les morts et de secourir les blessés... Malgré tout cela voici ce que j'entends le jour suivant :

Les chefs des conseils des trois bureaux des élections, tous membres du tribunal et des hommes civilisés, aujourd'hui des avocats - venaient de décider que les élections avaient été faites en bonne règle et d'une façon légale!

La vérité est que nous avons eu 6 tués et 20 blessés y comprise une fillette de 3 ans, tuée entre les bras
de son père.

DOKUMENTACION NGA BURIMET JUGOSLLAVE

Shtojca numër 5

Kushtetuta e Serbisë

Ekstrakte nga një fjalim, të cilin zotëri Ferhad Draga, deputet për Mitrovicë, e ka mbajtur para Kuvendit të deputetëve në Beograd

Përkitazi me zgjedhjet komunale në Mitrovicë:

“Kur jam kthyer ditën e nesërme në Mitrovicë, në zyrën time e kam gjetur një letër me këtë përmbajtje: “Nëse përzihesh në zgjedhjet komunale, këtë do ta paguash me jetën tënde!...” Pas kësaj jam interesuar, kam pyetur dhe kam zbuluar se edhe 8 fisnikë tjerë në qytet, përfshirë këtu edhe myftiun, kishin pranuar letra me përmbajtje të njëjtë. Myftiu ia ka dorëzuar letrën, që e kishte marrë, zëvendësprefektit, ndërsa unë ia kam përcjellë me telegraf përmbajtjen e letrës ministrit të brendshëm dhe aty ia kam treguar të gjithat që kishin ndodhur në Prishtinë”.

“Në këtë telegram e kam njoftuar po ashtu se kundër nesh janë duke u përgatitur atentate. Dhe çfarë ka ndodhur? Të shtunën kemi parë se si kanë ardhur rreth njëzet organosh (*fashistë serbë*) me qëllim që të marrin pjesë në sulme. Përkitazi me këtë unë iu kam drejtuar menjëherë zëvendës-prefektit të qytetit dhe e kam informuar për arritjen e orianoshëve. Me këtë rast edhe e kam pyetur atë, nëse do të jetë në gjendje që të na mbrojë apo jo. Përndryshe, i kam thënë, ne do ta shohim vetën të detyruar që, njësoj sikur edhe në Prishtinë, të mos marrim pjesë në zgjedhje”.

“Pas kësaj, diku rreth mesnatës më ka thirrur zëvendësprefekti dhe më ka kumtuar që ka marrë udhëzime nga Ministria e Brendshme që ta parandalojë çfarëdo lloj të sulmeve. Madje ministria e sipërpërmendur i kishte thënë që do ta bëjë atë personalisht përgjegjës për gjithçka që do të ndodhte”.

Shtojca numër 5 (vazhdimi)


Duke ju besuar këtyre premtimeve, ne kemi shkuar në mëngjesin e ardhshëm deri të vendvotimet, për ta ushtruar me këtë rast të drejtën tonë kushtetuese për pjesëmarrje në zgjedhje. Deri nga ora dhjetë e paradites çdo gjë ka shkuar mirë. Mirëpo në orën dhjetë ka filluar demonstrata e orianoshëve, ndërsa në krye të tyre kanë qenë ata të Prishtinës, të cilët endeshin rrugëve dhe i fyenin shqiptarët. Rreth orës një të pasdites votuesit tanë janë sulmuar me plumba të shkrepur nga pushkët. Me rastin e shkrepjes së plumbit të parë unë jam ndodhur në ballkonin e shtëpisë sime dhe ky sulm ka ndodhur mu para lokalit të vendvotimit, i cili ndodhet mu përballë shtëpisë sime. Me rastin e shkrepjes së plumbit të dytë, kemi parë se ka qenë zoti Pretiç, referenti për çështje agrare, ai që e ka shkrepur këtë plumb. Pikërisht në këtë moment tek lokali i vendvotimit ia ka behur një patrullë e policisë, e cila i ka shkrepur disa plumba në ajër... Pas pesë minutash ka arritur një patrullë tjetër e policisë me tre xhandarë dhe e ka qëlluar një berber të ri, i cili ka qenë krejtësisht i paarmatosur. I gjori nuk e ka pasur, me këtë rast as edhe një shkop në dorë, dhe megjithatë është vrarë nga xhandarët. Ai është plandosur i vrarë mu në pragun e shtëpisë sime. Pas kësaj kam dëgjuar se....



Zgjerimi i Serbisë në vitet 1804-1913

Përkthimi i verifikuar nga gjuha frënge

NJI SHKURTIM KUJTIMESH




Fitimin që ka me u nxjerrë prej kësaj broshure, kam m'ë kushtue për sigurim t'arësimit të femibet jetima të Kosovës, Dibrës e të Çamërisë që gjinden në Shqipëri.

Hasan Prishtina

NJI SHKURTIM KUJTIMESH

mbi kryengritjen shqyptare
të vjetit 1912

shkrue prej
Hasan Prishtinës
botimi i dytë



BARI
Societa tipografica pucliese
1925

Botimi i parë në Kosovë
2009

Janë disa motive të forta për me i ribotue kujtimet e Hasan Prishtinës që keni në dorë. Motivi i parë asht se vdekja fizike e Hasan Prishtinës nuk do të duhej me e nënkuptue edhe shuemjen e njohurisë tek breznitë e reja mbi nismëtarët e luftës për pavarësi. Vetë Hasan Prishtina thoshte: "Na luftojmë e ndoshta nuk e gëzojmë (lirinë), por ata qi vinë mbas nesh, kanë me i gjetë shejet tona". Ribotimi i *Nji shkurtim kujtimesh për kryengritjen e vjetit 1912* të Hasan Prishtinës ka për qëllim që, përveçse me u ndihmue breznive të sotme me i gjetë ato sheja, edhe me i njohë këto brezni me sakrificat e këtij patrioti vetëmohues dhe me i ba me kuptue se kombi shqiptar ka ditë me pasë edhe udhëheqës politikë që vendin e vet jo veç nuk e kanë vjedhë, po madje për të e kanë shkri edhe pasuninë vetjake. Në parathënien e botimit të parë të këtyne kujtimeve, i cili doli në dritë në Shkodër më 1921, Hasan Prishtina thotë: "Titmin qi ka me u nxjerrë prej kësaj broshure, kam m'e kushtue për sigurim t'arësimit të fëmivet jetima...". Tue e ndjekë shembullin e vumë prej tij, Shpia Botuese Rrokullia ka vendosë që fitimet prej këtij botimi t'i dhurojë për arsimimin e fëmijëve jetima.

PARATHANË

Tue lanë botimin e një libri ma të plotë për atë herë kur kam me pasë në dorë dokumentat që i përkasin kryengritjes shqyptare të vjetit 1912, të cilat më gjunden në Stambollë e Kosovë; tesh për tesh, po e shoh të nevojshme vetëm me qitë këtë broshurë me qëllim për me ndritsue pjesësisht mendimin e përgjithëshëm e me forcue pa vjeftsin e disa çpifjeve pa-logjikë që përliten për punë të kesaj kryengritje.

Fitmin që ka me u nxjerrë prej kesaj broshure, kam m'e kushtue për sigurim farësimit të fëmivet jetima të Kosovës, Dibrës e të Çamëris që gjunden në Shqypni.

Hasan Prishtina

Tue këndë se gjyshi i em, Haxhi Ali Berisha, para 150 vjetve ka ngritë në Valçitllin nga katundit Polanocë (Orzinicë), prandej nabi-emni em duket me këtë "Polanca". Por mbasat që u zgjedha deputet i Prishtinës e mbroptë, mulejper shkrime, shifera e tjera në qerjeshtat Hasan Prishtina, për ket shkak po me vazhdon gjithnjë ky nabi-emni.

Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912

I.

Shkaqet e kryengritjes:

Shkaqet e kryengritjes janë të shumta e shumë nduersh.

Por po i shkurtojmë ndër këto që janë më kryekrejt:

- 1) Shovinismi i komitetit "Jeune-Turc".
- 2) Pa pajtimi i traditaveve e zakoneve të Shqipnis, sidomos të Gegnis, me kondicionet e liris tyrke.
- 3) Intrigat panislamike të administrationit.
- 4) Të përzimurit të ushtrisë në politikë.
- 5) Mizorit tyrke të vjetit 1910.
- 6) Shvillimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipni.
- 7) Sistemi mizues e i pa ligjëshëm që ndoqi qeverija e tyrqvet të ri ndëpër zgjedhje të vjetit 1912.

II.

Para lëvizjes së armatisun

Nji ditë historike në Parlament Othoman

Nji mizori pa farë freni mbretonte në Shqipni fill prej asaj dite që operationi i Turgut Pashës (1910) mori fund me fitim të plotë të Turkis.

Nuk kish ma në Shqypni as klube, as komitete e shkolla. Bashkimxhit (emën qi u epshin tyrqit nacionalistve shqyptarë), ishin shpërda e krejt organizimi komtar nuk shënonte veç se një shkatërim; kësaj gjendjeje të dishprueme i dhanë deri diku një shkas pozitiv lëvizja malcore e vjetit 1911, veprimi i komitetit bullgar ndër viset e Makedonis, ngatrrerat qi paten le u shvilluen në mes t'elementave othomanë mbas themelimit të partis "Marrveshtje e Liri" e lufta Italo-Turke qi plasi për çashtjen e Tarabullusit.

Kah fundi i vjetit 1911, tue u frymëzue nga idhruimet e mizoris tyrke, partija kundrështare bani një pyetje mbi gjendjen e Shqipnis e e ngushtoi Hakki Pashën me dhane hesape mbi ket pikë përpara Parlamentit.

Shumica e deputetënvet të Shqipnis më patën ngarkue me i ba ball shpjegimevet të Vizirit tyrk, tue i u mbështetë dokumentavet qi kishin mbledhun përmbi këto mizorina.

Biseda u hap e qysh në fillësë shkoi tue u ashprue. Çashtja kishte një lëndë të pa kufizue. Na ishim të fortë në lamë të logjikës e me prova të gjalla në dorë. Mora pra edhe unë fjalën. Kritikova ashprisht politikën e turpshme qi po ndiqej në Shqypni. I derdha arësyesnat qi më shtyjshin në ket kritikë kaq të rreptë e ma në fund tue përmbledhë krejt energin t'eme i a lidha kryet me ket frasë:

"Në kjoftë se Qeverija nuk ndrton politikë e administrim në Shqypni, në kjoftë se shqiptarët nuk i gëzojnë të drejtat e tyne politike, asht për t'u vu oroe qi kanë me shpërthye një varg ndodhinash të përgjakëshme e t'idhta".

Një deputet arab ma priti:

"Ç'kuptoni me fjalën ndodhina të përgjakëshme e t'idhta?"

I përgjegja:

“Po due me thanë qi në kjoftë se “Tyrqit e Rij” vijojnë në zbatim të këtij sistemi mizuer në lamë të politikës së përbrendëshme, kam me kenë njeni, e ndoshta i pari i atyne, qi kam për t’a ngrehë flamurin e kryengritjes”.

Ky deklarim përpara ma se dy qind deputetëve, kabinetit tyrk e mija ndigjuesve u bari efektin e një bombe.

Hakki Pasha u çue në kambë e tha:

“Hasan begu t’a kishte përdorue kët fjalë për dobi të vendit pat me krye një shërbim të madh. Por, Hasan begu me këto fjalë ka për qëllim me i a shti zjarmin krejt Perandoris”.

I a prita:

“Pashë, Pashë, nuk po flas veç se një të vërtetë. Në kjoftë se një ditë themelohet në ket vend një liri e vertetë, vendi i yt e i shokvet t’uej nuk ka për të kenë këtu, por në Gjyq të Naltë (divan alii)”. Kur duelëm nga Parlamenti, deputetët e Shqypnis e shqyptarët e Stambollit rrëfyen një gëzim të pa kufizuem e më përshëndetën me një simpathi të posatshme.

Ismail Kemal begu më përgëzoj nxehtësisht e më proponoi me u gjetë në darkë në shpi t’eme për me pasë shteg me bisedue pak ma gjatë mbi situation të ri.

Kështu mbaroi këjo ditë historike qi nuk pat lanë shteg pajtimi në mes të Shypnis e të Komitetit “Jeune-turc”.

Vendimi

Ismail Kemal begu, sikur m’a pat dhanë fjalën, u gjet në shpi t’eme për darkë dhe e kaluem natën së bashku.

Gjanë e gjatë biseduem mbi fatin e Shqypnis e ma në fund venduem me i dhanë mbarim mizorivët tyrke me një kryengritje. Biseda u mbyll me këto fjalë:

Ismail Kemal begu: “Hassan beg, i besoi fetarisht karakterit të Zotnis s’Ate. Ky besim më ka shty me i shkruë

në zemër t'eme me ato fjalë që i përdorove në Parlament tue thanë: kam me kenë njeni e ndoshta i pari i atyne që kam për t'a ngrehë flamurin e kryengritjes"!. I përgjegjia:

"Ismail beg, para se me folë një fjalë matem shumë e mbasandej flas; por, mundem me ju sigurue që zakon i em asht me mbajtë një fjalë që më del nga goja. Pra mbassi edhe Zotnija e Juej po e ndin nevojën e njëj kryengritje, ndoshta vetëm vendimi i ynë nuk mund të mjaftojë për me qitë në krye ket qëllim, e më duket që do të na duhet me u bashkue edhe me katër, pesë vetë rreth ketij vendimi".

Ismail Kemal begu më përgjegji: - "Poh, edhe unë jam në mendim të Zotnis s'Ate".

Mbasandej më propozoi me u gjetë n'ë nesre në Hotel "Pera Palace" e me vijue bisedën aty mbi ket pikë.

Në Hotel "Pera Palace"

Të neserme në mes t'Ismail Kemalit e meje zgjati ma se tre sahat e, në fund, venduem me mbajtë një kuvend tue pasë me vedi këta Zotnij:

Myfid beg Libohovën, Esad Pashë Toptanin, Aziz Pashë Vrionin e Syreja beg Vlonën.

Me disa prej tyne u muer vesh Ismail begu e me disa unë. Kur kuptuem se këta zotnij mendoheshin si na të dy, venduem me ba një mbledhje në shtëpi të Syreja begut, në Taksim.

Mbledhja e Taksimit

Mbledhja u mbajtë nën kryetari t'Ismail Kemalit.

Tue marrë para sysh randësin e çashtjes që kishim për të bisedue proponova me u betue të gjith para se të fillojshim kuvendin.

Ky propozim u pranue dhe betimi u ba tue dhanë fjalën e nderes seicili prej nesh mos me i kallxue kurrkuj shka do t'u flitte e t'u vendote n'at mbledhje.

Mbas betimit filloi kuvendi.

U numruen e u përmenden dhe një here krejt mizorit e "Jeune-turqvet" në Shqipni e politika e tyne në çashtje të shkollavet e të shkrolavet që pat shkue gjithnji tue u rreptësue.

Sa për ndonji privilegj politik e administruer jo me u marrë vesh, por nuk ish punë as me hy në bisedë me 'ta.

Pra, kuvendi nuk zgjati shumë e të gjith shokët u bashkuem mbi ket pikë:

"Për me i dhanë fund politikës tyrke në çashtje të kultures komtare e për me sigurue disa privilegje politike për Shqipni nuk ka tjetër mjet veç se me fitue më një kryengritje të përgjithëshme".

Kështu pra u vendue që t'u organizonte kryengritja e biseda nisi me rrjedhë mbi ket pikë të dytë: Qysh do t'u organizonte këjo lëvizje e kur kishin me fillue veprimet?

Ne ket mes rolin ma të çmueshem kishte për t'a luejtë Kosova.

Për ket arsye u vendue me gjetë e me i futë ndëpër Mal të Zi në Kosovë pesë-mbëdhetë mijë pushkë "mauzer" e me mbajtë n'urdhen t'em, posë ketyne, edhe dhetë mijë napoleona ari.

Zbatimin e këtij vendimi e mori mbi vedi Ismail Kemal begu që pat tëfaqë një uzdajë të fortë me sigurue ket punë ndepër Europë.

I sigurova shokët se kisha për t'a organizue kryengritjen ndepër të gjitha krahinat e Kosovës e këjo kryengritje kishte për të plasë kur armët e të hollat do t'i kishe në disposition t'em. Me gjith këtë, për me fitue ma mirë e ma shpejt, menduem se nuk kishte me mjaftue një lëvizje e kufizue vetëm në

Kosovë. Pra, shtova, se kishte me i u dashtë si Toskënis ashtu edhe Shqypnis së Mesme me marrë pjesë në kryengritje disa dit mbas Kosovës.

Esad Pasha, tue u përgjegjë, siguroi me dalë vetë e me i pri Shqypnis së Mesme e Mirditës.

Sa per Myfid begun, Aziz Pashën e Syreja begun edhe këta zotnij dhan fjalën me u gjetë në krye të çetave të Jugut drejtë për së drejti.

Ismail Kemal u detyronte me mbetë n'Europë e me na ndihmue me armë e me të holla tue sjellë në të mirë të lëvizjes s'onë mendimin e përgjithëshëm t'Europës.

Këto ishin fjalët t'ona para se me dalë prej shpis së Syreja begun:

Tue i u perdrejtue shokvet u thaçë:

"Jam i bindun, se të gjith jeni të ndershëm; por, po ju deklaroj edhe një herë qi, ku të dalë le të dali, unë kam për të kenë në mal kur ka me tingllue çasi i kryengritjes. Per këte kam vu peng pak përpara fjalën t'eme të nderes. Ju lutem pra mos me më lanë vetëm, pse jeni betue edhe ju.

M'u përgjegjën të gjith me një heri:

"Mundeni me kenë të sigurt se edhe na kemi për t'a krye detyrën t'onë".

Kështu mori fund kuverdi e u mbyll komploti i Taksimit.

Ni pritje prej anës së Sulltanit (audience)

Nuk ishin vetëm shqyptarët qi i kundrështoheshin sundimit "jeune-turc", por krejt elementat e perandoris, edhe një pjesë e popullit tyrk, punë këjo qi na i lehtësonte më një mënyrë të posatshme veprimet në lamë të përgatimevet e na siguronte sympathin e krejt elementave te Shtetit të Turkis nder minuta të para të kryengritjes.

Fra; për me i dhanë një shkas pak ma të gjallë levizjes antijeuneturke, me iniciativë të grupit shqyptar u formue një deputation prej pesë deputetësh (shqyptarë, arabë, tyrk, qyrd, armen) për me ia paraqitë Sulltanit ankimet e partis kundërshtare.

Mora pjesë në ket deputation edhe unë.

Nafi Pasha, përfaqësuesi i grupit arab, kritikoi me ashprim politikën e partis Jeune-turke dhe shtoi se këjo politikë heret a vonë kishte për t'i tronditë themelet e Perandoris.

Kur Nafi Pasha i mbaroi fjalët e veta, mora fjalën unë tue i thanë Sulltanit:

"Mbreti i im, në kjoftë se nuk i nepet fund një orë e ma para politikës së shtrembët qi po ndjekë partija Jeune-turke ndepër të gjitha krahinat e Perandoris, vendi ka për t'u baltua e shumë ndodhinave të përgjakëshme dhe do të heci me vrap kah një rrënim i plotë. I vetmi shpëtim për t'a pritë ket rrezik asht të largumunit e partis së turqvet të rij nga fuqija".

Fjalët e mia ban një përshtypje aqë të thellë sa Sulltanit i u përlotuen syt.

Audienca muer fund mirë, por, fitimi mbeti fjeshtë moral, pse Sulltani nuk e kishte at fuqi sa me shkatrrue sundimin Jeune-turk. Këte, muejtem me e kuptue të nesermen kur "Tanini", organi i partis Jeune-turke, botoi një artikull të rreptë kundra mejet me ket titull:

"Hassan begu nga Vulçitirni, deputeti i Prishtinës, filloi me na kercnue (lehdidë) përpara Mbretit".

Një fitim në dyluftim (duel)

Ky artikull, tue më shtrëngue me përgjegjë, hapi në shtyp të Stambollit një polemikë t'ashpër qi u përfundue me një fitim

në dyluftim (duel) qi i a çova Hysein Xhahidit, drejtorit të "Taninit".

Sheih-islami, mbi këtë, botoi një fetva me të cillen kundërshtoi tue gjykue duel-in kundra parashkresave (prescriptions) të Sheriatit e Mbretit, jo vetëm ndaloi me ba duel, por dhe na shtrengoi me u pajtue.

U pajtuem me Hysein Xhahidin e "Tanini" nuk shkroi ma as kundra mejet as kundra shqypetarvet.

Partija "Marrveshtje e Liri" e kryengritja Shqyptare

Tue i u mbështetë levizjes vepruese qi paten pasë nder këto kohna komplotistet e Taksimit ndeper konflikte të partis "Marrveshtje e Liri" me partin "Bashkim e Perparim" shumë zotnij paten pretendue ma vonë se kryengritja 1912 u organizue me dijeni e me bashkpunim të partis "Marrveshtje e Liri".

Këjo dava asht fare kundra së vertetës, pse as na nuk ishim aqë të pa mendë sa me i lajmue tyrrqit mbi një komplot shqyptar, as tyrrqit nuk kishin pranue qi shqyptarët t'i rokshin armët kundra ushtris së tyne.

Komplotistët kanë përfitue nga antagonisimi i partivet politike, por pa i a bjerrë me as një mënyrë karakterin fjeshtë komtar Komplotit.

Partija "Marrveshtje e Liri" ka muejtë me dijtë aq sa partija sunduese d.m.th, "jeune-turke".

Roli i komplotistvet në ket mes asht kufizue më këtë: Me e ndezë me çdo mënyrë antagonismin e këtyne dy partivet kryesore të politikës othomane.

Të shpërndamit e Parlamentit othoman

Partija kundërshtarë ishte tue fitue dita me ditë, antagorismi pat mërrijtë më një shkallë aq l'ashpër sa partis Jeune-turke nuk i pat mbetë ljetër armë për veç se me shpërda parlamentin, mjet qi mund të quhet fysheku i dishprimit qi i takon me provue ase me kerkue me provue çdo partije politike në të bjerrun të davas.

Partija Jeune-turke përfitoi nga karakteri i vet revolucionar e guximtar dhe e përdoroi me fitim ket fyshek të mbramë.

U shpërda pra parlamenti tue lanë mbrapa një pezmetim të pashoq nder trette l'oppositionit.

Më ket rasë u thashë deputetenvet arabë e qyrdë qi Xhemietxhit kanë për të kerkue të fitojnë ndeper zgjedhjet e reja tue perdorue mënyra të pa ligjëshme e ndoshta edhe mjetet e terrorismit e kështu nuk ka me na mbetë ne veç se me i rrokë armët për me i dalë zot të drejtavet l'ona politike.

Qëllimi i em me ket propagandë ishte, me i u dhanë guxim e me i shty edhe ata kah udha e kryengritjes.

Komiteti bullgar i Makedonis e kryengritja e 1912-ës

Mbassi u shpërda parlamenti othoman, Ismail Kemal begu u nis per Europë e unë për Kosovë, tue vendue me permbajtë korrespondencën ndepër mjet të Konsulatës Britanike të Shkupit.

Kur arrijta në Shkup puna e parë qi m'u desht me krye kje me qitë një hap të njëmendshëm per një të marrëm-vesh Shqiptar-Makedonas.

E kërkova dhe u poqa me Z. Pavlof, ish-deputetin e Shkupit në kohë të Turkis e ambassadori i Bullgaris pranë Mbret Wied-it më 1914.

Këtu po shkurttoi propozimin qi i bana:

"Tyrqit, mbas konstitutionit 1908, kanë ba e po "bajnë mjaft mizori në Shqypni e në Makedoni".

"Nuk i kanë nderue kurrqysh të drejtat e shqyptarvet e të bullgarvet".

"Terrorismi i tyre po shkon gjithnji tue u ashprue e po ndjekun nji politikë fjeshtë panturkiste. Pra, më duket se ka arrijtë koha me pështue prej kësaj zgjedhe mizore ndeper mjet të nji kryengritje të përbashkët tue pasë për qëllim me krijue nji shtet autonom shqyptar-makedonas".

"Më duket shumë e nevojshme qi mos t'a bjerrim ket rasë e unë jam aq i sigurët qi kemi për të fitue tue kenë se po pranoni të merrni pjesë në kryengritje vetëm atë-herë kur keni për të pa se shqyptarët po fitojnë".

Z.Pavlof m'u pergjegj:

"Propozimi i zotnis së Juej ka nji randësi aq të madhe sa nuk mundem me ju pergjegj pa dergue nji njeri të posatshëm në Sofje e pa marrë urdhna prej qendrës së përgjithëshme të Komitetit t'ynë. Qandra e Shkupit nuk ka kompetencë me vendue mbi nji çashtje kaq të randësishme. Ju lutem pra me më dhanë lejë deri sa të më këthehet njeriu".

Të përpjekunat me Konsulin e Anglis të Shkupit

Tue pritë pergjegjen e Z.Pavlof i u pendrejtova Konsulit Britanik të Shkupit dhe i bana ket deklaration me gojë:

"Na shqiptarët, per me i dhanë fund mizoris tyrke në Shqypni si edhe pengimevet qi po na bahen në çashtje t'alfabetit e kultures s'onë komtare, kemi zgjedhë si të vetmin

mjet shpëtimi me ba një lëvizje t'armatisun kundra sundimit tyrk.

Më ket rasë të rrezikëshme kemi nevojë të madhe për perkrashjen e Anglis.

Ju lutem pra të lajmoni Ministerin t'Uej të Punëvet të jashtme mbi ket deklaration".

Konsuli ish një zotni shumë liberal. Më përgjegji tue më thanë se kishte për t'i a komunikue me një herë ket deklaration qeveris së vet e cilla sigurisht nuk kishte për t'a kursye një përkrashje të gjallë në të mirë të njëj Shqyptarije qi trokë armët për liri.

"Me gjith ketë, shtoi Konsuli Britanik, kam me muejtë me ju dhanë një përgjegjie të këputme mbassi të marr përgjegjen e Londrës".

Shënimi: - Mbas disa ditësh Konsuli Britanik më stoi në çajë me anën e dragomanit të tij z. Fazil Hoxhës e me tha se Qeverija e tij i kishte përgjeggjur mbi deklarationin t'ua tue thanë se Anglia nuk ka interes ndër çashtje Ballkanike, prandaj s'ishin as kundra as anëtare e një kryengritje së Shqyptarvet.

Të parët e Kosovës

Në Kosovë mbretonte një pezmetim shumë i ashpër kundra Xhemjetit. Pra, kujdo qi i a hapa nevojën e njëj levizje me armë m'u përgjegji pozitivisht.

Kuvendova me shumë Zotnij nga Parisja mbi shvillimin e njëj kryengritje; por damas e me rezervë të madhe. Çashtja ish shumë e randë e sberthimi i saj kerkonte një mëshehtësi e mjeshtri sa as një punë tjetër. Pra, ata qi u mertshe fjalën nuk muejshin me njoftë shoqishoin e të gjith ishin lidhë në mue.

Tue kenë se një pjese e këtyne zotnive rmon edhe sot në Kosovë, ku po mbretnon mizorija sllave, nuk kam se si me

permende këtu veç se emnat e atyne qi kanë dekë, ase qi nuk mund të kenë ndonji dam prej sundimit barbar të Serbis.

Riza beg Kryeziu nga Gjakova, Zeinullah begu, im kushëri, nga Vulçitimi, Isë Boletini, Xhemal beg Prishtina, Halim beg Deralla, Ahmed beg Gjakova, një nga një, u besatuan me mue qi kanë për të hécë deri në fund. Kështu m'a dhanë besen dhe krent e Llapit e të Drenicës.

Kryengritja kishte per të fillue at ditë qi unë kishte me i mbathë opengat e me dalë në Drenicë (Malci e Vulçitimt e e Mitrovicës). Mbas mejet kishin me i marrë malet krejt ata qi më patën dhanë besën.

Ismail Kemali

Koha e shënueme për kryengritje u afronte gjithnji.

I shkrova Ismail Kemalit qi t'a kryente detyrën. M'u përgjegj me sot e neser e me premtime të thata.

Unë, aqë rreptas i pata hy punës sa nuk muejshe me bjerrë as një minutë nga friga sidomos qi mos po dishprohen e mos po lodhen ata qi ishin betue.

Kështu, bjen fjala, më ngjau me Nexhip beg Dragen.

Ky zotni m'a pat dhanë fjalen si tjetër: Nji ditë më vjen Selim Fanda e më thotë: "Nexhip Begu më ndeshi te Ura e Gurit e më tha: "A po shef Selim aga qi policët po duen me më xanë!"

"A thue Nexhip begu ka dijeni mbi kryengritje qi organizohet?"

"Jo" i thashë, nuk din gjë. "T'ishte kenë polic, m'a priti Selim Fanda, kishte me nxjerrë shumë sende e punë nga tuta qi diktova te ky zotni".

Me gjithë qi ket lajm e prita me gjak të ftohët, kuptova mirë qi kishe nevojë me qetësue Nexhip Begun. U poqa me zotnin e tij në Kafe t' Izzetit prej nga shkuem në Kafe "Turati". Aty, mbassi hapem biseden tue kuvendue mbi disa punë të pa randësishme, gjeta rendin dhe i thashë: "Me gjithë qi Ju pala dftue se do të na u lypte me u përgatitë per një kryengritje të pergjithëshme, kam muejtë me kuptue tash vonë se realisimi i këtij mendimi nuk asht i mundshëm veç se mbas dy vjetve e për hesap t'em kam hjekë dorë tash per tash nga caktimi qi kishim;"

Me ket dredhi i dhashë fund tules së Nexhip begut.

Më tjetren anë, per të holla e për armë nisa me ngushtue Ismail Kemal begun pak ma seriozisht.

Ndër këto ditët ma të kritikëshme të përgatimevet z. Pavlof-i më bani një vizitë në shpi e më lajmoi se bullgarët nuk mundshin kurrsesi me marrë pjesë më një kryengritje. U çudita e kurrqysh nuk mujta me e marrë vesh pse Makedonasit refusojshtin me u lidhë me ne kur ata, më një kohë jo shumë larg, kanë pasë kundershhtimin ma të madh prej nesh nder lëvizje të tyne për librim të Makedonis.¹

¹ Lidhja Ballkanike qi u tfaq kahë fundi i vjetit 1912 na jep dorë me gjetë shkakun e vertetë të pergjegjes negative të Z. Pavlof-it.

Nuk mund të mirret me mend se çfarë ndryshimit pat me i pru kohës s'onë ma se historike të kishte pasë këjo përgjegje një natyre të përkundërt.

Tue u gjetun një herë në Vjenë më ra rasa me kuvendue me një njeri të famshëm të diplomacis austro-hungare mbi çashtjen e propozimit t'em bullgarve për një marrveshje mbi autonomin shqyptare-makedone. Diplomati austro-ungar më tha se po t'a kishin pranue bullgarët propozimin t'em e po t'ishite realizue ky mendim, për sigurë se jo velem lufta ballkanike nuk do të kishte ndodh, por edhe lufta botnore kishte muejtë me u zgjatë për shumë kohë.

Këjo përgjegje tue u bashkue me apathin qi dftoi Ismail Kemal begu në të kryemurit e detyres së vet, na pat krijue një gjendje gadi të dishprueshme.

Nuk kishe veç se krejt pak të holla e puna qi i pata hy ishte shumë e madhe. M'u lypte me gjetë të holla e me gjetë pa hall! Nuk më pat mbetë veç se një rrugë: me i shitë gazet qe kishe në Shkup e me fillue veprimin e kryengritjes me ket kapital.

I shita pra gazet e me pretekst të zgjedhjevet u nisa për Vulçitimi bashkë me Nexhip beg Dragen qi shkonte për në Mitrovicë.

Prej Vulçitimi çova më katër anë njerës per me i lajmue besnikët e lidhjes se ishte afrue çasi i veprimit.

Kryengritja Drenicë-Jynik

Më 5 maj 1912 ishe në Drenicë bashkë me Zeinullah begun, burrë në shej per besniki, nacionalisem e bujari.

Nga Drenica shkrova dy letra, një per nenprefektoren e Vulçitimit e një per Nexhip beg Dragen në Mitrovicë.

Letra e parë permbledhte me pak fjale këtë:

"Tue u bindë qi politika Jeune-turke po vijon mizorisht në Shqipëri, ashtu si pata deklarue në Parlament, po e ngrehi sot flamurin e ngritjes kundra sundimit të Turkis".

Letra e dytë shkurtrohet si vijon:

"Krejt Kosovasis e unë ngrehem flamurin e kryengritjes kundra tyrqve të rij. Në kjoftë se nuk dishroni me u nda prej popullit të Kosovës, ky njeri ka per detyrë me ju pri deri në vend ku gjindem unë e shokët e mij".

Këto fjale u ndrruen në mes të Nexhip beg Drages e Ahmet Prekazit, derguesit të letres:

- Ku asht Hasan begu?

- Nuk dij. Nuk kam kohë për me folë shumë e me ndigjue shumë. Në patshit mendën me ardhë, jam i gatshëm me ju pri.
- Jam i smuet. Nuk mundem me ardhë – i a ka këthye Nexhip Begu. –

Ket letër i a çova Nexhip begut, për mos me muejtë një ditë me më kritikue e për mos me i mbetë shteg fjalës së tij të thonte ndo i herë se Hasan Begu nuk më ka lajmue e prandej s'kam marrë pjesë në kryengritje.

Natën e parë bujtem në Balincë e të nesërmen, me dy-qind pushkë ram në Prekaz, të Ahmet Delija ku i mbledhen krenët e Drenicës dhe kerkuen qi t'a perësritshim besën e dhanme.

Besa u lidh me këto fjalë:

"Bajmë be e japim besën e burravet, se kemi me ba çfardo flije e në kjoftë nevoja kemi me i ba kurban me duer kona robët e fëmit tonë."

Kur arrijtem në Gjyrxhevik (krahin' e Pejes) tu Sadik Rama u persërit besa, dhe në ket krahinë e prej këndeje ram në Pozhar, krahin' e Gjakovës.

Fuqija e jonë shkonte gjithnji tue u shtue e aty për aty ishim të zotet me çue në kambë një ushtri të madhe fort kryengritësh.

Kështu erdhem në Jynik, vendi historik ku gjithmonë bashkoheshin e lidhshin besë Peja e Gjakova për me i ra Turkis.

Lidhja e Jynikut

Populli i Jynikut na priti shumë mirë. Me të arrijtun këtu i a perdrejtova Riza beg Gjakovës një letër qi mund të shkurtohet në këto fjalë:

“Arrija në Jynik bashkë me shokët për me realizue qëllimin.

Ketu po ju pres, ju e pari e Gjakoves”.

Të nesërmen Riza begu u gjet në Jynik. Ahmed begu, i biri i Myrteza Pashes, pat mërrijtë në Jynik bashkë me ne. Pak mbrapa mërrijti edhe Hassan Feri me pari të Plavës e të Gucis.

- Nder këto ditë Malcija e Gjakovës, tue nxjerrë për preteks çashtjen e zgjedhjevet e me të shtyme t' Ahmet begut pat fillue me u turbullue e me i u kercenue Gjakoves. Malcorët patën nisë me kerkue qi të mësohet gjuha komtare ndër shkollat e Shtetit.

Zeqir Halili, një prej krenvet ma në shej të Krasniques, i pat pri kësaj levizje. – Zeqir Halili, në kryengritje të 1912-ës i ka krye pikë për pikë instruksionet qi ka marrë dhe ka mbushë plotësisht detyrën e vet komtare. –

Në Jynik u bashkuen për pak ditë shumica e atyne qi muejshin me perfaqësue popullin e Kosovës.

Në ket mes arrijti dhe Bajram beg Curri pak si idhnueshëm pse nuk e pata lajmue kur ishim në Shkup. Tue pa qëndrimin e zemrueshem të Bajram begut u solla e i thashë si tue u mahite:

- Shka kishe me ba, kur ju pashë se kishi lidhë mjaft miqësi me xhemietxhit?
- Jam shqyptar, m'a priti, nuk kam mendue kurr veç se si shqyptar e këtë koha ka për t'a provue.
- Bajram beg, na kësaj pune i kemi hy. Jemi të shtrenguem me dalë me nderë e me i sigurue Shqypnis disa privilegje. Në kjoftë se kësi shtegu nuk mundemi me realizue qëllimin kemi për të ra n'at gjendje qi gjinden tyrgjit e

lushes "Hajmana", e kështu kanë për t'u vërtetue fjalët e Talat begut, kryetarit të Jeune-turqvet.²

Bajram Begu nuk vonoi me kuptue randësin e gjendjes e biseda në mes t'onë vijoi:

- Per me luftue me një Perandori e me fitue kundra saj duhet me pasë shumë sende e sidomos armë, munition e të holla – tha Bajram Begu.
- Unë i përgjegja:
- Ismail Kemal begu ka pasë marrë mbi vedi me na dërgue 15.000 pushkë e 10.000 napoleona. Si duket këto nuk kemi për t'i pasë, mbassi deri me ditë të sodit as të hollat nuk na i ka çue. Por Bajram beg nuk kemi edhe fort nevojë për këto sende. Mos muejshim sot me ngrehë krye pse nuk kemi pushkë e të holla do të bahemi razi me jetue si tyrcit e Hajmanes e kurrqja kurrkujt...
- Poh, tha Bajram begu, keni të drejtë. Asht një detyrë e shejtë për ne me luftue kundra çdo anmiku dhe mos me pasë as pak pushkë. Lufta na u ka ba detyrë. Pra duhet t'i dalim zot të drejtavet t'ona e të pështojmë prej robnis.

Në Jynik ishin të mbledhun shumica e paris së Kosovës. Paris së Pejes nuk i besojshim mjaft e pra dhe ket pari e ftuem në Jynik.

Zejnol Begu, Sejjeddin begu e Jashar Pasha erdhen e i u dftuem pse po u bante mbledhja.

Këta zotnij, jo vetëm nuk dftuen një vullndesë të mirë, por filluen tinzisht me ba një propagandë për me paralisue qëllimin. Deri diku ia patën këthye mendjen dhe Riza beg Gjakovës. Na muejshim me i hy punës dhe pa pasë fort nevojë

² Tyrcit e Hajmanës perbahjnë at pjesë të popullit tyrc që janë shtypë ma së forti nga Turqija.

per parin e Pejës; por dishrojsim m'u dukë fare të bashkuem per me fitue ma lehtas e ma mirë.

Na duhej pra me e ba një hap guximtar e me i lanë të parët e Pejës e Riza beg Gjakovën perpara një "fait accompli".

U mora vesh me Ahmet begun e Myrteza Pashës që i u dha urdhën çetavet të Berishës me ia fillue pushken ushtris tyrke nder rrethe të Pejës.

Të nesermen heret, para se me u zbardhë dita, pushka krisi me tyrgit tue mos i lanë shteg kurrkujt me u marrë ma me diplomati.

Riza begut i a çuem një njeri që u shti sikur me pasë ardhë prej Gjakove at ditë per me i kallxue se tyrgit e kishin dënue për dekë e në kjoftë se do të këthente në Gjakovë, kishin per t'a xanë e gri.

Kuvendi nuk kishte se si shtyhet ma. Të ndeshunat u shvilluen rreptësisht e krejt parija ram në Strelc, katund afër Peje ku u ngreh qandra e kryengritjes.

Populli nisi me u mbështjellë rreth kësaj qandre.

Rrethimi i Pejës

Kryengritja u shvillue shpejt e me një energji f'egersueshme rreth Pejës; katundet rreth qytetit u pushtuen e qarku i rrethimit u ngushtue e të mësymet kundra kodravet të forcuemë me topa shkuen tue u ashprue pa pra.

Xhafer Tajari, kommandanti i këtij vendi, bari mrekulli qindrese per mos me na i lëshue kodrat e Jarinës e të Karagaçit.

Furija e kryengritsvet kishte marrë një fytyrë aq të mnershme sa u bind dhe Xhafer Tajari se qindresa per te duhej t'ishte një qindresë dishprini.

Tri dit e tri net nuk pushoi as një minutë gjatë të topave e fishkullimit të plumbave.

Numri i kryengritësve ishte shumë më i madh se ai i ushtrisë; por shqyptarët kishin një pushkë për më së dhënë vetë, me fort pak municion e ushtria turke ishte ngujë nënder llogore e pika strategjike me krejt veglat rrenuese të teknikës së shekullit XX.

Lufta u ashprue gjithënjë e kur fortesat ishin tue ba qindresen e mbramë, regjimenti 21 turk i Gjakovës, bashkë me regjimentin e parë të Stambollit shpërthyen tue na ra kahë shpina e na shtrenguen me i u veshë malevet që shtrihen kahë Rugova e Plava.

Kështu hovi i parë i kryengritjes u thye mjaft keqas përpara Pejes; por morali i shqyptarëve nuk u prish fare e mënjani e shpagimit (intikamit) u shtue edhe më tepër nëder zemra të tyre.

Trathtija e paris së Pejes

Mbas këtij të thymuni dy vende na paten mbetë ku muejshim me u përmbledhë e me vijue kryengritjen: Rugova e Pejes ase Malcija e Gjakoves.

U preferue Rugova³ për ku nguli kambë Zejnel begu i Pejes bashkë me dy shokët e vet.

Rugova me gjithë që na priti mirë, me gjithë këtë i u përkrash paris së Pejes e cila ishte e marrun vesh me Xhafer Tajarin para së me ardhë në Jynik bashkë me krenët e Rugovës, posë Qerim Begut.

³ Rugova asht krahina më e forta e Pejes që shtrihet kah veri i qytetit me një grykë të gjatë e tepër strategjike e me një popullsi në za për trimni e shëndet.

Nuk na pat mbelë pra, tjetër mjet për me pështue prej një kurthe trahitare, veç se me lëshue Rugovën.

Qandra e kryengritjes nguli në Krasniqe prej kahë na duhej me komandue një levizje që shkonte tue u shtri nder të gjitha krahinat e Kosovës e ma rreptas nder rrethe të Mitrovicës, men prisi t'Isë Boletinit e nder rrethe të Prishtinës.

Një çpallje

Mu nder keto minuta kritike të lëvizjes, kur nuk muejshim me dijtë kush ka për t'a fitue davan, a Shqyptarët apo Turqija, u pa si e arësyeshme me i lëshue popullit othoman një thirrje për t'i dhanë shkas kryengritjes e për me fitue sympathin e krejt elementave të Perandoris në të mirë t'onë. Nuk kishim se si me fitue luftën pa i a shti çartën dhe ushtris tyrke.

Këjo çpallje u shtyp ndeper të gjitha gazetat dhe mund të shkurtohet si vijon:

“Qëllimi i të ngrehunit të flamurit të kryengritjes asht për me i dhanë fund sundimit barbar të jeune turqve, që nën fytyrë të liris janë tue perkrye të gjithë llojet e mizorinave në vendin t'onë të cilat të shtynë me pasë ndjesë për absolutizëm të Sulltan Hamidit.

Ata që duen atdhen e nderin, i perkrahen landsisht e moralisht trupit t'onë kryengritës, që ka dalë në fushë me këtë qëllim të shejtë. Ata që dishrojnë që osmanlijt mos të mërrijnë në një gjendje të dhimbshme, mblidhen nën flamurin t'onë kryengritës. Atdheu pret prej nesh bashkimin. Dita asht sod e minutat janë afrue për me pështue prej të këqijave të jeune-turqve. A pështim a vdekje!”

Lufta e Qafes së Prushit

Nuk kishim kohë për të bjerrë, na duhej me fitue një luftë për me çue moralin e popullit nder rreth të Pejës e të Gjakovës.

Këtu Bajram Curri permbledhi fisin e vet Krasniqen e mësyri qafen e Prushit (Has).

Në Has Turkija kishte lanë një garnison prej katër bataljonash.

Një luftë e përgjakëshme që zgjati ashprisht nën komandë të Bajram Currit, tue marrë pjesë Hasi, Gashi e Bitçqi nder rreth të Qafes së Prushit me të mësyre e kundra të mësyre i shperdau këta katër bataliona. Tyrqit u thyen keqas tue na lanë në dorë shumë munitione, armë, mitraloza e topa, me qinda të dekun, të plaguem e robë luftë.

Gjallniri i ynë ishte aq i plotë sa i dha shpirt e zemer krejt popullit.

Robët e luftes shka ishin ushtarë, u liruen mbassi u çarnatisen e mbassi i mashtruem tue i thanë se kryengritja nuk kishte tjetër qëllim veç se me pështue katundarin shqypar e anadollak prej një sundimi mizuer. Këta të mjerët me habi të madhe e perbijshin ket propagandë e kur u këthyen në Gjakovë demoralizuen gadi krejt ushtarët e garnisonit t'atij qyteti.

Një lidhni me ushtrinë othomane të Gjakovës

Fitimi i një luftë mjaft me randësi, demoralisoi deri diku ushtrinë e Gjakovës dhe i dha dorë atyne oficervet të partis kundershtrare me tfaqë pa kënaqësin e tyne ndaj regimit Jeune turk tue sympatisue çiltas kryengritjen shqyptare.

Këjo ndodhi fort pak e pritme na dha dorë mos me bjerrë kohë perpara Gjakoves e fuqija e jonë komtare heci guximisht mbi fushën e Kosovës.

Pushtimi i Prishtinës

Per pak dit ma se 12.000 kryengritës u duken perpara Prishtines tue u betue të gjith me pushtue qytetin me luftë ase paqsisht.

Në ket mes kryengritësit e krahinave të Gëllanit, të Kaçanikut, të Prizrenit e të Tetovës i paten xanë grykat e Kaçanikut e të Cernoleves e shqyptarët e rrethit të Prishtines, me Isë Boletin e Xhemal Beg Prishtinen e Beqir agë Vulçitimin në ball, i paten thye tyrrqit në Llap e në Gollak e ata të Drenicës, nën komand të Zejnullah Begut, pushtuen Vulçitimin.

Kommandanti i garnisonit të Prishtinës deshti me ba si Xhafer Tajari perpara Pejes dhe morri të gjitha masat ushtarake per me mburue qytetin kundra çdo të mësymes.

Por disa prishtinas trima e ndaluen rrezikun e nji lufte mizore tue i a vu koburen në gojë komandantit të vendit mbrenda në zyrë të telegrafit e tue e ngushtue këte me nenshkrue nji urdhen qi ndalonte ushtrin ndër llogore me ba çdo kundreshtim në kjoftë se kryengritësit dishirojnë me pushtue qytetin.

Populli i këtij qyteti na priti me nji entusiasëm të pa shoq në kronologji të lëvizjevet komtare e i madh e i vogël u bashkuen me ne.

Tash qandra e kryengritjes ishi Prishtina e numri i kryengritësve pat arrijtë në 30.000.

Në ket mes korrespondentat e shtypit të huej si të "Times", "Neu Freu Presse", "Novoje Vremja" etc., u çuditshin sidomos mbi këto dy pika:

- a) Si muejten me fitue shqypetarët kundra një ushtrie tyrke prej ma se 60.000 vetësh.
- b) Dishiplina e madhe që mbretronte në mes të kryengritësve.

Këtu po shkurttoj një intervistë që bëri me mua në Prishtinë redaksioni i fletores së Petresburgut "Novoje Vremje".

- Shka asht natura e fuqis që po siguron dishiplinën në mes të këtij populli kryengritës. Pse edhe një ushtri e rregullshme në kohë të luftës nuk kishte me muejtë me mbajtë një dishiplinë kaq të madhe; sidomos kur dihet që ky popull asht i pa dijshtëm?
- Poh, i thashë unë, shqiptarët nuk mund të thomi se janë të dijshtëm; por, kanë një intelligencë që i dan në shej nder sa e sa popuj. Shqiptarët në kohë të luftës mund të sillen si sot, pors i një ushtri e dishiplinueme, në kjoftë se prisat dijnë me perfitue nga psikologia e tyre.
- Me të vërtetë, m'a priti korrespondenti rus, jam i bindem sot që shqiptarët përbajnë popullin ma të zgjuem të Ballkanit. Munden me meritue një fardhute të shkëlqyeshme.

Rrëximi i Kabinetit Jeune-tyrk

Pushtimi i Prishtinës na lëshonte në dorë krejt vilajetin e Kosovës. Në Stamboll filloi me mbretnuë një frigë aq e madhe sa shkaktoi dorhjekjen e Said Pashës, ministri i parë i kabinetit Jeune-tyrk. Në vend të tij formoi kabinetin e Turkis Qamil Pasha, i njoftëm si ma i madhi anënik i Xhemietit.

Qamil Pasha na lajmoi telegrafisht se kishte vendosë me çue në Prishtinë një mission zyrtar nën kryesi t'Ibrahim

Pashes, ish qeveritar e kommandant i Tarabullusit, me Ali Danish Prishtinën, ministri i Punevet të Mbrendëshme e me Sylejman Pashë Kolonjën, senator.

Ky mission kishte per detyrë me u marrë vesh me shqiptarët e me i dhanë fund kryengritjes. Qellimi i im u permbledhte në këto pika kryesore:

- a) Të njihen zyrtarisht kufijt e Shqypnis.
- b) Autoritetet civile e ushtarake të ken komsin Shqyptare.
- c) Ushtriya shqyptare të sherbejë në Shqypni e të jet komanda prej oficervet shqyptarë.
- d) Veprimet zyrtare në Shqypni të bahen në gjuhë shqype.

Ibrahim Pasha këto pika i gjykoi si shumë të randa e si hapi i parë qi qitet per me u da nga Perandoria othomane. Pra, kerkoi prej meje qi t'i lehtësojshe këto pika e më tha qi nuk kishte me i pasë hije Shqypnis me kerkue kësi pikash, pse populli asht muhamedan.

- Pashë i a prita: feja nuk ka shka të bajë me komsin, Zotnija e Juej jeni nga Manastiri, pra shqyptar si unë. Këto pika lypet t'i gjeni teper të lehta per me lanë kështu një emën të mirë në histori të Shqypnis.

Pritëshe prej Zotnis së Juej qi të më këshilloni me kerkue dishka ma me randësi. Pse jeni ma shumë të vaditun se unë për kësi punësh. Sido qi të jet, vjçova, nuk pranoi kurrfarë pergjegjsije në kjoftë se këto pika nuk pelqehen e na mund të hecim kështu deri në Stamboll e aty mund të mirremi vesh me Turkin. Besojmë se këjo punë nuk asht aq e vështirë per ne.

Ibrahim Pasha kerkoi prap me fjalë t'ambila me më kallxue se sjellja e ime ishte kundra myslimannismit e nuk u dam mirë me te.

Në tjetrën anë Ibrahim Pasha filloi me i lëmue kryetarët tjerë qi shkuen m'e vizitue edhe nisi me u perpjekun me të gjith fuqin e vet per me shti dasin në mes t'onë. Sidomos filloi me perfitue në ma të miren mënyrë prej pa dijes së Riza Beg Gjakovës e të fanatizmit fetar të tij. Riza Beg Gjakova e mandej edhe Isa Boletini filluen me thanë: "Na nuk duem autonomi edhe nuk mund të dahemi prej osmanlive". N'anë tjetër filluen me u përpjekë me konsulin serb në Prishtinë. Konsuli do t'i u ket thanë se do t'u epte armë, mbasi ma vonë, moren prej Serbis shumë pushkë. Gjendja ishte tue shkue per ditë e ma keq. Para se me lanë Prishtinën u mendojshe me sigurue shkaqet per të xjerrunit e privilegjeve; pse ishte e mundur me sigurue qellimin ma lehtësisht në Prishtinë. Por në njeren anë Ibrahim Pasha e në tjetrën konsuli i Serbis kishin mërrijtë me futë farën e dasis në mes t'onë me propaganda qi bajshin nën dorë.

Kur shkuem prej Prishtine në Ferizoviq ishte nevoja me shkruë privilegjet qi do t'i kerkojshin prej qeveris edhe me i a kumtue asaj në një mënyrë kategorike. Ma në fund, me vështirsina e mbas shumë fjalimeve i u ba kerkesa Ibrahim Pashës qi përmbante 14 pika; e cila kje pranue prej Qeveris së Qamil Pashës. Në këtë rasë, me të vertetë, asht për t'u permendë mundi e zelli i Bajram Beg Currit. (Kur ishim në Ferizoviq krejt parsija e Shqypnis jugore, per secillën punë, më kishte ba perfaqshues të vetin edhe më kishte dhanë një autorizim të plotë. Në librin qi kam me shkruë ma gjansisht per kryengritjen e vjetit 1912, kam me pershkruë ndodhinat e rrjedhuna në Shqypnin e Jugut e të Mesmen).

Pikat janë këto:

- 1) Me perdonue në Shqypni nëpunës të praktikuem që dijnë gjuhën e zakonet e vendit;
- 2) Me ba shërbimin ushtarak vetem në Shqypni e Makedoni, për jashta kohës së luftës;
- 3) Me ba e me vu në zbatim ligjë tue u bazue në ligjen e maleve (xhibal) për disa krahina në të cilat asht forcue me fakte se nuk mund të xierret kurtnji fryt prej organizmit të drejtsis;
- 4) Me i dhanë shqyphtarve armët e nevojshme e moderne, mënyra e të damit të cilavet do t'i perkite Qeveris. (Do t'u bajshim nder vende të randësishem deposita armësh, të cilat, në rasë të nevojës, do të mund t'i merrshin shqyphtarët).
- 5) Me themelue e me hapë shkolla reale në të gjitha Prefekturat e qandrave të Kosovës, të Monastirit, të Shkodrës e të Janinës që numrojnë ka një popullsi ma se 300.000 frymesh; me hapë edhe shkolla bujqsije si të Salonikut; mbassi vendi me krejt kuptimin asht një vend bujqsije; si edhe me shti në program të mësimëve gjuhën e vendit.
- 6) Me hapë shkolla thelogjike moderne ndër vende ku asht nevoja;
- 7) Mekenë i lirëshëm në Shqypni të hapunite të themeluemit e shkollave private;
- 8) Me u mësue gjuha e vendit në shkollat fillestare, qytetse e në gjymnaze;
- 9) Me i dhanë randsi të posaçme tregtis, bujqsis e punve botore si edhe me plotsue e me perhapë udhët e hekurit;

- 10) Me vu në veprim organizimin e krahinave;⁴
- 11) Me u kujdesue me rrujtë ma fort se perpara zakonet e tradicjonet komtare;
- 12) Me çpallë amnistin (faljen e pergjithshme), pa vështreue klasë e racë, per të gjith othomanët qi kanë marrë pjesë ne kryengritje, per komandantat, oficerat, nepunesit e ushtaret qi kanë lanë ushtrit e vendet e veta si edhe per të liruemit e t'ikunit prej burgut ne kohen e kryengritjes;
- 13) Me u dhanë çdamim, mbas çmimit të vertete, prej Qeveris Turke për të gjitha ato shpija qi u prishen ma para e nuk u kje dhane të zotve çdamimi si edhe për ato qi u prishen e u rrenuen kësaj here;
- 14) Me i marrë në gjyq të nallë pjestarët e kabinetvet të Haki e të Salt Pashes;

Kush mundet me mohue pra se këto privilegje nuk kanë kenë hape të mëdha kahë indipendenca e jonë.

Foh, vetem, lufta ballkanike u ba shkak qi këjo nder e famë t'i mbetet Vlones e jo Kosovës e ne vend të një Shqypnis se madhe të bahet një Shqypni e vogël.

U nisëm prej Ferizoviqit per Shkup. Nuk kishim ma shumë fuqi se 20% t'asaj fuqije qi kishim në Prishtinë. Shkaku i svoglimit të fuqis ishte ky: Riza Gjakova e Isa Boletini mendojshin me pështue Sulltan Hamidin, qi ishte i burgosun në Salonik e prandej me kenë qi u shkorte me një fuqi të madhe, tue mos muejtë me dallue antarët e Riza Begut e t'Isa Boletinit,

⁴ Këto janë propozime për me diltue kufijt e Shqypnis heshtimisht (tacitement) Me folë kjarisht për caktimin e kufijve të Shqypnis u donte të vrahemi me Riza Begun.

Këto kërkesa kjenë ba me qëllim për me përhapë ma shpejt e ma themelisht organizimin e propagandës. Sidomos dobija e organizimit të krahinave, n'administratë, nuk mund të mohohet.

kishim frigë e drojshim se ndjeksat e tyne do t'u bashkojshin me këta dy për pëshkrimin e Sulltan Hamidit e kështu e pam me nevojë për me shperda fuqin kunder çdo rase që mund të ndodhte. T'ardhmen në Shkup, çashtja e Sulltan Hamidit ndër qëllime të Riza Begut e Isë Boletinit u pa shumë kjartas; e për ket arsye u prishëm keqas me këta dy.

Ishe i bindun se ishte nevoja me shpërda një orë e ma parë fuqin, që kishim në Shkup, abolla që mos t'i mbette vend ndodhinave të pakandshme. Për ket shkak fillova me ba të perpjekuna ma të shpështa me Ibrahim Pashën. Edhe ky ishte frigue tepër keqas prej çashtjes së Sulltan Hamidit. Ibrahim Pasha, tue mendue se shqyptarët kishin një fuqi të pakët, kishte qitë ceken me xanë Riza Begun e Isa Boletinin bashkë me ushtarët e Turqis edhe këte m'a pat thanë edhe mue. Ibrahim Pasha kujtonte se unë do t'a pranojshe ket propozim, mbassi e dinte se unë nuk ishe i marrun vesht e një mendimi me Riza Begun e Isa Boletinin.

Unë i pata kundërshtue këtij propozimi rreptsisht edhe i pata thanë që ma parë t'a vete në veprim ket punë kunder meje se kunder të permendunve e kështu ma ne fund, merrijta m'e shporrë prej këtij mendimi Ibrahim Pashën. Qëllimi i em për të mprojtun të Riza Begut e t'Isa Boletinit ishte për mos me damtue prestigjin e shqyptarvet. Me të vertetë këta të dy, n'at kohë, nuk mendojshin ndonji send tjetër veç me pëshTue Sulltan Hamidin prej burgimit. Jo që nuk mund t'u flitte me ta për punë t'Independences; por nuk mund t'u permendte gjë as për autonomi pse keto ishin fjalë qyftri (mkati) për Riza Begun e Isa Boletinin.

Unë qindrojshe në mendimin që edhe me kenë nevoja me i ndeshkue dy të permendunit, t'u ndeshkojshin me anë të shqyptarve e jo të tjetër kujt. Me gjith këte këjo kryengritje na

ka mësue shumë të verteta f'idhta e na ka dhanë eksperiencë të madhe.

Patën ardhë në Shkup si përfaqësues të Shqypnis se mesme ZZ. Abdi Beg Toptani, Mustafa Krueja e Kapidani e Mirdites, Marka Gjoni. Kur e pan shkallen e fanatizmit, të Riza Begut, t'Isa Boletinit e të shokve të tij, të thuesh se u dishpruen. U vertetuen edhe ata se atë herë nuk ishte e mundun t'u ngrehte flamuri i independences. Unë u pata thanë këtyne zotnive të ndershem, se mas tre a kater mujve do të bajshim prap një kryengritje edhe se atë herë do t'a çpallshim independencen t'onë. Veç kësaj u pata shtue se nder këta tre a kater muej do t'a perhapshim organizimin t'onë ma gjansisht edhe do t'i bajshim të pa kenun, n'emen t'interesës së Shqypnis, disa vetë të cilët muejshin me kenë një pengim per t'arrijtun qëllimin e shejtë.

Per ket çashtje patem ra në godi me ZZ. e naltpermendun. Me të vertetë, patem fillue me u organizue ma themelisht se perpara, por çka të bajshim mbassi mbas pak kohe krisi lufta ballkanike, e cila i qiti poshtë të gjitha planet t'ona.

Perfundim e Vertetime

Në faqe 30 kam folë mbi perfaqsimin t'em të Shqypnis së Jugut në Kryengritjen me 1912 e autorizimin qi më kishin dhanë atdhetarët e asaj pjesë të Shqypnis në ket kryengritje. Për vertetim të këtyne fjalve po botoj këtu një letër të Z.Nenkolonel Ismail Haki Tatzatit:

Shkodër, me 15.6.1921

Fort të nderitil Zotni

Zot. Hasan Beg Prishtinës

Deputet i Dibres

në Shkodër

“Kam marrë vesht se Zot. e Juej jeni tue gatue nji broshurë mbi ndodhinat e kryengritjes shqyptare në vjetin 1912. Ju lutem të keni mirësin m’e pranue edhe ket pjesen t’eme e m’e shti në broshuren e sipertharun; mbassi ka të bajë me kryengritjen qi bahet fjalë:

“Në vjetin 1912, me qëllim per m’u bashkue me kryengritjen e Kosovës, kjemë nisë prej Elbasanit: Ymer Bej Ohri, unë (atë herë ishe kapitan), Ahmed Dakli; e shumë atdhetar tjerë e të gjith shashkut u bamë kund 40 vetë qi patëm formue nji komitë edhe kjemë mbledhë në katundin Martanesh; vend i permetueshem per të sjellun të komitës.

Këtu kje bashkue me ne edhe Zot. Ismail Haki Libohova, kapiten, i cilli kishte ikë prej Dibre. Çeta e jonë mbet në Martanesh nja dy javë e në ket kohë pat ardhë deri në kufi të Martaneshit nenprefekti i Matit, kapiten Esadi me nji bataljon ushtar e dy topa per gjurmimin e kësaj çete; por kje ndalue prej saj. Tue kenë qi prap në ket ditë paten ardhun prej Dibre; çeta kje detyrue me u largue në nji mal të fort të Martaneshit, ku filloi me ba gatimet e nevojshme, per mos me lanë në qetsim ushtirin e ardhun; por këto forca ushtarake u këthyen mbas 24 orëve per mbas nji urdhni të marrun.

“Edhe çeta e jonë kje ba 80 vetësh e shkoj në Domre e Shpat t’Elbasanit. Këtu u bashkuen me ne edhe kapiten Tajar Begu me shumë oficjera tjerë. Kur i u afruem Elbasanit, morem lajmin se ishte vu kabineti i Qamil Pashës. Tue kenë në Domre e Shpat paten ardhë edhe shumë atdhetarë tjerë e kje ba forca e jonë afer 800 vetësh. Këjo çetë u marshtronte prej Aqif Pash Elbasanit e shumë atdhetarve tjerë. Në ket kohë, në Fieri kjenë mbledhë Komitetet e Vlonës, të Lushnjes, Beratit, Mallakastres, e të Korçës nën kryesi t’Ismail Kemal Begut per me bisedue disa çashtë të randësishme edhe per ket punë paten lajmue komiten e Elbasanit telegrafisht; mbas

të cillit lajmim kjenë dergue prej Elbasanit, per me marrë pjesë ndër këto bisedime, unë, Ali agjah Begu, Hasan Beg Elbasani, Timor Efendija e Zenel Hoxha”.

“Nder këto dit Qeverija osmane kishte shenjue Ibrahim Pashen e Sylejman Pashen per me u marre vesht me komiten e Kosovës. Gadi krejt Tosknija kishte zgjedhë e lajmue telegrafisht per mëkamës të vetin Hasan Beg Prishtinen per m’u gjetë në ket bisedim. Qe pra edhe në Fieri paten fillue me u ba bisedimet mbi ket çashtë. Ndër këto bisedime ishin edhe Ymer Pashë Virjoni e Aziz Pash Virjoni”.

“Ismail Kemal Begu i pat ba një propozim mbledhjes per me zgjedhë per secillen krahinë nga dy vetë edhe me i dërgue një Kosovë për me bashkëpunue me Hasan Beg Prishtinën në të mprojtun të qëllimit e të kërkesavet shqyptare”.

“Mbledhja, tue kenë se ket mëkambsi i a kishte lanë qysh para Hasan Beg Prishtinës, nuk e pelqej ket propozim e kështu Ismail Kemal Begu pat mbetë vetëm në ket mendim”.

“Mbledhja propozoi qi Ismail Kemali i u niste me një herë per Stambollë per me u marrë vesht me kabinetin e ri edhe ai e pat pelqye ket propozim”.

“Tue kenë per të nisun, një ditë para, mbledhja muer një pergjegje me telegrafë prej Drejtorit të Telegrafes se Prishtinës. Ky telegram i marrun kje kendue para mbledhjes e ishte në ket mënyrë: Hasan Beg Prishtina asht nisë per një vend qi së dihet stop Telegrami nuk mujt me i u dorzue stop”. Kur mbledhja ishte tue e komentue në gjithfarë menyresh ket telegram, Zot. Qazim Kokoshi i pat dergue tekstualisht mbledhjes një lajm të marrun prej disa fletoreve italjane. Fletoret thojshin: “Hasan Beg Prishtina qysh në piken e parë të kerkesave asht prishë me delegacionin othoman, edhe asht tue shkue gjithnji kahë Shkupi me të gjith fuqin e vet. Me te asht tue u bashkue me gëzim edhe ushtria”.

telegrami i Z.Toger Frasherit qi i a pat drejtue Nijazi Begut në pergjegje të një telegrami q'i pat dhanë ky i mbrami Hasan Beg Prishtinës tue i thanë se: "po vi". Telegrami i Z.Frasherit qi i a pat drejtue Nijazi Begut mbassi e pat perzanë nenprefektin e Permetit ishte në ket veshtrim."

"Po kje qi nuk ju dhimbet qoshku magnifik i Juaji ju pres të vini. Kah unë eri jo kah Hasan Begu".

Nenkolonel

Ismail Haki Tatzani m.p.

Per me distue, si argument, sa mendime të gabueshme janë per kryengritjen e vjetit 1912 e perfundimet e saja po e shoh të nevojshem me pershkruie tekstin si asht të një artikulli të botuem në Nr. 166, me 16 të vjeshtës së parë 912 në fletoren "Dielli" të shkruem prej kryetarit të tashem te Partis Popullore, Emzot Fan Nolit nen titullin "Per zgjedhjet të deputetve". Artikulli asht ky:

Per zgjedhjet të Deputetve

"Pas një muaji Shqiptarët do të ftohen prej guvernes të zgjedhin perfaqësonjësit e tyre per Parlamentin e Perandorisë turke. Ne u-lençin të lirë, memedhetarët t'anë do t'apin voten e tyre verberisht per sa njerës, të "mëdhej" pas mendjes së tyre dhe çarillatane pa cipë pas mendjes s'onë, pa i lidhur me një program dhe pa venë re jetën e tyre të shkuar. Dy nga këta Shqypëtarë "të shkelqyer dhe me nam" që do të dalin pa dyshim janë Ismaili i Vlorës dhe Hasani i Prishtinës".

Ç'behët Gjetke

"Ne viset e qyteteruara, kur del nje njeri perpara popullit dhe i lyp voten per të dalë deputat, i kerkojnë pik'së pari t'u tregojë programin që do të mbajnë në Parlament po të zgjidhet. Çdo kandidat ben hesap që do të harxhojë një sumë të madhe per të shtypur këto programe dhe një sumë tjetër me të madhe per të shtetituar qytet me qytet e fshat me fshat që t'u ç'koqitet zgjedhëve pikë pas pike e t'u pergjigjet ç' politikë do të mbajë në qeshtje, të cilen harroj t'a verë në program. Kjo është pjesa me e lehtë e fushatës elektorale. Se çdo vagabond munt të paguajë qatip, që t'i shkruajë sa programe, ne të cilat t'i zotohet turmes që, po të zgjidhet, do t'u mbarojë dëshirat të gjithë zgjedhëve të tij. Çobeneve do t'u thotë që, po të behët deputat, dhent e tyre do të pjellin nga dymbëdhjet shqera; bujqerve arat do t'u siellin grurë dhe miser pa lëruar; hajduteve do të zbrësë hena t'u thotë ku munt të vjedhin kecer dhe misiroke pa gjakosur hunden per lavdi të memedheut; memdhetarëve do t'u mbijnë shkolla dhe mesonjës si kepudhra pa levizur vendit e pa futur dorën në xhept; medrescrat do të lulëzojnë, ylefete do të shtohen, puna do të pakësohet, plaçkat do të lirohen, në vent të shiut do të bjerë raki nga qielli, dhe në vent të deboret muhalebi. Po turma e qytetëruar, ndonëse i perkedhelot veshi nga gjithë këto bekime që do t'i vijnë, ka dyshime dhe nisë e pyet cili është ky nieri që do të bejë këto çudira; ç' gjera ka berë në jetë të tij më parë që të garantilin ato që zotohet? Në mos ka berë veç të keqia gjer aherë, si do të ndrrojë me një herë e do të perhapë miresira dhe lumerira më të gjitha anët? Kandidati duhet të pergjigjet në të gjitha këto pyetje. Duhet të thotë cili është, ç' ka berë per popullin dhe të hedhë dritë mi gjithë pikat e errëta të jetës së tij. Në mos e beftë ay, do t'a bejnë armiq e tij, të cilët do mos lenë asnjë cip të jetës së tij pa gervishtur.

asnjë fjalë, asnjë shkrim, asnjë punë pa nxjerë në shesh e pa kritikuar. Dhe kjo është pjesa më e rënda e fushës elektorale në viset e qytetëruara”.

“Po le të thomi qi kandidati u shtroj zgjedhsve një program të pelqyer, që u pergjegj në gjith pyetjet e tyre që jet e tij e shkuar qe pa njollë dhe u zgjoth deputat. Mos pandehni se zgjedhësit e tij do t'a lenë të lirë. Jo! po venë re si silllet në Parlament, a mban programin e tij dhe ne u provoftë qe e shkel, mblidhen, kritikojnë politiken që mban dhe e thërresin të japë demicjen. S'ka njeri të nderçim në boten e qyteteruar i cili të qendrojë deputat, posa zgjedhsit të protestojnë kunder tij”.

“Po në Shqipëri nuk çajnë koken per gjithë këto hollësira. Asnjeri, fjala vjen, do mos kuxojë t'u kërkojë një program të shkruar me ngjyrë të zezë në kartë të bardhë Ismailit të Vlorës dhe Hasanit të Prishtinës. Asnjë do mos u kërkojë të shpjegojnë pse kanë ndrruar aqë herë mendje dhe s'kanë mbajtur kurrë zotimet që dhanë. Do t'i zgjedhin verberisht se i kanë degjuar per njerës të “mëdhej”. Po ne qe jemi rritur në qendra qytetërie Anglosaksone, ku ka lindur dhe ngaha u perhap gjetke forma koshtutale e guvernes kemi detyrë t'a ndriçojmë popullin, duke i treguar ç'duhet të kërkojë nga njerëzit që i lypin voten. Dhe në është populli i verber e s'di ç'tu kërkojë, do t'i pyesim ne drejt per drejt”.

“Hasani dhe Ismaili duhet të na tregojnë programin e tyre, të na zotohen që do t'a mprojnë me gjithë fuqi në Parlament të Turqisë, të japin demicjen nga deputatesia porsa qe të protestohen zgjedhesit e tyre e t'i denojnë si genjeshhtarë që shkelë zotimet që bejtin. Kështu bejnë njerëzit e nderçim që vihen kandidatë per nje ofiq në viset e qyteteruara”.

Ismail Qemali

"Po Hasani dhe Ismaili **NUKË** do t'i japin popullit shqiptar asnjë program, se bota e tërë i rrejeh për tjerës të nderçim, të mëdhej dhe patriotë. Fort mirë po jeta e tyre e shkuar therrët për kunder që janë njerës pa cipe e pa nder, carllatanë pa ndergjegje, tregëtarë patriotikë me zemer Kucovllahu dhe Serbi, Turq dhe Anadollakë gjer në palcë e gjer në koskë".

"Për të nisur me Ismailin, - se, siç thotë fjala frengë "a tout seigneur tout honneur" - si, si mor Shqiptarë pikevratë e të humbur, i kini besë këtij njeriu dhe e dergoni në Parlament? Porse nukë hihti një sy mi jeten e tij të shkuar, që është një Iliade carllatanirash, bataçillekesh dhe tradhetirash? Porse nukë pyesni ç'ka berë për Shqipërinë gjer me tani? A është nevojë të ndyj pendën që t'ua thom unë? Ky kallpozan s'ka berë në jetë të tij t'atër gjë veç të shesë yje të Shqipërisë në kompanira italiane, kongresë dhe kryengritjera Liberaleve, dhe të genjëjë Greket dukë u falur Epirin. Për Shqipërinë s'ka hapur kurrë gojen boterisht as në Parlament, as në gazetë shqipe, as në të huajtë. Kur shaheshin në Gegeri pa mëshirë, Ismaili heshtte, dhe bente hesap sa para dhe fitime munt të nxire nga këto turbullime. U sull në Mal të Zi dukë u këshilluar Toskëve të heshtin e të mos i turbullejnë hesapet. Tregetoj gjakun e Malesorëve dhe pastaj u tha Toskëve që është koha të ngrihen. Sivjet gjith'ashtu u-zotua që do t'a çironte fare Shqipërinë me një kryengritje. I beri që të dyja, u'a shiti Liberaleve, mori paratë i futi në xhept, shkoj nga Korfuzi ku i shiguroj Grekët që Epiri është i tyre, doli në Vlorë ku i këshilloj Toskët të mos kerkojnë nga guverna veç gjera që të munt t'u jipen. Pas këtyre të gjitha Myzeqarët munt t'a besojnë për njeri të math Ismailin e t'a zgjedhin deputat, Shqiptarët e vertetë s'duhet t'a bejnë kabull as t'a peshtyjnë".

F.S.NOLI

Boston, Mass., 6 Vieshtë 1, 1912.

SHTIGJEVE TË ARSIMIT



**“Sa të rroj do të përpiqem për dituritë edhe për atdheun,
për mbrothësinë e vëndit tonë”.**

Hasan Prishtina

HASAN PRISHTINA SIMBOL I ARSIMIT KOMBËTAR


***“Sa të rroj do të përpiqem për dituritë edhe për atdheun,
për mbrohtësinë e vendit tonë”.***

(Hasan Prishtina, Klubi “Dituria”, Selanik, 1910)

Megjithëse situata politike ishte e rëndë dhe kishte dalë në shesh politika demagogjike e regjimit xhonturk, qarqet atdhetare shqiptare filluan realizimin e platformës kombëtare. Si hap i parë i Lëvizjes Kombëtare ishte hapja e klubeve dhe shkollave në gjuhën shqipe.

Në zhvillimin e arsimit kombëtar, kontribut të madh dhe të pakontestueshëm ka dhënë atdhetari Hasan Prishtina si para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Përpyqjet e tij për përhapjen e mësimit shqip gjatë viteve 1908-1912, sa ishte deputet në parlamentin osman, nuk u ndalën edhe karshi sundesve serbë, austro-hungarezë, bullgarë. Për përmbushjen e kësaj detyre kombëtare, ai kërkonte të botoheshin libra në gjuhën shqipe, përdorimin e alfabetit latin dhe hapjen e shkollave fillore, të mesme e të larta në gjuhën amtare.

Pas rishpalljes së Kushtetutës, në korrik të vitit 1908, klubet kombëtare të formuara nga atdhetarë shqiptarë ishin organizuar me qëllim që të realizonin të drejtat kombëtare si në aspektin politiko-ushtarak por edhe në atë kulturor arsimor. Ndër klubet e para që u formuan për këtë qëllim ishte Klubi “Bashkimi” i Manastirit (31 korrik 1908), kurse me kërkesën e Hasan Prishtinës dhe atdhetarëve të tjerë në muajin gusht ishte hapur edhe Klubi Shqiptar i Shkupit, i cili merrej përveç çështjeve politike edhe me hapjen e shkollave shqipe në Vilajetin e Kosovës.



Synimi i këtyre përpjekjeve kishte të bënte me hapjen e shkollave shqipe të pavarura nga çdo ndikim fetar. Përpos që pati takime me drejtues të tjerë të Lëvizjes Kombëtare, në vjeshtë të vitit 1908, Hasan Prishtina u takua me krerët e Lëvizjes Kombëtare të Kazasë së Gjilanit me ç'rast u mor vendim që në kazanë e Gjilanit të hapen tri shkolla në gjuhën shqipe: njëra prej tyre të hapej në Pozheran, kurse dy të tjera në Gjilan.

Në Programin e Lëvizjes Kombëtare parashihej edhe zgjidhja e problemit të shkollës shqipe. Klubet kombëtare, pas Kongresit të Manastirit bënë thirrjen e një Kongresi tjetër që u mbajt në Elbasan më 2-8 shtator 1909, i cili mori vendim që të hapet Shkolla Normale (pedagogjike). Ajo u hap më 1 dhjetor 1909, në Elbasan nën drejtimin e Luigj Gurakuqit. Kjo shkollë në fillim kishte 160 nxënës, prej tyre 50 ishin nga Vilajeti i Kosovës, të cilët kishin ardhur përmes klubeve shqiptare dhe nën përkujdesjen e Hasan Prishtinës dhe atdhe-tarëve tjerë të këtyre viseve. Ai i kishte dërguar 21 të rinj në Normale dhe ishte zotuar se do t'i dërgonte edhe shumë të tjerë me shpenzime të veta. Në mesin e këtyre nxënësve që i financoi ishin edhe 5 gjilanas. Sipas gazetës “Liria” të Selanikut, ata ishin: Shyqyri Malushi, Qamil Zeneli, Nevzad Sherifi, Sait Ademi dhe Beqir Sadiku.⁸⁵

Në konferencën e mbajtur nga klubi “Dituria” e Selanikut, ai thoshte se edhe pse kundërshtimet për shkronjat e shenjta janë të rrepta, dituria dhe e drejta do ta mundin poshtërimin dhe paditurinë. Ai deklaronte se sa të jetë gjallë do të përpiqet për diturinë, për atdheun dhe për përparimin e vendit. Kurse në një mbledhje të mbajtur në Klubin Qendror në Stamboll prej shumë çështjeve që u diskutuan, Hasan Prishtina paraqiti edhe çështjen e shkollës shqipe.

Nga mesi i shkurtit të vitit 1910, në Normale të Elbasanit dërgoi 16 nxënës nga Vilajeti i Kosovës. Më vonë në Elbasan shkoi një grup prej 19 nxënësish nga Gjakova, Prishtina, Vuçitërna, Mitrovica, Peja, Struga etj. Me këtë rast, gazeta “Bashkimi i Kombit” në Manastir, më 25 shkurt 1910 citonte fjalët e drejtorit të shkollës Luigj Gurakuqi, i cili ndër tjerash thoshte: “...Rroftë atdhetari i shkëlqyer Hasan Prishtina! Rroftë përjetë ky atdhetar i lartë, ky engjëll i Shqipnis së mjerë!”

Kurse, gazeta “Dielli”, më 11 mars 1910 shkruante se me iniciativën e Hasan Prishtinës e Nexhip Dragës në Elbasan u dërguan edhe 15 djem nga Shkupi. Më pas, në një telegram tjetër të botuar në këtë gazetë të datës 17 mars 1910, Hasan Prishtina theksonte se para pak ditësh dërguam në Elbasan 10 çuna, kurse këto ditë do i dërgojmë edhe 11 të tjerë. Po ashtu, në maj të vitit 1910, nga Shkupi, Gjakova, Peja, Vuçitërna e Gjilani, në Elbasan arritën edhe

⁸⁵)Gazetës “Liria”, Selanik 1909; shënim arkivor.

38 nxënës të cilët do të bëheshin mësues të ardhshëm të shkollave shqipe në Vilajetin e Kosovës. Hasan Prishtina ishte angazhuar edhe për cilësinë e mësimdhënies. Për këtë qëllim në një rën nga seancat e parlamentit osman më 11 qershor 1910, polemizoi me Ministrin e Arsimit të Perandorisë Osmane, i cili i thoshte se në 200 shkolla që do të hapen sipas Ministrit në Vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit të dërgoheshin njerëz të zot për mësues.

Ai vazhdoi edhe më tej përpjekjet për zhvillimin e arsimit shqip. Kështu, në seancën parlamentare të 2 majit 1911, Hasan Prishtina kërkoi që në Vilajetin e Kosovës të hapej një shkollë e mesme bujqësore, sepse aty ishin kushtet e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, sidomos të industrisë së duhanit dhe të pambukut.

Edhe në flakën e kryengritjes së vitit 1912 e mbrojti shkollën shqipe nëpër-mjet 14 kërkesave që ndryshe njihen edhe si “14 pikat e Hasan Prishtinës”, brenda të cilave i kushtoi rëndësi të madhe çështjes së arsimit dhe hapjes së shkollave në gjuhën shqipe, duke e ndarë arsimin laik nga ai fetar (*pika 5, 6, 7 dhe 8*) të dalë nga Kuvendi i Ferizajt (*gusht 1912*).

Në artikullin me titull “Shqipëria e Re” të botuar në gazetën “Liria e Shqipërisë” në Sofje, më 22 tetor të vitit 1912, vlerësohej lart veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës në luftën e vazhdueshme për liri dhe të drejta kombëtare të shqiptarëve duke i dhënë atij epitetin e “Një nga më të mëdhenj atdhetar...”.


Hasan Prishtina nuk u ndal asnjëherë në përhapjen e mësimin shqip në tokat shqiptare. Në vitin 1915, me iniciativën e tij hapet një shkollë në gjuhën shqipe në Vuçitërnë dhe në Koshtovë të Bobit. Në këtë kohë në Gjakovë hapet Kursi Pedagogjik për rikualifikimin e mësuesve të shkollës osmane që të jepnin mësim në shkollën shqipe. Vetëm në vitin e parë u rikualifikuan rreth 40 mësues për shkollën shqipe. Njëkohësisht filloi mbajtja e kurseve të natës për zhdukjen e analfabetizmit. Hasan Prishtina kishte pranuar se nën sundimin e Vjenës shqiptarët patën përparime në shumë fusha, por edhe në atë arsimore, ku gjatë viteve 1916-1918 u hapën qindra shkolla në viset shqiptare.

Ai punoi për hapjen e shkollës shqipe edhe në zonën e pushtimit bullgar. Në fund të vitit 1917, kishte aktivizuar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për mbrojtje nga pushtuesi bullgar dhe hapjen e mësimin shqip në ato vise të okupuara nga bullgarët.

Angazhimi i Hasan Prishtinës për hapjen e shkollave shqipe vazhdoi edhe më tej. Kështu, më 1 qershor 1921 nga Ministri i Arsimit të Shqipërisë, kërkoi që të hapen shkolla shqipe në tërë vendin, sidomos në Malësi ngase andej nuk kishte asnjë shkollë. Ai kërkonte nga qeveria shqiptare që sa më parë të hapet së paku një shkollë në Lurë, në të cilën do të mësojnë së paku 100 djem shqiptarë.

Edhe gjatë sundimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, Hasan Prishtina kishte reaguar për ndalimin e shkollës shqipe nga pushtuesit sllavë. Kështu, më 15 mars 1927, i kishte dërguar Lidhjes së Kombeve një memorie të hollësishme mbi gjendjen në Kosovë duke përfshirë edhe arsimin. Hasan Prishtina në këtë dokument trajtoi gjerë arsimin e shqiptarëve nën sundimin e Mbretërisë së SKS-së, ku ndër të tjera theksoi: *“Prova më e qartë për keqtrajtimin e pakicave shqiptare në Mbretërinë e SKS-së, është fakti se në atë një milion shqiptarë janë të gjithë pa shkolla shqipe. Më shumë se çfarëdo tjetër kjo ankesë tregon se qeveria e mbretërisë së SKS-së ka për qëllim të shkatërrojë popullin shqiptar në kufijtë e shtetit të vet”*.

Krejt në fund, kontributi i Hasan Prishtinës për zhvillimin e arsimit kombëtar dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe me program kombëtar, reflektoi në rezultate të dëshmuara e të suksesshme, të cilat ndihmuan në ngritjen e vetëdijes dhe të atdhedashurisë së shqiptarëve.



Ismail Qemali, i biri dhe Hasan Prishtina, në Vjenë

KONTRIBUTI I HASAN PRISHTINËS PËR GJUHËN E ZYRTARIZUAR SHQIPE

Patriotët shqiptarë që moti e kishin kuptuar qëllimin e armikut, andaj energjitë e tyre i kishin orientuar duke u udhëhequr nga motoja se pa arsim kombëtar nuk ka as zgjim kulturor e as politik. Ata punuan dhe luftuan për të ruajtur atë që është më qenësore për popullin shqiptar - gjuhën shqipe dhe shkollën shqiptare.

Pa marrë parasysh sakrificat, humbjet, burgosjet, internimet, helmimet e masakrimet, ata me vetëdije të plotë iu përveshën punës kudo që u jepej rasti: në male e fusha, në bodrume e qerthuj, në shtëpi e dyqane, pra kudo me të vetmin qëllim -të mbjellin farën e dijes në gjuhën amtare në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, ashtu siç thoshte mjeku nga Struga Dr. Ibrahim Temo: *“Se ne mund të shpëtojmë vetëm po të edukohemi në gjuhën tonë”*.⁸⁶

Motoja e këtillë, që u përfaqësua nga pjesa më e shëndoshë e popullit shqiptar, ndikoi edhe në forcimin e ndërgjegjes kombëtare që me plot sukses në fazat e ndryshme të lëvizjes arsimore dhe kulturore e sidomos të kuptohet dhe demaskohet politika e xhonturqve, e cila shpiente në një politikë shkombëtarizuese ndaj popullit tonë. Dhe, tërë puna e patriotëve shqiptarë nuk shkoi huq, por përkundrazi ndikuan që në dy kryengritjet e viteve 1910 dhe 1911 kërkesat kryesore të ishin pikërisht gjuha shqipe dhe shkolla kombëtare. Patriotët e intelektualët e kohës i dhanë hov lëvizjes për arsim kombëtar, veçmas pas formimit të komiteteve të fshehta, në veçanti pas Kushtetutës turke të vitit 1908, kur u organizuan edhe shkollat nën drejtimin e klubeve kombëtare.⁸⁷

Gjatë këtyre viteve një ndër patriotët më të spikatur e tepër të rrallë, që shkroi faqe të ndritura në historinë e arsimit shqiptar pa dyshim është Hasan Prishtina. Me guximin e tij patriotik dhe me intelektin e tij të mrekullueshëm ai nuk nguronte që haptazi të kërkojë pavarësinë e Shqipërisë, të mbrojë shkronjat latine, të hapë mësonjëtoje, të fusë gjuhën shqipe në Gjimnaz e në Normalen e Shkupit, të dërgojë djem për shkollim, të mbrojë geramat shqipe e Normalen para Parlamentit Turk dhe të demaskojë hapur qeverinë osmane për pengesat që i bënte arsimit shqip në trojet e Shqipërisë.⁸⁸

Kur ishte fjala për shkollat e huaja Sulltanati udhëhiqte një politikë krejtësisht të ndryshme, sidomos ndaj shteteve fqinje, ngase ato pranonin subvencione të mëdha. Shkollat greke, përveç fondeve të llasove, merrnin edhe subvencione të veçanta nga qeveria greke. Kjo nuk ndodhte edhe me shkollat shqipe, të cilat

⁸⁶) Prof. Dr. Avzi Mustafa, “Figura mësuesish shqiptarë 1”, BKSH. Tetovë, 1995, f. 6.

⁸⁷) Gaqo Peci, “Arsimi Popullor” nr. 2, f. 82-83.

⁸⁸) Instituti i Studimeve Pedagogjike, “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, vëllimi I, Tiranë, 2003, f.304.

ndiqeshin e mbylleshin. Prandaj shkollat klandestine në shumë qytete të Shqipërisë mbaheshin me ndihmën e klubeve dhe nga patriotët vendës, që ndanin kafshatën e fëmijëve të vet që ashtu t'i mbajnë gjallë shkollat në gjuhën shqipe.

Megjithatë, si problem kryesor, që ende nuk kishte gjetur zgjedhje përfundimtare, ishte ABCE-ja shqipe. Që t'i jepej fund kaosit të alfabeve, që përdorehin nga shqiptarët dhe nga albanologët e huaj, Klubi i Manastirit "Bashkimi" mori përsipër ta organizojë një kongres kombëtar për këtë çështje. Dhe, në këtë kongres u vendos përfundimisht edhe çështja e njësimimit të alfabetit shqip.⁸⁹

Aprovimi i alfabetit shqip e iritoi Sulltanatin, atëherë filluan me të madhe manovrat e xhonturqve. Edhe pse Kushtetuta 1908 jepte në fakt një liri që gjuha shqipe të mësohej, *de jure* ajo ndalohej, duke vënë në përdorim disa merimanga e klerikë myslimanë që të fusin huti në popull. Ata dërguan disa emisarë që ta aktualizonin përdorimin e alfabetit turko-arab, duke propaganduar se me germa kaurësh nuk shkohet në Qabe. Xhonturqit nuk e shihnin problemin e alfabetit thjesht si problem grafie, por si problem politik, pas të cilit fshihej diçka e madhe. Kjo çështje "*e madhe*" do të vërehet në acarimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke. Ndërsa ky acarim vihet re edhe nga mendimi i ministrit xhonturk të Punëve të Brendshme të Perandorisë, i cili deklaronte: "*Shqipëri nuk ka! Ka vetëm provincë turke*".⁹⁰

Kësaj politike djallëzore iu kundërvu patrioti Hasan Prishtina, i cili në dhjetor të vitit 1909 protestoi në Parlamentin Osman në Stamboll, kur u kërkua të ndaloheshin shkronjat shqipe.⁹¹

Por, jo vetëm kaq! Hasan Prishtina si një intelektual i spikatur aty ku i jepej mundësia i shprehte qartë kërkesat e shqiptarëve dhe e mbronte alfabetin dhe gjuhën shqipe, si dhe trojet tona dhe nuk nguronte që haptazi të deklarohet për një kryengritje të armatosur të përgjithshme ndaj Perandorisë Osmane. Ai do t'i deklarojë konsullit britanik në Shkup: "*Ne shqiptarët për t'i dhënë fund mizorisë turke në Shqipëri, si dhe pengesave që po i bëjnë çështjes së alfabetit e kulturës sonë kombëtare, kemi zgjedhur si të vetmin mjet shpëtimi bërjen e një lëvizje të armatosur kundër sundimit turk*".⁹¹

Po në verën e vitit 1909 Hasan Prishtina merr një mision të ri si një sofist shkon prej një vendi në një vend tjetër në të gjitha trojet shqiptare për të agjituuar në lidhje me rëndësinë e hapjes së shkollave në gjuhën amtare. Sepse, mendonte ai; *vetëm shkolla në gjuhën shqipe do të jetë e aftë për t'u kuptuar.*

⁸⁹) Avzi Mustafa, Studime dhe artikuj, UISHM, 2012, f. 16.

⁹⁰) Po aty, f. 31.

⁹¹) Instituti i Studimeve Pedagogjike, "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Vëllimi I, Tiranë, 2003, f.304, 305.

Instinktet natyrore janë nga më të ndryshmit, por instinkti i dashurisë ndaj atdheut, gjuhës amtare, me të cilën lindesh dhe vdes, janë tipare të identiteti të çdo kombi.

Intelektualët e kohës si dhe patriotët shqiptarë këtë e kuptuan më së miri në momentet më të vështira kur popullit tonë i kanosej rreziku i asimilimit nga sllavët, helenët e turqit, ashtu që ruajtja e gjuhës dhe e kombit ishte strumbullari ku shqiptarët bashkoheshin pa marrë parasysh fenë dhe krahinën. Për Hasanin si parim pedagogjik kryesor ishte mësimi i gjuhës amtare.

Hasan Prishtina këtë parim e realizoi në Normalen e Shkupit, ku filloi të mësohet gjuha shqipe. Por, jo vetëm kaq, ai kërkonte që 5% të ardhura vjetore të shkojnë në dobi të arsimit kombëtar në Shqipëri. Gazeta “Dielli”, që botohej në Boston të Amerikës do të shkruajë kështu: “...dëgjojmë burra me vlefë si Hasan be Prishtina, i cili të lëçitnjë çiltazi se sot e tutje pesë për qind nga gjë e tij e përvitshme, si edhe nga muaj që merr e do të marrë qeverija, do ta përdorjë vetëm për mësimin e gjuhës shqipe”.⁹²



Faksimile e gazetës shqiptare “Dielli” që botohej në Boston

Kështu me hapjen e Shkollës Normale të Elbasanit në dhjetor të 1909-tës, sipas një dokumenti, kryetari i Klubit “Bashkimi” më 18 kallnor të vitit 1325 (sipas kalendarit turk), gjegjësisht sipas kalendarit të ri, më 31 janar 1909, patrioti e pishtari i arsimit shqip Hamdi Ohri nga Ohri i drejtohet Këshillit të Klubit “Bashkimi” në Elbasan; “që me nismën e Hasan Bej, deputet i Prishtinës ju rekomandojmë tre zotni Gillanas e dy Vuçitërnas, të

⁹²) Revista Shkencore “Vjetar” nr. 45-46, 2011 e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës

studjue në shkollën Normale t'Elbasanit, na u dërguan prej Klubit "Bashkimi" të Manastirit, me lutje qi të përmendurve t'u tregohet lehtësirat e duhuna në kryemejen e veprimeve qi lypen, për pranimin e tyne në atë shkollë".⁹³

Pas pranimit të këtyre nxënësve, Hasani u nis bashkë me to dhe, kur arriti në Shkup, ai bashkë me nxënësit një natë bëri konak në shtëpinë e Kolë Bojaxhiut, të atit të Nënës Tereze, të cilin Hasani shpesh e vizitonte, herë vetë e herë me patriotët e tjerë. Për t'i disponuar nxënësit, Kola gjeti momente që t'i argëtonte fëmijët, duke luajtur pak me instrumentin e muzikës.

Parimi kryesor i Hasan Prishtinës bazohej në një sistem arsimor të përgjithshëm e të detyruar në gjuhën shqipe. Pra, jo vetëm arsim fillor, por edhe të mesëm. Ai e quante bazë të çdo përparimi arsimin në gjuhën amtare në shkolla të pavarura.

Kur u hap Normalja e Elbasanit, në këtë shkollë për një kohë shumë të shkurtër u bënë mbi 100 nxënës, ndërsa numri i tyre dita-ditës shtohet. Ky shtim bëhej gati gjatë gjithë vitit, sepse kushtet dhe vështirësitë nga vilajetet shqiptare ishin tepër të këqija. Kështu ndodhi edhe me ardhjen e dy grupeve të nxënësve nga Vilajeti i Kosovës në muajin shkurt dhe mars të vitit 1910, të cilat ishin organizuar dhe financuar nga Hasan Prishtina. Ato përfshin gjithsej 35 nxënës. Për ardhjen e grupit të parë të 16 nxënësve Hasan Prishtina e kishte njoftuar me një telegram Shkollën Normale të Elbasanit. Ishte një gëzim i madh i profesorëve të Normales së Elbasanit, por edhe i tërë qytetarëve të Elbasanit, që dolën rrugëve dhe i pritën këta "bij të Kosovës" ose, siç e quanin ata të "Shqipërisë së Sipërme", duke brohoritur: "*Rroftë Hasan Prishtina!, Rroftë për jetë ky atdhetar i shkëlqyer i Shqipnisë së mjerë!*"⁹⁴ Po ashtu edhe ardhja e grupit të dytë të nxënësve nga Shqipëria Lindore (nga Gjakova, Peja, Vushtrria, Shkupi e Struga), që ishin gjithsej 19 nxënës, ishte një ngjarje dhe festë e madhe. Me këtë rast ata i përshëndeti patrioti dhe drejtori i parë i kësaj shkolle, Luigj Gurakuqi, i cili, siç theksojnë studiuesit, "*në atë ligjëratë të shkurtër edhe një herë spikati ëmbëlsirat e gjuhës shqipe, bukurinë e të folurit e mendimin e ngjeshur të atdhedashurisë*".⁹⁵

Kjo ngjarje nuk ngeli edhe pa fjalën e Nolit të madh, i cili do të shprehet kështu: "*Të ardhurit tuaj na përsëriti gëzimin që kemi ndëgjumun një muaj më parë, kur erdhën disa shokë tuaj nga ajo Kosovë kreshnike që ka qenë kurdoherë çerdhe atdhetarësh të mirë e trimash skifterë, na përsërit atë gëzim që dëgjojmë gjithmonë kur na vijnë nxanës të rinj në këtë Shkollë Normale nga viset e ndryshme të atdheut tonë*".

93) AQSH, F 102, V.1909.D. 28. fl.1.

94) Gazeta "Lirija" 10 korrik 1910.

95) Piro Tako, "Luigj Gurakuqi, Jeta dhe vepra", Tiranë, 1980, f.120-121.

Hasan Prishtina për veprimtarinë e tij arsimore pedagogjike na ka lënë edhe veprën me titull “*Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vitit 1912*”, ku qartë e shpalos programin e tij të arsimit, të cilin e shihte si pjesë më të rëndësishme të luftës për të drejtat e shqiptarëve. Në këtë broshurë, siç e quan ai vetë, e gjejmë platformën dhe sintezën për arsim në Shqipërinë e plotë e të pavarur, për një sistem arsimor me bazë të vetme në gjuhën shqipe. Me programin e tij arsimor Hasan bej Prishtina bashkohet me idenë e të gjithë rilindësve se parimi bazë për të ndërtuar një sistem arsimor me karakter kombëtar është ngritja e shkollave në gjuhën amtare shqipe. Koncepti për shkollën dhe arsimin ishin faktor kryesor për të arritur lirinë dhe vëllazërimin midis njerëzve, sepse për të, një popull i cili dëshiron të trajtohet me të drejta të plota, duhet të jetë i arsimuar.

Duke i njohur mirë marifetllëqet e xhonturqve, në kohën kur ata u frikësuan nga lëvizja e armatosur e shqiptarëve dhe kur duhej që të gjendej ndonjë kompromis, Hasan Prishtina nuk nguroi që me vendosmëri të kërkojë që gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare në Shqipëri, të vendosej përdorimi i detyruar i gjuhës shqipe në administratë, të bëhet krijimi i një sistemi unik arsimor, ndërsa përmbajtja e shkollës shqipe të ketë synim frymën kombëtare demokratike e laike, duke kërkuar: “*Me themelue e me hap shkolla reale në të gjitha prefekturat e qendrave të Kosovës e Manastirit, të Shkodrës e të Janinës... me hap edhe shkolla bujqësie, pasi vendi në krejt kuptimin është një vend bujqësor, si dhe me shti në program të mësimëve gjuhën e vendit. Me hap shkolla teknologjike moderne ndër vende ku e lyp nevoja*”.⁹⁶

Me ndihmën dhe përkrahjen e Hasan Prishtinës dhe me mbështetjen e klubeve shqiptare dhe atdhetarëve të tjerë që në vitin 1909 u hapën shkolla shqipe në Moravë me mësues Rexhep Repën, në Gjilan me Adem Efendiun, ndërsa në Pozheran me mësuesin Imam Pirën e Baki Efendiun. Hasan Prishtina me padurim priste që sa më parë të kthehen nxënësit që i kishte dërguar në Normalen e Elbasanit, që pastaj ta hapë një shkollë edhe në vendlindjen e tij në Vushtrri (Vuçitërnë).⁹⁷

Puna frytdhënëse për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe u ndërpre në vitet 1912-1913, kur tokat shqiptare të Kosovës u pushtuan nga shovinistët serbë, malazez e bullgarë, të cilët nuk donin që popullsia shqiptare të arsimohej në gjuhën amtare.

96) Insitituti i studimeve pedagogjike, “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, vëllimi I, Tiranë, 2003, f.305.


97) Murat Gecaj, “Nëpër udhët e shkollës shqipe”, Tiranë 2008, f.106.

Pas rënies së qeverisë xhonturke dhe fitores së kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912, qeveria e re - me kërkesën këmbëngulëse të Hasanit vendosi që gjuha shqipe të futet edhe në gjimnazet turke me disa orë në javë në shkollat fillore qytetëse e të mesme të arsimit profesional.

Në librin e përmendur të Hasan Prishtinës në fund të parathënies ka edhe një shënim ku thuhet: “*Se fitimin që ka për t'u nxjerrë nga kjo broshurë, do t'ia kushtoj sigurimit të arsimit të fëmijëve jetimë të Kosovës, Dibrës e të Çamërisë, që gjenden në Shqipëri*”.⁹⁸

Puna e një luftëtari, si dhe humanizmi i tij i thellë me shpirtin e tij të sakrificës dhe preokupimit për dije dhe ndihmë për të varfërit, e lartëson më shumë atë si njeri në shërbim të njerëzve. Prandaj me të drejtë Hasan Prishtinën mund ta quajmë *Pestaloci Shqiptar*, ngase ai gjithçka bëri për të tjerët, e asgjë për vetveten.

Hasan Prishtina, që bëri gjithë atë sakrificë për shpëtimin e trojeve tona dhe për shkollën e arsimit në gjuhën amtare në kohët më të vështira, meriton që këto pak fjalë të jenë homazh nderimi për personalitetin e tij të shquar.



Luigj Gurakuqi

⁹⁸⁾ Avzi Mustafa, Studime dhe artikuj, UISHM, 2012, f. 16.

DY AKTE PËR IDEOLOGUN E ARSIMIT

Në faqet e këtij libri nuk mund të kalohet pa u përmendur kontributi i Shkollës Normale të Elbasanit dhe i atyre që e ideuan, ngriten, drejtuan, financuan si Aqif pashë Elbasani, Dervish Biçakçiu, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Lef Nosi etj. Ishin pikërisht këta atdhetarë të shquar që më pas punuan për shpalljen e pavarësisë, e ngritjen e shtetit shqiptar. Mjaft bukur vëmendjen e tyre për Shkollën Normale, dashurinë e qytetarëve të Elbasanit për Shkollën Normale e pasqyrojnë këto tri akte, në formë reportazhi të shënuara më poshtë e të botuara në vitin 1910.

AKTI PARË:

Këtu flitet për arritjen e 19 nxënësve nga Kosova në Shkollën Normale të Elbasanit, të financuar nga atdhetari i shquar Hasan Prishtina, duke pasqyruar entuziazmin me të cilin ata u pritën nga populli i Elbasanit, thuhet kështu: *“Të enjten më 25 të muajit nxanësit e Shkollës Normale bashkë me profesorët e t'yne, me qeleshet e bardha përmbi krye, kishin dalun me kohë për jashta qytetit për me pritun nantëmbëdhjetë djemt, që po vinin prej Kosove dhe Struge. Kishin dalë përpara t'i presin edhe një shumësi e madhe prej qytetarvet që u mallëngjehet zemra për përparimin e kombit dhe për një arsim të vërtetë për bijtë e Shipënis. Nxënësit bashkë me popullin zunë vend në kopësht të madh të shkollës, ku nga ana e këshillës së profesorëvet i palodhuri atdhetar Luigj Gurakuqi, me atë ambëlsi gjuhe dhe bukuri të folunit, e cila kurdoherë karakterizon fjalët e tij tha: ... me përpyjekjet e parreshtuna të këtij zotnie (Hasan Prishtinës) ka me ardhë një ditë, dhe nuk asht e largët, kur me ditunië të vërtetë dhe me themel, me një arsim krejt kombëtar do të dritësohet dhe do të marrë rrugën e qytetnimit gjith ajo Kosovë burrnore, gjithë ai vend i atdheut të dashun, ku kanë shkëlqyer kurdoherë besa ma e madhe dhe trimnia ma e rrallë, me të cilat asht pajtuar kombi shqiptar. Historia e kombit t'onë me shkronja t'arta, me shkronja të çkëlqyera do të shkruajë ndër faqet e' saj shërbimet e mëdha, punët e shënuara, ... të cilat asht tue bâmun deputeti i adhureshëm ndër deputetet t'onë Hasan be Prishtina në fushë atdhësië... brez pas brezi, zembrat e djegura t'atdhetarëvet emënin t'uaj kânë me bekuar, dhe një shtat (shtatore) i shkëlqyeshmë, një shtat i mermertë që do të ngrehet për ju, pasi mote të kalojnë, ka me leçitun për para botës së qytetënueme, që një komb i gjithë ju ka detyrë!”*⁹⁹

⁹⁹ Lef Nosi, gazeta “Tomorri”, dt. 31 Mars 1910.

AKTIDYTË:

Këtu bëhet fjalë për provimin e nxënësve të parë të Normales, pas përfundimit të vitit shkollor. Është impresionuese ceremonia e organizuar me atë rast, marrin pjesë figurat më të shquara të Elbasanit, por ajo që veçanërisht tërheq vëmendjen, pjesëmarrja masive e qytetarëve të tij. Një provim i hapur me publik, një festë për qytetin. Për këtë thuhet: *“Ora ishte njëmbëdhjetë para dreke dhe njerëzia... zunë të derdhen pa pushim në Mësimore, me gjithë që binte një shi i hollë. Për pakë kohë, salla u mbush me njerëz, sa që s'kishnje se ku të huthnje gjelpanën. Shkallët e Mësimores edhe oborri ma së fundi, me gjithë që shiu nuk pushonte, ishin plot për plot me atdhetarë, të cilët, me zjarr në zemër, kishin rendun të ndëgjojnë provimet e djelmohavet shqiptarë dhe të shohin e të çmojnë me syt e tyne punën e përparimin që ishte bamun për shtatë muaj në këtë Mësimore Shqiptare të lartë, që vlerëson ndihmën e përkrahjen landore (materiale) të gjithë atdhetarëve të vërtetë. Në kjoftë se nuk kishte me ranë shi, në kopësht të math të Mësimores, do të kishte rrjedhun gjithë qyteti. Në sallën e madhe shohim gjithë parësin e vendit: Aqif Pashën, Dervish Beun (Biçakçiu), Shefqet Beun (Vërlaci), Hasan Beun (Biçakçiu), Kryetarin e Beledies (Bashkisë), Alush Saraçin, gjithë parësiet pushtërore dhe politike, përfaqësonjësit e Klubit “Bashkimi i Ri”, shoqëniyet “Afërdita”, “Drita” dhe “Dielli”. Kryetari i Parësisë së Mësimores i palodhuni atdhetar Dervish Be Elbasani (Biçakçiu) qëndronte në krye të shkallvet edhe, me atë fisnikëni të hollë që karakterizon gjithë mënyrat e të siellunat e tij, priste gjindjen... Për gjithë secilin kishte edhe një fjalë të ambël e një nderim të veçantë”.*

Fjalën e merr Luigj Gurakuqi, drejtor i Normales: *“Shtatë muaj ma parë n'atë ditë fatbardhë e të paharrushme u hapën dyert e kësaj Shkolle Normale... E dinim se do të punonim për gjuhë e për atdhe siç e ka detyrë ç'do shqypëtar i vërtetë, e ky mendim na ngrohte zemrën e na jipte guxim e durim... Po sot gëzohem që ju dëftenj, o Zotërinj të ndershëm, se puna me ndihmën e Zotit e t'afetsiës së Shqyptarëve i kapërceu shpresat t'ona. Sot qe kemi nderin të ju shohim përsëri të mbledhun në këtë vend të bekuar në këtë çerdhe të dituniës të shqypëtarëve, shpresojmë se nuk do të ju mbajmë ma vetëm me fjalë të gjata e të thata po do të mundohemi t'ju vërtetojmë, me vepra e me tregime, mendimet e fjalët t'ona e t'ju japim një provë të vogël po të këthjellhtë të dobis e të frytit, që sjell ky lloj mësimi tue ju shtrumun përpara pemët e reja të kësaj vjete shkollare... Djemt t'onë rrodhën nga të gjitha viset e Shqypëniës e u derdhën këtu n'Elbasan, e jo vetëm nga Toskëria, po mâ fort Gegënia e Sypërme, nga Kosova fisnike e trimoshe me të përpjekunit e të nderëshmit Hasan Be Prishtina... Këtu do të rriten me urti e do t'ushqehen me mësim e me dituni ata apostuj Shqypëtarë, që për së shpejti do të përndajnë dritën në të gjitha viset e vëndit tonë.*

E shoh për detyrë t'i falem nderit si Komisionit të shkollës si edhe parësisë e të gjithë njerëziës s'Elbasanit, që aqë fort janë munduarë të na ndihnin në të kryemit e barrës s'onë. Elbasani, përveç se truni e zembëra e Shqypëniës do të jetë paskëtaj për të gjithë ne edhe si një vënt lindjeje i dytë. Nxânësit e kësaj shkolle, nashti që do të këthehen në vëndet e në shtëpiat e veta, besonj se do të sjellin me vehte një kujtim të mallëngjyeshëm e do të përhapin e do të përndajnë nâmin e tij në të katrë anët e atdheut t'onë. Rroftë pra Elbasani, djepi i mësimet e i dituniës kombëtare!”

Pas kësaj fjale të zjarrtë të fillon provimi. Në reportazh shkruhet:

“Përgjithësisht të gjitha mësimet, të trajtuara më një gjuhë të rrjedhëshme dhe të përbashkme kupëtoh-eshin lehtësisht prej të gjithëve dhe ma tepër po thua se dy orë rresht tërhoqën pa ndonjë farë mërzie vërejtjen e gjithë asaj gjendjeje të madhe, e cila nuk pushonte tue trokitun duart nga pëlqimi”

Dhe, pas provimit janë çmimet për më të mirët që sot përbëjnë një surprizë më vete. Por, çka ishin çmimet?, shkruhet në reportazh: *“Me kohë atdhetari i dëgjuar dhe i adhuruarshmi deputeti ynë Hasan bej Prishtina kishte dërguar dymbëdhjetë orë dore, katër me mbulesë t'artë dhe tetë me rreth të këtitllë. Përveç këtij zotnie të lartë orë dhuruan edhe këta zotnië të ndershëm: Aqif pasha dy, Shefqet beu dy, Dervish beu një, Qamil beu një, i vëllai Dervish beut dy, Hasan Çiftja një, Klubi “Bashkim i Ri” dy, shoqënia “Drita” një, Esnafi” një.*¹⁰⁰



Mësonjësit së bashku me Dervish bej Biçakçiun, kryetar i Kongresit Kombëtar të Shkollave Shqipe të Elbasanit, kryetar i komisionit drejtues të Shkollës Normale. Ulur: Hafiz Ibrahim Dalliu, Luigj Gurakuqi, Hajdar Blloshmi, Aleksandër Xhuvani. Në këmbë: Sotir Peci, Simon Shuteriqi, Petër Dodbiba, Hasan Merja

¹⁰⁰) Lef Nosi, gazeta “Tomorri”, dt. 30 Qershor 1910.

HAPJA E SHKOLLËS SHQIPE NË VUSHTRRI (1915)

Ai që përkujdeset për shpëtimin e të rinjve, bën punën e hyjnive!

Hasan Prishtina është unikat edhe në fushën e arsimit kombëtar. *“Kontributi i Hasan Prishtinës për zhvillimin e arsimit kombëtar është i madh dhe nuk mund t’i gjendet krahasim, jo vetëm në historinë e popullit shqiptar, por edhe në historinë e popujve të tjerë. Përpyekjet e tij për shkollën shqipe përbënin një krah të luftës së tij të përgjithshme për lirinë kombëtare shqiptare,- konstaton historiani i njohur, dr. Muhamet Pirraku.¹⁰¹*

Ky arsimdashës i flaktë, fitoren mbi regjimin e tiranit sulltan Abdyl Hamiti, e shfrytëzoi në të mirë të gjuhës dhe shkollës shqipe. Me nismën e tij, pa humbur kohë, u organizua Kongresi i Alfabetit në Manastir, i cili i zhvilloi punimet prej 14 - 22 nëntor 1908. *“Thirrja e Kongresit të Manastirit u mirëprit nga forcat atdhetare shqiptare si një ngjarje me shumë rëndësi në fushën e kulturës kombëtare të popullit shqiptar, por edhe si një ngjarje me rëndësi të madhe politike”.*¹⁰²

Mirëpo, vendimi i Kongresit që, hëpërhë, të mbesin në fuqi dy alfabetet, ai i Stambollit (*i Sami Frashërit*) dhe ai i Shkodrës (*i Shoqërisë “Bashkimi”, të udhëhequr nga Preng Doçi, Gjergj Fishta, Ndoc Nikaj etj.*), nuk qe shumë i kënaqshëm për Hasanin. Kjo sillte telashe të mëdha, ua hapte gojën armiqve, që të thoshin nuk ka bashkim kombëtar. Nisur nga kjo, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Ismail Qemali e deputetë të tjerë shqiptarë në Parlamentin e Turqisë, hartuan Programe dhe bënë kërkesa që populli shqiptar dhe gjuha e tij amtare të gëzonin barazi në perandori.

Në këtë vazhdë shkon edhe Kongresi i Elbasanit, i njohur edhe si Kongresi i Shkollës Shqipe, i mbajtur më 2- 9 shtator 1909. *“Vendimet e Kongresit të Elbasanit patën mbështetje të fuqishme të Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës. Barrën e organizimit të përpjekjeve shqiptare e bartën Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Bajram Curri, Salih Gjuka, Bedri Pejani, Rrok Berisha, Rexhep Mitrovica etj. Dhe për një kohë të shkurtër u hapen shkolla shqipe në Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Vushtrri e gjetkë...”*¹⁰³

Ëndrra e Hasan Prishtinës që të dominojë alfabeti latin në shkollat shqipe, po bëhej realitet. Atë vit do të nisë punën edhe Shkolla Normale me në krye Luigj Gurakuqin. Në atë vatër diturie do të mësojnë edhe shumë nxënës nga Kosova, shumica me harxhimet e Hasan Prishtinës, i cili kishte vendosur që gjithë pasurinë e vet që e kishte gjithandej në Vushtrri, në Mitrovicë, në

101) Bedri Tahiri, “Hasan Prishtina-Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1912- 1933”, Prishtinë, 2008; f. 85-97.

102) Tomor Osmani: “Udha e shkronjave shqipe”, Shkodër, 1999, (f. 318).

103) Dr. Muhamet Pirraku, “Roli i Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të alfabetit kombëtar shqiptar”, Tiranë, (17 nëntor 2008).

Prishtinë, në Drenicë, në Shkup, në Selanik etj. ta shkrinte për shkollën shqipe e për çështjen kombëtare.

Ky “*korife i shqiptarizmës*”, siç e cilëson dr. Muhamet Pirraku, me guximin intelektual i demantoi kualifikimet e Turqve të Rinj se kinse Lëvizja e alfabetit të gjuhës shqipe është vepër e “Austriës”, duke thënë: “*Austria e ka protektoratin fetar të krishterë katolik në Shqipëri dhe jo arsimin, se shkollat shqipe si dhe Normalja e Elbasanit, janë kërkesë dhe vepra të shqiptarëve për interesa të jetës së kombit*”.

Kështu, vetëm nga qyteti i lashtë i Vushtrisë, në Normalen e Elbasanit vajtën 12 nxënës: ¹⁰²⁾

1. Muharrem Ymer Velqetrini,
2. Sylejman Bajram Velqetrini,
3. Mehmet Jusuf Velqetrini,
4. Halim Shaqir Velqetrini,
5. Izet Ymer Velqetrini,
6. Tejfik Sylejman Velqetrini,
7. Xhafer Hafiz Muharrem Velqetrini,
8. Hasan Abedini,
9. Emin Hoti,
10. Qerim Mustafa,
11. Iliaz Velqetrini dhe
12. Ragip Abdurrahimi



Atdhetarët Hasan Prishtina e Luigj Gurakuqi

¹⁰⁴⁾Prof. Fahri Buçinca; “Zhvillimi i arsimit në Vushtri me rrethinë, Vushtria- Vicianë me rrethinë”, Vushtri, 2003, f. 325- 326).

Nga i njëjti burim mësojmë se Hasan Prishtina, pos në Normalen e Elbasanit, shumë të rinj, rreth 25, i kishte dërguar edhe në shkollën bujqësore në Budapest, si: Ismetin e Abdullahun e Zejnullah Begut-Berishës, Abdullahun e Haxhi Shefqet Koronicës, Nazmi Nuri Spahiun, Fevzi Mulla Hysenin, Hamdi Mulla Ibrahimin, Sherif Gollakun dhe Emin Haxhi Hasanin.

Dhe, kjo pati sukses. Përhapja e arsimit shqip mori rrugë të mbarë gjithandej trojeve shqiptare. Drejtori i Normales së Elbasanit, atdhetari Luigj Gurakuqi, i priste përzemërisht djemtë e Hasanit, siç i quante ai nxënësit kosovarë dhe gjithmonë i entuziazmuar brohoriste: *Rroftë Hasan Prishtina!*

Luigj Gurakuqi, ky arsindashës dhe atdhetar i madh, e çmonte pa masë dërgimin e nxënësve nga Kosova. Ai, në gazetën “Koha” të Mihal Gramenos shkruante: *”Kosova fisnike e trimoshe, me të përpjekunit e të ndershmit Hasan Prishtina, i cili na rroftë përjetë, na dërgoi mjaft nxënës në Shkollën Normale, të cilën vetë Hasan Prishtina e kishte quajtur qendër të parë të vëllazërimit të rinisë shqiptare”*. Është interesant edhe pritja që iu bë grupit të parë prej 16 nxënësish kosovarë, të cilët dolën për t’i pritur në rresht, një orë larg Elbasanit, nxënës, mësues e popull. Pas ceremonisë madhështore, e cila gumëzhinte nga brohoritjet: Rroftë Kosova!; Rroftë Hasan Be Prishtina! Rroftë Shkolla Normale! Rroftë Shqipëria!, dhe pas përshëndetjes së zjarrtë që bëri Avni Rrustemi në emër të nxënësve, fjalën e mori drejtori Luigj Gurakuqi, ku, midis tjerash tha: *“Gjithë sa herë na vijmë djem nga vise të ndryshme të Shqipërisë zemra e jonë kënaqet e mallëngjehet, shpirti ynë gëzohet e dëfren, pse kështu shohim se Shkolla Normale jo vetëm po përparon si shkollë, por edhe po i afrohet gjithnjë e për ditë e ma tepër qëllimit për të cilin është ngrehurë. Kjo shkollë duhet të jetë qendra e arsimit kombëtar, këtu jo vetëm do jepet mësim e ditur, po do të trajtohet, do të përmirësohet e do të dalin vetëm njerëz të ditur, po mësonjësa, ma mirë, apostoj të nxehtë e të vullnetshëm, që bashkë me diturinë, do të përhapin nder më të largëtat vise të atdheut dhe ndjenjat kombëtare. Mësonjësi shqiptar duhet të gdhend jo vetëm mendjen e popullit të mjerë po të ushqejë edhe zemrën e tij me ndjenja të drejta e të shëndosha, të fortësojë e të lartësojë karakterin e tij, të ngjallojë në shpirt të tij shpirtin e dashurinë e së mirës e t’a vejë kështu në udhë të përparimit... Ju djemtë e Kosovës pastaj e keni për detyrë t’i shpërbleni me sjelljen tuaj të mirë, të ndershmit Hasan Prishtina nderin e madh që po ju ban, po këtij i kemi detyrë të gjithë, pse ky burrë i vlerëtë po përpiqet e nuk po kursen sot aspak vendin që të mbrojnë kombësinë t’onë kundër armiqvet, që duan të na prishin gjuhën e të përmbajnë përparimin e arsimit ndër ne. Duke u sjell mirë, duke i vunë mendjen mësimi, duke i ranë pas këshillat t’ona ju do të fitoni të mirën tuaj...¹⁰⁵*

¹⁰⁵Gazeta “Bashkimi i Kombit”, Nr. 25, Manastir, më 25 shkurt 1910

Ditë e shënuar ka ngelur edhe 25 qershori, dita kur u mbyll viti shkollor 1909-1910 për Normalen e Elbasanit. Atë ditë, për nxënës të dalluar, pos tjerash u ndanë edhe dhurata, dërguar nga Hasan Prishtina.

Peripeçitë e shkollës shqipe gjatë asaj periudhe janë të shumta, herë lejoheshin, herë ndaloheshin, dhe, gjithmonë në kacafytje me ngulfatësit e saj anadollakë, qëndronte i madhi, i dituri dhe sypatremburi, Hasan Prishtina.

As pushtuesit e rinj, austro-hungarezët e bullgarët, nuk u treguan aq të ashpër ndaj shkollave shqipe në Kosovë. Ata që u gjendën nën sundimin austro-hungarez, për një nuancë jetuan më mirë dhe i gëzuan disa të drejta më tepër se ata nën sundimin bullgar. Ky pushtues lejoi hapjen e shkollave në gjuhën amtare. *“Aspiratat dhe përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës, veçmas të intelektualëve përparimtarë të tij, për një sistem arsimor në gjuhë amtare shqipe filluan të mëkëmben më 1916, në ato treva, të cilat i pushtoi Austro-Hungaria. Vjena lejoi dhe ndihmoi, jo vetëm hapjen e shkollave laike e shtetërore shqipe, por njëkohësisht bëri të mundur që pjesërisht edhe administrata të realizohej në gjuhën shqipe”*.¹⁰⁶

Gjatë pushtimit austro-hungarez, Hasan Prishtina u angazhua për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një njësi administrative. Së bashku me Nexhip Dragën kishin formuar organizatën arsimore e kulturore me seli në Mitrovicë. Me iniciativë të tij, më 1916, u hapën shkolla shqipe në Bajskë (veri i Mitrovicës), në Koshtovë, në Zhabar, në Pantinë, në Mitrovicë, në Vushtrri. Ai solli libra shqipe nga Shkodra dhe kështu, për herë të parë popullata shqiptare e këtyre mjediseve mësoi të shkruajë e të lexojë në gjuhën amtare”.¹⁰⁷ Pra, shqiptarët, edhe pse të vetëdijshëm për qëllimet imperialiste të Vjenës, i shfrytëzuan rrethanat e krijuara dhe brenda një kohe të shkurtër u hapën shumë shkolla në gjuhën shqipe dhe u vendosën shqiptarë nëpër administratat lokale (nëpër komuna dhe rrethe).

Ndër qytetet që i shfrytëzuan këto rrethana ishte edhe vendlindja e Hasanit, Vushtrria. Aty, që në fund të vitit 1915 e gjejmë shkollën shqipe, e cila është ndër të parat në Kosovë. Klubi “Besa Kombëtare”, e udhëhequr nga Hasan Prishtina e Bajram Curri, dërgon Abdullah Hadrin nga Gjakova që të hapë shkollën shqipe në qytetin e lashtë të Vushtrrisë.

Nxënësit e parë të saj kanë qenë:

- 1) Emin Badivuku,
- 2) Musai i Ibrahim Agës,
- 3) Aliu i Latif Agës,
- 4) Fevziu i Mustafë Agës,
- 5) Ferat Ahmet Pika,
- 6) Sylejman Popova (djali i Hysit),
- 7) Maksut Xhafer Muharremi,
- 8) Isaji i Ibrahim Agës,
- 9) Hyzejr Hoti,
- 10) Naim Jahja Bylykemi,

¹⁰⁶) Prof. dr. Hajrullah Koliqi, Shkollat dhe arsimit në Kosovë në vitet 1915-1918, “Shkëndija”, nr. 4, Pr, 1994)

¹⁰⁷) Fazli Hajrizi: Shkolla Normale “Hasan Prishtina” e Mitrovicës- Monografi, Prishtinë, 2007, (f. 263).

- | | |
|-------------------------------------|--------------------------------|
| 11) Abdullah Begu, | 18) Hamdi Zajmi, |
| 12) Besim Zejnullah Begu (Berisha), | 19) Rizai i Latif Agës, |
| 13) Përtej Izet Badivuku, | 20) Qazim Ali Riza, |
| 14) Jakup Hafuz Maxhuni, | 21) Haki Guxha, |
| 15) Alushi i Mahmut Begut, | 22) Sherif Isuf Gara dhe |
| 16) Bahtijar Begu, | 23) Ibush Fanda ¹⁰⁸ |
| 17) Ilijaz Badivuku, | |

Mësuesit e saj të parë ishin Abdullah Hadri nga Gjakova dhe vëllezërit Emin e Tefik Hoti. *“Duke marrë parasysh se Abdullah Hadri kishte mbaruar Shkollën Normale të Beratit e njëkohësisht ishte dërguar nga Klubi “Besa Kombëtare”, u emërua drejtor i shkollës fillore në Vushtrri. Në fillim në këtë shkollë u hapën vetëm paralelet e meshkujve, por më vonë me angazhimin e arsimtarëve dhe të Hasan Prishtinës, është hapur edhe paralelja e femrave”*¹⁰⁹

Pas tre-katër muajsh, po me këta nxënës u formua edhe orkestra-banda muzikore-frymore (*orkestra frymore*) e shkollës, e cila u pagëzua me emrin e Hasan Prishtinës, i cili ishte nismëtar i saj dhe me mjetet e veta bleu veglat muzikore. Në fakt, Hasan Prishtina, i pat dërguar në Vjenë për t'i blerë instrumentet Izet Badivukun, Latif agë Fonden dhe Abit Novolanin.

Të mos harrojmë se ky apostull i arsimit shqip, në të njëjtën kohë, e kishte hapur edhe një shkollë shqipe në Polac të Drenicës, në vatrën e të parëve të vet. Ditën e hapjes së shkollës në Polac mori pjesë edhe orekstra frymore “Hasan Prishtina”. Njëri nga nxënësit më të dalluar të gjeneratës së parë të kësaj shkolle ishte edhe i biri i trimit të madh Hys Popova, Sylejman Popova, i cili i mbante mend shumë momente interesante...

*“Prej lëndëve të cilat i kemi mësuar dhe mësuesit të cilët na i kanë mësuar këto lëndë më kujtohen:”*¹¹⁰

1. *Gjuhë shqipe dhe gramatikë, gjithashtu edhe histori na ligjëronte mësuesi dhe drejtori i shkollës Abdullah Hadri,*
2. *Dija e sendeve, Tefik Smajli, gjermanisht, hungarisht dhe muzikë Shefqeti”.*

Atij i kujtoheshin edhe vizitat që ua bënte Hasan Prishtina sa herë që vinte në Vushtrri, kur ata edhe organizonin manifestime rasti për nder të tij. E tregonte edhe rastin kur nxënësi trupvogël, Nail Haxhiu, doli për të recituar dhe Hasan Prishtina e kishte kapur dhe e kishte ngritur mbi tavolinë për ta parë të gjithë. Është interesant edhe momenti kur, më 1917, kishin shkuar në Mitrovicë për të vizituar Hasan Prishtinën. *“Tërë anëtarët e orkestrës kemi hyrë në shtëpinë e Hasan Prishtinës, e cila në këtë kohë ishte mjaft e madhe, kurse arsimtari hyri brenda në dhomë me disa shokë të tij, ku gjendej Hasan*

¹⁰⁸) Prof. Fahri Buçinca, “Rilindja”, (më 30. X. 1979).

¹⁰⁹) Prof. Fahri Buçinca: Po aty, (f. 327)

¹¹⁰) Prof. dr. Liman Rushiti: “Kujtime për Lëvizjen Kaçake”, Prishtinë, 2003, (f. 67)..

*Prishtina. Gjatë tërë kohës, derisa kemi qenë brenda, ne kemi ekzekutuar dhe kemi kënduar këngë të ndryshme patriotike, të cilat i kemi pasë mësuar. Pas një kohe mjaft të gjatë doli Hasan Prishtina, nga dhoma dhe të gjithëve na përkëdheli dhe na përshëndeti e njëkohësisht u falënderua për zemërsisht për këtë vizitë dhe për gazmendin që ia kishim bërë”.*¹¹¹

Në anën tjetër, as krahun luftarak, nuk e la të pushojë për asnjë çast. Pas shuarjes së dy kryengritjeve dhe depërtimit të forcave serbe thellë në tokat shqiptare, ky atdhetar, edhe pse ishte ministër në Qeverinë e Durrësit, kaloi në Malësinë e Veriut dhe riorganizoi rezistencë të re me dibranët e me lumjanët. Kështu, kur sulmohet Garnizoni serb në Zhur, grupi i drejtuar nga Hasani i këpusin telat (lidhjet) telegrafike e telefonike në malet e Koretnikut.¹¹²

Hasan Prishtina, për t'i treguar edhe njëherë botës së lirë se populli shqiptar kërkon liri dhe bashkim, se asnjëherë nuk është pajtuar dhe nuk do të pajtohet me gjendjen e krijuar në Luftën e Parë Ballkanike, me shokët e idealit dhe me përkrahjen e popullit punoi dhe organizoi edhe kryengritjen e tretë, të cilën drejtpërdrejtë e udhëhoqi vetë, e cila shpërtheu më 12. 2. 1915 në Zhur dhe përnjëherë u përhap në vijën Qafë-Thanë deri në Malësinë e Gjakovës.¹¹³



Orkestra frymore e shkollës shqipe në Vushtrri (1916)

¹¹¹) Grup autorësh: Vushtrria-Vicianë me rrethinë, Po aty, (f.332).

¹¹²) Sheradin Berisha: Kryengritja shqiptare e vitit 1915, Epoka e re, (7 shkurt 2006).

¹¹³) Dr. Liman Rushiti: Rezistenca e popullit shqiptar kundër pushtuesve serbo-malazezë 1912-1914, Kosova nr. 24- 25, Prishtinë, 2003, (f.169).

VITI 1915
KOSHTOVËN E STOLIS ME PETKUN E DITURISË

Në historinë e arsimit të shqiptarëve në Kosovë, veçanërisht në të kaluarën, dallohen disa figura të ndritshme, ndër më meritoret, padyshim ishte, është dhe do të mbesë Hasan Prishtina, pastaj Isa Boletini e Ferat Draga si dhe mësues të nderuar e luftëtar për shkollën kombëtare.

Meqë shkolla e parë shqipe në Koshtovë dhe në Zhabar lidhet me emrin dhe kontributin e Jusuf Rexhës, Shaban Idrizit dhe të Hajrë Haxhisë, pra edhe pse zhvillimi i arsimit në këtë mjedis, puna, rezultatet janë të lidhura me emrat e tyre, jeta dhe veprimtaria e këtyre pishtarëve, thuajse fare nuk është studiuar, as nga historianë e as nga krijuesë që janë marrë me studimet e shkollës shqipe në Kosovë.

Nuk janë marrë ndoshta pse regjimi antipopullor i mbretërisë serbo-kroato-slllovene, por edhe ai sllavokomunist i derivonshëm, duke bërë përpjekje që ta fshijë nga kujtesa e popullit çdo gjë që kishte të bënte me ngjarjet e rëndësishme kombëtare, bënë ç'mos që ta fshijnë nga kujtesa e popullit edhe atë moment të rëndësishëm kur në Koshtovë dhe Zhabar u hapen shkollat e para shqipe dhe Shaban Idrizi e Jusuf Rexha, mësues të respektuar të këtyre fshatrave, filluan të parët të ligjërojnë shqip.



Patrioti Hasan Prishtina



Mësuesi i parë në Koshtovë Jusuf Rexha

Për mësuesin Jusuf Rexha deri më sot nuk është shkruar thuajse asgjë, ose është thënë shumë pak. Këtu mund të thuhet se ai i takon atij grupi të mësuesve të parë trima e të devotshëm, por edhe me fate të rënda në jetën e tyre.

Nga regjimi serb por edhe nga bashkëpunëtorët e tij, Jusufi vazhdimisht është trajtuar si “armik”, por fatbardhësisht, nga bashkëkohësit dhe nga disa nxënës të tij që ende janë gjallë, janë siguruar këto të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e tij.

Jusuf Rexha u lind në Koshtovë në vitin 1890 në një familje me tradita patriotike kombëtare. Babai i tij Shaban Rexha, një burrë që nuk i frikësohej t'i dilte armikut përballë, kishte miqësi me Hasan Prishtinën e Isë Boletinin, me Haxhi Zekën e Ferat Dragën, me Azem Bejtën e Fejzullah Lubovecin e me burra të tjerë të vendit e të kuvendit, të penës e të pushkës. Jusufin e njihnin edhe me emrin Ukë, sepse kështu e kishin thirrur prindërit që nga lindja. U rrit e u burrërua në një familje të madhe e cila gëzonte autoritet të madh në popull. Ishte dhëndër i Fejzullah Liman Lubovecit, për të cilin Hasan Prishtina kishte një respekt të veçantë sepse kishte qëndruar shumë herë në kullën e tij dhe ishte ky që i lidhi në miqësi me Shaban Rexhën. Jusufi urrejtjen kundër armikut, por edhe kundër dhunës e shpërnguljeve do ta kultivojë që nga fëmijëria e tij. Shpeshherë i evokonte kujtimet për Haxhi Zekën, të cilin si fëmijë e kishte dëgjuar tek fliste në odën e burrave; *“Shqipëria përbëhet nga Vilajeti i Shkodrës, i Kosovës, Manastirit dhe Janinës. Këto troje përbëjnë atdheun tonë, të cilin e kemi për detyrë ta mbrojmë...”*



Koshtovë e Bobot, 1915, ndërtesa ku kishte filluar mësimi i parë në gjuhën shqipe

Në një referat të përgatitur nga mësikhënësit e shkollës fillore të Koshtovës, në një nga përvjetorët e mësuesit Jusuf (Ukë) Rexhës, në mars të vitit 1992, hasim në rrëfimin interesant të plakut 104 vjeçar Selim Jashari.

RRËFIMI I PARË

Plaku 104 vjeçar Selim Jashari nga Koshtova e Bobit, mban mend një dialog që ishte zhvilluar në kullën e Shaban Rexhës, ku Hasan Prishtina iu kishte drejtuar koshtovasëve;

- Do t'vjen koha qi edhe këtu për fëmijët tanë do ta hapim shkollën në gjuhën shqype, ku do të mësojnë për historinë e Shqypnisë dhe të popullit shqiptar, - *kishte thënë Hasan Prishtina i cili qëndronte ulur ballë oxhakut të kullës.*

- Po cilët fëmijë do të mësojnë n'atë shkollë, Hasan beg? Po ti nuk... - *kishte pyetur një bashkëmohatar i Hasanit që rrinte ulur te trapazani.*

Në kullë për momentin mbretëronte një qetësi. Hasani, i cili e kuptoi pjesën tjetër të mendimit të pashprehur të bashkëmohatarit të tij iu përgjegj;

- Gjithë djemtë e vashat e Shqypnisë janë bimët e shpirtit e të zemrës sime, or të paça. Edhe Osmani, edhe Selmani, edhe Idrizi, edhe Uka (Jusufi) nuk janë vetëm të Shabanit, po janë edhe të vatanit. Mbasi janë të vatanit janë edhe të mitë, a s'është kështu mixha Shaban? - *iu drejtua Hasan Shaban Rexhës.*

- Të lumtë goja Hasan beg! - *iu pat përgjigjur babai i Jusufit.* Vërtet këta djem kanë lindur në shtëpinë time dhe unë i ushqej me bukë, po ti Hasan, po i ushqen më mirë se unë, po i ushqen me dituri që të bëhen më të vlefshëm në jetë!

- Bashkë do t'i ngrisim për të mirën e atdheut e të popullit tonë. Këta djem do t'i dërgojmë në shkollë që të bëhen dyfish më të vlefshëm. Arsimi është shpirti i kombit, vëllezër... Dhe, Shaban Rexha, i cili e çmonte çdo fjalë të Hasan Prishtinës, i regjistroi në shkollë djemtë e tij.



Shaban Rexha me bashkëfshatarë dhe nxënës në Zasellë, 1927

Atë kohë dihej botërisht se regjimi turk nuk lejonte që të hapeshin shkolla në gjuhën shqipe. Pushteti turk ua mohonte të gjitha të drejtat kombëtare, ua mohonte identitetin, përpiquej me dhunë t'i nënshtronte e t'i asimilonte shqiptarët. Në atë kohë nuk ishin vetëm pushtuesit turq kundër Lëvizjes sonë kombëtare, kundër shkollës shqipe e librave, kundër gazetave dhe kundër shoqërive, por kundër qenies sonë kombëtare ishin dhe vepronin edhe monarkitë ballkanike si Greqia, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, të cilat punonin e përgatiteshin se cila më shumë e cila më parë t'i kafshonin trojet shqiptare.

Jusufi ndoqi mësimet e para në mejtepin e fshatit, por shkollimin nuk do ta ndërprejë me kaq. Tek Rexhep Remziu, ish profesor i gjimnazit (hidadie) të Shkupit, Jusufi nisi t'i mësojë edhe shkronjat e gjuhës shqipe deri në aftësimin e tij për mësimdhënës.

Një ditë vere të vitit 1915, banorët u mblodhën te Dardha e Mirë dhe filluan bisedimet për shkollën shqipe, sepse më herët, Serbia i kishte mbyllur edhe mejtepet e medresetë që kishin plotësuar sadopak arsimimin e shqiptarëve. Në këtë tubim ishin të pranishëm Hasan Prishtina, Isa Boletini e Ferat Draga dhe ishte vendosur për ndërtimin e një shkolle, ku fëmijët e këtyre anëve do të ndiqnin mësimet në gjuhën amtare. Shkolla u vendos që të ndërtohet në vendin Kokol, pikërisht në tokë të Man Bahtirit, i cili e dhuroi truallin e shkollës. Pas kësaj filluan përgatitjet për ndërtimin e shkollës, ku do të plotësohej kërkesa profesionale e shpirtërore e kësaj ane. Ferat Draga i kishte siguruar dërrasat dhe materialin e drurit për ndërtimin e shkollës, kurse Isë Boletini i pagoi mjeshtrit e shpenzimet tjera i hoqi Hasan Prishtina, i cili, siç e thonte plaku Selim Jashari: *“Ky burrë mendjehollë e largpamës e shkriu tërë pasurinë për shkollën shqipe e për vatan”*. Edhe banorët e Koshtovës ndihmuan shumë që ndërtimi i shkollës të përfundojë sa më shpejt. Pusin (bunarin) afër shkollës e hapi Shaban Rexha...



Shkolla e parë shqipe në Kokol, Koshtovë

RRËFIMI I DYTË

Të rinjtë e fshatit kishin dëgjuar se në fshatin e tyre së shpejti do të fillonte shkolla në gjuhën shqipe. Ata mes veti po bisedonin e po pyesnin për shkollën. Biseda po zhvillohej kur Jusufi ishte në mesin e tyre.

- Athua nga do të na vijë mësuesi? Nga Prishtina apo nga Shkupi? -
pyesnin njëri-tjetrin derisa një tjetër thoshte;

- Jo more, ndoshta do të vijë nga Sarajeva ose nga Shqipëria?

- Athua a do të jetë i ashpër mësuesi? - *pyesnin njëri-tjetrin duke u vërejtur në fytyrat e tyre edhe gëzimi edhe pasiguria. Jusufi që po i dëgjonte bashkëmoshatarët e tij, më në fund, edhe pse i skuqur nga fytyra foli;*


- Unë do të jem mësuesi i juaj vëllezër! *Dhe i luti që të mos ia marrin për mburrje. Jusufi e nxori Abetaren që e kishte futur nën xhaketë dhe filloi t'u flasë bashkëmoshatarëve të tij për vlerën e Abetares.*

- Kjo është Abetarja e gjuhës shqipe, vëllezër. Kjo na i mëson shkronjat e gjuhës sonë të ëmbël...

- Na trego ku e more këtë libër, o Ukë?, - *pyeti njëri nga barinjtë që deri atëherë nuk iu kishte dëgjuar zëri.*

- Para disa ditësh ma solli Hasan Prishtina. Ai më vonë do të na sjellë edhe libra të tjerë. *Të rinjtë mbetën gojëhapur nga habia. Të gjithë ishin kureshtarë ta dinin se ç'përmbajtje kishte ai libër i shkruar në gjuhën shqipe.*

- Na lexo se ç'shkruan në faqen e parë të Abetares? - *iu drejtua njëri nga të rinjtë, i cili po e shikonte me admirim.*
Jusufi filloi t'ua lexojë këto të bukura;



Kur mësuesi përfundoi leximin, iu drejtua bashkëfshatarëve me fjalët më të mira që kishte mundur t'i fliste një mësues i posaemëruar prej një figure të madhe të kombit:

- Nesër ejani në shkollë, vëllezër! Lajmëroni edhe fëmijët tjerë! Mos harroni merrni edhe motrat sepse shkolla është dritë e diturisë për të gjithë! Këtë ma ka thënë mua i madhi Hasan Prishtina e unë po ua themë ju e do t'ua them të gjithëve për jetë e mot.

Barinj të mbetën duke u shikuar mes veti, kurse Jusufi vazhdonte:

- Gjuhën tonë të ëmbël duhet ta mësojnë dhe ta shkruajnë edhe motrat tona! *shtoi mësuesi dhe u nis kah shkolla.*

Të nesërmën oborri i shkollës në Kokol u mbush plot me të rinj. Kështu ndodhi, mësuesi i kërkoi dhe i ftoi nxënësit e vet, e ata e gjetën mësuesin në mesin e tyre. Atë ditë kur nisi punën shkolla shqipe në Koshtovë, në Kokol u tubuan shumë njerëz nga të gjitha anët. Aty kishin ardhur edhe vëllezërit nga Rrasa e Malësisë së Gjakovës, nga Zhabari e Çabra, nga Vinarci e Kelmendi... Ajo ditë ishte ditë e shenjtë. Të gëzuar për këtë ditë të madhe një muaj kishte zgjatur manifestimi nëpër odat e fshatit Koshtovë.



Pamje e fshatit Koshtovë e Bobit (2013)

Punës së mësuesit në shkollën e Koshtovës i pari i hyri burrërisht Jusuf Rexha, i cili i mësonte mbi 25 nxënës. Ligjërimin e parë që bëri ishte që t'i përgatiste për jetë nxënësit e tij që ta kultivojnë dashurinë ndaj atdheut, shkollës e prindërve, dashurinë ndaj punës, ndjenjën e dashurisë dhe miqësisë ndaj njëri-tjetrit. Jusufi kishte thithur idetë patriotike nga ideologu e demokriti i shquar Hasan Prishtina, nga myderrizi Rexhep Remziu, nga Ferat Draga dhe nga patriotët tjerë që shpesh vinin në kullën e tyre, të gjitha këto u përpoq që t'i mbjellë tek nxënësit e tij. Shpeshherë u ligjëronte të rinjve se si duhet dashur shkollimin, sepse shkolla u jep pasurinë më të madhe në jetë-diturinë.

RRËFIMI I TRETË

Se Hasan Prishtina e çmonte shumë shkollën dhe mësuesit që jepnin mësim, tregon edhe vetë fakti se si në një odë të fshatit Koshtovë ishin mbledhur shumë burra. Në ballë të oxhakut e kishin ulur si gjithmonë Hasan Prishtinën. Oda ishte mbushur plot me burra. Hasani përshëndetej me ta, por për asnjërin nuk ishte ngritur në këmbë. Kur hyri Jusufi, ai ishte ngritur në këmbë, e përqafoi dhe e uli pranë vetes. Njëri nga pleqtë ishte çudit dhe nuk iu durua pa e pyetur:

- Hasan beg, sa burra erdhën në këtë odë ti nuk luajte vendit, e kur erdhi ky djalë i ri, u çove dhe e rroke ngrykë. Ky është i ri dhe nuk e meriton nderimin tënd kaq të madh!...

- Ky është mësuesi ynë, burra, dhe është duke na i mësuar fëmijët tanë që nesër do të na e shkruajnë historinë tonë kombëtare -*u përgjegj Hasani*.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore Kosova sërish bie nën sundimin e egër të Serbisë. Shqiptarët, të cilët para luftërave ballkanike kishin luftuar kundër regjimit turk për ta fituar lirinë, prapë u detyruan t'i kapin armët edhe kundër Serbisë edhe kundër Austro-Hungarisë. Serbia, e cila po ndiqte një politikë edhe më të vrazhdë se Turqia, jo vetëm që i mbylli shkollat shqipe, por kishte filluar të ushtrojë terror mbi popullatën shqiptare, të cilin popull nuk e përmend asnjëherë si etni me emrin kombëtar, por vetëm herë si popullatë myslimane e herë si pakicë të jugut.

Jusuf Rexha, sikurse edhe mësuesit tjerë të shkollave shqipe, punoi me vetëmohim të madh, i përkushtuar dhe zhvilloi një veprimtari të dendur arsimore duke lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e arsimit dhe të shkollës shqipe. Pushteti serb vërtet e mbylli shkollën shqipe në Koshtovë, por nuk arriti t'ia ndalë hovin e veprimtarisë së Jusufit, i cili nuk u thye e as u përkul asnjëherë nga rruga kombëtare, ashtu siç nuk i harroi asnjëherë këshillat e të madhit Hasan Prishtina. Jusufi u shqua si njeri i dijshtëm, i moralshëm, me ide përparimtare e patriotike, tani u bë njëri ndër kundërshtarët më të rreptë të politikës antishqiptare serbe dhe luftëtari më i shquar në luftimin kundër shpërnguljeve me dhunë të shqiptarëve nga trojet etnike.

Plot tetë vite pasi vritet ideologu i shkollës shqipe dhe i çështjes kombëtare, Hasan Prishtina, Jusuf Rexha i cili kishte jetuar jetën e tij ndërshtëm, burrërisht e shqiptarisht, ndërron jetë dhe sot e asaj dite, vepra e tij edukative e arsimore, personaliteti i tij prej patrioti e atdhetari ka mbetur e pashlyer në kujtesën e popullit që është faqja më reale e historisë sonë kombëtare. Se është kështu, më së miri tregon fakti që: në vitin 1968, kur ishte ndërtuar shkolla e re në Koshtovë (*e që për fat të keq sot është duke u rrënuar*), nga vetë populli doli propozimi anonim që shkolla e fshatit të emërtohet me emrin “Jusuf Rexha”...



*Godina e shkollës shqipe në Koshtovë, e ndërtua në vitin 1968,
Sot ky monument historik me rëndësi të veçantë, është në gjendje jo të mirë!*



Godina e shkollës së re në Koshtovë që u ndërtua në vitin 1984

“...çdo gjë është e qartë, Jusuf Rexha ishte dhe do të mbetet për jetë e mot mësues i popullit, fundja për këtë flet vetë populli”.

PËR HASAN PRISHTINËN

Hasan Prishtina dhe Zejnullah Begu kanë qenë djemtë e dy vëllezërve. Të gjitha kontaktet që i kishte Hasan Prishtina me patriotët e asaj kohe i kishte të mundësuar nga Zejnullah Begu. Zejnullahu ka investuar edhe në armatosjen e trimave për luftë kundër pushtuesve të shumtë të Kosovës.¹¹⁴

Hasan Prishtina, është burgosur më 26 tetor të vitit 1912, nga ushtria okupatore serbe. Ndërkaq, në fillim të vitit 1913, tri qeveritë: ajo e Italisë, Anglisë dhe Austro-Hungarisë me anë të një memorandumit kërkuan në mënyrë ultimative lirin e menjëhershëm të Hasan Prishtinës nga burgu i Kalimegdanit.

Ismail Qemali për Hasan Prishtinën dhe kryengritjet shqiptare
“...Organizimi i ynë më duket sot më i mirë. Shqipëria e Sipërme dhe e Mesme janë të lidhura me një fjalë, e ashtu më shumë se gjysma e Toskërisë, e cila, ndonëse nuk është tundur akoma, prapë nuk do të mbetet mbrapa, në qoftë se nevoja do ta kërkojë. Sot burrat e Kosovës, të Dibrës, të Lumës, të Mirditës, të Malësisë të kryesuar nga më të mirët Atdhetarë po përpiqen për të drejtat e Atdheut, të lidhur bashkë Muhamedanë e të Krishterë. Hasan Prishtina, që ka marrë burrërisht flamurin në dorë bashkë me shumë shokë të tjerë, në këto ditë e fundit i dërgoi Ismail Beut, një letër plot me lajme të mira, e z. Gurakuqi, u poq në Kosovë, me Bajram Begun, i cili punoi ma tepër se kishim shpresë e duke luftuar, doli jashtë që të pijej me neve e të merrnin së bashku vendimet, që kërkojnë nevoja e gjendja e sotshme...”¹¹⁵

Në vitin 1909, hap shkollën e parë shqipe në Drenicë, në vendlindjen e stërgjyshit të tij në Palac të Drenicës. Shkolla kishte filluar punën në plemen e Dan Kerollit.

Hasan Prishtina, në vitin 1913 është kthyer në Shqipëri dhe u ngarkua nga Ismajl Qemali me detyrën e Ministrit të Bujqësisë në Qeverinë Kombëtare të Vlorës. Gjatë Luftës së Parë Botërore ishte kthyer në Kosovë dhe duke shfrytëzuar rrethanat e kohës, nën okupimin e Austro-Hungarisë do të bëhet përsëri promotori i arsimimit të shqiptarëve, duke hapur shumë shkolla anembanë Kosovës.

Në vitin 1915, në Koshtovë të Bobit, hap shkollën shqipe duke e emëruar edhe mësuesin e parë të kësaj ane z. Jusuf Rexha dhe duke sjellë edhe Abetaren e parë në këtë anë.

114) Hakan Berisha, familjari më i afërt i Hasan Prishtinës.

115) Pjesë nga letra e Ismail Qemalit, shkruar më 25 maj 1912, dërguar Pleqësisë së Shoqërisë Shqiptare “Vëllazëria” në Egjipt.

Në vitin 1915 hapi shkollën e parë shqipe edhe në Pantinë të Vushtrrisë, e cila shkollë shënohet si shkolla e parë shqipe në Komunën e Vuçitërnës, kurse më vonë, po në të njëjtën sene, në shtëpinë e tij në Vushtrri, do ta hapë edhe një shkollë shqipe, më pas edhe shkollën e muzikës.¹¹⁶

Nga kujtesa historike e popullit të Vilajetit të kësaj ane vërtetohet se: nga Lugina e fshatit Koshtovë e deri në Zubin Potok ishte pronë-pasuri e Hasan bej Prishtinës, bile në mes Zubçit dhe Uglarit, edhe sot e asaj dite edhe vetë serbët vendorë një vend afër lumit e thërrasin “Begov mlin” Mulliri i Begut (duke kujtuar Hasan bej Prishtinën).

Hasan Prishtina, krahas aktiviteteve të tij kombëtare e atdhetare për çlirimin e trojeve shqiptare të okupuara dhe ribashkimin e tyre në një shtet, asnjëherë nuk ndalojë aktivitetin e vet dhe rrugëtimin drejt arsimit shqip duke hapur shkolla shqipe.

Hasan Prishtina, në mënyrë sekrete, pengonte rekrutimin e shqiptarëve në njësite ushtarake austro-hungareze për t'i dërguar në frontin e Galicisë, kundër Ruisë. Gjatë kësaj kohe bëri përpjekje për të riaktivizuar Lëvizjen Kombëtare edhe në Shkup e rrethinë që ishte pushtuar nga Bullgaria, ku më 1917, u burgos nga policia bullgare. Hasan Prishtina, do ta thejë dritaren e qelisë së burgut duke shpëtuar nga zhdukja e sigurt; në këtë rast do ta lëndojë rëndë njërën këmbë nga e cila do të vuajë shumë kohë.

Me themelimin e Komitetit "*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*" në Shkodër më 1918, të udhëhequr nga Hoxhë Kadriu (1878-1925) u zgjodh anëtar i tij, ndërsa në dhjetor të vitit 1919 Komiteti e ngarkoi si kryetar të delegacionit të tij në Konferencën e Paqes në Paris, ku do të kërkonte bashkimin me shtetin kombëtar shqiptar të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Në këtë Komitet ishin edhe këta atdhetarë të njohur: Bajram Curri, Avni Rustemi, Sali Nivica, Hysni Curri, Bedri Peja, Azem Galica, Elez Isufi, Sotir Peci, Sotir Kolea, etj.

Në veprimtarinë e tij të pashembullt do të ketë pengesa të mëdha, si nga ana e shteteve shoviniste ballkanike: Serbisë, Greqisë, Malit të Zi, Bullgarisë, të përkrahura nga Fuqitë e Mëdha, sidomos nga Rusia e Franca, dhe nga tradhtarët shqiptarë, nga Esat Pashë Toptani, Ahmet Zogu, Ceno beg Kryeziu, e tradhtarë të tjerë.

¹¹⁶) Haxhi Koshtova, arsimtar dhe shënues i kujtesës historike (1970-2013).

Hasan Prishtina ishte një nga promotorët më aktivë në përgatitjen dhe organizimin e Kongresit të Lushnjës 1920 dhe në prill të vitit 1921 ku u zgjodh deputet i Dibrës në Parlamentin shqiptar. Në dhjetor të vitit 1921 kryesoi një ndër qeveritë më demokratike të vendit.

Hasan Prishtina bëhet një nga drejtuesit dhe organizatorët kryesorë të Lëvizjes anti-zogiste të shkurt-marsit 1922. Gjatë viteve 1922 dhe 1923 u shqua si kundërshtar i vendosur i reaksionit të brendshëm. Shquhet si luftëtar për mbrojtjen e "Zonës neutrale" të Junikut nga forcat serbe dhe ato zogiste, si dhe udhëheqës i Lëvizjes nacional-çlirimtare dhe i çetave kryengritëse në Kosovë kundër sundimit serb.

Në shtator të vitit 1924 Hasan Prishtina në krye të një delegacioni, në emër të Komitetit "*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*", shkoi, së bashku me Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, Bajram Currin e Bedri Pejanin në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ku protestoi kundër barbarizmave mbi popullsinë shqiptare të qarqeve shoviniste serbe në Kosovë.

Pas dështimit të revolucionit të 1924-ës u largua jashtë Atdheut. Gjatë tërë kohës në mërgim (1925-1933) qëndroi në krahun më të përparuar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. E vazhdoi luftën kundër regjimeve diktatoriale e monarko-fashiste, kundër tiranisë zogiste në Shqipëri dhe zgjedhës shoviniste serbomadhe në Kosovë.



Ismail Qemali me bashkëveprimtarë

Nën drejtimin e tij u themelua " Komiteti i Çlirimit të Kosovës" i cili veproi jashtë vendit krahas Komitetit të Çlirimit Nacional. Hasan Prishtina luftën çlirimtare në Kosovë u përpoq ta lidhë e ta bashkërendojë me luftën e popujve të shtypur ballkanikë. Disa herë u bë nismëtar i bashkëpunimit me përfaqë-suesit dhe organizatat nacional çlirimtare të Maqedonisë, të Bosnjës, të Kroacisë e të tjerëve që vuanin nën zgjedhën e regjimeve shoviniste të huaja.

Kundër Hasan Prishtinës ishte shpifur, madje edhe shpallur tradhtar nga propaganda e Beogradit dhe regjimi i Ahmet Zogut. Ai e kishte parë rrezikun e Shqipërisë nga Ahmet Zogu dhe klika e tij.

Në gazetën "Ora e Shqipërisë" Vjenë, datë 22 maj 1928 në shkrimin "Deri në vdekje", Hasan Prishtina do të deklaronte: *"...Por në vend të kolltukut me turp në Stamboll preferova kryengritjen me nder në malet e Kosovës. Akuzat, shpifje, kërcënime rreziqe nuk më kanë frikësuar kurrë deri më sot e kundër-shtarët e mijë le të jenë të sigurt se nuk do të më frikësojnë as mbas sodit. Unë, kam një rrugë të caktuar para meje: atë kam shkelë dhe atë do të shkeli deri në vdekje rrugën e independencës ma të plotë të tanë Shqipërisë! Rrugën e tradhëtisë as nuk e kam shkelë as nuk do ta shkeli kurrë edhe pse disave sot po u kande me më quajt publikisht tradhtar! Në kjoftë se këta kanë ngulë syet në personin t'eme tue kujtue se unë trembem prej shpifjeve të tyre e do të ndërroj rrugë, u diftoj kjaras se kanë gabuar adresë. Nderin t'em si njeri e si shqiptar e çmoj, e them me kreni, nuk e le të përlyhet me llumin e shpifjeve. Mue n'iden t'eme patriotike nuk ka mujtë as nuk do të muej me më shtruar ari i të tanë botës, por as mënia e të tanë armiqvet! Ka me më shtruar vetëm vdekja!"*

Hasan Prishtina, kërkonte respektimin e të drejtave kombëtare të të gjithë popujve ballkanikë gjë që do të arrihej sipas tij me krijimin e shteteve kombëtare në bazë të parimit të vetëvendosjes, duke përjashtuar çdo formë të hegjemonisë së pushtuesve serbë, malazez, grekë e bullgarë...



Hasan Prishtina dhe Isa Boletini

NGJARJE:
58 VITE PAS RËNIES SË HASAN PRISHTINËS

Më 26 gusht 1991, në Palac të Drenicës, plot 58 vite pas rënies së atdhetarit Hasan Prishtina, aty ku është trangu familjar i tij, u formua Këshilli për pengimin e shpër-nguljes së shqiptarëve me emrin e patriotit të madh “Hasan Prishtina”, ndërsa më vonë, aktive e nënkëshilla u formuan edhe nëpër të gjitha komunat e Kosovës.



Pamje nga tubimi në Palac, 26 gusht 1991

Popullin shqiptar askush nuk ka mundur e nuk do të mund ta ndjekë nga trojet veta. Nga takimi doli thirrja “Rrini këtu në tokën tuaj!”. Kështu do t’i vihet pikë edhe një qëllimi të errët të Serbisë, e cila me represione të ndryshme po mundohet ta realizojë edhe një qëllim barbar të vetin. Tubimin madhështor në Palac e hapi Ramiz Veliqi, pastaj fjalën e mori Dr. Hakif Bajrami, i cili duke folur për veprimtarinë dhe shembëlltyrën e patriotit të madh Hasan Prishtina theksoi: *“Hasani duke luftuar për kauzën kombëtare dhe pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve ishte halë në sy jo vetëm eserbomëdhenjve por edhe të agjenturave evropiane. Në veprimtarinë e tij të frytshme ai u angazhua e dha çdo gjë për ndërprerjen e shpërnguljes së shqiptarëve. Andaj duke respektuar veprën e tij po e nisim këtë aksion të madh gjithëshqiptar e gjithë popullor mu nga Palaci i tij. Hasan Prishtina diti ta bashkojë kombëtarën, fetaren dhe regjionalen, diti të bashkojë popullin. Zëri i Hasan Prishtinës jehoi larg, ky zë jehon edhe sot, sepse ai është i gjallë në zemrat tona”*.¹¹⁷

117) Behram Hoti e Xhavit Qitaku: “Rrini këtu në tokën tuaj!”, Bujku, 26 gusht 1991.

FOTOALBUM



Zejnullah begu dhe Hasan Prishtina



Medaljet e Hasan Prishtinës



Medaljet e Hasan Prishtinës, Zejmullah Begut dhe Hakan Berishës



Zejnullah Begu me bashkëveprimtarët e tij



Fotografuar në Balincë, më 23. 10. 1903

Ulur Zejnullah Begu, nga e djathta: Haxhi Gjelo Maxhuni, Sulejmani, Jusuf Venhari, Muharrem Qallpani, Izet Badivuku, Kahriman Deliosmani



Gjylizari, gruaja e Zejnullah begut (ulur në mes), Qemajli (ulur nga e djathta), Ismeti (në këmbë nga e djathta), Abdullahu (ulur nga e majta), Besimi (në këmbë nga e majta), Shukrija dhe Nazirja (në mes), Leman (në të majtë), Hakani (në të djathtë) dhe Mazes, vajza e Qemalit (në të djathtë)



Familja e Zejnullah Begut



Hasan Prishtina



Ismeti me bashkëshorten Remzije dhe vajzën Leman



Hakan Berisha me delegacion për 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, Tiranë, 1978



Rexhep Veliqi




Zeqir Rexhep Veliqi



Hamami i Mitrovicës, tani pronë e Hakan Berishës, nipit të Zejnullah begut



Hakan Berisha, Tiranë, 1978



Hakan Berisha me autorin (2013)



Autori i librit me Hakan Berishen, nipin e Zejnullah Begut



Në odën e Zeqir Rexhep Veliqit, Palac, 2013



Në odën e Bilall Kocit, Palac, 2013



Behram Feka nga Koshtova e Bobit me autorin e librit



Zenel Ahmeti, Bekim Asllani dhe autori i librit



Gjatë grumbullimit të shënimeve në Mitrovicë të Hakan Berisha



Gjatë një konsultimi me Istref Veliun për ribotimin e librit - 2020

NË VEND TË EPILOGUT

FIGURA E NDRITUR E HASAN PRISHTINËS, PASTHIRRMA E ZËSHME E KOMBIT NË MBIJETESË, QË SOT KËRKON DIMENSIONET E REJA TË KOHËS QË JETOJMË

Shumë kohë do të kalojë, dekada e shekuj, por Historia e Popullit Shqiptar, e shkruar me gjak e heroizëm, do të marrë dimensione më të mëdha, falë njerëzve të mëdhenj që janë përfshirë brenda hapësirave të saj të ndritura e të pamata. Sa më shumë do të kalojë koha, aq më shumë këto figura të mëdha kombëtare do të marrin dimensione të reja, më të gjera, më të fuqishme dhe do të rrezatojnë për brezat që do të vijnë idetë reale të kohës, vlerat e pazëvendësueshme të sakrificave njerëzore, duke dhënë dimensionin e ri të ardhmërisë së Kombit Shqiptar.

Kjo kohë e artë, e pasqyruar në mënyrë dinjitoze, me nuancat e vlerave të kohës, me pasthirmën e zëshme të një Kombi në mbijetesë, që u përball me shfarosjen dhe gjakosjen deri në kufijtë e Holokaustit, do t'i bëjë “gjëmën” gjithçkaje që u shrua dhe u ngrit me dinakëri mbrapsht, gjithçkaje të grabitur dhe tjetërsuar, gjithçkaje që ka lidhje me deformimet e gjenezës sonë dhe që sot nuk është në vendin e vet.

Penat e ndritura të kohëve kanë lëvruar hapësirat e pamata të kësaj historie kaq pjellore, duke na sjellë të freskët madhështinë e burrave që dhanë gjithçka për çështjen kombëtare, për lirinë, pavarësinë dhe në shërbim të bashkimit tonë kombëtar. Ata shkrinë jetën dhe pasurinë e tyre, të bindur se po i kthenin nderin tokës që i lindi dhe i rriti, si dielli, ajri dhe uji për jetën. Ata bënë gjithçka dhe ngritën lart vlerat e gjenezës së tyre të ndritur.

E tillë është përmbledhja monografike e autorit Dibran Fylli, për figurën e ndritur të birit të Kosovës dhe të Shqipërisë, Hasan Prishtinës, mikut dhe bashkëpunëtorit të ngushtë të: Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit, Isa Boletinit, Bajram Currit e dhjetra atdhetarëve të tjerë, që vunë themelet e Pavarësisë Kombëtare në një kohë shumë të vështirë.

Ismail Qemali u përfshi në Lëvizjen Kombëtare si një figurë autoritare, kombëtare, rreth të cilit do të bashkoheshin shtresat e gjera shoqërore në të gjithë hapësirën shqiptare dhe në elitën e jetës social-politike të vilajeteve shqiptare.

Kush i priu proceseve të pavarësisë të Shqipërisë?

Ky burrë ishte pika e referimit brenda elitës shqiptare në drejtimin e Perandorisë Osmane, një personalitet i madh i jetës politike të Stambollit, me një karrierë të shkëlqyer, që në kushtet e krizës që kishte mbërthyer perandorinë në shuarje, diti të kuptonte dhe të kapte momentin e pavarësisë të trojeve shqiptare në një shtet të pavarur.

Rreth kësaj figure madhore reformuese, u grumbulluan atdhetarët e vërtetë nga të gjithë trojet shqiptare. Midis tyre, një vend mjaft të dukshëm, në krah të Ismail Vlorës, u gjend Hasan Prishtina, një atdhetar i shquar, një luftëtar i madh i pavarësisë, një ideator i madh i bashkimit kombëtar, veprimtar në terrenin konkret në lëvizjen atdhetare, me energji dhe aftësi të mëdha organizative zbatuese, që falë këtyre aftësive, diti të dalë në krye të lëvizjes për çlirim kombëtar në vilajetin e Shkupit.

Cili ishte koncepti themelor prej nga udhëhiqej Hasan Prishtina?

Ai gjykonte që qendra ku do të bashkohej shteti shqiptar dhe kryeqyteti i tij do të ishte Shkupi, si qendra më luftarake, në fillim për të fituar autonominë e plotë nga perandoria, e në ardhmëri, për pavarësinë e vendit. Kjo nuk do të thotë se Hasan Prishtina, ky politikan mendjemprehtë e mendonte procesin të veçuar nga lëvizja e madhe atdhetare në tërë hapësirën shqiptare. Ai mendonte se vatra e lëvizjes do të ishte në Shkup dhe zjarri i luftës për çlirim kombëtar do të përhapej në tërë hapësirën shqiptare.

Pas viti 1912, ai nuk u pajtua kurrë me copëtimin e trojeve shqiptare. Bashkë me disa atdhetarë të tjerë, bashkë me Hoxhë Kadri Prishtinën organizuan “Irredentën” shqiptare në Kosovë, me objekt që të ndërgjegjësonin hap pas hapi popullin shqiptar në Kosovë për një kryengritje të armatosur, me synimin për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Por në mjedisin e atëhershëm shqiptar, fatkeqësisht jo të gjithë faktorët ishin përkrah kësaj lëvizje. Dora e Pashiqit godiste dhe intrigonte edhe në Shqipëri. Irredenta u gjend nën goditje të dyfishta. Megjithatë, me energji shumë të mëdha, me një këmë-ngulje tipike shqiptare, Hasan Prishtina e vazhdoi veprimtarinë politike, duke arritur të marrë edhe drejtimin e qeverisë së shtetit shqiptar, duke shpалosur në programin e tij edhe mbështetjen e gjithanshme për bashkimin e trojeve shqiptare me shtetin amë. Kjo shkaktoi tronditje në qarqet antishqiptare, të nxitura edhe nga faktori ndërkombëtar.

Segmentet reaksionare e detyruan të jap dorëheqjen, por kurrë nuk mund ta detyronin atdhetarin e dëshmuar të hiqte dorë nga misioni i tij historik, për të cilin ai ishte angazhuar me një idealizëm të jashtëzakonshëm.

Nuk kishte rrugë dhe mjet tjetër për ta ndalur, veçse në mënyrë tradhtare e të pabesë, duke e asgjësuar Hasan Prishtinën fizikisht. Ahmet Zogu, ky misionar i antishqiptarizmit, pasi grumbulloi një pushtet të pakufizuar me ndihmën e Serbisë dhe të bjello-gardistëve, si shpërblim për këtë, organizoi vrasjen në Selanik në vitin 1933, të këtij tribuni të madh popullor, së bashku me likuidimin që u bëri atdhetarëve të tjerë të mëdhënj si: Avni Rustemi, Luigj Gurakuqi dhe Bajram Curri.

Është ironi e hidhur e fatit dhe e realitetit që i njëjti subjekt politik t'i ngrejë edhe kriminelit edhe viktimave të tij, në të njëjtën kohë, monumente përkujtimore. Edhe një herë, kjo tregon krizën dhe konfliktualitetin e madh të gjithanshëm moral, që sot ka përfshirë politikën dhe shoqërinë shqiptare. Reagimi për këtë poshtërsi është i ashpër edhe në këtë botim, nga njerëzit e trungjeve fisnore që kanë qenë afër Hasan Prishtinës.

Por historia kurrë nuk harron. Këta abuzues dhe idhujt e tyre të hershëm, janë kalimtarë në Historinë e Popullit Shqiptar. Figura si Hasan Prishtina, e kanë monumentin të palëkundshëm në zemrat e shqiptarëve. Të tjerët janë produkt i konjunkturave politike. Hasan Prishtina e ka monumentin në trungun e jetës të vullnetit të lirë të popullit atdhetar dhe demokrat dhe ai kurrë nuk do ta pranonte “pajtimin” e turpshëm me pinjollët e kriminelëve.

Kjo figurë shumdimensionale merr përherë vlera me kohën dhe mësimet e këtij njeriu të madh, sot kanë rëndësi shumë të madhe në përjetimet aktuale të çështjes kombëtare. Hasan Prishtina nuk do t'i pranonte lëshimet politike, nuk do të pranonte përkuljen politike, ai do të tregonte mençurinë dhe forcën e shpirtit dhe të zemrës së tij, e cila deri në momentin e fundit punoi në shërbim të shqiptarisë.

*Tiranë,
1 maj 2013*

*Dr. Sulejman ABAZI
(NESHAJ)*



AI QË SHKRUAN PËR HASAN PRISHTINËN DINË TË DREJTOJË
KOMBIN NË RRESHTIMIN E HISTORISË SEPSE KA PËR STUDIM
NJË HERO EMBLEMATIK

Akademik Dibran Fylli, HASAN PRISHTINA, Prishtinë (2017/2020)

Filozofia e Hasan Prishtinës në veten e parë shumë!

“Kur mbante mbledhje Parlamenti turk, atje haptas i njoftova: nëse nuk plotësohen kërkesat tona, do të shpërthejë revolucioni. Dhe, ndër të parët që do ta kapë armën, do të jem unë. Si shenjë se ka filluar kryengritja do të jetë: “Kur t’i mbathi Qpingat, do të dal në Drenicë. Dhe e mbajta fjalën...”.

“Dasha gjakun ilir, nuk ka jetë dhe fat për ne, pa u çlirue nga të huejt dhe pa u bashkue teritorët shqiptarë”!-

“Gjendja e rëndë dhe dëshpëruese e shqiptarëve, të cilët jetojnë në Jugosllavi më detyroi që sërish t’i drejtohem Lidhjes së kombeve me lutje që të marrin masa për ndihmë për një popull të terrorizuem..”

“Derisa Jugosllavia në mënyrë paqësore nuk e pranon Ridefinimin e Kufijve, me çka shqiptarët do të kenë mundësi t’i kthejnë teritorët që i takojnë, ata nuk do të jenë të kënaçun me formimin e shtetit shqiptar me kufijtë e vitit 1912”.

“Krugën e tradhtisë as e kam shkelë e as që do ta shkeli ndonjëherë, Mue nga ideologjia ime patriotike nuk mund të më largojë as ari i gjithë kësaj bote, as mallkimet e të gjithë anmiqëve”.

“Vëllazën! Kosovën dhe të gjitha tokat shqiptare do t’i çlirojmë, do t’i bashkojmë dhe vetë do t’i qeverisim kah një ardhmëni e lumtun. Evropa dhe fqijët nga ne kërkojnë që atdheun ta trajtojmë si mall tregtar. JO, asnjëherë”!

“E sollëm alfebetin dhe hapëm disa shkolla. Disa fëmijë të Kosobës ia dërgova Luigjit (Gurakuqit-hb) në shkollën e mësuesisë në Elbasan. E tanë pasunia m’u shkri për hapjen s shkollave në gjuhën shqipe”!

“Do ta luftojmë kolonizimin e Kosobës me sllavë, do ta luftojmë shpërngujen e shqiptarëve në Anadoll. Nuk do të pajtohemi me asnjë padrejtësi, pa e la me gjak tokën tonë Ilire. Trojet tona nuk janë monedhë tregu qoftë nga tradhtarët, qoftë nga të huejtë”!.

Hasan Prishtina

Vlerësim ndryshe nga ata që shndërrohen në lojë fjalësh, sepse autori dhe titulli shtjellues janë shumë të posaçëm, për vogëlsinë time.

Nëse shkruan për Hasan Prishtinë, duke u pasuruar me dokumente, qofshin ato për apo kundër tij, aty fiton bindjen se prej tij mëson filozofi urtie. Së këndejmi, për dallim nga BIOGRAFITË tjera, ku ka edhe skajshmëri politike, dhe dështime shkencore, zakonisht të padokumentuara, Akademik Dibran Fylli, si shkrimtar që e njeh “fijet e holla” të etnopsikologjisë popullore, ka dëshmuar se edhe politika mund të humanizohet, nëse i qasësh me urti gnosologjike dhe dashuri objektive, sepse ke kënd ta nderosh si persoanlitet emblemantik.

Në fillim të këtij shkrimi recensial, jam i obliguar të theksojë se më 1973 e kisha të lejuar për temë të magjistraturës Hasan Prishtinën. Nuk isha i vetëdijshëm se me çfarë temë isha kacafytur. Kisha lexuar një monografi që aspironte këtë njeri ta rreshtojë në revolucionar dhe patriot. Nuk kishte studim monografik tjetër pra përpos ai i Ajet Haxhiut, Hasan Prishtina, Tiranë 1964. Po edhe në këtë monografi, kisha informata se është thënë vetëm nja 25 % të veprimtarisë së Hasanit kryengritës, orator, mecenë dhe themeltar i arsimimit shqip të fëmijëve shqiptar, madje dhe largpamës. Po, e dija se Hasani është dënuar me vdekje disa herë: nga xhonturqit, nga serbët, nga “jugosllavët”. E kisha pranuar me entuziazëm temën, sepse askush nuk e dinte se më 1912 Hasan Prishtina kishte qenë në Llap, në pikën kufitare të Përpellacit dhe Merdarit tri herë, për ta përgatitë shqiptarinë për kryengritje, dhe pastaj, për mbrojtje të tokave shqiptare, nga okupimi serb. Atë fjalim të “Hasan Begut te vendi “Dushku i Fushës”, të vjetrit e dinin sikur ta kishin incizuar. E kisha të shënuar çdo detal, të shprehur aty. Po, e kisha atë fat që të mësojë prej tyre se ku ishim në rrafshin kombëtar në ato rrethana kur po ndryshonin epokat historike. E kisha mësuar edhe një “tragjedi” se jo vetëm Fallanga Ballkanike por edhe gjashtë Fuqitë e Evropës (Anglia, Franca, Rusia me një anë dhe Gjermania, Austro Hungaria dhe Italia) luftën shqiptare e kishin akuzuar se “Arnautët po luftojnë për t`ia zgjatë turkut jetën në Evropë”. E nuk ishte ashtu. Ky “zanat” i masonerisë evropiane do të na akuzojë më 1918-1924 se “po luftojmë për ta mbrojtur Austro Hungarinë”, e nuk ishte ashtu. Edhe më 1944/45 Jugosllavët dhe aleatët e tyre do të na akuzojnë se: “po luftojmë për ta ndihmuar nazizmin gjerman”, e nuk ishte ashtu. Edhe më 1989-1999 do të na akuzojnë (natyrisht me metamorfoza-hb) se “jemi Ushtri terroriste”, e në të gjitha etapat doli në fund se nuk ishte ashtu. Pra Hasan Prishtina, të zbërthehet: pse ka luftuar, do ta kuptojë i tërë civilizimi botëror se luftën çlirimtare e kemi bërë me kohë dhe pa vonesë, por jemi gjykuar para kohe dhe kemi pësuar gjatë saj me dekada si Kosovë martire dhe fatmurge, siç thot Dr Xheladin Deda më 1913, kur ai ishte si student.

Pas katër muaj leximesh dhe hulumtimesh arkivore, edhe pse e aprovuar, tema Hasan Prishtina, mu refuzua sepse nga Tirana erdhi “haberi”: “Se nuk duhet të shkruhet më shumë se Ajet Haxhiu për Hasan Begun”. Nuk reagoja dhe tani (2019) mund të them se për Hasan Prishtinë janë shkruar gjashtë monografi. Kjo e Dibran Fyllit është e veçantë. Për çka. Sepse sjellë të dhëna të trungut dhe urtisë jo vetëm të një familje, por edhe të një NAHIE-DRENICA kokëllartë gjithmonë. Dibrani sjell dhe episode të zhvillimit familjar, sepse sjellë histori të mjaftuar që prodhon histori të re, për t’u bindur se kemi të panjohura shumë më tepër, pra kemi histori që na mungon sepse nuk e njohim, sepse shkencës që quhet MËSUESE E JETËS, iu kemi ngjitur për ta ndihmuar me kuadro që prej saj kanë provuar të benefitojnë, të përfitojnë financiarisht. E kur Historia të peshohet me “vlerë të shtuar” atëherë atij që e kultivon duhet të dihet se i “ka humbur rruga në oborr”. Dha ZOTI dhe prej Rrugës së humbur na nxori ADEM JASHARI dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Megjithë këtë, dikush që e ka sabotuar po mundohet për çdo ditë më ia shpronësuar kreditin dhe vlerën. Keni këtë vërejtje në kujtesë shqiptarë!

E di gjatë këtyre 40 vjet hulumtimesh nëpër arkiva, se si është trajtuar Hasani në Londër, në Paris, në Vjenë e Romë, por më tepër e di se si është programuar që Hasani të vritet nga nëntoka e Moskës, Athinës, Stambollit, e mbi të gjitha nga mafia masone e Beograd dhe e Tiranës deri në disa segmente deri më 1962. E di, se më 1962 dhe 1983 KRYEHEROIT të Kosovës (Hasan Prishtinës) i është “ngulë” në biografi një “tradhti” e cila ka jetuar në kokat e studentëve dhe hulumtuesve shkencor, deri më 2002, e që ka pasur për qëllim që të mbetet si e “VËRTETË” se: *“Hasan Beg Prishtina më 28 XI 1912 ka mbajtur fjalim në Parlamentin e Turqisë”*. Ishte ky një sajim intrigë e shekullit, që vetëm “kominternistët” lindor dhe “makivelsitët” perëndimor dinin ta thurin dhe trillojnë. Nuk kisha rrugë tjetër, përpos që ta hulumtojë detalisht se ku kishte qenë Hasani më 28 XI 1912. Këtë detyrë ia kisha shtruar veti më 1975. E demantova nuk e demonatova me fakte, njerëzit e “niveleve” kishin krijuar bindje se vërtetë “Hasani i kishte dy fytyra, një për komb, e tjetër për t’i shërbyer Anadollakut”. Kjo e dyta ishte akuzë e rëndë dhe nuk e kam besuar kurrë. Lidhur me këtë, kurrë në jetë, edhe po t’i shkruaj edhe 100 libra, nuk do të gëzohesha më tepër kur u botua demanti im dhe Hasan Prishtina doli i DLIRË, patriot dhe i pathyeshëm, sepse na duhej një dritëdhënës i tillë.

Po, me fakte u vërtetua se Hasan Prishtina më 6 nëntor 1912, është arrestuar në Shkup nga okupatori serb, dhe menjëherë është transferuar në burgun e Beogradit në Kalemegdan. Madje, publikisht, pas atij shkrimi, Bac Adem Dema e shpalli se është nxënës i Hasan Prishtinës.

Po këtu, nuk është kulmi. Në librin studimor etnografik dhe socio-kulturor dhe politikohistorik të Akademik Dibran Fyllit, Hasan Prishtina,

mësojmë risi të detalit dhe të tërësisë, që rrëfejnë në veten e parë shumë, sepse Hasani (për këtë shkruan Dibrani) duhet të bëhet Abetare e popullit: i pa shibla, luftëtar, i thjeshtë, e i paepur, trim dhe liberator kryengritës dhe ideator shteti për krijimin e shtetit shqiptar, por i ndjekur dhe i sharë e urrejtur deri në vdekje, pasi që AI do të luftojë deri në vdekje, për një kauzë të drejtë. E atë kauzë Dibrani Fylli e kupton si një ujë që rrjedh prej kroit në gojë të barinjve arbëror, të cilët Hasani i ngritë në luftëtarë më 1910, më 1912, më 1915, më 1919- deri në vdekje, të gjithë në kryetrima nga Kulina e në Crarralevë, nga Kaçaniku e në Shkup, nga Shkupi e deri në Junik e Drenicë, por kurrë nuk mendoi që të krijojë liri për shqiptarë e robëri për të tjerët. JO, Hasani lirinë sipas fakteve të Dibrani Fyllit e kupton si mall i përbërë nga ajri, i cili i ushqen të gjitha gjallesat- njësoj, sa kanë nevojë, aq ka leje të konsumojë, por pa e dëmtuar tjetrin që nuk është as i kombit, as i religjionit e as i racës së Hasanit legjendar, si soj i arbërit të moçëm.

Për Hasanin janë shkruar studime biografike interne shtetërore, që nuk janë botuar kurrë, por u kanë shërbyer profesionalistëve shtetëror për të mësuar politikë dhe filozofi Hegeliane. Po, janë shkruar 11 biografi interene shtetërore në Serbi nëpër kohë të ndryshme, 2 biografi janë shkruar në Francë, 3 në Rusi, 3 në Turqi, 2 në Bullgari, 4 në Vjenë, 3 në Itali, 2 në Greqi-të gjitha shënojnë një emërues të përbashkët në prapaskenë se: Kombi i Hasanit dhe Hasani nuk duhet lejuar si BINOM të ketë shtet, mu pse Hasani luftonte në çdo etapë për komb dhe shtet etnik, më të katër vilajetet” në NJË, për çka TAPI e kishte shtrirjen e shqiptarisë dhe përqindja e saj në jetë den baba den Autokton. E vërteta për Hasan Prishtinën, kush jetonte në hapësirën jetësore shqiptare duhej të ishte “milet” (qytetar) i lirë dhe sovran. E kjo shkollë ka vrarë larg synimet imperialsite të fqinjëve. Për këtë fakt guximi i Akademik Dibrani Fyllit, që të shkruaj edhe ky monografi për Hasanin e kuptoi se ky shkrimtar akademik, do të na thotë diçka më tepër se të tjerët, sepse dinë të bëjë film për dallim prej autorëve tjerë, sepse është shkrimtar e shkrimtari hynë më thellë në limfatë e kombit se sa çdo historian. E filmi dhe romani historik, ka një botë tjetër që peshon në argumente, peshon në libra të shkruara, por Dibrani është me dituri që dinë të bëjë edhe libër HISTORIK, si në rastin konkret, por dinë të bëjë edhe film dhe drama që pasqyrojnë imtësitë e jetës në çdo grimcë të saj. Të dy obligimet Akademik Dibrani i kryen në të njëjtën kohë, sepse publikimi shoqërohet edhe me një DVD-film dokumentar, që kurdoherë mund të lexohet Hasani si në pasqyrë, madje duke dëgjuar edhe nëse je i verbër. Psikolog është Akademik Dibrani Fylli, është ai që ia dinë hallet çdo krijese të gjallë, sepse është shkrimtar i mirëfilltë.

Akademik Dibrani Fylli shkruan me një stil të rrjedhshëm se si Hasan Prishtina ishte i përkushtuar që të digjet si qiri, për t`u siguruar shqiptarëve

arsimim, sepse kombi kishte sharruar thellë në padituri, prej kah vijnë pasojat e mjerimi dhe robëria bëhet dyfish më e egër. Lidhur me këtë Akademik Dibran Fylli e studion Hasanin edhe në fushën e ndikimit ontologjik dhe etnologjik, madje historiko civilizues në stilin e filozofisë racionaliste “Cogito ergo sum” (Mendoj pra jam!) për të nxjerr prej veprës Hasanit një aksiomë jetësore dhe politike kombëtare tjetër, sepse Hasani në politikën shqiptare është si HEGELI në filozofinë botërore, por shumë më të thellë dhe më revolucionar, më pregnant sepse zbulohet me lufta dhe argumente duke pohuar: **mendoj, flas, punoi, pra jam këtu SHQIPTAR, me TAPI**. Ky nivel filozofik i të menduarit ka një porosi edhe më të thellë humanitare, ka një kërkesë plebiscitare popullore që me punë fizike dhe djersë intelektuale të nxirret kombi nga gremina e prapambeturisë, të nxirret kombi i rreshtuar pa hezitim dhe duke e përplasë dilemën që ishte ngulitur te disa “turkoshakë” dhe hafie në favor të serbit, grekut, turkut e italianit, austriakut e rusit, të cilët si në orkestër po luftonin “nën tavolinë”, që shqiptarizmin ta shfarosin për njëherë ose në tapa. E këtë synim Hasan Prishtina e kishte mësuar si i pari ndër të parët, prandaj ishte “krushku i parë kryengritës në çdo etapë historike”, si e quante Fan Stilan-Noli. Hasani në veprën e Akademik Dibranit na del se e njihte në TRI RRAFSHE çështjen shqiptare: e njihte në gjerësi, në lartësi dhe në gjatësi, pse të cilave kombi nuk guxon të lodhët, sepse çdo rrugë i ka ngatërresat e veta. E këtë faktorin e fundit (gjatësinë e luftës), për ta mbajtur luftën për Hasanin, shqiptarët e kishin dobësinë më të madhe, sepse shqiptarët kryengritës po, por ushtri të rregullt nuk kishin. Prandaj me luftë speciale për një javë e tri ditë, mendonin se vuloset fati i luftës (fitores ose humbjes sikurse në Mesjetë! E koha e shpatës kishte mbaruar në pakthim-hb). Këtë plagë shqiptare Hasani e kishte studiuar me vite dhe pa krijimin e shtetit nuk kishte gjetë “**derman**” se do të dali në krijimin e fitores faqebardhë. Por në bazë të biografive sekrete, Hasani e dinte se shqiptarët nuk kanë shansë ma të i ktheheshin prapa, duke i konvertuar me premtime në tarafe humbëse, sepse as krishterimi nuk ishte pranuar në shekullin e parë të Erës sonë, me aq zemërgjerësi. Sepse Hasani do të konstatoi se në mes shqiptarëve të krishterë (Ortodoks e katolikë) kishte pasur më shumë kokë qarje dhe mosdurim se sa në mes të krishterëve së bashku dhe myslimanëve, tërësisht. E as islamizimi nuk ishte përqaftuar si metabolizëm që krijon favore pa e “përtypur ushqimin”. E Evropa, sipas dokumenteve që ende nuk janë plasuar në publik për Hasanin dhe Epokën e tij, e kishte një projekt, atë të **Hamjakovit**, që të frymoi në çdo cep të saj si e krishterë, pa marrë parasysh se Roma dhe Konstandinopoja ishin në luftë të heshtur, por të pa përfunduar. Dhe lufta “kryqzatë”, mbeti e pa përfunduar në mes Osmanlisë dhe Evropës, për t’ia fakturuar dhe përplasur me shpërngulje, shpronsim dhe shfarosje tërë masoneria “kryqzatë”.

Kombit shqiptarë gjatë shekullit XIX dhe XX-të, tërë atë hasmëri mileniumesh (476-1354 e tutje deri më 1923), viset shqiptare mund të quhen si thotë Akademik Dibrani “tokë e mbjellë me varre”. Hasan Prishtina e kishte mësuar “këtë peshë që ia then kurrizin çdo populli” qysh në studime e në shumë takime pastaj, me të huaj (evropian e aziatikë). Hasani e kishte hetuar këtë synim dhe ua thoshte në sy të gjithëve, ua përplaste në fytyrë të gjithë ambasadorëve në Stamboll dhe mu për këtë u shkruan aq “aktakuza” e gjykime në mungesë se: “Komb që ka pranuar islamin në Evropë është mundim për juve, që ta toleroni e lëre ma të prosperojë si i tillë në “kopshtin e juaj të marrëzive të inkvizicionit dhe territ inkludiv” të Perëndimit kur të u duhet ta akuzoni dhe të lindjes kur keni nevojë ta vrisni shqiptarin në stilin që e zbatuan sllavët pastaj gati për një shekull: - “*Hyp se të vrava, zbrit se të vrava*”. Prandaj keni vendosur që ta luftoni e shkallmoni nga çdo anë shqiptarinë, do të shpërthej Hasani më 1913, si po e masakroni sot duke e deportuar me 395 anije në Anadoll. E një ditë kur të zbardhën pamjet, do të turpërohet Evropa se u kënaqën peshkaqenët nëpër Mesdhe duke gëlltitur shqiptarë fatmejrë-1914”. Kështu që dënimi i Hasanit për tetë herë me vdekje (*nga të dy krahët Perëndim - Lindje*), nuk ka qenë i pa patentë nga gjashtë fuqitë evropiane (*Anglia, Franca, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia*). (*shiko: Karikaturën e gomarit “Albani” që më 1913, theret nga çdo anë me bajoneta të këtyre fuqive, plus fqinjëve që therin me ndonjë çaki të ndryshkur!*)

Biografia e Hasan Prishtinës pra nuk është studim i rëndomtë, por bartë me veti një Epokë historike që po vdiste dhe një Erë të re që po lëshonte shtat dhe po maturohej si lulet e pranverës. E themi këtë sepse kombi shqiptar më 1913/1914 u nda në shumë pjesë. Por u themelua, do të bindet Hasani, një Shqipëri Bregdetare dhe një Shqipëri Kontinentale me vetëdije më të lartë se ndarja ka qenë më vullkanike se sa bashkimi që do të na vente në gjumë triumfalisht me plotë turkoshakë që kishin mbetë me sy kah Anadoll dhe dilingji që frekuentoni n'kryeqendrat e fqinjëve dhe atje bymeheshin me “kafe dhe para” sa që maratona pas tre flamujve për ta ishte pak, sepse në secilin flamur xhepi ishte më i fryrë. Me gjithë fryrjet Kombi mbeti në ***shpresë se një ditë qoftë edhe me vargoj gjaku do t`i tuboi zogjtë në një fole***.

E pse mos të lind një Azem Bejtë, Nazim Gafurr, Emin Durak, Shaban Polluzhë, Adem Demë, Adem Jashar, që atë shpresë ta plasojë aty ku duhet në zemrat e djalërisë, që e kthejnë beharin e pranverës, e realizojnë lirim dhe ia sigurojnë Tapinë Dardanisë së Hasan Prishtinës. Me libra për Hasanin, vendit i shtohet nga një tapi shtesë, sikur shtyllat e gardhit arbëror, që mos të lakohet kurrë.

Me Hasanin të huajt nuk mund të luanin, sepse i kishte informatat. Lidhur me karakterin e të qenurit deputet në Parlamentin turk (1908-1912),

Hasani i shfajëson të gjithë ata që vijnë pas tij e që ishin deputetë në një parlament të Okupatorit, por me një kusht, që të ia bëjnë me dije në çdo çast se liria e shqiptarit ka çmim. E sa i takon Luftës parë Ballkanike, Hasani do të shpërthej para Arqibad Rjasit dhe Llav Trockit, që ishin doajen të gazetarisë evropiane në Ballkan se:

“Të gjithë oficerët e lartë në Luftën ballkanike ishin nga fuqitë evropiane, nuk ishin as serb, as montegrinë, as bullgarë e as grekë. Këtë fakt ne e dijme fare mirë”. Dhe kur jemi te ky fakt, kur jemi të përkushtimi i juaj për liri dhe civilizim, atëherë pse nuk na ndihmuat neve shqiptarëve kur e çliruam Vilajetin e Kosovës deri më 26 gusht 1912, dhe synuam të ia mësyjmë Vilajetit të Manastirit, drejtë Selanikut pastaj, Ju erdhët në Shkup dhe na konfirmuat se; - “Çfarëdo rezultati të ketë lufta juaj, ndryshim të kufijve të Perandorisë Osmane nuk ka (!!!). E pse lejuat ndryshim të kufijve pas dy muajve (?), kur ne e shkallmuam okupatorin anadollak në çdo aspekt. Këtu pushon hipokrizia Juaj në çdo epokë, sikurse që pushoi më 1878-1912. Këtu jemi dhe do të mbijetojmë si stralli- thot Hasani në maj 1914 në Shkodër”. Pra, Lufta Ballkanike nuk ka qenë antiturke por antishqiptare, sepse tokat shqiptare janë okupuar nga malazezi, serbiani, greku e kush jo, se mbi një milion shqiptarë janë dëbuar me dhunë në Anadoll 1912-1914”. Këto fakte Hasani i shprehë jo për akuzë, por për mbrojtje, sepse trojet e okupuara duhet t’u kthehen shqiptarëve.

Të përfundojmë: Akademik Dibran Fylli me një gjuhë që kuptohet shumë lehtë, nga çdo kategori lexuesish, me një eksplikacion shtrues e plason Hasanin para lexuesve si një figurë që shkëlqen në çdo pëllëmbë të trojeve shqiptare, që mbjellë frikë në çdo zyre të krajlive, të fqinjëve dhe më gjerë, sepse ishte nga një trevë që kurrë nuk është dorëzuar para asnjë okupatori dhe atë edukatë e ka shpërndarë edhe te kombet tjera.

Në vend të përfundimit përmbyllës

Studimi i Akademik Dibran Fyllit, Hasan Prishtina stërnip i Abdullah Veliqit, mbështetet në një kompozicion funksional dhe eksplikativisht të ndër-tuar në çdo aspekt drejtë, sepse me lehtësi kuptohet, se Akademik Dibrani është mjeshtër i shtjellimit të veprave të mëdha, që kanë peshë specifike në rrjedhat e historisë. Ta fitosh këtë nivel të diturisë është punë shumë e vështirë, por që të plason para publikut lexues me faqe të bardhë. E kur t’i shtohet këtij konstatimi edhe stili aq narrativ dhe i lehtë historik, në vetën e parë njëjës, kuptimi i realitetit në studimin e Dibranit, është dyfish më edukativo-arsimor, më kultivues i kulturës, jo përmbi klasën dhe mbi njeriun, por për publikun dhe thjeshtësinë e njeriut kreativ dhe civilizues. E deri te ky nivel socio historik shkencor, autori ka ardhur duke përdorë dokumente (argumente), sepse historia pa argumente është si bari pa lagështi. E kur jemi te ky nivel i prezantimit lehtë është për ta gjetur argumentin (**Heuristika** si shkencë ndihmëse e

historisë, për mënyrën e zbulimit të fakteve-hb), por është vështirë për ta plasuar argumentin dhe atë rrafsh, si të plasuar nuk ka askush të drejtë të përshtatë, të shartojë, sepse kohës dhe individit, shoqërisë i sjellë dilema, i faturon faje, nëse e shtrembëron realitetin. E kur ke punë me Hasan Prishtinë, ke punë me zërin e **Kombit** dhe të **Zotit**.

Në lidhje me atë u tha më lartë, për Akademik Dibran Fyllin e kam një porosi miqësore. Ka plasuar në ribotimin e vitit 2017 tekstin Hasan Prishtina, “Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912”, botuar në Bari më 1925. Kështu si është botuar te hulumtuesi i ri ngritë dilema (!), sepse shumë pjesë kanë munguar. Aq më parë kur kemi të bëjmë me një personalitet si Hasan Prishtina që sot ka emër të dëlirë se është i përkryer e brilime tjera politike sikurse Frojdi në Psikoanalizë, nivele luftarake dhe kombëtare gati në nivel të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. I riu duhet të kuptojë se personalitetet e këtilla, i niveleve të këtilla, nuk është pa të meta, por atë që i ka thënë duhet respektuar dhe pastaj fillon rrahja e çështjeve a ka pasur të drejtë bie fjala të thotë për Isa Boletinin atë që e ka thënë, a ka pasur të drejtë ta thotë për Nexhip Dragën, atë që e ka thënë, apo jo, gjithnjë duke e krahasuar mendimin subjektiv të Hasanit me dokumentet e proveniencave tjera dokumentare. E kur jemi të qëndrimi ndaj Isa Boltetinit në Shkup, duhet peshohet me fakte akuza e Hasanit. Dokumentet tjera të kohës e nxjerrin jo vetëm Isën, por edhe ata që ishin pranë tij, se nuk kanë pasur synim “çlirimin e sulltanit në asnjë variant”, por kanë lëshuar një “kauzë” që është keqinterpretuar qoftë edhe nga Hasani famëlartë. E Vërteta, jo vetëm Isa, por aty ishin edhe ca intelektualë dhe diplomatë me famë botërore (shqiptar si doajenë të diplomacisë) dhe fjalinë: “*Po shkojmë për Selanik për ta çliruar Sulltan Abdylhamidin...*”, ishin vetëm një hudhje mjegulle për ta fshehur qëllimin e kryengritjes shqiptare në Vilajetin e Kosovës, që ia dridhi themelet Stambollit, por i frikësoi edhe të gjitha politikat koloniale ballkanike dhe evropiane se: “*shqiptarët do të avancohen në kombin-shtetin më të fuqishëm në Ballkan*”.

E, këtë e thanë: francezi dhe austriaku me rusin në Shkup, 26 gusht 1912. Ishte fjala pas çlirimit të Vilajetit të Kosovës, se Isa Boletini, mendonte se kryeqyteti i Kosovës u “çlirua”, ejani të kamuflohem i ta çlirojmë edhe Vilajetin e Manastirit, e pastaj ia mësyjmë Selanikut që synohej të integrohej në Shqipërinë etnike, si thuhej atëherë. Pra, kujtimet e Hasanit duhet të botohen si tërësi e duke i botuar duhet botohen në mënyrë kritike, duke sjellë po në ato faqe, referenca edhe dokumente të plota se në çfarë kontesti është thënë “*po shkojmë për Selanik...*”, pa e përmendur Manastirin, për çka do të ngriteshin kundërshtarë të tjerë bie fjala- bullgarë dhe grekë, që aspironin okupimin tinëzisht të tij, sepse aspiratat serbo franceze dhe ruso panësllave ishin zbuluar në tërësi shumë kohë më parë.

Ende nuk e kemi thënë atë që duhet. Posa u çlirua Shkupi, aty erdhën tre misionarë evropian: një rus, një austriak, dhe një francez. Është çudi se si Hasani këtë fakt nuk e përfillë kurrë, por e kritikon Isën me të cilin ngriti front më 1915 kundër Serbisë në vijën; Plavë-Guci-Tropojë-Kukës-Lumë-Dibër. (me komandantët Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri dhe Elez Isufi me kreshnikët e Dibrës).

Fronti dështoi jo me fajin e njërit prej këtyre, por me fajin e “punëdhënësit”- Vjenës, sepse filloi gjenerali **Trollman** të dyshojë se Shqiptarët nuk do ta përdorin armatimin që iu premtua në favorin e tyre, të ndërtojnë shtetin ashtu si projektonte Vjena, që Vlora t`i jipet Italisë dhe disa “Çoshe”, madje edhe Elbasani Bullgarsië, e kështu me radhë. Ja pra sa na ka pasur për qejfi Vjena, e cila po ashtu Hasanin me shokë kur i shkuan për kryeshëndosh me rastin e vdekjes Franc Jozefit (1917), të 34 prijësit shqiptar e ku ishte edhe Hasani, Vjena i ngujoi-izoloi deri sa mbaroi Konferenca e Versajit.

Tinëzi bizare e njëjtë me atë të burgosjes së Hasan Prishtinë, Nexhip Dragës, Idriz Seferit me shokë më 6 nëntor 1912 në Shkup dhe mbajtja e tyre deri më 1 prill 1913 në burgun e Kalemegdanit, atëherë kur Konferenca e Londrës kishte lëshuar verdikt se: “*Shqipëria pranohet si autonomi, por nën sovranitetin e Sulltanit*”.

Tjetër çështje është se konvertimet politike ngjanë më vonë, si do të ngjajnë edhe më 1919 në Versaje, ku edhe në rastin e parë (1913) edhe në rastin e dytë (1919 në Versaje) frika vdekjeprurëse, jo vetëm e fqinjëve por edhe atyre që nënshkruanin dhe vulosnin për çështje shqiptare, u vinte nga Hasan Prishtina. Mu për këtë, dhe jo vetëm për këtë, si është rasti i betimit se do të hapi shkolla shqipe, Hasani ishte dhe mbeti edhe kur e vranë mortajë për politikën grabitqarë ndaj tokave shqiptare.

Prandaj edhe njëqind monografi për Hasanin të shkruhen janë pak. Por shtatë sa janë sot janë edhe më pak, sepse ende nuk e dimë peshën që e ka ky personalitet për shqiptarë. Dhe nuk është e rastësishme kur Bac Adem Demaçi në pyetjen se: “*Kush është Hasan Prishtina si stërnip i Abdullah Veliqit, do të shpërthej pa dilema: Jam nxënësi i Hasan Prishtinës*”.

Për Akademik Dibran Fyllin është nderë dhe respekt që ka marrë guximin të shkruaj për këtë figurë madhështore kombëtare.

LITERATURA

- Prof. Dr. Muhamet Pirraku, "Gjenealogjia e Hasan Prishtinës",
- Prof. Dr. Skender Rizaj, "Shqiptarët dhe serbët në Kosovë", Prishtinë, 1991
- Ferdinand Schewill, "Ballkani-historia dhe qytetërimi", Eugen, Tiranë, 2002
- Prof. Dr. Skender Rizaj, "E drejta historike...",
- Prof. Dr. Hakif Bajrami, "Pse Hasan Prishtina më 28 nëntor 1912 nuk ishte në Kuvendin e Vlorës", "Dëshmi dhe Artikuji".
- Prof. Genc Sulçebes, "Fakte gjenetike që hedhin dritë mbi lashtësinë autoktone të popullit shqiptar".
- Dr. Luftulla Peza dhe M. Liljana Peza, "Pellazgët e shpikën shkrimin dhe alfabetin e parë në botë".
- Robert Elsie, "Historia e letërsisë shqiptare", Dukagjini, Pejë, 2001
- Agim Spahiu, "Kurpalët", Monografi, Tiranë, 2000
- Peter Bart, Shqipëria nga mesjeta deri sot, 1999 (*nga gjermanishtja Shkumbin Brestovci*)
- Dr. Anastas Dodi, "Shkronjëto e gjuhës shqipe", Sami Frashëri, Bukuresht, 1886 (botimi, 1988)
- Filip Sollers, "Ylli i të dashuarve", Tiranë, 2005
- Refik Ramiz Gërbeshi, "Familja e Gërbeshëve të Marecit", Prishtinë, 2012
- Dr.sc. Ilmi Veliu, "Kujtesa historike e Rasim Dan Çelikut",
- Ramadan Pllana, "Hasan Prishtina, ideologu kryesor i Shqipërisë etnike",
- Kujtim Nuro dhe Nezir Bato, "Hasan Prishtina-Përmbledhje dokumentesh 1908-1933", Tiranë, 1982
- Sh. Hoxha "Portrete e syzime atdhetarësh", Tiranë 2002,
- Shefqet Hoxha "Luma në luftërat për liri", Tiranë 2002, cit. Hasan Prishtina-dokumente, Tiranë 1983
- I. Strazimiri, "Kujtime 1910 - 1924", (AIH Dosja A - VII-94)
- Xh. Shala "Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918", Prishtinë 1990,
- Q. Mataj, "Hoxhë Mehmeti 1867-1927", Kukës 2002,
- Prof. Dr. Avzi Mustafa, "Figura mësuesish shqiptarë 1", BKSH. Tetovë 1995
- Gaqo Peci, "Arsimi Popullor" nr.2
- Instituti i Studimeve Pedagogjike, "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Vëllimi -I-, Tiranë, 2003
- Piro Tako, "Liugj Gurakuqi, Jeta dhe vepra", Tiranë, 1980
- Murat Gecaj, "Nëpër udhët e shkollës shqipe", Tiranë 1908
- Shukri Rahimi, "Kryengritjet shqiptare 1909-1912",
- Ajet Haxhiu, "Hasan Prishtina", Tiranë, 1960
- Bedri Tahiri, "Hasan Prishtina-Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1912-1933", Prishtinë, 2008

DOKUMENTE NGA ARKIVAT

- Dokumente, Arkivi i Gjenevës (1924/1927, *Origjinali gjermanisht*)
- Dokumente, Arkivi i Vjenës (1924/1927, *Origjinali gjermanisht*)
- Dokumente arkivore - AQSH i RPSH, F. 251, D. 9 f. 122. (*Origjinali frëngjisht*)

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit: Hasan Prishtina, Përmbledhje dokumentesh 1908-1934, Tiranë, 1983.
- Revista Shkencore “Vjetar” Nr. 45-46, 2011, A.SH i Arkivave të Kosovës
- Arkivi Shtetëror i Maqedonisë (23 shkurt 1931)
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit: Hasan Prishtina, Përmbledhje dokumentesh 1908-1934, Tiranë, 1983.
- Revista Shkencore “Vjetar” Nr. 45-46, 2011, A.SH i Arkivave të Kosovës
- Arkivi Shtetëror i Maqedonisë (23 shkurt 1931)


BURIMET E GAZETAVE

- Gazeta “L’Albanie”, Losanë-Zvicër, 19 janar 1919, (redaksia)
- Gazeta greke “Maqedonia e Re” (Μακεδονικά Νέα)
- Gazeta kroate “Slobodna riječ”, Turso pred raspadom, Nr.145
- Gazeta “To Fos” - Athinë, 18 gusht 1933, (redaksia)
- Gazeta kroate “Slobodna riječ”, Veliki dogagjaji na Ballkanu, Nr.170
- Gazeta “Spiros” - Janinë, 15 gusht 1933, (redaksia)
- Gazeta kroate “Obzor”, Ustanak u arnautluku, Nr.207
- Gazeta kroate “Hrvatska” Dogagjaji u Tursoj, Nr.223, (1.8.1912, f.1)
- Gazeta kroate “Obzor” Dogagjaji u Albaniji, Nr.214, (6.8.1912, f.3)
- Gazeta kroate “Obzor” Arnautska buna pri kraju, Nr.221, (13.8.1912, f.1)
- Gazeta kroate “Hrvarska” Raspust turske komore, Nr.222, (6.8.1912, f.1)
- Gazeta kroate “Slobodna riječ” U tursoj, Nr.184, (14.8.1912, f.2)
- Gazeta kroate “Slobodna riječ” Polozhaj u Tursoj, Nr.186, (16.8.1912, f.1)
- Gazeta kroate “Novosti” Arbanashki ustanak, Nr.174, (1.7.1912, f.1)

BURIMET TJERA

- Hakan Berisha, Kujtime për Zejnullah Begun, (shënime familjare, 1943-2013)
- Prof Arben Llalla, Si u vra Hasan Prishtina në Selanik,
- Gani Xhafolli, Shënime për Hasan Bej Prishtinën dhe Kurpalët, (1990-2013),
- Zeqir Rexhep Veliqi / Kujtimet e Plakut për Hasan beg Prishtinën
- Naim Halimi, Koha, Përse u vra Hasan Prishtina (!?)
- Mr. Kadri Rexha, Motoja jetësore e atdhetarit Hasan Prishtina...
- Avzi Mustafa, Studime dhe artikuj, UISHM, 2012
- Shukri Rahimi, Kryengritjet shqiptare 1909/1912,
- Halil Xani, Palaci dje, sot, nesër...
- Samedin Kukiqi, Kujtime për Habib Kukiqin (shënime familjare)
- Bilall Koci, Shënime për Palacin dhe ideologun e arsimit shqip
- Behram Feka, 95 vjeçar nga Koshtova, Kujtime për Jusuf Rexhën
- Zenel Ahmeti, Shënime historike për Hasan Prishtinën dhe shkollën e parë shqipe në Koshtovë të Bobit 1915 (kujtesë historike)
- Avdullah Koci, Shënime për shkollën e parë në Palac 1909
- Xhafer Koci, Varri i paraardhësit argument (kujtesë)
- Haxhi Salihu: Kujtesa historike për Hasan Prishtinën dhe Abetaren e parë...
- Vehbi Koci, Palaci vend antik (shënime personale)
- Nexhat Rexha, Kujtime për Jusuf Rexhën (shënime familjare)
- Behram Hoti e Xhavit Çitaku: “Rrini këtu në tokën tuaj”, Bujku, 26.8.1991

BIOGRAFIA E AUTORIT



Dibran Fylli

Dibran Fylli u lind në fshatin Açarevë, të Skënderajt. Shkollën fillore katërklasëshe e kreu në vendlindje, duke vazhduar në Ujmirë e Likofc, të mesmen në Mitrovicë ku vazhdoi Shkollën e Lartë Teknike deri para diplomimit. Nga Kosova ishte i detyruar të largohej dhe vendoset në Slloveni, në qytetin universitar të Lubjanës. Atje u regjistrua dhe kreu Akademinë për Teatër, Radio, Film dhe Televizion (AGRFT), drejtimi i regjisë. Në Kosovë kthehet për të vazhduar aktivitetet e tij në fushën e artit e të kulturës. Me përkushtim të madh punoi në Teatrin “Drenica” të Skënderajt, duke e realizuar filmin “Deri kur...?!” në dy pjesë, komedinë “Kalanica e Kadiut” dhe një varg krijimesh të tjera. Qysh në ditët e para, u radhit në radhët e UÇK-së. Është pjesëmarrës i shumë betejave. Beteja e Grykës së Llapushnikut, për të është më e veçanta, ku edhe plagoset.

Që nga rinia e tij merret me shkrime. Gjatë luftës ka botuar dy vepra në Tiranë, përmbledhjen me poezi “Të fala nga Stambolli” dhe argumente “Drenica dikur dhe sot”. Është themelues i TAU “Hamëz Jashari” të UÇK-së, i Manifestimit “Ai është i gjallë”, tash “Epopoja e UÇK-së” (5, 6 dhe 7 Marsi), i Festivalit folklorik “I këndojmë lirisë” në Klinë...

Ka të botuara veprat: “Ai është i gjallë”, “Sharkia e Drenicës”, “Ditari i Taftruk Taftrukut të Taftrukajve”, romanin “edhe kjo është pjesë e jetës”, “1365 Ditët e jolirisë”, “Prekazi brezni trimash” (në 7 gjuhë), “Tahir Mehapushkë lirie”(Kronologji), “Lulëkuqet e lirisë” Antologji, “Hasan Prishtina, stërnip i Abdullah Veliqit” monografi, “Fryma e lirisë”, “Penë e pushkë”, poezi, “Tokë e mbjellë me varre”-Krimet serbe në Kosovë 1998/1999, si dhe ka ribotuar veprat: “Sharkia e Drenicës”, “edhe kjo është pjesë e jetës”, roman, “Hasan Prishtina, stërnip i Abdullah Veliqit” dhe tani ribotimi i tretë me plotësime, i monografisë “Hasan Prishtina, stërnip i Abdullah Veliqit”.

Është autor i mbi 40 filmave dokumentarë e autor i shumë skenarëve dhe organizator i dhjetëra Akademive Përkujtimore e Solemne. Autor i mbi 200 fotografive dhe mbi 400 minutave xhirime ekskluzive gjatë kohës së luftës. Dhjetra role të realizuara në filma artistik. Skenarist e regjisor i filmit të metrazhit të shkurtër “Qyteti i Zi”, pjesëmarrës në tri Festivale Ndërkombëtare Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro Amerikane.

Thënie të pavdekshme.....	5
Në vend të prologut.....	6
Në vend të hyrjes.....	10

PALACI (PAL-LACI) HISTORIK I SHKURTËR

Emri, historiku, arkeologji.....	13
Antikë, monumente kulturore-fetare.....	14
Trojet e lashta.....	15
Legjendë.....	17
Arsimi dhe shkolla.....	18
Historia e drejtë del nga shpirtit i popullit.....	19
Për Hasan Prishtinën.....	20

HASAN PRISHTINA, STËRNIP I ABDULLAH VELIQIT

Sipas kujtesës historike.....	23
Hasan Prishtina-Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.....	26
Vigan i papërkulur.....	27
As toskë, as gegë, por shqiptar.....	28
Pse Hasan Prishtina nuk ishte në kuvendin e Vlorës?.....	29
Veprat e tij e bën të përjetshëm.....	38
Hasan Prishtina në faqet e historisë.....	41
Hasan Prishtina mik me trimat e Zajazit.....	35
Shtypi kroat për çështjen shqiptare dhe Ideologun.....	43
Hasan Prishtina, ideolog i çlirimit dhe i bashkimit kombëtar.....	52

E VËRTETA HISTORIKE

Historia nuk ndryshohet.....	55
Trungu familjar.....	56
Vizita në truallin e të parëve.....	58
Fundi i rrëfimit i Hakan Berisha-	63

HASAN PRISHTINA I MUNGON SHQIPTARISË

Kujtimet e plakut për Hasan Prishtinën.....	67
Lëvizja e patriotëve të kohës.....	70
Hasan Prishtina ka qenë i të gjithëve.....	71
Shaban Memish Koci, ushtar i Hasanit.....	72
Vepra e tij përputhet me jetën e tij.....	72
Abetaren e parë e solli Hasan Prishtina.....	73
Ata jetojnë në kujtesën e popullit.....	75
Argument varri i paraardhësit të Hasanit.....	75

Hasanin e ka njohur historia.....	76
Disa fakte.....	78

EDHE ËNDRRAT LIDHESHIN ME HASAN PRISHTINËN

Pak më ndryshe për Hasan Prishtinën.....	81
Kështu ndodhi.....	82
E pse? (tregim artistik).....	82
Edhe ëndrrat lidheshin me Hasan Prishtinën.....	83
Fakte historike.....	84
Kujtesë historike.....	85
Flitet e thuhet prilli i Kaçanikut.....	86

HASAN PRISHTINA JETON BASHKË ME HISTORINË

Si u vra Hasan Prishtina në Selanik.....	89
Gazetat e kohës për vrasjen e Hasan Prishtinës.....	91
Pasuria e Hasan Prishtinës në Selanik.....	92
Pse u vra Hasan Prishtina.....	93

HASAN PRISHTINA-IDEOLOGU I KOHËS

Këmbëngulja për alfabetin latin.....	97
Kombi shqiptar dhe armiqtë e tij.....	98
Hasan Prishtina-diplomat mendjendritur.....	103
Pjesë nga letra e Hasan Prishtinës (18 dhjetor 1918).....	104
Pajtimi i Hasan Prishtinës me Ahmet Zogun (1931).....	105
Hasan Prishtina dhe Lidhja e Kombeve.....	107
Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.....	108
Ushtar në mes të ushtarëve.....	109
Organizatori dhe udhëheqësi i kryengritjeve të armatosura.....	112
Largimi nga Durrësi.....	114

FAKTE HISTORIKE NGA ARKIVA GJENEVË-VJENË

Dokumenti Nr.39302, dt.26 shtator 1924 (frëngjisht).....	119
Dokumenti Nr.39302, dt.26 shtator 1924 (shqip).....	123
Dokumenti Nr.58664, dt.15 mars 1927 (gjermanisht).....	126
Dokumenti Nr.58664, dt. 15 mars 1927 (shqip).....	128
Dokumentacion nga burimet jugosllave (frëngjisht).....	130
Dokumentacion nga burimet jugosllave (shqip).....	131
Dokumentacion nga burimet jugosllave, viti 1924 (frëngjisht).....	132
Dokumentacion nga burimet jugosllave, viti 1924 (shqip).....	134
Dokumentacion nga burimet jugo., dt.23.12.1923 (frëngjisht).....	136

Dokumentacion nga burimet jugo., dt.23.12.1923 (shqip).....	138
Dokumentacion nga burimet shqiptare, (frëngjisht).....	140
Dokumentacion nga burimet shqiptare, (shqip).....	141
Dokumentacion nga burimet jugosllave, (frëngjisht).....	142
Dokumentacion nga burimet jugosllave, (shqip).....	146

Një SHKURTIM KUJTIMESH

Mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912.....	149
--	-----

SHTIGJEVE TË ARSIMIT

Hasan Prishtina simbol i arsimit kombëtar.....	189
Kontributi i Hasan Prishtinës për gjuhën e zyrtarizuar shqipe.....	193
Dy fakte për ideologun e arsimit.....	199
Hapja e shkollës shqipe në Vushtrri (1915).....	202
Viti 1915, Koshtovën e stolis me petkun e diturisë.....	208
Rrëfimi i parë.....	210
Rrëfimi i dytë.....	212
Rrëfimi i tretë.....	214
Për Hasan Prishtinën.....	216
58 vite pas rënies së Hasan Prishtinës.....	220

FOTOALBUM

Fotografi nga arkivi familjar i Hakan Berishës dhe fotografi tjera.....	221
---	-----

NË VEND TË EPILOGUT

Figura e ndritur e Hasan Prishtinës, pasthirrma e zëshme e kombit në mbijetesë, që sot kërkon dimensionet e reja të kohës që jetojmë.....	233
Ai që shkruan për Hasan Prishtinën dinë të drejtë kombin në rreshtimin e historisë sepse ka për studim një hero emblemantik.....	236
Literatura.....	245
Burimet e gazetave.....	246
Burimet tjera.....	246
Biografia e autorit.....	247



...edhe njëqind monografi për Hasanin të shkruhën janë pak. Por shtatë sa janë sot janë edhe më pak, sepse ende nuk e dimë peshën që e ka ky personalitet për shqiptarë...

Akademik Hakif Bajrami

Dibran Fylli
Hasan Prishtina,
stërnip i Abdullah Veliqit
(*Ribotimi III me plotësime*)

Botues
SHB "ProkultPress"
Prishtinë

Për botuesin
Fatmir Halimi

Formati: 24 cm.

Tirazhi: 500 copë

U shtyp në shtypshkronjën
"Officeprinty"
Prishtinë, 2020

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

94(=18)
929(496.51)Prishtina, Hasan

Fylli, Dibran

Hasan Prishtina, stërnip i Abdullah Veliqit / Dibran Fylli. -
(Ribotim). - Prishtinë : Prokult Press, 2020. - 252 f. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-793-06-3